



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

# RAPORT

i veprimtarisë vjetore  
të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

**RAPORT VJETOR 2016**

Përgatitur nga:  
Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Mbështetur në analizat vjetore të:  
Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike  
Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike

Nën drejtimin e:  
Akad. Vasil S. Tole

Redaktore:  
Brikena Liko

Kompjuterizimi  
Enkelejda Misha

Adresa:  
Akademia e Shkencave e Shqipërisë  
Sheshi Fan S. Noli, Tiranë  
Tel: 00355 4 2259657  
Tel/Fax: 00355 4 2227476

Tiranë, 2016

## PASQYRA E LËNDËS

• <b>Vështrim panoramik</b> .....	5
A. Sipas raportimit vjetor të SSHSHA .....	6
B. Sipas raportimit vjetor të SSHNT .....	9
<b>A. Bashkëpunimi me institucione kërkimore dhe mësimore</b> .....	11
A.I. Bashkëpunimi ndërkademiç .....	11
A.II. Bashkëpunimi me projekte (raportime të SSHNT) .....	15
<b>B. Fusha të reja kërkimore e studimore të propozuara</b> .....	17
B.I. Sipas raportimit vjetor të SSHNT .....	17
<b>C. Kontribute në projekte kombëtare e ndërkombëtare për nisma dhe përmirësime ligjore, drafte, këshillim e ekspertizë</b> .....	20
C.I. Sipas raportimit vjetor të SSHSHA .....	20
C.II. Sipas raportimit vjetor të SSHNT .....	21
<b>Ç. Botimet, paraqitje analitike</b> .....	22
Ç.I. Sipas raportimit vjetor të SSHSHA .....	22
Ç.II. Sipas raportimit vjetor të SSHNT .....	26
<b>D. Konferencat shkencore, paraqitje analitike</b> .....	27
D.I. Sipas raportimit vjetor të SSHSHA .....	27
D.II. Sipas raportimit vjetor të SSHNT .....	33
Veprimtari të tjera shkencore .....	37
<b>Dh. Organizim konkursesh dhe dhënie çmimesh</b> .....	38
• <b>Drejtime kryesore për veprimtarinë e vitit 2017</b> .....	39
A. Sipas raportimit vjetor të SSHSHA .....	39
B. Sipas raportimit vjetor të SSHNT .....	40
<b>Shtojcë I. Administrata dhe shërbimet</b> .....	42
I. Financa .....	42
II. Veprimtaria e bibliotekës shkencore të ASH-së dhe botimet kryesore .....	44
III. Burimet njerëzore .....	48
<b>Shtojcë II. Veprimtaritë shkencore vetjake të akademikëve, sipas seksioneve</b> .....	51
<b>I. Sipas raportimit të SSHSHA</b> .....	51
I.A. Projekte kombëtare e ndërkombëtare në kuadër të programeve të BE-së (FP6 dhe FP7 etj.) dhe të organizatave të tjera .....	51

I.B. Aplikime të reja për projekte në kuadër të programeve e organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë .....	51
I.C. Pjesëmarrje në konferenca shkencore .....	51
• Pjesëmarrje në konferenca jashtë vendit .....	52
• Pjesëmarrje dhe kontribute në konferenca brenda vendit .....	53
• Botime shkencore .....	55
• Artikuj të botuar në revista shkencore .....	55
- Jashtë vendit: .....	55
- Brenda vendit: .....	56
• Aktivitete të tjera .....	57
• Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor ....	58
<b>II. Sipas raportimit të SSHNT .....</b>	<b>59</b>
II.A. Konferenca, seminare dhe forume shkencore .....	59
II.B. Referime në konferenca shkencore .....	73
II.C. Projekte shkencore .....	78
• Projekte të Këshillit të Ministrave .....	78
• Projekte në kuadër të protokollit të bashkëpunimit shkencor dhe artistik midis ASH dhe ASHAK .....	80
• Projekte në kuadër të bashkëpunimit shkencor ASH dhe institucioneve shkencore të huaja .....	82
II.Ç. Propozime të reja .....	83
II.D. Pjesëmarrje e anëtarëve të SSHNT-së në projekte .....	87
II.DH. <i>Edukimi në shkencë</i> .....	90
II.E. Botimet .....	93
• Botimet periodike .....	93
• Libra dhe monografi .....	95
• Artikuj në revista shkencore .....	102
II.F. Veprimtari të tjera .....	109
• Veprimtari shkencore organizuese .....	109
II.G. Bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor .....	111
• Mësimdhënie .....	111
• Drejtim shkencor në shkallët master e doktoratë .....	113
II.GJ. Detyra të parashikuara për vitin 2017 .....	114

# RAPORT I VEPRIMTARISË VJETORE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË PËR VITIN 2016

## • Vështrim panoramik

Sikurse dhe në vitet e mëparshme, raportimi për veprimtarinë vjetore të ASH-së mbështetet në dy grupe të dhënash, që përfshijnë:

**I. Veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe koordinuese në kërkimin në fushën e shkencave humane dhe albanologjike me nismën, organizimin dhe pjesëmarrjen e ASH-së në mënyrë institucionale;**

**II. Arritjet shkencore të çdo akademiku më vete, që, në vështrimin tonë, pavarësisht se ku kryhen, janë të raportueshme edhe në këtë analizë për qëllim informimi brenda ASH-së dhe jashtë saj.**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASH) gjatë vitit 2016 ka bërë përpjekje për të rritur rolin e vet, duke marrë përgjegjësi e duke kryer detyra të parashikuara për të sipas Statutit të saj. ASH-ja vitin e shkuar humbi dy prej anëtarëve të tij më me përvojë, me autoritet shkencor brenda dhe jashtë vendit dhe me krijimtari të frytshme, **akad. Alfred Uçin** dhe **akad. Arben Puton**. Një anëtar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSHSHA), për shkak të moshës, ndërpreu veprimtarinë aktive me të. Këto mungesa kanë pasur ndikimin e vet në pamjen e përgjithshme të veprimtarisë së tij.

Po gjatë këtij viti ASH-së iu shtua një anëtar i ri i jashtëm, **prof. dr. Matteo Mandalà**, një bashkëpunëtor i hershëm i ASH-së, i njohur për veprimtarinë e tij të frytshme si albanolog në gjithë bashkësinë e studiuesve të kësaj fushe.

ASH-ja vlerëson si arritje krijimin e një mjedisi të dobishëm debati shkencor dhe kolegial për çështje të kuptimit të përgjegjësive të veta funksionale dhe për rolin dhe detyrat e ASH-së në tërësi. Gjatë vitit 2017 ajo krijoi kushte më të mira që alternativat për një rregullim të ri juridik të statusit të ASH-së dhe të institucioneve kërkimore shkencore jashtë universiteteve të trajtohen brenda tij. Gjithashtu është respektuar debati shkencor në masmedia e multimedia.

Shqetësimi themelor i ASH-së edhe për vitin 2016 ishte gjendja e pezullt juridike, ecja e ngadaltë e procesit të reformimit, luhatjet dhe paqartësitë e shumta të institucioneve ligjvënëse në lidhje me një ligj të ri për shkencën. Lidhur me këtë ASH-ja ka shprehur shqetësimin se rezultati parapërfundimtar i reformës sipas komisionit të ngritur nga Qeveria pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Sporteve (MAS), i sintetizuar në tri variante, sërish rrezikon autonominë institucionale dhe pavarësinë e veprimtarisë akademike. Gjendja e krijuar pas miratimit të *Ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në universitete* krijoi paqartësi për institucionet që kishin lidhje me ligjin e mëparshëm, duke përfshirë ASH-në dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike (më tej: QSA). Mungesa e një perspektive të qartë për të ardhmen institucionale, kuptimi i reformës thjesht si zgjidhje administrative, përgjithësisht një sjellje nënçmuese ndaj ASH-së, kanë ndikuar për demotivimin e kërkimit dhe për ato pasoja të pashmangshme që sjell ideja e përkohshmërisë. Sa i takon kuptimit të reformës në shkencë, asambleja e ASH ka luajtur rolin e saj dhe rol vetjak kanë luajtur anëtarët e SSHSHA-së, **akad. Artan Fuga** dhe

**akad. Beqir Meta.** Ndërsa përgjegjësia për përfaqësimin institucional të pikëpamjes së SSHSHA-së është përballuar nga **akad. Muzafer Korkuti**, anëtar i komisionit për reformën. Konsiderojmë një mospasë të SSHSHA-së që, duke refuzuar në mënyrë kritike konceptin e paraqitur nga komisioni, nuk ka arritur ende të propozojë një amendament të vetin, që mund të përbente një referencë parësore për një debat më konstruktiv. Nga anëtarë të seksionit dhe nga kryetarja është propozuar në Asambleshën e Akademisë që të krijohet një grup pune për të hartuar një projekt mbi strukturën e reformës që përfshin Akademinë, por ky propozim nuk u miratua në Asamble. Gjithsesi, mendojmë se ky mbetet prioriteti themelor i angazhimit të SSHSHA-së.

**A. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE DHE ALBANOLOGJIKE** (më tej: **SSHSHA**), sipas raportit të analizës vjetore, ka kryer detyrat e veta edhe në aspekte të tjera, që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e tij, si propozimi i akteve nënligjore dhe ligjore për rregullimin kushtetues të përdorimit të gjuhës shqipe, mbrojtja e të drejtave të autorit në fushën e kërkimit shkencor dhe në disa drejtime të tjera.

Me rëndësi është të përmendet se gjatë këtij viti pati nisma nga anëtarë të SSHSHA-së për të organizuar forume shkencore me rezultate të shprehura në formën e rekomandimeve për mirëqeverisje, siç mund të veçojmë forumin e organizuar nga **akad. Kosta Barjaba**: “Karta e Gjelbër - rimodelimi i zhvillimit ekonomik në kontekstet lokale”.

SSHSHA-ja, në punën e vet gjatë vitit 2016, është përqendruar në: **1.** Organizim veprimtarish kërkimore-shkencore kombëtare e ndërkombëtare; **2.** Botime cilësore në fushat themelore që mbulon; **3.** Koordinim ndërinstitutional për veprimtari shkencore me palë të treta brenda dhe jashtë vendit; **4.** Debat për të ardhmen e kërkimit shkencor jashtë universiteteve; **5.** Hapje ndaj institucioneve me mundësi bashkëpunimi dhe veçmas ndaj studiuesve të rinj.

Në rolin e vet si koordinator, SSHSHA-ja ka mundur përfaqësim të studiuesve shqiptarë në veprimtari jashtë vendit, që kishin lidhje me Shqipërinë. Disa bashkëpunëtorë të saj kanë marrë pjesë në konferenca shkencore jashtë vendit (në Mal të Zi, Bullgari, Maqedoni, Poloni, Kinë etj.).

Sa i takon bashkëpunimit ndërakademik, përparësi e përhershme mbetet edhe për vitin 2016 puna dhe nismat e përbashkëta me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (më tej: ASHAK), sipas protokollit të nënshkruar dhe jashtë këtij protokollit, në përputhje me dinamikat vjetore.

Shqetësim i SSHSHA-së mbetet fakti që gjatë vitit të kaluar Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe (më tej: KNGJSH), jo për ndonjë përgjegjësi të tij, megjithëse ekziston vullneti i mirë për të marrë përgjegjësi në lidhje me çështjen e shqipes së shkruar, tashmë si gjuhë zyrtare ose pjesërisht zyrtare në tri shtete, nuk ka ndonjë gjurmë të dukshme. Duke qenë se këtë vit do të përkujtohet 45-vjetori i mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit (1972), është me vend që Kryesia e ASH-së, në marrëveshje me Kryesinë e ASHAK-ut, të nxisë veprimtarinë e KNGJSH-së, duke bërë dhe ndryshime në përbërjen e tij, nëse është e nevojshme. SSHSHA-ja u përfaqësua në mbledhjen e Asambleshës vjetore të ALLEA-s dhe përfundimet e rekomandimet e kësaj mbledhjeje i janë paraqitur për njohje e veprim Kryesisë së ASH-së.

SSHSHA-ja gjatë vitit 2016 ka negociuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes letërkëmbimit me shumicën e institucioneve akademike të rajonit dhe jashtë tij për organizimin e dy veprimtarive të rëndësishme për vitet 2017–2018: *250-vjetori i lulëzimit të Voskopojës* (2017) dhe *550-vjetori i vdekjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut* (2018). Veprimtari shkencore ndërakademike janë duke u përgatitur edhe për projekte të tjera (shih në vijim).

Me qëllim që ky raport të jetë sa më informues për anëtarët e SSHSHA-së, u jemi drejtuar atyre me ftesën që të njoftojnë rezultatet e punës së tyre akademike jashtë projekteve dhe veprimtarive të ASH-së. Ne i falënderojmë ata që i janë përgjigjur kësaj ftese dhe na vjen keq për shpërpjesëtimet që mund të vërehen sa i takon përbërëses së dytë të raportit, të të dhënave të ofruara nga vetë anëtarët. Kjo ka lidhje me mosofrimin e këtyre të dhënave punonjësve të SSHSHA-së ngarkuar me këtë detyrë që në fillim të vitit.

SSHSHA-ja gjatë vitit 2016 ka propozuar, ideuar, organizuar e përfunduar disa veprimtari shkencore me karakter kombëtar e ndërkombëtar, si dhe botime e projekte të rëndësishme nga fusha të ndryshme të dijeve shoqërore dhe në shkencat e albanologjisë.

a. Ka vazhduar puna mbi projekte të rëndësishme të kërkimit shkencor në fushë të historisë, gjuhësisë, studimeve letrare, sociologjisë, ekonomisë, drejtësisë etj., disa prej të cilave kanë përfunduar dhe janë finalizuar me botime monografish e veprash të rëndësishme përgjithësuere.

b. Ndonëse jo rregullisht, puna e KNGJSH-së, që vepron prej kohësh si organizëm i përbashkët bashkëpunimi me ASHAK-un nuk është ndërprerë. Por nuk ka pasur ndonjë gjë të rëndësishme për t'u shenjuar si arritje. Gjendja e pezullt e KNGJSH-së mbetet një shqetësim për SSHSHA-në dhe për ASH-në (ndonëse, në mënyrë të çuditshme SSHSHA-ja është konsideruar, nga Kryesia, jashtë këtij aksioni të rëndësishëm për gjuhën shqipe).

c. Viti 2016 ka qenë viti i organizimit të disa konferencave, kombëtare e ndërkombëtare, si dhe i disa veprimtarive solemne kushtuar ngjarjeve dhe personaliteteve të shquara të shkencave albanologjike, si:

1. Konferenca shkencore ndërkombëtare **“Shekulli i Kadaresë”**, organizuar në bashkëpunim me ASHAK-un, bashkinë e Gjirokastrës dhe universitetin “Eqrem Çabej”. Studiues, përkthyes, kritikë dhe akademikë nga Shqipëria e Kosova, si dhe të ftuar të shumtë nga Italia, Franca, Bullgaria, Polonia, Rumania, Rusia, Gjermania e Australia, gjatë dy ditëve theksuan kontributin që ka dhënë shkrimtari Ismail Kadare nëpërmjet veprave të tij letrare, jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij. Për herë të parë në kryeqytetin tonë u mblodhën dhe këmbyen përvojat e tyre kadareologë nga gjithë kontinentet (shih në vijim).

2. Konferenca jubilarë në nderim të shkrimtarit dhe akademikut Dritëro Agolli. Kjo veprimtari, sa akademike, aq edhe njerëzore, e quajtur **“Dritëro!”**, shërbeu si rast për të rivlerësuar veprën e këtij personaliteti në jubileun e 85-vjetorit të lindjes së tij (shih në vijim).

3. Me rastin e përkujtimit të 1000-vjetorit të Shën Gjon Vladimirit, ASH-ja, në partneritet me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi (më tej: ASHAMZ), me Akademinë e Shkencave të Bullgarisë (më tej: ASHB), me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (më tej: ASHAM) u organizua konferenca **“1000-vjet Shën Gjon Vladimiri”** (21-22 tetor 2016), një ditë në Podgoricë e një ditë në Tiranë (shih në vijim).

4. Në bashkëpunim me ASHAK-un dhe në përputhje me protokollin e përbashkët, u organizua në Prishtinë konferenca **“Ndre Mjeda – në 150-vjetorin e lindjes”** (shih në vijim), me një pjesëmarrje të vlerësueshme nga SSHSHA-ja.

5. Në bashkëpunim me ASHAK-un, sipas protokollit të bashkëpunimit, u organizua në Tiranë veprimtaria dypjesëshe **“Tribunë muzikologjike”**, kushtuar krijimtarisë së kompozitorit dhe akademikut nga Kosova Zeqirja Ballata (shih në vijim).

6. U organizua konferenca shkencore **“100-vjet nga vetëqeverimi i Korçës”**, në bashkëpunim me universitetin “Fan S. Noli” dhe QSA-në, me mbështetjen e këshillit të qarkut të Korçës (shih në vijim).

7. U organizua konferenca **“Tish Daija në 90-vjetorin e lindjes (1926-2003)”**, *tribunë muzikologjike* kushtuar jetës dhe veprës së kompozitorit dhe akademikut Tish Daija (shih në vijim).



8. Në bashkëpunim me Institutin Albanologjik të Prishtinës (më tej: IAP) u organizua konferenca jubilarë “Adem Demaçi dhe letërsitë shqipe”, me rastin e 80-vjetorit të lindjes së shkrimtarit Adem Demaçi (shih në vijim).

9. Dy studiuës të SSHSHA-së morën pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare “The Balkan Jews & the Minority Issue in South-Eastern Europe”, organizuar nga AIESEE, Poloni (shih në vijim).

10. Nën drejtimin e akad. asoc. Kosta Barjaba u zhvillua forumi publik: “Karta e Gjelbër – rimodelimi i zhvillimit ekonomik në kontekstet lokale”, që u finalizua me botimin e paraqitjeve shkencore (shih në vijim).

11. Me rastin e pranimit si anëtar të jashtëm të prof. dr. Matteo Mandalà-së, sipas traditës së viteve të fundit, u organizua auditoriumi shkencor “Vepra e Ismail Kadaresë në kontekstin e letërsisë moderne europiane”, ligjëratë përuruese dhe akademike (shih në vijim).

12. SSHSHA-ja është përfaqësuar nga kontribuues me kumtesa dhe artikuj për botim në disa ngjarje shkencore kombëtare e ndërkombëtare si konferencat: “Esad Mekuli, në 100-vjetorin e lindjes” (Prishtinë); “Studia kadareiana albanica et humanitatis” (në bashkëpunim me Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë) etj.

13. Janë bërë disa paraqitje të botimeve shkencore nga fusha e historisë, arkeologjisë, ekonomisë etj., të anëtarëve të ASH-së dhe të bashkëpunëtorëve të saj, në mjediset e ASH-së, të ASHAK-ut, në panairë të librit etj. (shih në vijim).

14. Në bashkëpunim me shërbimin e marrëdhënieve me jashtë, SSHSHA-ja ka synuar të mbajë dhe të fuqizojë lidhjet bashkëpunuese me seksionet përkatëse të institucioneve akademike të rajonit (Kosovë, Maqedoni, Bullgari, Mali i Zi).

Në pasqyrën e mëposhtme jepen në trajtë statistikash të dhëna për punën e SSHSHA-së në drejtimet kryesore të realizuara gjatë vitit 2016.

Nr.	Emërtime të veprimtarive	Brenda vendit	Jashtë vendit
1.	Projekte shkencore	4	
2.	Konferenca shkencore, simpoziume etj.	7	3
3.	Botime, monografi	9	1
4.	Kumtesa në konferenca shkencore	21	21
5.	Referime akademike, përurime botimesh	8	
6.	Artikuj e studime në revista shkencore	12	14
7.	Pjesëmarrje në borde botimesh dhe komisione organizimi konferencash shkencore	13	4
8.	Mësimdhënie universitare	15 (lëndë)	3 (lëndë)
9.	Veprimtari në shërbim të shoqërisë	5	



## **B. SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE** (më tej: SSHNT)

gjatë vitit 2016 në përmbushje të misionit të tij, ka synuar realizimin e veprimtarive në disa drejtime kryesore. Përcaktimi i përparësive të zhvillimit shkencor në vend, që përkoi edhe me vitin e Shkencës – 2016 (Year of Science 2016), vazhdon të jetë objektivi kryesor i veprimtarive të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike të ASH-së. Përparësitë janë orientuar në përputhje me programet e zhvillimit shkencor, nevojat dhe mundësitë aktuale të vendit, bazuar në strategjitë që kanë lidhje direkte dhe indirekte me kërkimin shkencor dhe janë në harmoni me programet e bashkëpunimit rajonal e më gjerë europian; Strategjinë Rajonale për Kërkimin dhe Inovacionin në vendet e Ballkanit Perëndimor; programet bilaterale të nënshkuara me vendet e rajonit (Itali, Greqi, Turqi, Slloveni dhe Maqedoni), si dhe programet e BE-së (p.sh. Horizon 2020 etj.), kur bëhet fjalë për të marrë pjesë në projekte shkencore konkurruese me cilësi të lartë.

Në zbatim të misionit të Akademisë së Shkencave, SSHNT-ja, për vitin 2016 ka zhvilluar veprimtari, të cilat kanë shënuar kontribute në dobi të prioritetëve të zhvillimit të vendit. Përparësi të veçanta i janë dhënë zhvillimit të veprimtarive që lidhen me problematika e kërkime në fushat e ujërave, të pyjeve, të shkencave të tokës, të zbatimit të teknologjive të reja e inovative në vend, në zbatimet inxhinierike, të emergjencave civile, të shëndetësisë, të energjisë, të teknologjive të informimit dhe komunikimit, të mjedisit, të biodiversitetit, të bioteknologjive dhe biosigurisë e ushqimit, të etnobotanikës, të nanoteknologjisë, të biosferës dhe njeriut etj. Gjithashtu, u është kushtuar vëmendje edhe mundësive për kontribute në disiplinat e tjera shkencore, si në trashëgiminë kulturore, në mënyrë që edhe ato të zhvillohen duke u mbështetur me teknologji të kohës. Prioritet ka qenë edhe rritja e rolit në zhvillimin e ndërsjellë Akademi–universitet–biznes, publik dhe privat, në zhvillimin e biznesit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) e më gjerë; vënia e produkteve shkencore për kërkim e zhvillim në shërbim të politikëbërësve e vendimmarrësve, shoqërisë civile dhe biznesit.

Është synuar edhe forcimi i kapaciteteve të Seksionit për të qenë të aftë për këshillim të qeverisjes dhe shoqërisë civile, si një domosdoshmëri për zhvillimin e vendit, në përputhje edhe me përparësitë e InterPanelit të Akademive të Botës (IAP). Arritje e Seksionit është përgatitja e projektit të fizibilitetit për projektpropozimin për Këshillin e Ministrave “Mbi gjendjen dhe masat që propozohen për mënjanimin e ndikimit të veprimtarisë antropogjene në Liqenin e Prespës së Vogël”.

Në planin ndërkombëtar, ka qenë në vazhdimësi përparësia e bashkëpunimit të anëtarëve të Seksionit me homologët në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e mbarë komunitetin shkencor në Kosovë, me synimin për të kontribuar që veprimtaritë e tyre të jenë të harmonizuara e pararendëse me programet madhore të Qeverisë së Shqipërisë me atë të Kosovës. Në qendër të projekteve të përbashkëta ndërmjet dy akademive kanë qenë zgjidhjet shkencore të problemeve shqetësuese të pemëtarisë në Shqipëri dhe Kosovë, si dhe përdorimi i teknologjive bashkëkohore në mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht të zonave të mbrojtura ndërkufitare. Gjithashtu kontributi i anëtarëve të Seksionit ka synuar në forcimin e bashkëpunimit me akademi dhe organizata të tjera ndërkombëtare, me institucionet homologe e më gjerë, të cilat zhvillojnë veprimtari në të njëjtat fusha, si me akademitë e rajonit, me Rrjetin e Akademive të Botës (ALLEA), me Rrjetin e Akademive të Europës, InterPanelin e Akademive (IAP), Rrjetin e Akademive të Vendeve të Botës së Tretë (TWAS), si dhe me organizmat shkencorë CNR-Itali, ato të Kombeve të Bashkuara etj.

Anëtarët e SSHNT-së kanë marrë pjesë në 69 konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, me paraqitjen e studimeve të tyre me tematika shkencore për kërkim e zhvillim në fusha të ndryshme. Studimet e prezantuara kanë synuar në kërkimet e aplikuara në fusha

prioritare; ndërsa ato të realizuara nga anëtarët e Seksionit, rezidentë jashtë vendit, janë bërë të njohura për komunitetin shkencor në Shqipëri nëpërmjet tavolinave të rumbullakëta, ditëve informative etj. me pjesëmarrje të gjerë të kërkuesve e veçanërisht atyre të rinj. Si të gjitha akademitë e botës, ASH-ja ka dhënë kontributin e saj në drejtim të: arritjeve të Millenium Development Goals (MDG) dhe pjesëmarrjes efektive në partneritetin global për zhvillim; ndihmesës për krijimin e qendrave të ekselencës në disiplinat përparësore, si: bujqësia, qendrat e studimeve detare e të peshkimit, nanobioteknologjia etj. në drejtimet që janë përparësore për vendin. Inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet shkencëtarëve në institucionet brenda dhe jashtë vendit është një nga drejtimet me të cilat parashikohet që të sigurohet një mbështetje edhe më e madhe nga anëtarët e Akademisë jashtë vendit. ASH-ja ka bërë përpjekje të konsiderueshme në vazhdimësi, në drejtim të pjesëmarrjes në programet e BE-së ose në programe të tjera me karakter kërkimor, ku ajo përfaqësohet si koordinatorë, partnere ose që jep kontribut në nivel ekspertësh. Vlen të theksohet nisma e akademik Arben Merkoçit dhe mbështetja nga ana e Seksionit për pjesëmarrjen në projekte të Komisionit Europian “Horizon 2020” për ngritjen e Qendrës së Ekselencës për Nanoteknologjinë dhe Biosensorët në Shqipëri.

Me përparësi ka qenë edhe inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet shkencëtarëve të diasporës, shkencëtarëve të rinj nga institucionet brenda dhe jashtë vendit, me anë të përfshirjes nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, si: *workshop*-e, forume shkencore, projekte etj. Gjithashtu, akademikët e SSHNT-së kanë drejtuar dhe kanë marrë pjesë në realizimin e disa projekteve ndërkombëtare në fusha të ndryshme të teknologjisë së informacionit, energjisë në përgjithësi e asaj të rinovueshme në veçanti, transportit, edukimit, rasteve emergjente dhe problematikave që lidhen me to etj.

Në kuadër të programit “Edukimi në shkencë” për masivizimin e shkencës janë realizuar veprimtari të rëndësishme: përrurime të veprave shkencore (kombëtare e ndërkombëtare); nderim për figura të shquara të shkencës shqiptare; “Ditë informimi” e “Ditë të hapura” të institucioneve shkencore, mbështetje të shkencëtarëve të rinj në institucione shkencore elitare ndërkombëtare. Nxitja e të rinjve në shkencë është në fokusin e përparësive të Seksionit. Tërheqja e brezit të ri për karrierë në shkencë ka demonstruar përmirësimin e imazhit të Seksionit në drejtim të efektivitetit të punës së tij. Është koha e përshtatshme për zgjedhjen, mbështetjen e vlerësimin e pjesës më të mirë të kërkimit shkencor. Në këtë kuadër iu dorëzua medalja “Nderi i Akademisë”, prof. dr. Mira Mezinit, që konsiderohet si një nga ekspertet më të mira në lëmin e shkencave kompjuterike në Gjermani. Një mënyrë tjetër efektive për përhapjen e dijeve me qëllim kontributin në kërkimin shkencor, atë universitar, në politikëbërjen e vendimarrjen e deri në veprimtaritë prodhuese e biznesin në përgjithësi, është edhe fusha e botimeve shkencore: librat e monografitë, botimet e revistave periodike të seksionit, si dhe 109 artikujt shkencorë në revistat kombëtare e ndërkombëtare, që janë instrumente për efektivitetin dhe dëshmojnë për rritjen e rolit të ASH-së në zhvillimin e vendit.

Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike ka realizuar organizimin e 7 veprimtarive të mëdha shkencore (konferenca, simpoziume etj.), 5 veprimtari të mëdha ndërkombëtare, ku seksioni ka paraqitur rezultate shkencore të rëndësishme; botimin e 11 librave dhe monografive (9 brenda dhe 2 jashtë vendit), si dhe dy revistave shkencore periodike ndërkombëtare: “Journal of Natural and Technical Sciences – JNTS” (ASH; 2 vëllime/vit) dhe “Journal of Agriculture of Animal Production Sciences for the Rural Development – JAAPSR” (botim i përbashkët i fondacionit “Shkencë, Teknologji, Shërbim Këshillimor për Zhvillimin e Fermës” – BLELAL dhe ASH; 2 vëllime/vit). Gjithashtu, ka realizuar edhe 5 veprimtari të tjera shkencore në kuadër të programit “Edukimi në Shkencë” që synon

masivizimin e shkencës, si përrurime të veprave shkencore, vlerësime të veprimtarive shkencore bazë e të aplikuara të figurave të shquara të shkencës shqiptare; promovimin dhe mbështetjen e shkencëtarëve të rinj në bashkëpunim me akademi të huaja dhe organizma të tjerë ndërkademi. Vlen të theksohet rritja e vazhdueshme e progresive e pjesëmarrjes së studentëve në veprimtaritë e organizuara nga SSHNT-ja.

SSHNT-ja përbëhet nga 14 anëtarë që mbajnë titullin “Akademik”, 6 anëtarë me titullin “Akademik i asociuar” dhe 1 anëtar me titullin “Akademik i përhershëm”. Anëtarët e Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike kanë marrë pjesë në 69 konferenca shkencore (brenda dhe jashtë vendit); kanë botuar 109 artikuj shkencorë në revista shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare; dhe kanë punuar në 22 projekte shkencore, nga të cilat 20 ndërkombëtare. Në pasqyrën e mëposhtme jepen të dhëna për drejtimet kryesore të realizuara gjatë vitit 2016 nga anëtarët e SSHNT-së.

Nr.	Emërtime të veprimtarive	Brenda vendit	Jashtë vendit
1.	Projekte shkencore	6 <sup>1</sup>	20 <sup>2</sup>
2.	Konferenca shkencore, simpoziume etj.	8	5
3.	Botime, monografi	9 + 2 revista	2
4.	Kumtesa në konferenca shkencore	16	53
5.	Referime akademike, përrurime botimesh	5	
6.	Artikuj e studime në revista shkencore	12	97
7.	Pjesëmarrje në borde botimesh dhe komisione organizimi konferencash shkencore / komisione vlerësimi	22	22
8.	Mësimdhënie universitare	24 (lëndë)	9 (lëndë)

## A. Bashkëpunimi me institucione kërkimore dhe mësimore<sup>3</sup>

### A. I. Bashkëpunimi ndërkademi<sup>4</sup>

#### Me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Marrëdhëniet mes dy akademive kanë vijuar në bazë të planifikimit në *Protokollin* mes dy institucioneve. Janë promovuar dhe vlerësuar personalitete të shquara të letrave shqipe me pjesëmarrjen dhe kontributet e akademikëve të të dyja institucioneve (Adem Demaçi, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Ndre Mjeda, Esad Mekuli). Hapësira të konsiderueshme bashkëpunimi me ASHAK-un në kuadër të platformave rajonale, europiane, brenda *Procesit të Berlinit* dhe *Horizon 2020*.

<sup>1</sup> Dy nga projektet janë individuale të anëtarëve të SSHNT-së.

<sup>2</sup> Projekte individuale të anëtarëve të SSHNT-së

<sup>3</sup> Raportimi sipas ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, neni 4, *funkcionet*, pika a: *Bashkëpunon me institucione kërkimore dhe mësimore, brenda dhe jashtë vendit, që kanë kapacitetet e nevojshme fizike për kërkim, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës.*

<sup>4</sup> Sipas raportimit të shërbimit të marrëdhënieve me jashtë.

### **Me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (ASHAM)**

U realizua një takim mes një përfaqësie të ASH-së kryesuar nga kryetari, akad. Muzafer Korkuti, dhe drejtuesve të rinj të ASHAM-it: me kryetarin akad. Taki Fiti, dhe nënkryetarin akad. Luan Starova. U shpreh gatishmëri për të avancuar në përfshirjen e përbashkët si në projekte dypalëshe edhe në bashkëpunime në projektet europiane. Angazhim i përbashkët u përcaktua për organizimin e disa aktiviteteve shkencore si *përkujtimi i 1100-vjetorit të Shën Klementit të Ohrit* (Ohër, gusht 2016), *përkujtimi i 550-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut* (Tiranë, 2018), *përkujtimi i 250-vjetorit të Lulëzimit të Akademisë së Voskopojës* (vjeshtë 2017). Në nëntor 2016, ASHAM-i, në bashkëpunim me ASH-në dhe ASHB-në, organizuan një konferencë ndërkombëtare shkencore për tolerancën me pjesëmarrje dhe paraqitje kumtesash nga studiues të tri vendeve.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë botoi studimin monografik të akad. Kristo Frashërit *Istorijska na albanskata civilizacija: od prastari vremenja do krajot na Vtorata svetska vojna / Historia e civilizimit shqiptar: që nga kohët prehistorike deri në fundin e Luftës së Parë Botërore*, përkthim maqedonisht i znj. Gzime Starova. Me këtë rast lexuesit maqedonas iu dha një mundësi të njihet me tipologjinë dhe rrugën historike të zhvillimit të etnosit dhe qytetërimit shqiptar ndryshe prej mënyrës së paraqitjes në *Enciklopedinë e Maqedonisë*, për të cilën pati shumë debate shkencore dhe akademike.

### **Me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi (ASHAMZ)**

Ndër veprimtaritë e përbashkëta të dy akademive, më e rëndësishmja për 2016 ishte konferenca shkencore organizuar me rastin e 1000-vjetorit të Shën Vladimirit: me një sesion shkencor në Podgoricë dhe një program vizitash shkencore një ditë më pas në Shqipëri. Në këtë sesion morën pjesë me kumtesa 6 studiues shqiptarë. Kumtesat janë në proces botimi. Bazuar në shprehjen e vullnetit dhe angazhimit të përbashkët për intensifikimin e lidhjeve, u diskutua më konkretisht me propozime konkrete, për të cilat të dyja akademitë kanë interesa specifike. Dy përparësitë themelore që u përcaktuan janë: **1.** Një botim shkencor-filologjik i Kodikut të Manastirit të Shën Gjon Vladimirit, që ruhet në AQSH; **2.** Një ekspeditë e përbashkët arkeologjike shqiptaro-malazeze në qytetin antik-mesjetar të Shasit pranë Ulqinit. Këto projekte do të marrin miratim përfundimtar gjatë një vizite të pritshme të kryetarit të ASHAMZ-it në Tiranë.

### **Me Akademinë Bullgare të Shkencave (ASHB)**

Viti 2016 njohu formalizimin e projektit të miratuar mes dy institucioneve. Por zbatimi do të fillojë më 2017. Projekti parashikon shkëmbimin e përvojave relevante lidhur me procesin e integritit europian, bazuar në kontribute kërkimi, studimi dhe vlerësimi të eksperiencave dhe praktikave pozitive. Fokusi kryesor është në sferat si ndërtimi dhe forcimi i institucioneve, aspekte thelbësore të modelit politik dhe politikave ekonomike në funksion të procesit dhe synimit të integritit në BE. Projekti parashikon angazhimin e studiuesve të të dyja palëve në disa tema specifike, dhe shkëmbime mes tyre në aktivitete planifikuar të organizohen në Sofje dhe në Tiranë.

### **Me Akademinë Turke të Shkencave (TUBA)**

Akademia Turke e Shkencave (TUBA) ka vijuar traditën duke organizuar seminarin dhe takimin vjetor shkencor në biologji molekulare. Gjatë vitit 2016 takimi u zhvillua në Antalia, më 19–21 maj, me temën *Terapitë biologjike-qelizore innovative në mjekësi dhe hematologji*. ASH-ja realizoi koordinimin e punës me institucione arsimore universitare dhe mundësoi pjesëmarrjen e 4 studiuesve.

### **Me Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup (ITSHKSH)**

Në 13 prill 2016 ASH-ja nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me ITSHKSH-në, një institut

shkencor publik me qendër në Shkup. Mbështetja nga ASH-ja do të jetë një hap që ndihmon konsolidimin e zhvillimin e institutit.

#### **Me Institutin e Historisë "Ali Hadri", Prishtinë**

Në tetor 2016 titullarët e dy institucioneve: akad. Muzafer Korkuti dhe prof. asoc. dr. Sabit Syla nënshkruan marrëveshjen për bashkëpunim e shkëmbime në sferën e studimeve albanologjike. Marrëveshja inkurajon bashkëpunim dhe shkëmbime mes studiuesve, për të bërë më efektive potencialet në secilin institucion dhe për të nxitur standarde rigoroze në kërkim.

#### **Angazhimi në rrjetet shkencore ndërkombëtare**

**Procesi i Berlinit.** Në kuadër të Procesit për Ballkanin Perëndimor më 22–24 maj 2016 u mbajt në Vjenë konferenca e 2-të e përbashkët shkencore. Si çështje me interes imediat u parashtruan: **1.** impakti i Deklaratës së Berlinit (2015); **2.** artikulimi i standardeve dhe parakushteve thelbësore (zotimi i qeverive për të rritur në 3 për qind të GDP-së buxhetin për kërkimin shkencor); **3.** krijimi i një ndërfaqeje të përshtatshme për dialogun me partnerë politikë; **4.** ndërtimi i një procesi të angazhimit reciprok të shkencës dhe politikës së shkencës.

Në lidhje me peshën e buxhetit për shkencën në GDP Shqipëria ka disa raportime: **a.** Deri në 2012 nga burime të huaja është raportuar 0.2 deri 0.24 për qind. Për vitet e fundit është dhënë një shifër buxhetore 0.18 për qind, por në një forum zyrtar të AKTI-t, është raportuar shifra 0.11 për qind e GDP-së. Ndërsa në *Progresraportin për integrimin europian* figuron një shifër shumë më e lartë, por megjithatë në diferencë shumë të madhe, si me standardin europian.

Procesi i nisur në Berlin për Ballkanin Perëndimor do të ndërtojë një ndërfaqe të përshtatshme me palët e interesit në politikë që janë relevante në këtë proces. Në Ballkanin Perëndimor nuk ka pasur mbështetje të mjaftueshme publike për shkencën. Në vendet e BP-së nuk janë marrë masa strukturale dhe institucionale për të zhvilluar ekspertizën dhe atësitë për kërkim shkencor, përveç atyre që ofrohen në kuadër të përgatitjes për studimet doktorale. Nuk është e mundur të gjenden zgjidhje brenda kuadrit të një vendi vetëm, dhe këtu shkenca po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Nga organizatorët u parashtrua se Berlioni ishte një moment i një procesi kompleks që ka filluar të lëvizë. Ky proces nuk është i lehtë, por ka filluar të ndërtohet një dialog, një komunikim në këtë kuadër. Përfaqësuesit e akademive gjermane dhe austriake parashtruan se ata kanë një kontratë me qeveritë e tyre dhe janë angazhuar për ecjen përpara të këtij procesi, dhe se është instaluar një dialog me qeveritë e vendeve të BP-së e pritet së shpejti të ketë reagim nga ana e këtyre qeverive. U theksua që diskutimet në këtë konferencë të shpërndahen, të trajtohen dhe të negociohen me qeveritë përkatëse të këtyre vendeve, si dhe me palët e interesit, institucionet kërkimore. Një rekomandim që u dha për përfaqësuesit e shkencës nga vendet e BP-së ishte që Brukseli nuk është i prirë t'u kushtojë vëmendje propozimeve me një palë, përparësi kanë projektet në të cilat palët do të vijnë të bashkuara.

#### **Me AIESEE-në**

AIESEE-ja organizoi konferencën vjetore më 8 nëntor 2016 në Varshavë. Institucioni organizator ishte komisioni polak i AIESEE-së dhe bashkëpunëtorët e tij. Tema ishte *Hebrenjtë e Ballkanit dhe çështja e minoriteteve në Europën Juglindore*. Nga ASH-ja u paraqitën me kumtesa akad. Floresha Dado dhe prof. dr. Shaban Sinani. Materialet do të botohen te *Colloquia Balkanica*. Komiteti shqiptar i AIESEE-së funksionon pranë ASH-së dhe ka nevojë për dinamizim.

#### **Me ALLEA-n**

Në 18–19 prill 2016 në Vjenë zhvilloi punimet Asambleja e Përgjithshme e ALLEA-s, ku



u organizua edhe një simpozium shkencor mbi një çështje specifike. Për 2016, ALLEA planifikoi diskutimin mbi temën *Liria e kërkimit shkencor*. Prezantimet në tekst të plotë paraqiten në faqen *online* të ALLEA-s. Në mars 2015 u nënshkrua një memorandum mirëkuptimi dhe në shtator 2015 rrjetet shkencore europiane: ALLEA, EASAC (rrjeti european në kuadër të IAP-it), Euro-Case, European Academia, FEAM realizuan një takim me Parlamentin e BE-së. Komisioni European ka krijuar lidhje të ngushta me ALLEA-n. Në një deklaratë të posaçme të KE-së, u përcaktua që kërkimi shkencor që kryhet në BE duhet të bazohet në parime që i përmban kodi i ALLEA-s për etikën e kërkimit, dhe ky kod u bë faktikisht dokumenti bazë për këtë qëllim. ALLEA ka komunikim me institucionet përkatëse për përcaktimin e drejtimeve në programet e rëndësishme shkencore, sidomos *Horizon 2020*. ALLEA është angazhuar në disa drejtime prioritare: këshillimi shkencor për politikën, edukimi shkencor, të drejtat e pronësisë intelektuale, diplomacia shkencore, liria e kërkimit.

#### **Me SAM-in dhe SAPEA-n**

KE-ja ka riformatuar natyrën e këshillimit shkencor në nivelet politikëbërëse. U krijua SAM - *The Scientific Advice Mechanism (Mekanizmi i Këshillimit Shkencor)*. Në kuadër projekteve të *Horizon 2020*, një konsorcium i ALLEA-s dhe katër partnerëve të tjerë (Academia Europaea, ALLEA, EASAC, Euro-CASE, FEAM), iniciuan projektin SAPEA (*Science Advice for Policy by European Academies*), që synon sigurimin e një këshillimi shkencor objektiv, të pavarur dhe bazuar në ekspertizën kërkimore nga më se 100 akademi europiane, për nivelin më të lartë politikëbërës në Europë. Komisioni European ka zgjedhur të përfshijë akademitë në SAM, për të marrë rekomandime bazuar në të dhëna për formulimin e politikave të veta. Ky këshillim me karakter transnacional mund të ndihmojë akademitë në rolet e tyre kombëtare që të japin këshillim për politikat.

#### **Me IAP-in**

Në Hermanus të Afrikës së Jugut u mbajt konferenca ndërkombëtare shkencore me temë *Këshillimi shkencor dhe mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit Botëror të Akademive të Shkencave (InterAcademy Partnership, IAP)*. Në këtë konferencë mori pjesë i ftuar akad. Salvatore Bushati. Duke analizuar aktivitetin trevjeçar të IAP-it rezultoi se akademitë e shkencave të vendeve të ndryshme kanë luajtur vazhdimisht rolin e sintetizimit të rezultateve shkencore më të fundit dhe kanë dhënë këshilla të besueshme të pavarura dhe vlerësime për politikëbërësit. Por akademitë nuk janë burimi i vetëm i këshillimit shkencor për qeveritë, gjithashtu dhe komitetet e ekspertëve dhe mekanizma të tjerë janë përdorur gjerësisht në vende të ndryshme. Mekanizma të tillë u shqyrtuan gjatë konferencës së IAP-it nga një sërë ekspertësh të përfshirë në ofrimin e këshillimit shkencor nëpërmjet një seri sesionesh interaktive si: *Këshillimi shkencor për ekosistemin, Ndërveprimi mes këshillimit shkencor, politikës dhe mediave*. Në fokus më të veçantë qenë *këshillimi shkencor në kohën e fatkeqësive / urgjencave dhe Këshillimi shkencor në arenën ndërkombëtare me një fokus të veçantë në biologjinë sintetike*. ASH-ja ekspozoi publikime dhe abstrakte nga veprimtaritë e kërkimit shkencor të zhvilluara në kuadër të programit të edukimit në shkencë, të shkencës në diplomaci, të pasurive ujore, të rreziqeve natyrore dhe urgjencave civile, të shëndetit, të biodiversitetit, të bioteknologjisë si dhe të studimeve të tjera që kontribuojnë në realizimin e strategjive të ndryshme kombëtare si ajo e kërkimit për zhvillimin teknologjik dhe inovativ etj. dhe këshillimit të politikëbërjes për zhvillimin në përgjithësi të vendit. Stenda e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u vizitua masivisht dhe publikimet e saj u vlerësuan pozitivisht nga pjesëmarrësit në konferencë, si produkte shkencore me ndikim kombëtar dhe më gjerë në përputhje me politikat e IAP-it.

## A. II. Bashkëpunimi me projekte (raportime të SSHNT)

**1. Projekti i fizibilitetit për projektpropozimin për Këshillin e Ministrave “Mbi gjendjen dhe masat që propozohen për mënjanimin e ndikimit të veprimtarisë antropogjene në Liqenin e Prespës së Vogël”.** Kryeministri Edi Rama ka urdhëruar ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e këtij raporti studimor të fizibilitetit, ku marrin pjesë përfaqësues nga disa ministri, agjenci kombëtare, institucione shkencore, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit dhe Akademia e Shkencave (akad. S. Bushati dhe prof. dr. N. Pano). Studimi i fizibilitetit është mbështetur në botimet shkencore, një sërë artikujsh e punimesh që trajtonin të gjitha problematikat e Liqenit të Prespës e ato që lidhen me to, të paraqitur nga Akademia e Shkencave; Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës; Agjencia e Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Shërbimi Gjeologjik Shqiptar; etj. dhe janë marrë në konsideratë dhe materialet e sjella nga Grupi i Ekspertëve të depozituara në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU). Bazuar në studimin e fizibilitetit do të zhvillohet projekti, që do të drejtohet nga MBZHRAU dhe do të zbatohet nga Agjencia e Zhvillimit Rajonal nr. 3 e rrethit të Korçës, pasi mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Menazhimit të Integruar të Burimeve Ujore, duhet të harmonizohet me Autoritetet e Baseneve Ujore edhe me Autoritetin e Komisionit të Ujërave Ndërkufitare.

### **2. Projekte në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës:**

**2.1. Hartimi i monografisë “Prodhimi cilësor i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve”, koordinatorë e projektit akad. asoc. E. Kongjika, (ASHSH, SSHNT); akad. L. Susuri (ASHAK, SSHN), në kuadër të këtij Protokollit 2015–2017** (pika 12: promovime veprash të rëndësishme shkencore dhe artistike të akademive, produksioni vjetor). Monografia me autorë kryesorë **akad. asoc. E. Kongjika, prof. dr. A. Zajmi, prof. as. dr. A. Myrta dhe akad. L. Susuri**, është hartuar nga një grup më i madh autorësh (22 autorë). Në hartimin e veprës kanë dhënë kontributin e tyre specialistët më me përvojë në fusha të ndryshme të pemëtarisë, të mbrojtjes së bimëve, të certifikimit, të biologjisë molekulare, bioteknologjisë, të njohjes së legjislacionit europian e të vendit për prodhimin e fidanëve etj. si në Shqipëri (SSHNT, UT, UBT, QTTB, Vlorë), Kosovë (ASHAK, SSHN dhe Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë) dhe kompania “Certis”, Belgjikë. Vepra do të jetë një kontribut konkret në duart e specialistëve në Shqipëri e Kosovë për ngritjen e një sistemi të përbashkët të certifikimit në prodhimin e materialit bimor të kategorisë “bazë”.

**2.2. Projekt pilot “Studimi i ndryshimeve mjedisore në një segment të zonës ndërkufitare Shqipëri–Kosovë”,** në kuadër të Protokollit (pika 6: përdorimi i teknologjive të reja në studimin e problemeve të mjedisit). Koordinator i projektit për ASHSH-në është akademik G. Beqiraj, zëvendëskryetar i ASHSH-së, kurse anëtarë të grupit shkencor janë: akademikët S. Bushati dhe N. Frashëri, si dhe akad. asoc. E. Kongjika. Për realizimin e projektit aktivizohen dhe ekspertë të jashtëm si prof. dr. Alfred Mullaj, florist, përgjegjës i Qendrës Kërkimore të Florës dhe Faunës në Fakultetin e Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës, prof. dr. Kujtim Onuzi, president i Shoqatës së Studimeve Malore dhe dr. Arben Pambuku, drejtor i Drejtorisë së Politikave Ujore, MBZHRAU. Studimi synon eksperimentimin pilot të kësaj metodologjie në vlerësimin e gjendjes mjedisore në një segment të zonave të mbrojtura në brezin ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Kosovës. Propozohet si zonë studimi ekosistemi natyror malor Korab – Koritnik.



### **3. Projekte në kuadër të bashkëpunimit shkencor midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe institucioneve shkencore të huaja**

**3.1.** Projekt i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike për **ngritjen e një observatori magnetik në Shqipëri** (koordinator akad. S. Bushati) në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Gjeofizikës dhe Vullkanologjisë, Romë, Itali (koordinator dr. Massimo Chiappini) me mbështetje të bashkisë së Tiranës. Në sajë të një bashkëpunimi prej vitesh të Akademisë së Shkencave, institucioneve shkencore shqiptare në fushën e shkencave të tokës, si Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe institucioneve universitare me Institutin Kombëtar të Gjeofizikës dhe Vullkanologjisë, Romë, Itali (Istituto Nazionale di Geofisica e Vulcanologia INGV), do të ngrihet një observator magnetik në Shqipëri, i pari i këtij lloji në vend. Të dhënat e përftuara nga observatori do të japin kontribut në kërkimet shkencore me vlera teorike e praktike, rreth fenomeneve të fushës magnetike, por gjithashtu për kontribute në monitorimin *meteorologjik hapësinor*, emergjencat e mjedisin. Të dhënat e përftuara do t'u vihen në dispozicion institucioneve qeveritare dhe shkencore, të cilat merren me observimet e tokës, si Agjencisë së Sigurimit të Informacionit të Gjeoshkencave (ASIGJ) etj.

Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike ka bashkëpunuar me shumë institucione shkencore dhe mësimore në vend dhe jashtë tij, si dhe me dikastere në vend për organizimin e një sërë veprimtarish shkencore, si:

#### **4. Konferenca, *workshop*-e, takime shkencore, forume etj.**

**4.1. Forumi shkencor “Mbi pasuritë e trashëgimisë kulturore dhe ato ujore”, nën këndvështrimin e botimit “Dibra e Madhe dhe Radika”** me autorë msc. T. Jegeni, prof. dr. M. Kolaneci dhe dr. S. Shatku, organizuar nga SSHNT-ja në bashkëpunim me shoqatën “Bashkësia Dibrane”, me përfaqësues të komunave të Dibrës së Madhe, të shoqatave mjedisore, si dhe me kërkues shkencorë të Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujërave dhe Mjedisit, Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, të ish-Institutit të Studimit dhe Projektimit të Veprave Kullim-Ujitje. Forumi u ndoq nga specialistë të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të Ministrisë së Energjisë dhe Ekonomisë, Sekretariatit Teknik të Ujërave, nga shoqëria civile e nga palë të interesit.

**4.2. Workshop “ALBANO 2016, Nanotechnology and Biosensors - Impact in health, environment, safety and security of Albania”**, organizuar nga Universiteti i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti Mjekësor i Tiranës dhe Instituti Katalan i Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë (ICN2), me mbështetjen e Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Ministrisë së Mjedisit, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Ambasadës së Spanjës në Tiranë.

**4.3. Takimi rajonal i Ballkanit “Terra Madre Balkans” dhe konferenca shkencore ndërkombëtare “Putting farmers first”**, kjo e fundit e organizuar nga SSHNT-ja dhe UBT-ja me përfaqësues nga fusha akademike e kërkues të rinj nga rajoni. Nëpërmjet mendimeve, ideve apo studimeve kërkimore, pjesëmarrësit dhanë ndihmesën e tyre duke marrë parasysh standardet e integritit në BE në çështjet e bujqësisë shumëfunktionale, të drejtat ligjore të prodhuesve të vegjël, të drejtësisë sociale, turizmit rural, marketingut të produkteve artizanale etj.

**4.3. Simpoziumi XII ndërkombëtar “Biodiversiteti dhe zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm”** u zhvillua si bashkëpunim i Akademisë së Shkencave, fondacionit “BLEKALB”, Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministrisë së Mjedisit, Universitetit Bujqësor, Universitetit Polis, universitetit “Hasan Prishtina”, Prishtinë, Kosovë, Universitetit Shtetëror të Tetovës, Maqedoni.

**4.4. Konferenca VII ndërkombëtare “Information Systems and Technology Innovations: the New Paradigm for a Smarter Economy”** u mbështet dhe u bashkorganizua nga SSHNT-ja me departamentin e statistikave dhe informatikës së aplikuar të Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës dhe me Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë të Kosovës.

**4.5. *Workshop*-i “Alpet, një pasuri madhështore monumentale e natyrës”** u mbështet dhe u bashkorganizua nga SSHNT-ja me Ambasadën e Austrisë, ku bashkësitë e studiuesve të Alpeve Austriake dhe atyre Shqiptare shpalosën eksperiencat e tyre dhe perspektivat për të ardhmen.

**4.6. Konferenca ndërkombëtare “Frutikultura alternative”** u organizua nga QTTB, Vlorë, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe u mbështet fuqimisht nga Qendra e Kërkimit të Frutikulturës, Romë, Itali, nga kompania private “Apice Piante”, Pescara, Itali, nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, si dhe nga Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike i ASH-së.

**4.7. Konferenca kombëtare “Siguria e digave dhe menazhimi i tyre”,** organizuar nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujërave, mbështetur nga SSHNT-ja (ASHSH).

**4.8.** Të gjitha veprimtaritë në kuadër të **programit “Edukimi në Shkencë”** janë organizuar nga SSHNT-ja në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës (Fakulteti i Shkencave Natyrore), me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, Shoqatën e Gjeofizikantëve etj.

**4.9.** Edhe **projektpropozimet** që ka hartuar SSHNT-ja janë hartuar në bashkëpunim me shumë institucione shkencore dhe mësimore në vend dhe jashtë tij, si dhe me agjenci të ndryshme, me dikastere etj.

## **B. Fusha të reja kërkimore e studimore të propozuara<sup>5</sup>**

### **B.1. Sipas raportimit vjetor të SSHNT**

SSHNT gjatë vitit 2016 ka punuar intensivisht për përgatitjen e propozimit për projektin e ri **ALBNANO (ALBAnianCentre of NANObiotechnology and Biosensors)** në kuadër të programit “Horizon 2020” të Komisionit Europian. Ky projektpropozim hap një fushë të re kërkimore bashkëkohore në Shqipëri, që do të rrisë jo vetëm nivelin e kërkimit shkencor në vend, por edhe do të ketë ndikim në ekonomi, në mbrojtjen e mjedisit dhe në shëndetin e njeriut. Një projekt i tillë bazohet në detyrat që rrjedhin nga Strategjia Shqiptare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin (2009–2015) dhe draftstrategjia për 2016–2020, që theksojnë se ndërkombëtarizimi dhe integrimi në zonën europiane të kërkimit (European Research Area) mund të realizohet vetëm nëpërmjet përmirësimit dhe forcimit të kapaciteteve lokale të kërkimit shkencor. Në këto strategji specifikisht i jepet prioritet ngritjes së 4-5 qendrave të ekselencës për kërkimin shkencor në Shqipëri. Përpjekjet e Qeverisë janë mbështetje për krijimin e qendrave të reja të ekselencës dhe SSHNT-ja synon që **ALBNANO të jetë qendra e parë e këtij lloji**. ALBNANO propozon një ekip nga komuniteti i kërkimit bio- dhe nanoteknologji në Shqipëri në bashkëpunim me Institutin Katalan të Nanoshkencave dhe Nanoteknologjisë ([www.icn2.cat](http://www.icn2.cat)) në Barcelonë për të krijuar Qendrën Shqiptare të Nanobioteknologjisë dhe Biosensorëve - ALBNANO në Shqipëri. Vizioni për ALBNANO-n e bën Qendrën të gjenerojë njohuri në kërkime bazë përmes zhvillimit dhe inovacionit për

<sup>5</sup> Raportimi sipas ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, neni 4, funksionet, pika **b**: *Propozon fusha të reja kërkimore e studimore, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit*. Nuk ka raportime nga SSSHHA.

aplikime reale dhe për shfrytëzimin e njohurive të krijuara përmes arsimimit dhe transferimit të teknologjive dhe veprimtarive të biznesit. Qeveria shqiptare ka vendosur të mbështesë projektin për impaktin social-ekonomik të projektit. Projekti bazohet në krijimin e një sipërmarrjeje të përbashkët afatgjatë midis pjesëmarrësve si ministritë shqiptare (arsim dhe sporte / inovacion), universitetet shqiptare (Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti Mjekësor i Tiranës), dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për pjesën shqiptare, dhe nga ana tjetër një partner i ekselencës institucionale, shkencore, teknologjike dhe inovative, Fundació Institut Català de Nanociència i Nanotecnologia (ICN2). Zgjedhja e fokusit të projektit ALBNANO bazohet në disa faktorë kryesorë:

- rëndësia e bujqësisë, shëndetit dhe mjedisit në ekonominë shqiptare;
- potenciali i nanobioteknologjive dhe biosensorëve për të pasur ndikim në këta sektorë, dhe në një numër sfidash sociale të H2020;
- gjerësia dhe fushëveprimi i veprimtarive kërkimore ekzistuese dhe të planifikuara, të lidhura me këto fusha;
- rëndësia e kërkimit shkencor i nanobioteknologjisë dhe biosensorëve të ICN2-shit dhe
- bashkëpunimi ekzistues shqiptar me ICN2 nëpërmjet akad. Arben Merkoçi, lider grupi për nanobioelektronikën dhe biosensorët. Misioni i ALBNANO-s do të jetë realizimi i aktiviteteve dhe përfitimi i njohurive në një qendër të ekselencës në nivel kombëtar, në nivel më të gjerë të Ballkanit dhe në shkallë ndërkombëtare. Në periudhën fillestare 12-mujore do të zhvillohet edhe plani i detajuar i biznesit. Projekti ALBNANO ofron mundësinë e lidhjes së ekspertizës më të mirë në Shqipëri në fusha të ndryshme që sigurojnë sukses, si dhe shërbejnë si model të një qendre të ekselencës për fusha të tjera specifike. Në terma afatgjatë pas 7 vitesh, misioni i ALBNANO-s do të jetë të arrijë ekselencën shkencore dhe teknologjike në nivel ndërkombëtar në nanobioteknologji dhe për biosensorët, për të lehtësuar integrimin dhe inovacionin në këto teknologji nga industria shqiptare që të adresojë sfidat sociale dhe për të siguruar trajnimin më të lartë dhe zhvillimin e karrierës për kërkuesit e rinj, duke krijuar një pol për tërheqjen dhe mbajtjen e talenteve të reja lokale dhe ndërkombëtare në Qendrën e Ekselencës.

**Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASH) me përfaqësues akad. Salvatore Bushati, akad. asoc. Efigjeni Kongjika dhe akad. asoc. Afërdita Veveçka** do të përfshihet në strategjinë dhe komunikimin e ALBNANO-s në kontekstin edhe të Inicativës së Investimeve të Infrastrukturës të K&Zh për të cilën vendi ka planifikuar të investojë në një numër fushash kërkimi, duke përfshirë nanoshkencën dhe nanomaterialet e reja – një fushë e interesimit formal të vendit dhe rajonit. Përveç kësaj, ASH-ja duke qenë me status ligjor si institucioni më i lartë shkencor, autonom në veprimtaritë e saj dhe e aftë për të krijuar grupe shkencore shumëdisiplinore bazuar në marrëveshje të ASH-së me universitete shqiptare, do të kontribuojë në fushat e kërkimit të lidhura me teknologjitë e nanoplatformave/nanobiosensorëve të përdorura në bioteknologji në përgjithësi dhe në veçanti për sigurinë ushqimore dhe biosigurinë. ASH-ja ka fituar përvojë në krijimin e një vizioni bashkëkohor për stimulimin e kërkimit shkencor në Shqipëri. Akad. S. Bushati ka marrë pjesë në përpilimin e Strategjive Shqiptare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, ku përfshihet prioriteti për ngritjen e Qendrës së Ekselencës ALBNANO. Gjithashtu akad. Asoc. A. Veveçka ka drejtuar projekte me objekt nanomaterialet, kurse akad. Asoc. E. Kongjika ka përvojë në shumë projekte shkencore, ku nevojitet përdorimi i nanomaterialeve për efektivitet të lartë të metodave bioteknologjike. Roli i ASH-së në këtë projekt përqendrohet në implementimin e disa paketave të punës si partner në menazhimin e cilësisë dhe të rrezikut, në

propagandimin dhe publikimet sensibilizuese rreth projektit. Parashikohet të krijohet një bazë të dhënash e përfituesve nga projekti dhe raporti final do të përfshijë përfundimet për veprimtaritë si dhe do të japë rekomandime të vlefshme. I rëndësishëm konsiderohet edhe roli në ndërgjegjësimin e komunitetit industrial, ku vlerësohet organizimi i sesioneve specifike dialoguese me NMV-të, që do të përfshihen në një bazë të dhënash. Gjithashtu ASH-ja ka detyrë të përcaktojë programin e kërkimit në terma të afateve të gjata për kërkim fundamental dhe të aplikuar për të identifikuar tematikat e reja të kërkimit për të ardhmen e Qendrës së Ekselencës në bazë edhe të përvojës së vlefshme të ICN2-shit.

**Projekt Pilot “Studimi i ndryshimeve mjedisore në një segment të zonës ndërkufitare Shqipëri-Kosovë”,** në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit Shkencor e Artistik ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (2015–2017), (pika 6: përdorimi i teknologjive të reja në studimin e problemeve të mjedisit) përfaqëson një drejtim të ri në kërkimin shkencor në Shqipëri, që do të realizohet në bashkëpunim me kërkues homologë në Kosovë. Imazhet satelitore janë bërë sot një mjet tepër i fuqishëm për studimin e problemeve mjedisore. Në planin teknik, imazhet e sateliteve si “Landsat” dhe “MODIS” japin pamje të sipërfaqes së tokës në bandat e dritës blu, e gjelbër, e kuqe dhe më tej një seri në brezin tejet të kuqe, kombinimi i të cilave mundëson jo vetëm pamjen natyrale të truallit, por edhe vlerësimin e situatave mjedisore si indeksi i bimësisë, temperatura e tokës, përbërja gjeologjike, lagështia, ndotja e ajrit etj. Një pjesë e imazheve që paraqesin këta parametra jepen nga agjencitë përkatëse në internet. Përdorimi i imazheve satelitore lehtëson identifikimin e zonave të dëmtuara dhe atyre me interes ekonomik, dhe duke zvogëluar koston e studimeve të stërzgjatura në terren. Studimi synon eksperimentimin pilot të kësaj metodologjie në vlerësimin e gjendjes mjedisore në një segment të zonave të mbrojtura në brezin ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Kosovës. Propozohet si zonë studimi ekosistemi natyror malor Korab – Koritnik. Koordinator i projektit për ASH-në është akad. G. Beqiraj, zëvendëskryetar i ASH-së, kurse anëtarë të grupit shkencor janë: akademikët S. Bushati dhe N. Frashëri, si dhe akad. asoc. E. Kongjika. Për realizimin e projektit aktivizohen dhe ekspertë të jashtëm si prof. dr. Alfred Mullaj, florist, përgjegjës i Qendrës Kërkimore të Florës dhe Faunës në Fakultetin e Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës etj.

Nga seksioni është përgatitur projekti me titull **“Young Researchers Forum is a key factor in sustainable development of Albania and West Balkan Countries”**, projekt që synon të krijojë Forumin e Kërkuesve të Rinj (FKR), një strukturë e re institucionale e përgatitur në kuadër të strategjisë së IAP-it. Shumica e akademive të shkencave e kanë krijuar FKR-në, por jo në Shqipëri. Projekti është përgatitur nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASH), akad. S. Bushati me partnerë Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK), akad. I. Krasniqi, Sekretar Shkencor; Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (ASHAM), akad. V. Matevski, zëvendëspresident në projektet e InterAcademy Partnership, Itali. Hulumtuesit duke nxitur krijimin e FKR-së, mund të marrin pjesë në zhvillimin ndërkombëtar të politikave të shkencës, të koordinojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e tyre me kolegët përtej kufijve; synimet e mëtejshme janë për krijimin e mundësive të përfshirjes së FKR-së me **Rrjetin e Akademive të Kërkuesve të Rinj** duke komunikuar në një rrjet virtual. Synohet që të rinjtë në shkencë të jenë pararojë të lëvizjeve ndërkombëtare të shkencëtarëve të rinj dhe të formojnë një zë të fuqishëm për të ndikuar në zhvillimet globale për një kërkim shkencor më efektiv, nëpërmjet lidhjes më të mirë, masave të përmirësuar të arritjeve dhe cilësisë së lartë të arsimimit shkencor. Aktualisht, ka një mungesë të bashkëpunimit të kërkuesve të rinj, si në vendin tonë ashtu dhe ndërmjet vendeve të rajonit e me studiuesit e diasporës, që është një problem shumë i rëndësishëm dhe që mbetet objektivi i seksionit.



Projekti synon të rrisë kapacitetet njerëzore dhe bashkëpunimin e hulumtuesve të rinj, jo vetëm brenda secilit vend, por edhe në rajon si dhe në Zonën Europiane të Kërkimit. Pritshmëritë e projektit do të kenë ndikim në:

- rritjen e nivelit shkencor të studiuesve duke përdorur transferimin e *know-how* të studiuesve nga diaspora në Shqipëri e më gjerë në rajon;
- zgjerimin e mundësive të kërkuesve për punë;
- rëndësinë e rolit që do të luajnë kërkuesit e rinj në procesin e menazhimit të kapaciteteve shkencore, të vendimmarrjes në Shqipëri e në vendet e rajonit tonë, si dhe në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet tyre edhe nëpërmjet përdorimit të rrjetit dhe portalit të kërkuesve të rinj.

## C. Kontribute në projekte kombëtare e ndërkombëtare për nisma dhe përmirësime ligjore, drafte, këshillim e ekspertizë<sup>6</sup>

### C. I. Sipas raportimit të SSHSHA-së:

**1. Projekti legjislativ për reformën në drejtësi.** Në lidhje me këtë projekt **akad. asoc. Aurela Anastasi** ka luajtur rol të rëndësishëm si eksperte e nivelit të lartë në kuadrin e *reformës në drejtësi*; bashkëkryetare e nëngrupit të arsimit juridik dhe edukimit ligjor të *reformës në drejtësi*; eksperte e nivelit të lartë në grupin e punës për *reformën kushtetuese*. Projekti përmban: hartimin e projektit të amendamenteve kushtetuese për reformën në drejtësi; hartimin e projektligjeve në kuadër të reformës në drejtësi: **a.** *Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve*; **b.** *Për provimin e shtetit për juristët*; **c.** *Për strategjinë për edukimin ligjor të publikut*. Këtyre u shtohet referimi në tri tryeza këshillimore për njohjen e publikut me projektligjet e mësipërme. Ky projekt është zhvilluar në janar–shtator 2016.

**2. Projekti legjislativ për reformën në shkencë.** Për këtë projekt është ngritur një komision ndërinstytucional, që funksionon pranë MAS-it. ASH-ja është përfaqësuar në këtë komision nga kryetari i saj **akad. Muzafer Korkuti**. SSHSHA-ja ka paraqitur pikëpamjet e veta në formën e një përkujtese pas diskutimit të rezultatit përfundimtar të shprehur në tri zgjidhjet e mundshme.

### 3. Forumi publik *“Karta e Gjellbër – rimodelimi i zhvillimit ekonomik në kontekstet lokale”*,

<sup>6</sup> Raportimi sipas ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, neni 4, *funksionet*, pika **c**: *U ofron institucioneve të larta shtetërore këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme për zhvillimin e vendit*.

<sup>7</sup> Korrelacioni midis rritjes ekonomike dhe zhvillimit ekonomik e social, *përkthimi* i rritjes ekonomike në mirëqenie dhe progres, ndikimi i saj në zhvillimin e qëndrueshëm, korrelacioni mes stabilitetit financiar dhe bankar etj.;

- Rritja e prodhimit të brendshëm nga prodhimi dhe jo nga konsumi, siç ka qenë modeli dominues i deritanishëm;
- Zgjerimi i lirisë ekonomike për të prodhuar një rritje ekonomike më të lartë dhe që të përmirësojë standardin e jetesës së qytetarëve.
- Përdorimi më funksional i sistemit të vlerave, besimeve dhe perceptimeve përkatëse për të formuluar politika zhvillimore adekuate, sidomos për grupmoshën e re.
- Përdorimi më i frytshëm i trashëgimisë kulturore në sjelljen ekonomike të qytetarëve dhe institucioneve;
- Mbështetja më e madhe e sipërmarrjeve transnacionale të emigrantëve për të përdorur më mirë potencialet e saj në zhvillimin e vendit;
- Rekomandime për politikat migratore, të cilat duhet të mundësojnë më shumë sinergjinë funksionale midis emigrimit dhe zhvillimit.

projekt i propozuar dhe i realizuar nën drejtimin e anëtarit të SSHSHA-së, **akad. asoc. Kosta Barjaba**, është finalizuar me një botim të prezantimeve të këtij forumi dhe të dokumentit të rekomandimeve për autoritetet qeverisëse. Për rekomandimet drejtuar autoriteteve qeverisëse shih shënimin në fundfaqe<sup>7</sup>.

4. Oponencë ndaj **projektligjit për të drejtën e autorit**. Në emër të SSHSHA-së mbrojtja e këtij projektligji, vërejtjet, amendimet etj. u paraqitën në komisionin përkatës parlamentar nga **akad. Vasil Tole** dhe nga **prof. Shaban Sinani**.

5. **Projekt për një VKM për mbrojtjen e gjuhës shqipe në përdorimin publik në Republikën e Shqipërisë**, si dhe relacion për këtë. Në lidhje me këtë akt është punuar nga **akad. Vasil Tole** dhe **prof. Shaban Sinani**. Projektakti i është dërguar Këshillit të Ministrave bashkë me relacionin dhe argumentin e nevojshëm për një nismë juridike për hartimin e një ligji kuadër për gjuhën shqipe, sipas detyrimit kushtetues.

## C. II. Sipas raportimit të SSHNT-së:

1. Projekti i fizibilitetit për projektpropozimin për Këshillin e Ministrave **“Mbi gjendjen dhe masat që propozohen për mënjanimin e ndikimit të veprimtarisë antropogjene në Liqenin e Prespës së Vogël”**. Një grup specialistësh të shkencave natyrore, teknike e inxhinierike të SSHNT-së ka paraqitur problemin e gjendjes së përkeqësuar të ekosistemit të Liqenit të Prespës së Vogël dhe ndikimit në sistemin ujor e më gjerë në Liqenin e Prespës së Madhe e në Liqenin e Ohrit. Kryeministri Edi Rama i është përgjigjur këtij shqetësimi me ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e raportit studimor të fizibilitetit, që të paraqesë gjendjen e plotë të përditësuar të situatës në Liqenin e Prespës së Vogël. Fillimisht, si fazë e parë u përgatit studimi i fizibilitetit, që do të prodhojë termat e referencës për një projekt shkencor për zgjidhjen e detyrave të vëna nga Këshilli i Ministrave për realizimin e projektit së bashku me ekspertë të jashtëm në fokusin e investimeve dhe ndërhyrjeve në liqen me qëllim ndalimin e përkeqësimit, rehabilitimin e mundshëm e përmirësimin e situatës aktuale trofike të Liqenit të Prespës së Vogël.

2. Seksioni, duke aktivizuar grupe të punës me specialistët më të mirë të fushave brenda dhe jashtë tij për të realizuar studime të rëndësishme së veçantë e prognoza të problematikave kombëtare e më gjerë në fushat përparësore, ka ngritur dhe do të konkretizojë në të ardhmen komisione *ad hoc* apo të përhershme për probleme të rëndësishme për vendin, si për ujërat, emergjencat civile, ruajtjen e biodiversitetit dhe mjedisit; përdorimin e teknologjive të reja në bujqësi etj. Komisionet udhëhiqen nga akademikë të shquar e specialistë në vend, jashtë vendit e në diasporë dhe parashikojnë kontribute në fushat e kompetencës, në kohë reale e cilësore, për ministritë e ndryshme e sidomos me Ministrinë e Arsimit e Sporteve, Ministrinë e Inovacionit, Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucione të tjera.

3. Detyrë kryesore e Seksionit konsiderohet hartimi i *Deklaratave* në përfundim të veprimtarive shkencore të rëndësishme si konferenca shkencore, seminare, forume me fokus probleme me rëndësi për ekonominë, ruajtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut etj. *Deklaratat* në formë rezolutash dhe rekomandimesh të hartuara nga grupe specialistësh të fushave përkatëse miratohen nga audienca shkencore dhe janë shpërndarë në institucionet politikëbërëse dhe vendimmarrëse si në komisionet pranë Kuvendit, në Këshillin e Ministrave dhe ministritë përkatëse, në institucione shkencore dhe mësimore në vend etj.

4. Në mbështetje të trajtimeve shkencore të problematikave prioritare të vendit, në

përputhje me strategjitë kombëtare, në zbatim të programit të Qeverisë, SSHNT-ja në bashkëpunim me shoqatën “Bashkësia Dibrane” ka organizuar forumin shkencor **“Mbi pasuritë e trashëgimisë kulturore dhe ato ujore”**, nën këndvështrimin e botimit “Dibra e Madhe dhe Radika”. Qëllimi i forumit shkencor ishte evidentimi i gjendjes së ujërave ndërkufitare tokësore të Shqipërisë, me fokus rastin e lumit të Radikës dhe problematikat në ditët e sotme; mbi orientimin e politikave, që duhen ndjekur për drejtmnazhimin e ujërave ndërkufitare të Shqipërisë me vendet fqinje në përgjithësi dhe në veçanti për rastin e lumit të Radikës. Forumi u organizua në formë debati shkencor me pjesëmarrje të gjerë të specialistëve, që merren me problemet e ujërave në Shqipëri në përgjithësi dhe në veçanti me ujërat ndërkufitare duke argumentuar faktin se sot ndërhyrja e qeverisë maqedonase në këtë zonë është e papranueshme të realizohet, sepse ujërat e përbashkëta ndërmjet dy shteteve rregullohen me marrëveshje dypalëshe, bazuar në konventa e ligje ndërkombëtare. E rëndësishme u theksua përgatitja e raporteve vlerësuese mjedisore. Veçanërisht, studimet shkencore të kryera, botimet shkencore e sensibilizimi i komunitetit, si dhe protestat paqësore të mbështetura në rezultatet e kërkimit shkencor, bënë që Banka Botërore të tërhiqej nga mbështetja e Projektit të Radikës, duke marrë parasysh që ky kishte ndikim negativ në ekosistemin e faunës dhe florës në përgjithësi.

5. Në përgjigje të problematikave aktuale të digave e ujëmbledhësve të hidrocentraleve të mëdha e rezervuarëve të vegjël e digave të tyre, në **konferencën kombëtare “Siguria e digave dhe menazhimi i tyre”** organizuar nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujërave, anëtarë të SSHNT-së prezantuan punimet e tyre shkencore për të ndërgjegjësuar institucionet qendrore dhe vendore për detyrimet ligjore që ka secili në këtë fushë dhe për të propozuar masa të mëtejshme që duhen ndërmarrë. U theksua nevoja e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve të këtij sektori si dhe të lidhjeve të ngushta ndërmjet institucioneve përgjegjëse të digave dhe institucioneve të kërkimit shkencor.

6. Problemit të këshillimit dhe ekspertizës shkencore iu kushtua dhe konferenca ndërkombëtare shkencore “Këshillimi shkencor” dhe mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Rrjetit Botëror të Akademive të Shkencave (InterAcademy Partnership, IAP), organizuar në Afrikën e Jugut, ku mori pjesë akad. S. Bushati, ku u ekspozuan publikime nga veprimtari të kërkimit shkencor të SSHNT-së në fusha të ndryshme si të shkencës në diplomaci, të pasurive ujore, të rrezikut natyror dhe emergjencave civile, të shëndetit, biodiversitetit, bioteknologjisë, si dhe të studimeve të tjera që kontribuojnë në realizimin e strategjive të ndryshme kombëtare si ajo e kërkimit për zhvillimin teknologjik e inovativ etj. dhe këshillimit të politikëbërjes për zhvillimin në përgjithësi të vendit. Publikimet u vlerësuan pozitivisht nga pjesëmarrësit në konferencë, si produkte shkencore me ndikim kombëtar dhe më gjerë në përputhje me politikën e IAP-it.

## Ç. Botimet<sup>8</sup>, paraqitje analitike<sup>9</sup>

### Ç.I. Sipas raportimit vjetor të SSHSHA-së:

Gjatë vitit 2016 këshilli i botimeve miratoi mbështetjen me buxhet të ASH-së të 22 titujve, nga të cilët 15 nga fushat që mbulon SSHSHA-ja. Sektori arriti të botonte gjatë vitit të kaluar

<sup>8</sup> Raportimi sipas ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, neni 4, funksionet, pika ç: *Boton organe periodike dhe vepra të tjera me nivel të lartë shkencor.*

<sup>9</sup> Të gjitha renditjet janë sipas alfabetit (referuar emrit të autorit).



dy numra të revistës së tij **Studia albanica**. Në lidhje me këtë revistë, gjatë analizës vjetore dhe përmes paraqitjes së mendimeve me shkrim, u kërkuar të dinamizohet jeta e redaksisë, të bëhen rregullisht mbledhjet e saj, institucioni të jetë korrekt me pagesat e punës redaktoriale dhe të honorareve dhe revista të jetë e hapur për të botuar në një gjuhë tjetër të huaj veç frëngjishtes.

Në vijim një paraqitje e detajuar e botimeve më të rëndësishme të fushave që mbulon SSHSHA-ja.

**1. Androkli Kostallari, Vepra**, vëllimi I, II, *Studime në fushën e gjuhës letrare kombëtare* (812 f.), përgatitur për botim nga **prof. asoc. Kujtim Kapllani** dhe **Irimi Kostallari**. Botimi i veprës, si hapi i parë i botimit të korpusit të plotë të veprës së **akad. Androkli Kostallari**, përfshin studime të dijetarit për problemet e gjuhës letrare kombëtare. Këto dy vëllime përmbajnë punime në të cilat ai ka trajtuar në rrafshin teorik e praktik çështjet e standardizimit të gjuhës shqipe dhe të hartimit të kodeve e të veprave normative të saj, punime monografike, artikuj në revista shkencore e në përmbledhje artikujsh, në shtypin joshkencor periodik si dhe në shtypin e përditshëm, të shkruara gjatë një periudhe më se 30-vjeçare, të cilat mbartin vlera të spikatura si në pikëpamjen teorike, edhe në pikëpamjen historike, për të njohur problematikën gjuhësore të kohës kur janë shkruar. Botimi njëherazi i këtyre dy vëllimeve të kësaj vepre ndihmon jo vetëm për njohjen e plotë të veprimtarisë krijuese të akademikut tonë në fushën e planifikimit gjuhësor, por edhe të paraqitjes së kontributeve të gjuhësisë shqiptare në lëmin e teorisë dhe të praktikës së planifikimit gjuhësor, sukseset e së cilës jo një herë kanë tërhequr vëmendjen e opinionit shkencor të huaj.

**2. Financat e Shqipnis (1839–1934)** (850 f.), me autor **Haxhi Shkozën**, përgatitur për ribotim nga **akad. Anastas Angjeli**. *Financat e Shqipnis* u botua në vitin 1935 nga Haxhi Shkoza, në atë kohë inspektor i përgjithshëm i Oborrit Mbretëror. Përfshin një periudhë gati njëqindvjeçare. Në këtë vepër me vlera të mëdha shkencore dhe historike, që janë themeli i financave publike për më se një shekull, autori jep konceptet bazë të financave, evoluimin e tyre, të politikave financiare dhe ekonomike, duke i argumentuar me akte ligjore, udhëzime, tabela dhe të dhëna statistikore, që na kanë dhënë një pasqyrë të detajuar të zhvillimeve të vendit tonë në atë periudhë ku dhe botimet e tjera janë të mangëta, të përgjysmuara ose në disa raste mungon informacioni, për arsye historike që dihen. Vlerat e këtij ribotimi janë të shumta, së pari, ai është unik dhe do të jetë në shërbim të studiuesve si një referencë tepër e vlefshme. Libri trajton problematika të financave shqiptare për një periudhë njëshekullore, që e bën librin një enciklopedi të financave publike shqiptare, ofron informacion të gjithanshëm për gjendjen e ekonomisë shqiptare për shumë vite dhe jep të dhëna statistikore që pothuaj nuk gjenden askund të sistemuara aq kujdesshëm dhe me një skrupulozitet të skajshëm shkencor. Ai nuk bën vetëm një përshkrim të hollësishëm të sistemit e të llojeve të ndryshme të të ardhurave, por në çdo rast shfaq edhe mendimet e tij mbi rrugët e përmirësimit të vetë sistemit, duke u dëshmuar si një studiues i mirëfilltë i ekonomisë në përgjithësi dhe si një historian i dorës së parë. Në vepër kuptohet qartë njohja e thellë që ai ka pasur për teorinë dhe praktikën botërore të financave dhe sidomos atë otomane e ballkanase. Ribotimi i këtij libri jep një kontribut shtesë për shkencën shqiptare dhe botimet e bëra në këtë fushë.

**3. Studime etimologjike**, bleu III (564 f.), me autor **Eqrem Çabejn** (ribotim).

**4. Shkrime historike për Rilindjen Kombëtare** (664 f.), me autor **akad. Kristaq Priftin**, përbën një përmbledhje artikujsh shkencorë, referatesh dhe kumtesash, të botuara nga autori gjatë rreth 50 vjetëve të veprimtarisë së tij shkencore. Shkrimet e këtij vëllimi u kushtohen ngjarjeve më të rëndësishme dhe disa figurave të shquara të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Shumica e shkrimeve janë në gjuhën shqipe, ndërsa ato që janë përgatitur në kongrese e

konferenca shkencore jashtë vendit, në gjuhë të huaja. Ndonëse trajtojnë ngjarje dhe aspekte të ndryshme të Rilindjes shkrimet e këtij vëllimi përbëjnë një vepër tërësore për Rilindjen Kombëtare, e përshkruajnë atë si një epokë të re dhe të ndritur të historisë së popullit shqiptar, me veçoritë ekonomiko-shoqërore, politike, me pasurinë e mendimit kombëtar-politik, me marrëdhëniet e saj me lëvizjet përparimtare me shtetet fqinje ballkanike dhe në ato europiane. Një vend të veçantë në këtë vëllim zënë studimet e autorit koncepti i Rilindjes për shtetin autonom e të pavarur shqiptar, që trajtohet në bazë të dokumenteve, të organizmave të lëvizjes kombëtare dhe të veprave të rilindësve të shquar. Interes shkencor për njohjen e Rilindjes përbëjnë edhe shkrimet e autorit kushtuar unitetit kombëtar të shqiptarëve. Vend të konsiderueshëm në këtë përmbledhje zënë artikujt, referatat dhe kumtesat për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878–1881), në të cilat **akad. Kristaq Prifti** ka sjellë të dhëna të reja, të hulumtuara në Arkivin Osman të Stambollit, që i kanë dhënë mundësi autorit të bëjë interpretime të reja për marrëdhëniet e Lidhjes me Portën e Lartë. Gjithashtu i janë kushtuar shkrime Lidhjes Shqiptare të Pejës (1899–1900) dhe Kongresit të Manastirit për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe (1908). Ky punim përfaqëson interes shkencor edhe për disa studime që autori ka botuar, duke u mbështetur në regjistrimet osmane të nxjerra prej tij nga Arkivi Osman i Kryeministrit për popullsinë e sanxhakut të Dibrës, vilajetit të Kosovës dhe për popullsinë e krahinës së Pollogut, si dhe për disa nga figurat kryesore të Lidhjes së Prizrenit e të Rilindjes Kombëtare në tërësi. Botimi shënon një kontribut në fondin e studimeve albanologjike dhe do të shërbejë si një burim e bazë orientuese për të ndërmarrë në të ardhmen studime të tjera për Rilindjen.

**5. Nga Kosova për Kosovën** (950 f.) përgatitur nga **akad. Marenglen Verli**, mbështetur në hulumtime rreth 30-vjeçare. Përmes materialeve të shumta bibliografike e arkivore, vendëse e të huaja, diku duke shfrytëzuar edhe material memorastik, të mbledhur në terren, si dhe duke e shoqëruar studimin me ilustrime fotografike, është bërë i mundur portretizimi i mbi 90 figurave, shumica e të cilave të evidentuara pak ose aspak në historiografi. Vlera e këtij punimi të **akad. M. Verlit** qëndron jo vetëm në ndriçimin e figurave të përzgjedhura për t'u trajtuar, por edhe në objektivitetin me të cilën është bërë kjo. Në raste të ndryshme autori ka lënë hapur shtegun për hulumtime e njohje të mëtejshme shkencore. Ilustrimet fotografike, për shumicën e figurave, duke qenë shpesh të panjohura ose foto shumë të rralla, ia shtojnë edhe më tej vlerën botimit.

**6. Veshje popullore shqiptare - Albanian folk costumes**, vëllimi IV (shqip-anglisht), 350 f., me autorë: **akad. asoc. Mark Tirta, prof. Afërdita Onuzi, prof. Kahreman Ulqini, prof. asoc. Yllka Selimi, prof. asoc. Agim Bido** dhe **Gjergji Martini**, është pjesë e korpusit *Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar*, i themeluar nga ASH-ja. Vëllimet e këtij korpusi janë realizuar me kontributin e studiuesve më të njohur të trashëgimisë kulturore shqiptare, të cilët i kanë filluar gjurmimet dhe studimet e tyre që nga viti 1947, me ngritjen e *sektorit të etnografisë*. Deri me tani, me mbështetjen e ASH-së, është bërë e mundur të kryhen kërkimet në terren si dhe fotografimi i të gjitha varianteve të veshjeve në krahinat e ndryshme të Shqipërisë, si dhe në atë të Kosovës, të cilat janë përmbyllur me botimet e vëllimeve I, II, III dhe V. Në këtë botim të vëll. IV përfshihen veshjet e rretheve administrative të Mirditës, Lezhës, Shkodrës, Malësisë së Madhe, Pukës, Tropojës, Hasit dhe Kukësit, që njëkohësisht përbëjnë dhe krahinat më të pasura me variante dhe lloje veshjesh popullore. Ky botim merr rëndësi të veçantë edhe për faktin se veshjet popullore tashmë jo vetëm kanë dalë nga përdorimi i përditshëm, por një pjesë e tyre mungojnë edhe në stendat muzeore. Vëllimi përmban foto, tekste studimore me diçiturat përkatëse, si dhe hartat kostumografike. Botimi i albumit ka rëndësi jo vetëm për studime në fushën e etnologjisë, por edhe në fushat e

historisë së artit, të kulturës në përgjithësi si dhe për zhvillimin e turizmit kulturor në Shqipëri.

**7. Etnogjeneza e ilirëve** (228 f.), me autor **akad. Muzafer Korkutin**, nuk është thjesht një përmbledhje studimesh dhe botimesh të mëhershme të autorit për këtë çështje, por një dëshmi historike e përpjekjeve të shkencës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX për të ndriçuar një proces historik me rrjedhoja tejet të rëndësishme për historinë e lashtë të Ballkanit Perëndimor: origjinën dhe shfaqjen e ilirëve. Ky botim ka një vlerë të rëndësishme, pasi është mënyra më e mirë për t'u njohur me evoluimin e mendimit të shkencës shqiptare të shekullit të kaluar për çështjen e origjinës dhe formimit të ilirëve. Një vend qendror zë në këtë përmbledhje botimi për herë të parë në mënyrë integrale i disertacionit të autorit, titulluar *Probleme të pre- dhe protohistorisë ilire në dritën e të dhënave të Shqipërisë* (1978). Ky është, pa dyshim, punimi më i plotë për temën e etnogjenezës së ilirëve, në të cilin të dhënat e shumta të prehistorisë së Shqipërisë analizohen nga autori në funksion të ndërtimit të procesit historik dhe etnokulturor që karakterizojnë epokat e bronzit dhe të hekurit. Etnogjeneza e ilirëve shihet si pjesë e këtyre proceseve dhe e lidhur ngushtë me shkak-pasojat e tyre. Argumentet këtu marrin karakter shkencor sepse bazohen në të dhëna të mbledhura me një metodologji të përcaktuar qartë (gërmime stratigrafike arkeologjike, studime tipologjike të kategorive të ndryshme të objekteve, qasje krahasuese brenda një zone gjeografike dhe më gjerë), në koncepte operative të shpjeguara mirë (kulturë arkeologjike, grup kulturor, raporti kulturë materiale – karakter etnik etj.) dhe mbi të gjitha, me një sistem teorik të të kuptuarit dhe shpjegimit të shoqërisë njerëzore. Përmbledhja pasohet edhe me një shtojcë, në të cilën **akad. M. Korkuti** mban një qëndrim kritik ndaj një numri të madh botimesh të këtyre 15 viteve të fundit, që i rikthehen trajtimit të origjinës së ilirëve nga një pozitë fatkeqësisht diletante dhe nacionaliste, me mungesa të theksuara koherence të argumenteve dhe të të dhënave arkeologjike, historike dhe gjuhësore. Studimet e **akad. Muzafer Korkutit** të paraqitura në këtë botim përbëjnë një shembull të rrallë të shtrimit dhe zgjidhjes shkencore të një problemi të vështirë. Ky punim, me përmbajtjen e studimeve të tij është dëshmia më e mirë e rolit të fortë të historicizmit në arkeologjinë shqiptare të shekullit XX.

**8. Himni kombëtar**, me autor **akad. Vasil Toles**. Libri i **akad. Vasil Toles** synon të shpjegojë fenomenin e mbijetesës së poezisë së Asdrenit, që u bë kryekënga e kombit, dhe është një dukuri unike kur mendon se ajo u rezistoi ndryshimeve të mëdha politike pas Luftës II Botërore, në një kohë kur himnet e të gjitha vendeve të sistemit komunist ku u përfshi Shqipëria, u ndryshuan. Autorit të librit *Himni kombëtar* i është dashur që me përkushtim të gjurmtojë shumë në arkiva, në shtypin dhe botimet e të gjitha kohëve, në dokumentacionin e të gjitha administratave shtetërore, duke ndërtuar një histori gati shteruese të lindjes, të pritjes, përhapjes, interpretimit, regjistrimeve muzikore e të tjera detaje e të dhëna faktike të hulumtuara për herë të parë prej tij. Merita e autorit qëndron në faktin se, duke e vendosur në kontekstin historik e kulturor historinë e himnit tonë kombëtar, e bën bindës gjithë parashtrimin e tij për rolin e himnit në gjithë proceset e zhvillimit e të qëndresës sonë historike, të plazmimit të ndërgjegjes sonë kombëtare.

**9. Mëngjes sirenash** (100 f.) dhe **Dritarja – sprovë** (300 f.), (poezi, ribotim), me autor **akad. Xhevahir Spahiu**. Në shqetësimet poetike, në përsiatjet e tij jetësore dhe filozofike nuk ka asgjë të programuar, shabllone dhe kornizime të paracaktuara, mekanike. Lëvizja e busullës poetike tek ai është e vetvetishme, shfaqet fuqishëm befasuese – si mrekullim pas bukurisë dhe si trishtim ndaj së keqes. E tillë është odiseja poetike e Xhevahir Spahiut, e shtrirë brenda një harku kohor gati gjysmëshekullor. Dhe tërë këtë ecje dramatike, lexuesi do ta gjejë mes vargjeve të poezive së tij, edhe në faqet e këtyre botimeve.

## Ç. II. Sipas raportimit vjetor të SSHNT-së

### Organe periodike

1. **Journal of Natural and Technical Sciences (JNTS)**, revistë shkencore shumëdisiplinore në gjuhën angleze. Revista ka realizuar botimet e saj vjetore që përfshihen në 2 numra me artikuj shkencorë në disa fusha si në: matematikë, ekonomi-matematikë, fizikë e zbatuar dhe fizikë bërthamore, kimi, kimi ushqimore, ndotje radioaktive e mjedisit të jashtëm (tokë dhe ujë) dhe mjedis i brendshëm, ndotje liqenore nga njeriu, bioteknologji bimore dhe biologji molekulare, biologji, mjekësi, industri e tekstileve, gjeologji, inxhinieri mekanike, inxhinieri ndërtimi; informacione shkencore. Një pjesë e artikujve janë fryt i studimeve ndërdisiplinore. Në një numër të veçantë të revistës janë paraqitur punimet shkencore të prezantuara në *workshop*-in ALBNANO 2016, i cili ishte dhe guri themeltar për projektin madhor të formimit të Qendrës së Ekselencës ALBNANO. Revista është pajisur me një numër të ri ISSN-je: 2489-0484 dhe me faktor impakti global 0.6.

2. **Journal of Agriculture of Animal Production Sciences for the Rural Development (JAAPSR)**, botim i përbashkët i fondacionit "BLELAL". Në të dy numrat e revistës paraqiten studime mbi probleme që shqetësojnë mbarështimin në blegtori dhe kultivimin e bimëve bujqësore me synim edhe rritjen e efektivitetit ekonomik të fermave në Shqipëri. Preken dhe probleme të marketingut si faktor kyç në bizneset e agropërpunimit, si dhe të përmirësimit të legjislacionit në këto fusha të rëndësishme të ekonomisë. Ekoturizmi, si mundësi reale për zhvillimin e qëndrueshëm rural, problemet e sigurisë ushqimore, programet dhe skemat financiare në mbështetje të fermerëve janë në qendër të studimeve të paraqitura.

### Monografi dhe libra

1. **Atlasi i Florës së Shqipërisë**, vëll. I, me autor **akad. Jani Vangjeli**, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 931 f. Botimi përbën një domosdoshmëri në studimet e thelluara për florën e Shqipërisë dhe do të kontribuojë në studimet e tjera në fushën e pyjeve, kullotave, bimëve aromatike e mjekësore, farmaceutikës, leksikografisë etj.

2. **Ndryshimi i klimës në tokë është shkaku i fenomeneve shkatërruese që do të shkaktojnë fatkeqësi të mëdha në jetën e njerëzimit dhe ndikimi i tyre në Shqipëri** me autor **akad. Edmond Pinguli**, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 214 f. Botimi është me vlera tekniko-shkencore, ekonomiko-shoqërore dhe historike. Është materiali i parë, që tregon këtë problem sa madhor, po aq edhe të rrezikshëm. Ky material i vjen në ndihmë organeve përgjegjëse në Shqipëri për të planifikuar masat që duhen marrë për të përballuar katastrofat.

3. **Ndryshimi i klimës në planet, pasojat në Shqipëri dhe ujësjellësi Vau Dejës – Brindizi; Përmirësimi i prodhimit të energjisë elektrike në kaskadën e Drinit Vau Dejës – Koman – Fierzë**, me autor **akad. Edmond Pinguli**, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 177f. Botimi është material me vlera teknike, shkencore, ekonomike, sociale dhe mjedisore për sot dhe në të ardhmen e zhvillimit të vendit. Kjo do të ndihmojë sadopak, për të mbështetur dhe planifikuar më saktë rrezikun katastrofik të parashikuar tashmë nga organizmat e shumta shkencore. Gjithashtu ndihmon në ndërgjegjësimin për përfitimet nga menazhimi dhe shfrytëzimi i resurseve të vendit në dobi të ekonomisë dhe zhvillimit tonë.

4. **Vështrim enciklopedik në hortikulturë** me autorë **akad. Nazim Gruda** dhe **prof. dr. Andrea Shundi**, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 839 f. Botimi mbush një boshllëk në një fushë ku bota akademike ka shumë nevojë. Traktati përbëhet nga 850 faqe, 4600 terma me qindra sinonime dhe një fjalorth me rreth 500 fjalë shqipe ose të shqipëruara. Materiali përshkohet nga një hulumtim i kujdesshëm shkencor me saktësi e thellësi të mendimit, prurje



të informacionit, si atij bashkëkohor botëror, ashtu edhe atij shqiptar.

**5. Prodhimi dhe certifikimi i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve në Shqipëri dhe Kosovë**, me autorë **akad. asoc. Efigjeni Kongjika; prof. dr. Agim Zajmi; prof. asoc. dr. Arben Myrta; akad. Latif Susuri dhe 23 autorë të tjerë** nga Shqipëria dhe Kosova, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 350 faqe. Grupi kryesor i autorëve është mbështetur nga puna e 23 specialistëve të njohur në fusha të ndryshme të pemëtarisë, të fitopatologjisë, biologjisë molekulare, bioteknologjisë, njohës të legjislacionit evropian dhe shqiptar për certifikimin e fidanëve të drurëve frutorë. Botimi i ri do të ndihmojë në krijimin e bashkëpunimeve midis dy vendeve për sa i përket mbrojtjes së specieve bimore me rëndësi ekonomike nëpërmjet zbulimit të hershëm të sëmundjeve virusale; do të përmirësojë ekspertizën e kërkuesve të rinj në përdorimin e metodave serologjike e molekulare të detektimit të fitopatologjive kryesore virusale, në prodhimin e fidanëve të shëndetësuar dhe në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit për certifikimin e materialit bimor fidanor të specieve frutore.

**6. Matematizimi dhe informatizimi i problemeve të gjeofizikës ndër vite në Shqipëri** me autorë **akad. Gudar Beqiraj, akad. Neki Frashëri, prof. dr. Alfred Frashëri dhe akad. Salvatore Bushati**, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 417 f. Modelimi matematikor i objekteve gjeologjike dhe interpretimi i të dhënave të vrojtimit në terren duke kryer inversionin gjeofizik, ka rritur cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të vrojtimit. Këto arritje lejuan të zgjidheshin probleme të ndërlikuara të vrojtimit në terren dhe të interpretimit të rezultateve të tyre. Janë krijuar kushtet për zgjerimin e fushave të zbatimit të metodave gjeofizike për zgjidhjen e detyrave inxhinierike dhe mjedisore, që vitet e fundit janë shoqëruar edhe me përpunimin e vrojtimit satelitor. Përmbledhja e studimeve ka për qëllim që rezultatet e studimeve më të arrira dhe problemore të vihen më gjerë edhe në shërbim të specialistëve, sidomos atyre të rinj.

## **D. Konferencat shkencore<sup>10</sup>, paraqitje analitike<sup>11</sup>**

### **D. I. Sipas raportimit të SSHSHA-së:**

**1.** ASH-ja dhe ASHAK-u, në bashkëpunim me bashkinë e qytetit të Gjirokastrës dhe me universitetin “Eqrem Çabej”, si dhe me mbështetjen e Këshillit të Ministrave, organizuan konferencën shkencore ndërkombëtare **“Shekulli i Kadaresë”** (13 dhe 14 maj 2016), në 80-vjetorin e lindjes së shkrimtarit dhe akademikut Ismail Kadare. Dita e parë e konferencës u zhvillua në Tiranë, ndërsa dita e dytë në shtëpinë-muze Kadare në Gjirokastrë. Në konferencë morën pjesë studiues dhe përkthyes të veprës së Ismail Kadaresë nga shumë vende të botës: Franca, Italia, Greqia, Serbia, Maqedonia, Kosova, Bullgaria, Rumania, Rusia, Gjermania, Britania, Japonia e Australia. Konferenca u organizua me pjesëmarrjen e personaliteteve nga bota e artit dhe e shkencës, miqve dhe bashkëpunëtorëve të shkrimtarit, përfaqësuesve të trupit diplomatik, funksionarëve dhe autoriteteve shtetërore. Në seancën e parë të konferencës ishte i pranishëm edhe presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani. Konferenca u përgatit me përgjegjësi nga SSHSHA-ja dhe i zhvilloi punimet me nivel shkencor. Fjalën e hapjes e mbajti **akad. Floresha Dado**, kryetare e SSHSHA-së. Në fjalën e saj ajo bëri të njohur qëllimin e kësaj konference, e para që u jep mundësi studiuesve të vendit dhe të huaj të bëjnë të njohura së bashku arritjet e tyre në kërkimet kadareane. Më

<sup>10</sup> Raportimi sipas ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, neni 4, funksionet, pika d: *Organizon kongrese dhe konferenca shkencore dhe problemore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.*

<sup>11</sup> Renditja sipas rëndësisë së veprimtarisë, shkallës së pjesëmarrjes dhe rolit specifik të SSHSHA-së.

pas akad. Floresha Dado u bëri të njohur shkurtimisht të pranishmëve disa prej rezultateve themelore të veprimtarisë së të ftuarve, studiues e përkthyes të veprës së Kadaresë. Konferencës iu drejtuan me fjalë përshëndetëse **akad. Muzafer Korkuti**, kryetar i ASH-së; **akad. Ali Aliu**, nënkryetar i ASHAK-ut; **akad. Luan Starova**, nënkryetar i ASHAM-it dhe **akad. Francesco Altimari**, anëtar nderi i ASH-së. Në nderim të 80-vjetorit të lindjes së shkrimtarit Ismail Kadare në këtë seancë u bë gjithashtu paraqitja e tri studimeve të reja monografike kushtuar veprës së tij: *Lexuesi "në kurth": eseistika e Ismail Kadaresë* (Floresha Dado); *Në studion "Kadare", botim kritik me parathënie i tri varianteve të romanit "Dimri i vetmisë së madhe"* (Matteo Mandalà); si dhe *Mite dhe demonë në veprën e Kadaresë* (Shaban Sinani). Paraqitja e tre librave u bë nga **akad. Francesco Altimari** dhe kopjet e para iu dhuruan në mënyrë simbolike autorit. Në seancën e parë u zhvillua gjithashtu ceremonia e nderimit të shkrimtarit Ismail Kadare me *Urdhrin e Flamurit Kombëtar*, mirënjohja më e lartë për merita intelektuale në Shqipëri, me këtë motivacion: *Në shenjë nderimi dhe mirënjohjeje të pakufishme për veprat e vyera letrare, për pasurimin e pashtershëm e të çmuar të letrave shqipe, si dhe për kontributin e jashtëzakonshëm dhënë në drejtim të lartësimit të emrit e vlerave të kombit shqiptar anembanë botës.* Presidenti i Republikës Bujar Nishani vlerësoi lart jo vetëm meritat letrare të shkrimtarit Ismail Kadare, rolin e letërsisë së tij për formimin e njerëzve me ndërgjegje të lirë, ndikimin e saj si faktor identiteti dhe imazhi evropian të shqiptarëve, por dhe meritat qytetare të tij, si një personalitet që ka ditur të qëndrojë lart dhe me ndikim orientues në shumë situata delikate që ka kapërcyer vendi dhe kombi. Në fjalën e tij të shkurtër **akad. Ismail Kadare** vlerësoi si një gjest emancipimi vëmendjen e presidentit të Republikës ndaj njerëzve të kulturës. Në mënyrë të veçantë ai çmoi praninë e përkthyesve dhe studiuesve të huaj. *"Ju mund të ndiheni të harruar, megjithëse i jeni kushtuar një gjuhë të vështirë dhe një autori të vështirë. Por nuk duhet të harroni kurrë se autorët ju kanë gjithnjë në mendje dhe ju janë mirënjohës,"* – tha ai në fund të fjalës falënderuese. Në seancën e dytë të pranishmëve në konferencë iu paraqitën tri referate: "Shekulli i Kadaresë", mbajtur nga **akad. Floresha Dado** dhe prof. Shaban Sinani; "Kadareja dhe Kosova", paraqitur prej **akad. Mehmet Krajës** dhe "Kadareja në gjuhët e popujve" prej **prof. Bashkim Kuçukut**. Dita e dytë e punimeve të konferencës u zhvillua në Gjirokastrë, në shtëpinë-muze Kadare. Takimi i parë i studiuesve dhe përkthyesve të veprës së Kadaresë u drejtua nga **akad. Matteo Mandalà**. Të ftuarve iu drejtua me një përshëndetje mirëseardhjeje rektori i Universitetit të Gjirokastrës **prof. Gëzim Sala**. Mendime rreth përvojave, vështirësive, rezultateve dhe projekteve të tyre shfaqën **Éric Faye**, **Dorota Horodyska**, **John Hodgson**, **Piter Morgan**, **Joachim Röhm**, **Giuseppina Turano**, **Aleksander Rusakov**, **Despina Serafidhou**, **Iura Ichiro**, **Russana Beyleri**, **Ardian Ndreca** dhe **Persida Asllani**. Të ftuarit nga jashtë shprehën mirënjohje për veprën e shkrimtarit Ismail Kadare, që u ka dhënë atyre mundësi të njohin një gjuhë, një kulturë dhe një qytetërim origjinal, si bota shqiptare. Ata falënderuan ASH-në për mundësinë që u dha për t'u takuar me autorin, për të këmbyer mendime e përvoja mes tyre, si dhe për të vizituar qytetin e Gjirokastrës. Kjo vizitë, thanë ata, u bën të mundur të kuptojnë më në thellësi veprën e autorit. Nga studiuesit gjithashtu u propozua që të bëhen përpjekje për të krijuar një rrjet ndërkombëtar të studimeve kadareane, i cili të jetë i përgatitur për t'iu përgjigjur pyetjes se çfarë përfaqëson Ismail Kadareja në kontekst të letërsisë evropiane dhe botërore. U propozua gjithashtu që takimet e studiuesve dhe të përkthyesve të Kadaresë të bëhen traditë dhe të zhvillohen rregullisht. U propozua po ashtu që të krijohet klubi ndërkombëtar i studiuesve kadareologë dhe të themelohet një çmim letrar me tri shkallë, që të jepet në mënyrë të përvitshme për veprën studimore më të mirë. Në një fjalë të shkurtër falënderimi **akad. Ismail Kadare** shprehu vlerësim për organizatorët e konferencës dhe për nderimin e

veprës së tij. Fjala përmbyllëse u mbajt nga **akad. Matteo Mandalà**. Aktet e kësaj konference janë pasuruar me kontribute të dërguara me shkrim në një kohë të mëvonshme nga studiuesit **Giuseppina Turano, Maria Sanches, Matteo Mandalà** dhe disa studiues e përkthyes të tjerë. Mbetet për t'u vendosur, varësisht prej vëllimit, nëse këto kontribute do të botohen në një numër ekskluziv të revistës *Studia albanica* apo si vëllim më vete.

2. Konferenca jubilarë "**Dritëro!**" (13 tetor 2016), e organizuar nga SSHSHA-ja në nderim të shkrimtarit dhe **akademikut Dritëro Agolli**, me rastin e 85-vjetorit të lindjes, u zhvillua në mjediset e ASH-së. Fjalë përshëndetëse u mbajtën nga kryetari i ASH-së **akad. Muzafer Korkuti**; nga **akad. Ali Aliu**, nënkryetar i ASHAK-ut dhe nga **akad. Luan Starova**, nënkryetar i ASHAM-it. Një përshëndetje u lexua edhe në emër të studiuesve arbëreshë, dërguar nga **akad. Matteo Mandalà**. Këtij aktiviteti nuk i mungoi edhe përshëndetja nga vetë **akad. Dritëro Agolli**. Në pamundësi për të qenë i pranishëm, ai shprehu mirënjohjen e tij të transmetuar përmes një videoregjistrimi. Në këtë konferencë jubilarë u mbajtën disa kumtesa: "Dionizi i letërsisë shqipe", nga **prof. Alexandre Zotos** (ardhur nga Franca); "Fenomeni 'Zylo' në prozën e Dritëro Agollit", nga **akad. Ali Aliu**; "Kulti i natyrës në veprën e Dritëro Agollit", nga **prof. Roland Zisi** (Universiteti i Vlorës Ismail Qemali); "Tungjatjeta, Dritëro!" prej shkrimtarit **Zija Çela**. Në vijim, me kumtimin "Një dhuratë Dritëro Agollit: Migjeni shqip pas 60 vjetësh" paraqitur nga **akad. Floresha Dado**, u bë i njohur botimi *preprint* në gjuhën shqipe i temës së diplomës së Dritëro Agollit "Skicat e tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar Migjeni" shkruar në gjuhën ruse më 1957 dhe mbrojtur në Universitetin e Petersburgut. Ky studim u soll për herë të parë në gjuhën shqipe e përkthyer nga njëri prej bashkëpunëtorëve të afërt të vetë autorit, **prof. Xhevat Lloshit** dhe u përgatit për botim (shënime e pasthënie analitike) nga prof. Shaban Sinani. Në trajtesën "Dramat e pabotuara të Dritëro Agollit" paraqitur nga **prof. Shaban Sinani** u theksua rëndësia e rikthimit të lexuesi për herë të parë të tri dramave të ndaluara të autorit, shkruar në vitet 1960 dhe 1970: *Fytyra e dytë*; *Mosha e bardhë* dhe *Baladë për një grua*, që u botuan për herë të parë në 85-vjetorin e lindjes. U pohua se këto drama nuk i ka pasur në dorëshkrim as vetë shkrimtari; njëra prej tyre, *Fytyra e dytë* është censuruar dhe dëmtuar aq shumë, sa autori humbi çdo interes për të. Janë tri drama të cilat janë gjetur në arkivat e teatrove ku dhe janë vënë në skenë, por, për fat të keq, këto drama, duke mos qenë as pjesë e historisë së letërsisë, sepse nuk kanë ekzistuar si tekst, as pjesë e historisë së teatrit, sepse kanë qenë të ndaluara, kanë mbetur jashtë qarkullimit. Botimi i tyre u mbështet nga *Agjencia Rajonale për Zhvillim nr. 2* dhe tirazhi iu dhurua të pranishmëve e bibliotekave shkencore. Kumtesa "Edhe një projekt tjetër për 85-vjetorin e Dritëro Agollit" u mbajt nga **prof. Valter Memisha** dhe përmes saj u bë e ditur se do të ketë një botim të dedikuar veprës së këtij shkrimtari. Në fund të këtij aktiviteti u shprehën mirënjohje e nderime në emër të shoqatës atdhetare-kulturore "Devolli".

3. Në partneritet me ASHAMZ-in, ASHAM-in dhe ASHB-në, u përgatit dhe u organizua konferenca shkencore ndërkombëtare "**1000-vjetori i Shën Gjon Vladimirit**" (21–22 tetor 2016). Dita e parë e konferencës u zhvillua në kryeqytetin e Malit të Zi, në Podgoricë, ndërsa dita e dytë u vijua në Tiranë dhe në Elbasan, me vizita shkencore-turistike në vendet e kujtesës historike që lidhen me emrin dhe bëmat e Shën Gjon Vladimirit. Në konferencë, përveç gjashtë kumtuesve shqiptarë, bashkëpunëtorë të ASH-së, mori pjesë edhe një përfaqësi zyrtare e saj, e kryesuar nga **akad. Muzafer Korkuti**. Gjatë qëndrimit në Podgoricë delegacioni pati një takim të shkurtër me presidentin e Republikës së Malit të Zi **Filip Vujanoviæ**. Më 21 tetor u zhvilluan bisedime me kryetarin e ASHAMZ-it **akad. Dragan K. Vukëeviaë**, ku u theksuan përparësitë e bashkëpunimit me projekte konkrete në dy vitet e ardhshme, në pajtim me marrëveshjen ndërakademike që është nënshkruar në vitin 2003.



U shpreh mirëkuptim për këto dy projekte kryesore: **1. Studimi i trashëgimisë arkivistike në Tiranë për Shën Gjon Vladimirit; 2. Përgatitja e një ekspedite të përbashkët arkeologjike në qytetin e Shasit.** Në trajtesat e studiuesve shqiptarë dhe të atyre vendës, si dhe në kumtimet e studiuesve nga Bullgaria e Maqedonia, doli në pah karakteri ekumenik, ndërjetar, ndërkishtar, ndëretnik, i figurës së Shën Gjon Vladimirit. U theksua se Shqipëria është vendi ku kujtesa historike-kishtare dhe ajo letrare ruhet më e plotë se në çdo vend tjetër. Me këtë rast u përmend tradita e ikonografisë shqiptare kushtuar Shën Gjon Vladimirit (Manastiri i Ardenicës, Muzeu Historik Kombëtar, Muzeu i Artit Mesjetar, Voskopoja dhe vise të tjera); tradita e botimeve jetëshkrimore kushtuar këtij shenjtori (sidomos gjatë shekujve XVII–XIX, duke përfshirë shtypshkrime të tipit *megalinarion* dhe *martirologion* dhe kushtimet poetike, botuar në Voskopojë e në Itali); tradita e pelegrinazheve dhe panegjirikeve në malin e Rumijes dhe në Manastirin e Shijonit; tradita e kishave që lidhen me emrin e tij (duke filluar nga Kraja). Në kumtime u theksua gjithashtu roli i familjeve patronimike shqiptare për mbrojtjen e trashëgimisë që i takon jetës dhe punëve të Shën Gjon Vladimirit, veçmas i Topiajve, që morën në mbrojtje lispanitë dhe reliktet e këtij shenjtori në fundin e shekullit XIV, duke ringritur manastirin e tij aty ku gjendet edhe sot, në Shijon të Elbasanit. Megjithëse vendvarrimi i Shën Gjon Vladimirit ndërroi vend tri herë (Prespë, Durrës, Shijon), në Shqipëri u ruajtën objekte që i takojnë drejtpërsëdrejti atij. Këto objekte ruhen prej vitesh në Muzeun Historik Kombëtar, në një pavijon të veçantë, që u vizitua nga studiuesit pjesëmarrës në konferencë me 22 tetor 2016. Në këtë pavijon ishin paraqitur me këtë rast edhe një numër ikonash kushtuar këtij shenjtori që ruhen në këtë muze; epitafi i Gllavenicës; si dhe tri inskripsionet e mirënjohura që urdhëruan të shkruheshin në portikun e Manastirit të Shën Gjon Vladimirit (latinisht, greqisht dhe në sllavishten e vjetër). Me këtë rast, studiuesit patën rast të vizitonin edhe mjedise të tjera të periudhës së mesjetës, duke përfshirë stemat e familjeve të mëdha të kohës. Gjatë vizitës në Manastirin e Shën Gjon Vladimirit vizitorët u pritën nga **mitropoliti i Shpatit dhe Elbasanit Hirësi Andoni**. Përveç vizitës në kishën e vjetër, ku ruhet edhe një afresk i periudhës mesjetare, si dhe shumë shenja të tjera kujtese në muret e kësaj kisha, u paraqitën në gjuhën shqipe edhe pjesë nga *Shërbesa e Shën Gjon Vladimirit*. Konferenca shërbeu jo vetëm për të vënë në pah qëndrimin e qytetëruar të shqiptarëve ndaj figurave si ajo e Shën Gjon Vladimirit, pavarësisht besimit që kanë predikuar dhe prejardhjes etnike, por dhe për të ritheksuar karakterin tolerant të tyre në raportet ndërjetare e ndërretnike; por dhe për të nxitur ndërveprimin midis studiuesve të disa fushave në shkallë rajonale.

**4.** Në bashkëpunim me ASHAK-un dhe në kuadër të protokollit të bashkëpunimit në Prishtinë u organizua konferenca **“Ndre Mjeda – në 150-vjetorin e lindjes”** (15 shtator 2016). Krijimtaria dhe veprimtaria e Ndre Mjedës u pa në disa fusha themelore: personaliteti i Mjedës; krijimtaria poetike; studimet letrare; kërkimet gjuhësore; krijimtaria fetare dhe studimet për Mjedën, të cilat u pasqyruan mes kumtesave të mbajtura edhe prej anëtarëve të SSHSHA-së: akad. Floresha Dado, “Tri poetikat në një të Mjedës”; **akad. Kolec Topalli**, “Ndre Mjeda si gjuhëtar”; **akad. asoc. Gjovalin Shkurtaj**, “‘Shqyptarija’ në vjershat dhe në veprimtarinë shoqërore, gjuhësore dhe politike të Ndre Mjedës” dhe **prof. Shaban Sinani**, “Ikja prej rimës gramatikore si ikje prej rapsodisë”.

**5.** Në kuadër të nismës për zgjerimin e lidhjeve të shkencës me publikun, përmes mbajtjes së ligjëratave të hapura akademike prej anëtarëve të saj, u organizua forumi publik **“Karta e Gjelbër – rimodelimi i zhvillimit ekonomik në kontekstet lokale”**, projekt i propozuar dhe realizuar nën drejtimin e anëtarit të SSHSHA-së **akad. asoc. Kosta Barjaba**. Ky projekt është shoqëruar me finalizimin me një botim të prezantimeve të këtij forumi dhe dokumentin e rekomandimeve për autoritetet qeverisëse. Nga kontribuuesit u theksua se *Karta e Gjelbër* përbëhet nga tre krrerë: **a.**

*Ekonomia*: modelimi ekonomik, trashëgimia, gjeografia, burimet natyrore, demografia dhe sinergjia me punësimin; **b. Shoqëria**: qasje antropologjike, psikologjike dhe sociologjike të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë; **c. Diaspora**: emigrantët shqiptarë si burim, faktor dhe përfitues të zhvillimit. Për hartimin e saj punuan ekspertë, me përfaqësues të ASH-së dhe të disa universiteteve nga brenda e jashtë vendit, si: **prof. Dhori Kule** (Universiteti i Tiranës); **prof. Adrian Civici** (Universiteti European i Tiranës); **znj. Milva Ekonomi** (ministre); **prof. asoc. Selami Xhepa** (Universiteti European i Tiranës); **prof. Arben Malaj** (Universiteti “Luarasi”); **Pandeli Garo** (sipërmarrës, RT Group); **akad. Vasil Tole** (ASH); **akad. asoc. Kosta Barjaba** (ASH); **prof. Shaban Sinani** (ASH); **prof. Adem Tamo** (Universiteti i Tiranës); **prof. Tonin Gjuraj** (Universiteti European i Tiranës); **prof. asoc. Zamira Çavo** (Universiteti “Marin Barleti”); **prof. Luigi Perrone** (Universiteti i Salentos, Itali); studiuesit *Martin Russell* dhe *Kingsley Aikins* (Diaspora Matters, Irlandë) dhe **Joniada Barjaba** (Universiteti Sussex, Mbretëria e Bashkuar).

**6. Konferenca shkencore “100-vjet nga vetëqeverimi i Korçës”** (9 dhjetor 2016), u organizua me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së autonomisë së qytetit dhe nahijes së Korçës. Në këtë veprimtari u ftuan për bashkëpunim Universiteti “Fan S. Noli” dhe QSA-ja dhe u sigurua mbështetja e këshillit të qarkut të Korçës. **Akad. Floresha Dado**, kryetare e SSHSHA-së, mbajti fjalën përshëndetëse, ndërsa tre anëtarë të këtij seksioni u paraqitën me kumtesa: **akad. Marenglen Verli**, “Shqiptarët, francezët dhe kleri i huaj në Korçën e viteve 1916–1920”; **akad. Beqir Meta**, “Federata panshqiptare ‘Vatra’ dhe Lëvizja Kombëtare në Korçë gjatë Luftës I Botërore”; **prof. Shaban Sinani**, “Korça në ditarët e komandave ushtarake franceze dhe italiane”. Në konferencë u ftuan dhe u angazhuan me kumtesa edhe disa prej bashkëpunëtorëve të jashtëm të SSHSHA-së. Kumtesat dhe materialet e tjera burimore që u paraqitën në këtë konferencë i shërbejnë përmbushjes së misionit të madh që ka historiografia e sotme shqiptare për të bërë një vlerësim real të ngjarjeve historike dhe për të nxjerrë në dritë dokumente që i ka mbuluar pluhuri i kohës. Aktet e konferencës janë në procesin përfundimtar të redaktimit dhe do të botohen së shpejti.

**7. Në bashkëpunim me Institutin Albanologjik të Prishtinës u organizua konferenca jubilarë “Adem Demaçi dhe letërsinë shqipe”** (27 dhjetor 2016), me rastin e 80-vjetorit të lindjes së shkrimtarit **Adem Demaçi**. Fjala përshëndetëse u mbajt nga kryetari i ASH-së **akad. Muzafer Korkuti**. Për të nxjerrë në pah veprimtarinë e tij letrare dhe artistike u mbajtën kumtesa nga profesorë e studiues nga Shqipëria e Kosova: **prof. Hysen Matoshi** (IAP), “Vendi i Adem Demaçit në letërsinë shqipe”; **prof. Ymer Çiraku** (UT), “Shkrimtari dhe misionari”; **prof. Sadri Fetiu** (IAP), “Romanet e Adem Demaçit”; **prof. Klara Kodra** (QSA), “Adem Demaçi dhe fillimet e prozës sociale kosovare”; **prof. Emin Kabashi** (IAP), “Letërsia e Adem Demaçit dhe Kosova”; **prof. asoc. Elvira Lumi** (Universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani), “Adem Demaçi – simbol i luftës në rrugëtimin e lirisë”; **dr. Fadil Grajçevci** (IAP), “Adem Demaçi dhe revista letrare *Jeta e re*”; **prof. Bardhosh Gaçe** (Universiteti i Vlorës *Ismail Qemali*), “Lexuesi në Shqipëri i Adem Demaçit dhe probleme të tjera receptimi”; **dr. Leonard Dauti** (Universiteti i Elbasanit *Aleksandër Xhuvani*), “Gjuha e veprës – mishërim i misionit intelektual e qytetar të Adem Demaçit”. Me këtë rast ASH-ja i akordoi shkrimtarit Adem Demaçi mirënjohjen “Nderi i Akademisë”.

**8. Në kuadër të protokollit të bashkëpunimit me ASHAK-un, më 18 tetor u mbajt tribuna muzikologjike** kushtuar jetës dhe krijimtarisë së kompozitorit Zeqirja Ballata, anëtar i ASHAK-ut, që u hap me fjalët përshëndetëse në emër të dy akademive dhe u vijua me kumtimet: “Aspekte kombëtare në muzikën e Zeqirja Ballatës” (**prof. Fatmir Hysi**), “Ballata në kontekstin e kulturës europiane” (**dr. Edmond Buharaja**), “Ballata në dhe për muzikologjinë shqiptare” (**dr. Mikiela Minga**), “Pjesë nga krijimtaria e Zeqirja Ballatës në këndvështrimin

e dirigjentit” (nga **prof. Eno Koço**) dhe “Zeqirja Ballata – një pararendës i novatorizmit në muzikën shqiptare” (**dr. Pandi Bello**). Aktiviteti u pasua nga një ekspozitë e botimeve muzikore të **akad. Zeqirja Ballatës** dhe u përmbyll pasdite me koncertin me muzikë dhome, me vepra të këtij kompozitori, në Universitetin e Arteve.

9. U organizua konferenca “**Tish Daija – në 90-vjetorin e lindjes**” (1926–2003), kushtuar jetës dhe veprës së kompozitorit dhe **akademikut Tish Daija**, i cili ka dhënë kontribut themelor në krijimin dhe zhvillimin e muzikës instrumentale-simfonike, muzikës së dhomës dhe për krijimin e një tradite të çmuar shqiptare të muzikës klasike si dhe kultivimit të trashëgimisë muzikore kombëtare te brezat e rinj. Kjo *tribunë muzikologjike* u shoqërua me një *koncert me muzikë dhome*, me veprat më të spikatura të tij. Kjo veprimtari jubilarë u pasurua edhe me një ekspozitë me partitura të kompozimeve të akad. Tish Daija dhe fotografi të shumta nga jeta dhe veprimtaria e tij artistike.

10. Gjatë vitit 2016 pati dy pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare shkencore “**The Balkan Jews & the Minority Issue in South-Eastern Europe**”, organizuar nga AIESEE, Poloni, gjegjësisht nga **akad. Floresha Dado** (*Jevrenia and Qyste Jakudia in the Albanian Epos of the Warriors*), **prof. Shaban Sinani** (*Disa akte ndërkombëtare që lehtësuan ardhjen e hebrenjve në Shqipëri*). Në këtë konferencë ishin raportuar edhe dy-tri pjesëmarrje prej studiuesish shqiptarë, por nuk u paraqitën. Nuk pati asnjë kumtues nga Kosova. Mbi 10 kumtime kishin të bënin me problemin e bashkëjetesës historike të hebrenjve në hapësirën shqiptare. Në konferencën e organizuar nga ASHAK-u “**Esad Mekuli: në 100-vjetorin e lindjes**” (6 dhjetor 2016) ASHAK-u u përfaqësua me kumtesën e **prof. Shaban Sinanit** “*Migjeni i Esad Mekulit*”. Në konferencën e organizuar nga Universiteti i Tiranës “**Studia kadareiana, albanica et humanitatis**” (dhjetor 2016), konferencë shkencore ndërkademiçe e ndëruniversitare, SSHSHA-ja kontribuoi si bashkorganizatore, me pjesëmarrjen e dy anëtarëve të saj (**akad. Floresha Dado** dhe **prof. Shaban Sinani**) në komitetin organizator dhe me katër kumtesa nga anëtarë dhe bashkëpunëtorë të SSHSHA-së.

### Kalendari i parashikuar i veprimtarive shkencore të SSHSHA-së (Parashikimi në fillim të vitit dhe realizimi)

Nr.	Veprimtaria	Organizatorët	Periudha
1.	Konferencë me rastin e 80-vjetorit të lindjes së shkrimtarit Ismail Kadare	ASH, ASHAK	prill
2.	Konferencë jubilarë në 80-vjetorin e akad. Rexhep Qosjes <sup>12</sup>	ASH (SSHSHA)	qershor
3.	Konferencë shkencore ndërkombëtare 150-vjetori i lindjes së poetit Ndre Mjeda	ASH, ASHAK	shtator
4.	Konferencë jubilarë në 85-vjetorin e shkrimtarit Dritëro Agolli	ASH (SSHSHA)	tetor
5.	Konferencë shkencore ndërkombëtare në 1000-vjetorin e Shën Gjoni Vladimirit	ASH ASHAMZ ASHAM, ASHB	tetor
6.	Konferencë shkencore ndërkombëtare mbi probleme të antropologjisë në trevat shqiptare <sup>13</sup>	ASH (SSHSHA)	nëntor
7.	Veprimtari përkujtimore në 90-vjetorin e lindjes së kompozitorit Tish Daija	ASH (SSHSHA)	tetor
8.	Konferencë shkencore në 100-vjetorin e vetëqeverimit të Korçës	ASH (SSHSHA), QSA	dhjetor

<sup>12</sup> Nuk u realizua për shkak se shkrimtari dhe studiuesi R. Qosja refuzoi me shkrim të konsideronte pjesëmarrjen dhe shprehu mospëlqim për vetë idenë.

<sup>13</sup> Nuk u realizua, sepse propozuesi i këtij projekti akad. Albert Doja nuk paraqiti një projekt të përfunduar, me tema kuadër, thirrje për pjesëmarrje, buxhet etj.

## D. II. Sipas raportimit të SSHNT-së:

Në zbatim të misionit të Akademisë së Shkencave, SSHNT-ja, për vitin 2016 ka zhvilluar veprimtari, të cilat kanë shënuar kontribute në dobi të prioriteteve të zhvillimit të vendit, si në fushat e ujërave, të pyjeve, të shkencave të tokës, të zbatimit të teknologjive të reja e inovative në vend, në zbatimet inxhinierike, emergjencat civile, të shëndetësisë, të energjisë, të teknologjive të informimit dhe komunikimit, të mjedisit, të biodiversitetit, të bioteknologjive dhe biosigurisë e ushqimit, të etnobotanikës, të nanoteknologjisë, të biosferës dhe njeriut etj. Janë organizuar 7 veprimtaritë e mëposhtme:

**1. Forumi shkencor mbi pasuritë e trashëgimisë kulturore dhe ato ujore, nën këndvështrimin e botimit “Dibra e Madhe dhe Radika”** me autorë msc. T. Jegeni, prof. dr. M. Kolaneci dhe Dr. S. Shatku, organizuar nga SSHNT-ja në bashkëpunim me shoqatën “Bashkësia Dibrane” në kuadër të programit “Edukimi në shkencë”.

**2. Workshop-i “ALBNANO 2016, Nanotechnology and Biosensors – Impact in health, environment, safety and security of Albania”.** Më 29 – 31 maj 2016, Universiteti i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti Mjekësor i Tiranës dhe Instituti Katalan i Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë (ICN2), me mbështetjen e Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Ministrisë së Mjedisit, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Ambasadës së Spanjës në Tiranë, organizuan këtë veprimtari bashkëpunimi Shqipëri-Spanjë, e cila ndihmoi në përgatitjen e projektpropozimit **ALBNANO (ALBAnian Centre of NANObiotechnology and Biosensors)** në kuadër të programit “Horizon 2020” të Komisionit European, të hartuar nga institucionet e sipërpërmendura. ASH-ja mori pjesë aktivisht në organizimin e *workshop*-it me anëtarët e Komitetit Organizativ: akad. S. Bushati, akad. asoc. E. Kongjika dhe akad. asoc. A. Veveçka.

**3. Takimi rajonal i Ballkanit “Terra Madre Balkans” dhe konferenca shkencore ndërkombëtare “Putting farmers first”.** Më 2 – 5 qershor 2016 u organizua në Tiranë takimi rajonal “Terra Madre Balkans” i prodhuesve të vegjël artizanë të ushqimit (Small-Scale Artisan Food Producers, SSAFPs) dhe komuniteteve të ushqimit nga Europa Jugore, së bashku me fermerë, seleksionues, aktivistë, shefa të kuzhinës dhe përfaqësues nga fusha akademike e kërkues të rinj nga rajoni. Në të u diskutua nevoja e SSAFPs për të qenë në qendër të agjendës së politikave si në nivel kombëtar, edhe në atë të BE-së. Të pranishmit në konferencë ishin të shumtë: 350 delegatë nga 13 shtete (Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë, Rumania, Serbia, Turqia, Italia dhe Shqipëria), të cilët u aktivizuan në veprimtaritë e organizuara. Në kuadër të kësaj veprimtarie, më 4 qershor në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u mbajt **konferenca shkencore “Putting Farmers First”** me 2 sesione referimi: një sesion posterash dhe një tryezë e rrumbullakët. Akad. S. Bushati kontribuoi në organizimin e takimit, kurse akad. asoc. E. Kongjika dhe akad. N. Gruda u aktivizuan si anëtarë të komitetit shkencor të këtij aktiviteti shkencor rajonal. Në konferencë morën pjesë kërkues nga vende të ndryshme të Ballkanit, përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, si dhe studentë nga universitete të ndryshme të Shqipërisë. Nëpërmjet mendimeve, ideve apo studimeve kërkimore, pjesëmarrësit dhanë ndihmesën e tyre duke marrë parasysh standardet e integritit në BE në çështjet e bujqësisë shumëfunktionale, të drejtat ligjore të prodhuesve të vegjël, të drejtësisë sociale, turizmit rural, marketingut të produkteve artizanale etj.

**4. Simpoziumi XII ndërkombëtar “Biodiversiteti dhe zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm”** u zhvillua më 21 dhjetor 2016 në Tiranë si bashkëpunim i Akademisë së Shkencave,



fondacionit "BLEKALB", Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministrisë së Mjedisit, Universitetit Bujqësor, Universitetit Polis, Universitetit "Hasan Prishtina" Prishtinë, Kosovë, Universitetit Shtetëror të Tetovës, Maqedoni. President i simpoziumit është prof. dr. Kristaq Kume, koordinatori kombëtar i Resurseve Gjenetike Shtazore për Ushqim dhe Bujqësi dhe kryetar i bordit të drejtorëve të fondacionit "BLEKALB". Akad. S. Bushati është aktivizuar si anëtar i komitetit organizativ të Simpoziumit, kurse akad. asoc. E. Kongjika si anëtare e komitetit shkencor. Në punimet shkencore u trajtuan rezultate të kërkimit shkencor në fusha që lidhen me identifikimin, karakterizimin dhe përdorimin ekonomik dhe të qëndrueshëm të biodiversitetit të kafshët dhe bimët, që përdoren për bujqësi dhe ushqim, rolin dhe vlerën e biodiversitetit, në përgjithësi dhe agrobiodiversitetit në veçanti, si faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm rural, zhvillimin e prodhimit bio- dhe agroturizmit etj. Vend të veçantë iu kushtua paraqitjes së rezultateve të arritura në kërkimet shkencore në fushën e shkencave ekonomike, që trajtojnë çështje të zhvillimit të integruar në rajonet që karakterizohen nga shumëllojshmëria e resurseve natyrore. Simpoziumi miratoi propozimin e konferencës e që u mbështet nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave si dhe nga Ministria e Mjedisit mbi dhënien në simpoziumet e ardhshme të çmimit "Për rezultate të dalluara në kërkimin shkencor në fushën e biodiversitetit" dhe çmimit "Për arritje në ruajtjen dhe përdorimin e biodiversitetit".

**5. Konferenca VII ndërkombëtare "Information Systems and Technology Innovations: the New Paradigm for a Smarter Economy"**, që u zhvillua në Tiranë, më 17–18 qershor 2016 u mbështet dhe u bashkorganizua nga SSHNT-ja me Departamentin e Statistikave dhe Informatikës së Aplikuar të Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës dhe me Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë të Kosovës. Kontribut në organizimin e konferencës kanë dhënë si anëtarë të bordit shkencor akademikët G. Beqiraj, S. Bushati dhe N. Frashëri. Konferenca pati si qëllim të forcojë dhe zgjerojë më tej rrjetin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me kompanitë në sektorin e IT-së, me agjencitë qeveritare dhe me përfituesit e tjerë kryesorë në mjedisin e IT-së. Në fokusin e tendencave të sotme të teknologjisë dhe inovacionit, çështja kryesore e konferencës është "Smart Economy", që përfaqëson ndërveprimin e ekonomisë, teknologjisë së informacionit dhe "Smart Cities" dhe se si një "Smart City" mund të përdoret si një forcë lëvizëse ekonomike kryesore. Eksplorimi i rrugëve të reja dhe përkthimi i tyre në vlera të shtuara për mjedisin dhe shoqërinë tonë në përgjithësi konsiderohen synimet kryesore të teknologjive dhe shërbimeve të krijuara si pjesë e "Ekonomisë Smart". Akademikët N. Frashëri dhe J. Kaçani me bashkautorë paraqitën kumtesën "Environment Monitoring in Public Transport Vehicles" në sesionin "Engineering and Networks".

**6. Workshop-i "Alpet, një pasuri madhështore monumentale e natyrës"**, i zhvilluar në sallën "Aleks Buda", më 23 shtator 2016 u mbështet dhe u bashkorganizua nga SSHNT-ja me Ambasadën e Austrisë, ku bashkësitë e studiuësve të Alpeve Austriake dhe atyre Shqiptare shpalosën eksperiencat e tyre dhe perspektivat për të ardhmen. Qëllimi i kësaj veprimtarie ishte vlerësimi i pasurive të mrekullueshme natyrore të Alpeve Austriake dhe Shqiptare dhe si objektiv nxitja e Turizmit Malor në Shqipëri, kryesisht për Alpet Shqiptare. Në këtë takim u theksua se nxitja e turizmit malor është e lidhur ngushtë me përmirësimin e jetës së komunitetit të zonave malore dhe kërkojnë disa hapa që turizmi malor të jetë sa më cilësor. Ndër to më të rëndësishëm konsiderohen: përgatitja e hartave turistike cilësore dhe vënia e tyre në dispozicion të institucioneve turistike brenda dhe jashtë vendit; publikime sa më të shumta, të sakta dhe cilësore mbi potencialet natyrore në rajonet malore të Shqipërisë. Një hap i rëndësishëm është edhe promovimi i produkteve ushqimore dhe i traditave kulturore



të zonës. Në takim u lidh edhe një marrëveshje ndërmjet bashkësive shqiptare dhe austriake me qëllim realizimin e projekteve të përbashkëta, që synojnë studimin, evidentimin, pasqyrimin dhe promovimin e potencialeve natyrore të Alpeve Shqiptare në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare dhe vënien e këtyre potencialeve në dobi të komunitetit dhe zhvillimit të turizmit malor.

**7. Konferenca ndërkombëtare “Frutikultura alternative”,** që u organizua më 5 tetor 2016, në Vlorë nga QTTB-ja, Vlorë dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave u mbështet fuqimisht nga Qendra e Kërkimit të Frutikulturës, Romë, Itali, nga kompania private “Apice Piante”, Pescara, Itali, nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, si dhe nga **SSHNT-ja (ASH)**. Pas një panorame për speciet e reja autoktone, që marrin rëndësi të veçantë në kuadër të zhvillimeve moderne të frutikulturës europiane, u paraqit përvoja pozitive e specialistëve italianë në këtë fushë. Dr. Flavio Roberto de Salvador, drejtor i Qendrës së Kërkimit Eksperimental të Frutikulturës së Romës, ndërmjet arritjeve të suksesshme të kësaj qendre kërkimore-shkencore, theksoi rëndësinë e përfshirjes së varieteteve të reja të specieve me përdorim të pakët në strukturën e frutikulturës moderne, që ndikon fuqimisht në shëndetin e njeriut. Me interes u ndoq referimi i dr. Roberto di Primio, titullar i kompanisë private “Apice Piante”, Pescara në Itali, që përdor metodën inovative bioteknologjike të kulturës *in vitro* për prodhimin e fidanëve të certifikuar nga ana fitosanitare dhe për pastërtinë gjenetike. Nga referuesi dhe auditori u mbështet fakti i domosdoshmërisë së prodhimit të fidanëve edhe në Shqipëri me anë të mikroshumimit me avantazh uniformitetin e tyre dhe mungesën e fitopatogjenëve. Akad. asoc. E. Kongjika dhe prof. asoc. dr. Valbona Sota paraqitën dy punime shkencore për konservimin *in vitro* të specieve autoktone me përdorim të pakët. Në tryezën e rrumbullakët të organizuar në fund të konferencës u propozua përpilimi i një deklaratë të konferencës për të sensibilizuar instancat politikëbërëse dhe vendimmarrëse për përfshirjen e frutikulturës alternative, si një rrugë e re e zhvillimit të frutikulturës shqiptare në kuadrin e zhvillimeve të sotme europiane. Akademia e Shkencave, duke pasur si mision të saj bashkëpunimin me institucionet kërkimore brenda dhe jashtë vendit për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës dhe teknologjisë dhe veçanërisht bashkëpunimin me biznesin për zbatimet e produkteve të kërkimit shkencor dhe inovativ në ekonomi, e mbështet këtë nismë dhe sugjeron disa opinione për organizimin e punës përgatitore. Si domosdoshmëri paraqitet sensibilizimi i popullatës shqiptare për vlerat ushqyese e mjekësore të përdorimit të frutave alternative, si dhe i fermerëve për kultivimin e tyre me përfitim jo vetëm nga përdorimi në tregun e brendshëm, por me përparësi në tregun european dhe global. Organizimi i veprimtarive si seminare, *workshop*-e nga institucione të kërkimeve bujqësore së bashku me ASH-në do të kontribuojnë në këtë drejtim.

**8. Konferenca kombëtare “Siguria e digave dhe menazhimi i tyre”,** organizuar më 17 tetor 2016 nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujërave, mbështetur nga SSHNT-ja. Konferenca kishte si qëllim ndërgjegjësimin e institucioneve qendrore dhe vendore për detyrimet ligjore që ka secili në këtë fushë dhe propozimi i masave të mëtejshme që duhet të ndërmerren. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të lartë shtetërorë të angazhuar në fushën e menazhimit të digave; përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor në fushën e ujit; institucione të rëndësishme shkencore që kanë pjesë të veprimtarisë së tyre projektimin, menazhimin e mirëmbajtjen e digave; përfaqësues të pushtetit lokal që merren me menazhimin e digave dhe investitorë që operojnë në këtë sektor. SSHNT-ja mori pjesë në këtë konferencë me dy referime: “Vlerësimi i gjendjes fiziko-mekanike të digave të hidrocentraleve sipas të dhënave gjeofizike *in situ* të realizuara në kaskadën e Drinit dhe të Matit” (S. Bushati, A. Frashëri) dhe “Monitorimi i rrëshqitjeve në shpatet e liqeneve të hidrocentraleve, sipas të dhënave gjeofizike zbatuar në zonën e Poravës,

Fierzë dhe Ragamit në Vaun e Dejës” (A. Frashëri, S. Bushati). Konferenca theksoi domosdoshmërinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve përgjegjëse të digave dhe institucioneve të kërkimit shkencor, vazhdimin e takimeve në rang kombëtar dhe lokal, nevojën e ngritjes së një grupi tekniko-shkencor, që do të bëjë inventarizimin teknik të të gjitha digave dhe ringritjen e një Instituti Kombëtar të Ujit.

Anëtarët e Seksionit që punojnë në ASH kanë marrë pjesë aktivisht në disa konferenca të organizuara nga Rrjeti i Akademive të Shkencave të Botës (InterAcademy Partnership), ai i Vendeve të Europës (All European Academies) si dhe nga institucionet kërkimore shkencore, me të cilat Akademia bashkëpunon brenda e jashtë vendit:

a. Anëtarët e SSHNT-së kanë paraqitur idetë e tyre interesante në **Konferencën ndërkombëtare shkencore “Technology + Society ‘!?’ Future”**, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Malit të Zi në bashkëpunim me Akademinë Botërore të Artit dhe Shkencës (WAAS), Akademinë Europiane të Shkencave dhe Arteve (EASA), Global Round-Table (GRT) dhe Federatën Europiane të Akademive Kombëtare të Shkencave Natyrore dhe Humane (ALLEA). Në konferencë u trajtuan çështje si teknologjia e progresit: sfidat dhe kërcënimet; teknologjia dhe vlerat e saj në ditët e sotme; kontrolli i teknologjisë, kufizimet ligjore dhe etike; teknologjia dhe gjinia etj. Akademikët G. Beqiraj dhe N. Frashëri në kumtesën e tyre “The tragedy of innovation – reflections on innovation and disruption impacts” theksuan rolin aktual të inovacioneve si çështje themelore në agjendat politike, në strategjitë dhe programet e zhvillimit për rritjen ekonomike dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Në anën tjetër, risitë e detyruara/të përshpejtuara krijojnë thyerje në kompleksin e marrëdhënieve shoqërore-ekonomike, që menazhohen me vështirësi. Jepet mesazhi se politikatat në vendet e vogla në zhvillim duhet të përshtaten me kujdes duke shmangur importimin e ideve nga vendet e mëdha dhe të zhvilluara në mënyrë që të nxisin rritjen e qëndrueshme. Në kumtesën e akad. S. Bushatit dhe msc. A. Bushatit “Encourage the creativity starting at the early childhood – the most effective investments for quality young researchers in the future” iu kushtua vëmendje e veçantë inkurajimit të kreativitetit që nga fëmijëria e hershme, si investimi më efektiv për kërkuesit e rinj të së ardhmes. Esencial është rikonceptimi i edukimit dhe i prioritetëve, me qëllim që të nxitet te fëmijët sensi i inovacionit, i cili më vonë do reflektohet në interesin e të rinjve në fusha të ndryshme të shkencës dhe kërkimit shkencor, duke rritur kështu kontingjente të reja kërkuesish të suksesshëm.

b. Në përgjigje të zbatimit të teknologjive inovative, anëtarë të SSHNT-së (N. Frashëri, G. Beqiraj dhe S. Bushati, si dhe prof. dr. A. Frashëri) paraqitën në **konferencën “EO Open Science Conference 2016” në ESA (European Space Agency)**, organizuar në Frascati, Itali referimin për përdorimin e teknologjive të imazheve satelitore në zgjidhjen e problematikave mjedisore me përdorimin e imazheve satelitore SAR në “pika të nxehta” si në zonën e Semanit dhe atë të Liqeneve të Prespës dhe Ohrit në harkun kohor 2003–2010 dhe 1999–2002. Përdorimi i këtyre metodave hap rrugën për aplikimin e tyre me sukses në vlerësimin e problematikave mjedisore.

c. Një nga tematikat më të rëndësishme në Programet e Bashkimit Europian është ai i energjisë, si faktor përcaktues i zhvillimit të qëndrueshëm dhe, në këtë kuadër, u zhvillua në Bratislavë, më 30 dhjetor 2016, **konferenca shkencore ndërkombëtare “Sistemet e informacionit të teknologjive strategjike të energjisë (SETIS Conference- informacion për vendimmarrësit)”**, ku mori pjesë akad. S. Bushati. Në konferencë u shpalos Strategjia e Zhvillimit të Bashkimit Europian. Akad. S. Bushati diskutoi për gjendjen e burimeve energjetike në Shqipëri dhe për nevojat e ndërmarrjes së nismave në këndvështrimin e kontributit që kërkohet të jepet nga kërkimi shkencor. Duhet që pas disa vitesh zbatimi të Programit Kombëtar për

Ujin dhe Energjinë të rishikohet programi në përputhje me përparësitë e energjisë dhe stimulimin e prodhimit të energjive të rinovueshme në harmoni me strategjitë e zhvillimit të vendit.

**d. Konferenca shkencore ndërkombëtare “Water, Knowledge and Innovation in the Danube Region”,** zhvilluar më 3 – 4 nëntor 2016 në Bratislavë, Sllovakia dhe organizuar nga Komisioni European, ku u mbajtën referime kryesore nga ekspertë europianë dhe sllovakë, si dhe u zhvilluan 6 *workshop*-e, ku u trajtuan problematika të rëndësishme me fokus ujin dhe përdorimin e tij. Pas një seance diskutimesh të lira për problematikën e ndryshme u raportua në lidhje me thirrjen e dytë të *Programit* ndërshtetëror *INTERREG – Danubi*, që do të hapet në janar 2017. Projektet në këtë thirrje do të fokusohen në partneritete të bashkëpunimit ndërmjet vendeve me 4 tematika prioritare dhe objektiva specifike. Në diskutimet e konferencës, në lidhje me prioritetet e paraqitura nga drejtuesja e *Programit* *INTERREG – Danubi* zhvilloi një diskutim akad. S. Bushati, i cili prezantoi interesat e Shqipërisë në kuadër të këtij programi dhe objektivave që ai synon të zgjidhë.

**e.** Në kuadër të programit “Edukimi në shkencë” janë realizuar përrurime të veprave shkencore; janë nderuar figura të spikatura të shkencës shqiptare; “Ditë informimi” dhe “Ditë të hapura” të institucioneve shkencore, mbështetje e shkencëtarëve të rinj në institucione shkencore elitare ndërkombëtare, veprimtari për nxitjen e të rinjve për shkencë etj.:

- Prezantimi i botimit “Bazat e Teorisë së Relativitetit” i autorit prof. dr. H. Sykja. Veprimtaria u realizua në kuadër të “Vitet të Ajshtajnit”.

- Takimi shkencor “Ujërat termominerale dhe minerale të Shqipërisë” për prezantimin nga autorë prof. dr. R. Eftimi dhe prof. dr. A. Frashëri.

- Simpoziumi shkencor “Akademik prof. Teki Biçoku, një jetë kushtuar shkencave të tokës”. Ky simpozium u organizua nga Akademia e Shkencave dhe nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në kuadër të programit “Edukimi në shkencë”, që përkon me rastin e 90-vjetorit të lindjes të akad. Teki Biçokut.

- Gjatë ditëve të zhvillimit të veprimtarive të “Terra Madre Balkans”, akademik prof. dr. Andrea Pieroni, anëtar nderi i ASH-së, zëvendësrektor i Universitetit të Gastronomisë së Torinos mbajti seminarin “New wine in old wine flasks? Of the importance of documenting traditional plant uses in Albania”, me ekspertë, studentë universitarë dhe pasuniversitarë të përzgjedhur nga universitetet, institucionet dhe qendrat shkencore në Shqipëri.

- Ceremonia e dorëzimit të medaljes “Nderi i Akademisë”, prof. dr. Mira Mezin me motivacionin: *Shkencëtares shqiptare, vlerësuar botërisht si kërkuese ekselente dhe si lider në trendet bashkëkohore në fushën e programimit dhe softuerit të shpërndarë në “cloud”*. prof. dr. Mira Mezin aktualisht konsiderohet si një nga ekspertet më të mira në lëmin e shkencave kompjuterike në Gjermani.

### **Veprimtari të tjera shkencore<sup>14</sup>**

**1.** Promovimi i librit të **prof. Gjergj Frashërit, *Dyrrahu ilir*** (27 janar 2016), mblodhi në ASH arkeologë, historianë, kolegë e bashkëpunëtorë të autorit, studentë dhe dashamirës të kulturës dhe vlerave të pasurisë sonë kombëtare. Ky prezantim u bë në bashkëpunim me fondacionin “Qendra Frashëri” dhe me mbështetjen e Ambasadës së Republikës Federale Gjermane në Shqipëri. Referuesi i parë **akad. Muzafer Korkuti**, njëherësh edhe arkeolog, vlerësoi botimin voluminoz trigjuhësh të prof. Gjergj Frashërit si për nga cilësia, dokumentacioni i përsosur i pasqyruar aty, të dhënat e shumta bibliografike, por edhe për

<sup>14</sup> Renditja sipas kronologjisë.

sjelljen e të dhënave të panjohura deri më sot mbi gjeografinë historike të Durrësit në përgjithësi, si dhe të sheshit të gërmimit në veçanti. Gjithashtu veprën e vlerësoi edhe ambasadori i Republikës Federale Gjermane në Shqipëri **z. Helmuth Hoffmann**. Vlerësime u paraqitën nga studiuesit **Moikom Zeqo** dhe **Hava Hidri**, e cila zbulimin e lagjes romake nga Gjergj Frashëri, e quajti *sintezë që vërtetoi hipotezat disavjeçare të arkeologëve*.

**2. Eposi shqiptar i kreshnikëve në pesë shtete të Ballkanit**, fitues i çmimit “Europa Nostra” (21 shtator 2016) ishte veprimtaria që ASH-ja organizoi për përfundimin e dosjes së regjistrimit të eposit heroik legjendar në programin e UNESCO-s si *trashëgiminë jomateriale të njerëzimit*, e cila u vlerësua me çmimin special “Europa Nostra”. Dosja është përgatitur nga një grup studiuesish, mbi bazën e një vendimi të Qeverisë së Kosovës. Në këtë veprimtari përshëndetën kryetari i ASH-së **akad. Muzafer Korkuti** dhe **akad. Arsim Bajrami** (ministër i Arsimit dhe Shkencës, Kosovë). Kryetari i grupit të punës **prof. Zymer Neziri**, si dhe **prof. Begzad Baliu**, si anëtar i nëngrupit të punës, paraqitën në mënyrë të hollësishme rezultatet e këtij projekti. Një paraqitje e përmbajtjes së dosjes u bë nga **prof. Shaban Sinani**. Certifikata e dhënë në Madrid, më 24 maj 2016, u dorëzua në mënyrë simbolike nga **prof. Lida Miraj**, përfaqësuese në Tiranë e çmimit “Europa Nostra”. Kjo veprimtari u moderua nga **akad. Vasil Tole**, Sekretar Shkencor i ASH-së dhe anëtar i SSHSHA-së.

**3. Vepra e Ismail Kadaresë në kontekstin e letërsisë moderne europiane** (28 tetor 2016), nga prof. dr. Matteo Mandalà. Ligjërata akademike është mbajtur me rastin e dhënies së Çmimit të Kulturës Mesdhetare (*Premio per la Cultura Mediterranea*) për vitin 2016, shkrimtarit dhe **akad. Ismail Kadare**. Para fillimit të kësaj ligjërate, kryetari i ASH-së, akad. Muzafer Korkuti deklaroi pranimin e prof. Matteo Mandalà-së si *Anëtar nderi* i saj. Në fjalën e kryetarit të ASH-së zinte vend gjithashtu profili intelektual i shumanshëm i Matteo Mandalà-së.

**4.** Promovimi i botimeve *Etnogjeneza e ilirëve* dhe *Shkrime* (si një histori e shkencës arkeologjike shqiptare), me autor **akad. Muzafer Korkuti**, kryetar i ASH-së, u bë më 15 dhjetor 2016. Në vlerësimet e bëra nga kolegë arkeologë e studiues të **akad. Muzafer Korkutit**, si **prof. Lorenc Bejko**, **prof. Gjergj Frashëri** e **prof. Shaban Sinani**, u theksua se këto botime janë një dëshmi historike e përpjekjeve të shkencës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX për të ndriçuar një proces historik me rrjedhoja tejet të rëndësishme për historinë e lashtë të Ballkanit Perëndimor: origjinën dhe shfaqjen e ilirëve; dhe kjo është mënyra më e mirë për t’u njohur me evoluimin e mendimit shkencor shqiptar të shekullit të kaluar për këto çështje. Aktiviteti u pasurua me dy dokumentarë: pjesë nga *Kuvendi I i Studimeve Ilire*, mbajtur më 15–20 shtator 1972 dhe filmime nga gërmime të ekspeditave arkeologjike të **akad. Muzafer Korkutit**. Po ashtu, u hap një ekspozite e pasur me foto të ekspeditave të gërmimeve, pjesëmarrjeve të tij në kuvende studimesh, konferenca e simpoziume brenda e jashtë vendit.

#### **Dh. Organizim konkursesh dhe dhënie çmimesh<sup>15</sup>**

Nxitur edhe prej rekomandimeve të ALLEA-s, me propozim të **akad. Vasil Tole**, u themeluan çmimet për kërkim shkencor akademik: **Çmimi i karrierës**, **çmimi “Çabej”**, **çmimi “Radovicka”** dhe **Çmimi i kërkuesit të ri**. SSHSHA-ja ka kontribuar me pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në konceptimin e objektivave dhe qëllimeve kryesore të këtyre çmimeve, në hartimin e rregullores së konkursit, në formulimin e kriterëve të pjesëmarrjes, detyrave dhe procedurave të jurisë dhe të shpalljes së vendimeve për fituesit. Rezultati pozitiv është i dukshëm, si në pikëpamje të hapjes

<sup>15</sup> Raportimi sipas ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, neni 4, funksionet, pika **dh**: *Organizon konkurse dhe dhënie çmimesh shkencore*.



së ASH-së ndaj brezave të rinj të studiuesve, ashtu dhe në pikëpamje të zgjimit të interesit për konkurrim tek albanologët brenda dhe jashtë vendit. Këto çmime krijojnë vijimësinë e tre brezave të studiuesve. Numri i veprave të paraqitura për konkurrim është rreth 60 tituj. Themelimi i këtyre çmimeve i jep mundësi ASH-së të identifikojë cilësinë shkencore dhe të inkurajojë më të suksesshmit. SSHSHA-ja konsideron si një prej arritjeve më të rëndësishme të tij shtimin e urave të bashkëpunimit dhe krijimin e një bashkësie studiuesish të afërt me të, me mundësi afatgjatë projektesh dhe botimesh të përbashkëta. Pjesëmarrja e anëtarëve të SSHNT-së në jurinë e konkursit, si dhe ekspertizat e specialistëve të brendshëm e të ftuar kanë kontribuar në nominimin e 4 veprave shkencore për **çmimin shkencor kombëtar vjetor "Radovicka"** për studimin më të mirë në fushën e shkencave natyrore dhe teknike ("Ujërat termale dhe minerale të Shqipërisë" me autorë A. Frashëri dhe R. Eftimi; "Bazat dhe metoda klinike e trajtimit të dhimbjes fantome" me autor A. Vaso; "Polimorfizmi gjenetik i sistemit HLA në popullatën shqiptare dhe roli i markuesve imunologjikë dhe imunogjenetikë në realizimin e transplanteve dhe diagnozën e sëmundjeve autoimune" me autor G. Sulcebe dhe "Pasuritë Ujore të Shqipërisë" me autor N. Pano) dhe 2 nominime për **Çmimin shkencor kombëtar vjetor të kërkuesit të ri** më të suksesshëm në fushën e shkencave natyrore dhe teknike ("Integrating antimicrobial therapy with host immunity to fight drug-resistant Infections: Classical vs Adaptive treatment" me autore E. Gjini dhe "Molecular Evolution of Pyroglutamylated RFamide peptide and Orphan G Protein Coupled Receptor" me autor R. Baku).

Për të nxitur dhe vlerësuar arritjet në kërkimin shkencor në fushën e biodiversitetit dhe të përdorimit të tij për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, simpoziumi XII ndërkombëtar "Biodiversiteti dhe zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm", që u zhvillua më 21 dhjetor 2016 si bashkëpunim i Akademisë së Shkencave (SSHNT) dhe një sërë institucioneve shkencore dhe mësimore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, ka miratuar propozimin e konferencës e që u mbështet dhe nga MBZHRAU si dhe Ministria e Mjedisit mbi dhënien në simpoziumet e ardhshme të çmimit "Për rezultate të dalluara në kërkimin shkencor në fushën e biodiversitetit" dhe të çmimit "Për arritje në ruajtjen dhe përdorimin e biodiversitetit".

#### • Drejtime kryesore për veprimtarinë e vitit 2017

##### A. Sipas raportimit të SSHSHA-së

SSHSHA-ja përcakton si përparësi kryesore të punës së vet këto drejtime:

**1. Pjesëmarrje aktive brenda ASH-së, në komisionet përkatëse dhe në këshillimet në bashkësinë e studiuesve akademikë gjatë procesit përgatitor për një zgjidhje ligjore afatgjatë mbi statusin e ASH-së.** Qëllimi kryesor i këtij prioriteti është ruajtja e autonomisë akademike, dalja prej krizës statutore, ripërcaktimi afatgjatë me qartësi i funksioneve të ASH-së, mbrojtja e interesave të institucionit prej rrezikut të degradimit të nismës për reformën në një propozim me karakter thjesht administrativ. SSHSHA-ja duhet të përgatitet për të pasur një propozim të vetin, në formën e amendamentit ligjor, për të përsosur zgjidhjen e pritshme.

**2. Ngulmimi për një zgjidhje ligjore afatgjatë për përdorimin e gjuhës shqipe** është një çështje që i takon drejtpërdrejtë ASH-së dhe SSHSHA-së. Ky detyrim është parashikuar në nenin 14 të Kushtetutës, pika 1. Pikat 2, 3 dhe 4 të këtij janë zgjidhur me kohë, me hartimin

<sup>16</sup> Neni 14 i Kushtetutës së Shqipërisë përcakton: 1. **Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja;** 2. **Flamuri kombëtar** është i kuq me një shqiponjë të zezë dykrenore në mes. 3. **Stema e Republikës së Shqipërisë** paraqet një shqyt me fushë të kuqe me një shqiponjë të zezë dykrenore në mes. Në krye të shqytit, me ngjyrë të artë, është vendosur përkrenarja e Skënderbeut. 4. **Himni kombëtar** është *Rreth Flamurit të Përbashkuar*.



e një ligji të posaçëm për simbolet kombëtare, himnin dhe stemën shtetërore të Shqipërisë, hartuar nga ASH-ja, me pjesëmarrjen e akad. Vasil Tole dhe të bashkëpunëtorëve të tjerë<sup>16</sup>.

**3. Përparësi shkencore e SSHSHA-së mbetet si gjithnjë forcimi i bashkëpunimit me ASHAK-un.** Për këtë vit është parashikuar konferenca shkencore ndërkombëtare “Studimet albanistike në arealin e gjermanishtes”, në të cilën priten kontribute më të mëdha nga anëtarët e SSHSHA-së dhe nga bashkëpunëtorët. Protokollit të bashkëpunimit ndërkademi këtë vit i mbaron afati dhe duhet përtëritur, duke propozuar veprimtari konkrete, angazhuese, që kanë të bëjnë me identitetin shqiptar, gjuhën, traditën. Është e domosdoshme të rigjallërohet veprimtaria e KNGJSH-së.

**4. SSHSHA-ja do të rrisë rolin e vet për vendosjen e urave të qëndrueshme me brezin e ri të studiuesve,** në përputhje me *Procesin e Berlinit* dhe me *rezolutën e ALLEA-s (2016)* për krijimin e statusit të *akademikëve të rinj*.

**5. Dy veprimtaritë më të rëndësishme shkencore** që duhet të përgatisë dhe të përballojë SSHSHA-ja janë: **a.** *250-vjetori i lulëzimit të Voskopojës, si një kryevatër e iluminizmit në Ballkanin e shek. XVIII*; **b.** *Gjergj Kastrioti - Skënderbeu si figurë e shekujve të humanizmit europian*.

**6. SSHSHA-ja e sheh të domosdoshme daljen e ASH-së nga gjendja ishullore** që ka tani, përmes pjesëmarrjes në nisma ndërkademi në Ballkan dhe më gjerë, si dhe përmes përfshirjes në nisma europiane.

**7. SSHSHA-ja do të ngulmojë që themelimi i çmimeve shkencore akademike kombëtare t’i shërbejë nxitjes së konkurrencës për cilësi** në kërkimin shkencor në shkencat kombëtare dhe shoqërore, duke identifikuar përmes këtyre çmimeve cilësinë shkencore që ajo kërkon.

**8. Është detyrë e SSHSHA-së të lehtësojë bashkëpunimin midis institucioneve shkencore universitare,** publike e jopublike, duke ofruar vetveten në rolin e koordinatorit, bashkërenduesit, këshilluesit shkencor. Kjo na kërkon vendosjen e kontakteve dhe rregullimin e bashkëpunimit në formë të institucionalizuar, duke tejkaluar gjendjen e deritashme, që karakterizohet kryesisht prej ofrimit të të tjerëve për bashkëpunim dhe ndonjëherë edhe prej rastësisë. Në mënyrë të veçantë konsiderojmë një diskutim të frytshëm me QSA-në.

## **B. Sipas raportimit të SSHNT-së**

- Konferenca shkencore ndërkombëtare “**Kanceri i qafës së mitrës: parandalimi, diagnostikimi dhe trajtimi i tij**”, Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike në bashkëpunim me “Cytomol”, Frankfurt mbi Main, Gjermani, Ministrinë e Shëndetësisë, Universitetin e Mjekësisë Tiranë, Institutin e Shëndetit Publik, Spitalet Universitare Obstetrike Gjinekologjike “Mbretëresha Geraldinë” dhe “Koço Gliozheni” dhe Shoqatën e Patologëve Shqiptarë (4 shkurt 2017);

- Konferenca shkencore ndërkombëtare në fushën e obstetrikë-gjinekologjisë, Shoqata Shqiptare e Obstetrikë-Gjinekologjisë dhe SSHNT-ja (12–14 maj 2017);

- Konferenca shkencore ndërkombëtare për moshën e tretë dhe sëmundshmërinë, SSHNT-ja në bashkëpunim me ASAG-un dhe me Shoqatën Shqiptare të Geriatriisë dhe Gerontologjisë (shtator 2017);

- Konferenca për 20-vjetorin e revistës “Journal of Natural and Technical Sciences”, SSHNT (tetor 2017);

- Ceremonia e dhënies së medaljes “Nderi i Akademisë” dr. Agim Ballvorës, Universiteti i Bonit, Gjermani (mars 2017);

- Seminar shkencor “Bioteknologjia moderne bimore dhe efektet në ekonomi” me dr. Agim Ballvorën, Gjermani, SSHNT (ASH) në bashkëpunim me UT-në dhe UBT-në (tetor-nëntor 2017);

- Takime shkencore me shkencëtarë, pasuniversitarë, grupe të palëve të interesit, komunitetit të biznesit e prodhuesve si dhe shoqërisë civile për problematika të kohës (SSHNT-ja në bashkëpunim me institucione shkencore dhe mësimore, biznese dhe shoqata etj.) (vazhdimisht gjatë vitit 2017);

- Veprimtari shkencore për tematika përparësore të komisioneve tekniko-shkencore të SSHNT-së:

1. Forum shkencor “Arritje në pemëtari, vreshtari në Shqipëri dhe Kosovë dhe përdorimi i metodave bashkëkohore në prodhim dhe certifikim”, SSHNT (E. Kongjika) në bashkëpunim me ASHAK-un dhe Universitetin e Prishtinës (shtator 2017, Prishtinë) dhe me UT-në dhe UBT-në (tetor 2017, Tiranë);

2. Simpozium shkencor “Hortikultura Shqiptare në këndvështrimin e botimit **Një vështrim enciklopedik për hortikulturën** me autorë akad. N. Gruda dhe prof. dr. A. Shundi”. SSHNT (ASH) në bashkëpunim me UBT-në (qershor 2017);

3. Simpozium shkencor “Pasuritë floristike të Shqipërisë të paraqitura në botimin *Atlasi i Florës Shqiptare* me autor J. Vangjeli”. SSHNT (ASH) në bashkëpunim me UT-në, FSHN (nëntor 2017);

Seksioni në synimet për bashkërendimin e grupeve të punës me specialistët më të mirë të fushave, për të realizuar studime të rëndësisë së veçantë e prognoza të problematikave kombëtare e më gjerë në fushat përparësore, do të konkretizojë ngritjen e komisioneve *ad hoc* apo të përhershme të tilla si: Komisioni i Ujit, Komisioni i Shkencave të Tokës dhe Emergjencave Civile, Komisioni i Biodiversitetit dhe Mjedisit dhe Komisioni i Bujqësisë, Ushqimit dhe Bioteknologjisë.

Këto komisione do të udhëhiqen nga akademikë të shquar e specialistë në vend, jashtë vendit e në diasporë dhe parashikojnë kontribute në fushat e kompetencës, në kohë reale e cilësore, për ministritë e ndryshme e sidomos për Ministrinë e Arsimit e Sporteve, Ministrinë e Inovacionit, Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucione të rëndësishme kombëtare e më gjerë.

## SHTOJCË I



### Administrata dhe shërbimet

#### I. Financa

Realizimi i shpenzimeve për periudhën janar–dhjetor 2016 krahasuar me planin vjetor të miratuar paraqitet si vijon:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Buxheti vjetor 2016	Fakti i 12-mujorit të vitit 2016	Në përqindje
1.	Paga (600)	25000	24843	99
2.	Sigurime shoqërore (601)	3650	3628	99
3.	Shpenzime korente (602)	35700	35684	100
4.	Transferta të brendshme (604)	700	609	87
5.	Transferta me jashtë (605)	400	397	99
6.	Transferime të brendshme (606)	28274	28224	100
7.	Investime (231)	2000	1969	98
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>95724</b>	<b>95354</b>	<b>100</b>




Shpenzimet faktike krahasuar me fondet e buxhetit për vitin 2016:

- Artikulli 600 është realizuar 99 për qind
- Artikulli 601 është realizuar 99 për qind
- Në artikullin 602 realizimi i fondeve është 100 për qind
- Për artikullin 604 (shpenzime për Kosovën) janë realizuar 87 për qind.
- Në artikullin 605 (pagesa të kuotave të anëtarësisë në organizata ndërkombëtare ku aderon institucioni), janë realizuar 99 për qind.
- Artikulli 606 është realizuar në masën 100 për qind
- Në zërin 231 realizimi i fondeve është 98 për qind

Shpenzimet me fondet e buxhetit sipas limiteve të miratuara janë si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fondi limit i 12-mujorit të vitit 2016	Fakti i 12-mujorit të vitit 2016	Në përqindje
1	600-601	28650	28470	99
2	602-606	65074	64914	100
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>93724</b>	<b>93384</b>	<b>100</b>



Niveli i realizimit të shpenzimeve në total për vitin 2016 në krahasim me fondet e vëna në dispozicion arriti në 100 për qind.

Gjatë vitit 2016 janë mbështetur financiarisht këto veprimtari:

**I. Realizim i projekteve dypalëshe e shumëpalëshe:**

1. Ndërmjet ASH-së dhe ASHAMZ-it;
2. Ndërmjet ASH-së dhe ASHAM-it;
3. Me rrjetin e akademive të vendeve të Europës Juglindore (IAC SEE).

**II. Konferenca dhe simpoziume:**

1. *Shekulli i Kadaresë*, në 80-vjetorin e lindjes;
2. *Dritëro!* me rastin e 85-vjetorit të lindjes së akad. Dritëro Agollit;
3. Konferencë dhe koncert me vepra kamerale të akad. Zeqirja Ballata;
4. *1000-vjetori i Shën Gjon Vladimirit*, Podgoricë
5. *100-vjet nga vetëqeverimi i Korçës*;
6. *Tish Daija*, në 90-vjetorin e lindjes (1926–2003);
7. Adem Demaçi dhe letërsitë shqipe;
8. *The Balkan Jews & the Minority Issue in South-Eastern Europe*, Poloni;
9. *Esat Mekuli*: në 100-vjetorin e lindjes, Prishtinë;
10. *Ndre Mjeda* në 150-vjetorin e lindjes, Prishtinë;

11. Simpozium shkencor në kuadër të programit “Edukimi në shkencë”, me rastin e 90-vjetorit të lindjes së akad. Teki Biçokut;

12. Konferencë shkencore ndërkombëtare *Putting Farmer First*, në kuadër të takimit rajonal *Terra Madre Balkan*.

### III. Botime dhe përrurime:

1. Botime monografish;

2. Botimi i dy numrave të revistës shkencore *Journal of Natural and Technical Sciences (JNTS)*;

3. Botimi i dy numrave të revistës *Studia Albanica*.

IV. Forume shkencore, promovime botimesh, tryeza të rumbullakëta me grupe ekspertësh:

1. Promovimi i botimit *Dyrrahu Ilir*, me autor Gjergj Frashërin;

2. Promovimi i dosjes *Eposi i kreshnikëve në 5 shtete të Ballkanit*, i nderuar me çmimin “Europa Nostra”;

3. Forumi publik: *Karta e Gjelbër: Rimodelimi i zhvillimit ekonomik në kontekstet lokale, i akad. asoc. Kosta Barjaba*;

4. Promovimi i botimeve *Etnogjeneza e ilirëve dhe Shkrime* (si një histori e shkencës arkeologjike shqiptare), me autor akad. Muzafer Korkuti;

5. *Vepra e Ismail Kadarese në kontekstin e letërsisë moderne europiane*, nga **prof. dr. Matteo Mandalà dhe dhënia e titullit “Anëtar nderi i ASH-së”;**

6. **Dhënia e mirënjohjes “Nderi i ASH-së” kryeministrit të Kosovës z. Hashim Thaçi;**

7. Promovim i botimit *Bazat e teorisë së relativitetit* me autor prof. dr. Halil Sykjen, në kuadër të programit “Edukimi në shkencë”;

8. Promovimi i botimit *Dibra e Madhe dhe Radika* me autorë msc. Tofik Jegeni, prof. dr. Molnar Kolaneci, dr. Saimir Shatku (*Edukimi në shkencë*);

9. Promovimi i botimit *Ujërat minerale dhe termale të Shqipërisë*, me autorë prof. dr. Romeo Eftimin dhe prof. dr. Alfred Frashërin, në kuadër të programit “Edukimi në shkencë”;

10. Leksion i hapur me studentë pasuniversitarë nga akad. Andrea Pieroni, anëtar i jashtëm i ASH-së: *New wine in old wine flasks? Of the importance of documenting traditional plant uses in Albania*;

11. Takim shkencor *Alpet – një pasuri madhështore monumentale e natyrës*;

12. Mirënjohja “Nderi i ASH-së” prof. Mira Mezinit;

13. *Albano 2016*, workshop.

## II. Veprimtaria e bibliotekës shkencore të ASH-së dhe botimet kryesore

Biblioteka shkencore e ASH-së kryen veprimtarinë e saj përmes qasjes së informacionit shkencor në shërbim të komunitetit shkencor, akademikëve, kërkuesve shkencorë e studiuesve të disiplinave të ndryshme shkencore, studentëve dhe gjithë të interesuarve për shkencën.

Drejtimet e punës së BSH-së edhe për vitin 2016 janë përqendruar në rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që biblioteka ofron përmes: shfrytëzimit optimal e efikas të infrastrukturës teknologjike, të burimeve e kapaciteteve të saj dhe të kualifikimit profesional të stafit të bibliotekës.

Rritja e cilësisë së shërbimeve është synuar duke gërshetuar kërkesat e kërkuesve



shkencorë sipas fushave të tyre të interesit, me mundësitë që ofron BSH-ja nëpërmjet:

**1.** Shfrytëzimit të katalogëve të saj tradicionalë (me skedarët sistematikë, sipas lëndës, dhe skedarët alfabetikë), si dhe të katalogëve online.

**2.** Mbështetjes së kërkuesve të rinj, studiuesve të doktoraturës dhe atyre të masterit shkencor të degëve të ndryshme duke siguruar qasje në informacion nëpërmjet literaturës shkencore: tituj e monografi shkencore dhe burime të tjera; periodikë: revista shkencore të niveleve të përparuara në shqip dhe gjuhë të huaj për hulumtime të specializuara sipas indekseve.

**3.** Krijimit të hapësirës së nevojshme për pavarësi në kërkimin shkencor nëpërmjet qasjes e përdorimit të lehtë të internetit në sallë. Ky lehtësim është arritur edhe përmes përdorimit të internetit në mjediset e bibliotekës, duke mundësuar shfletim të informacionit elektronik dhe përdorimin e katalogut *online*. Kujdesi në shërbimin ndaj përdoruesve nëpërmjet vënies në dispozicion të tyre të katalogëve manualë dhe katalogut elektronik; serioziteti në përzgjedhjen e botimeve të reja dhe atyre retrospektive përmes konsultimit me katalogët informues dhe me entet botuese brenda dhe jashtë vendit në funksion të *pasurimit* të BSH-së, si dhe përshpejtimi i ritmeve të regjistrimeve bibliografike në bazën e përbashkët të të dhënave COBISS.AL, e cila përfaqëson një sistem bibliografik të ndërtuar mbi platformën COBISS, kanë qenë përparësi për funksionimin e BSH-së në drejtim të zhvillimit të shërbimeve të saj.

Fondi i BSH-së është pasuruar nëpërmjet tri proceseve kryesore: blerjes së botimeve të reja shkencore, shkëmbimit me biblioteka e institucione shkencore në botë dhe nëpërmjet dhuratave nga institucione e individë. Buxheti i përcaktuar për bibliotekën, prej 400.000 lekësh, është shpenzuar për blerjen e botimeve më të fundit, të cilat kanë pasuruar koleksionin e bibliotekës sonë me 125 tituj të rinj. Shkëmbimi me rreth 60-70 institucione të huaja të rëndësishme, biblioteka, universitete dhe organizma shkencorë, ka qenë një tjetër burim i pasurimit të fondit të Bibliotekës me botime monografike, vëllime e periodikë bashkëkohorë shkencorë në shërbim të kërkuesve shqiptarë të disiplinave të ndryshme shkencore. Janë dërguar monografi shkencore dhe periodikët shkencorë të ASH-së (*Studia albanica* dhe *JNTS*), si dhe kanë ardhur të rejat e fundit të shkencës përmes 79 titujve të periodikëve të huaj. Është treguar kujdes që të përditësohet komunikimi dhe shkëmbimi me personalitete të njohura, albanologë e studiues elitare në mbarë botën.

Dhuratat (108 tituj), kanë rritur ndjeshëm numrin e botimeve që pasurojnë fondin, por është synuar në përzgjedhjen e titujve, në funksion të karakterit e specifikës së BSH-së, si qendër elitare e informimit shkencor. Në këtë mënyrë BSH-ja është pasuruar me 312 tituj të rinj:

- |                           |           |
|---------------------------|-----------|
| <b>1.</b> Nga blerjet:    | 125 tituj |
| <b>2.</b> Nga shkëmbimet: | 79 tituj  |
| <b>3.</b> Nga dhurimet:   | 108 tituj |

Të gjithë titujt e rinj, botimet e ASH-së dhe botimet që kanë pasuruar fondin përmes burimeve të mësipërme, kanë kaluar procesin e klasifikimit dhe të regjistrimit të tyre përmes katalogimit online. Këto regjistrime (të cilat për BSH-në kanë arritur në rreth 8050 tituj), mund të këshillohen në bazën e të dhënave online (OPAC), ku përdoruesit mund të kërkojnë me elementet e kërkimit të përshkrimit bibliografik materialet që u nevojiten.

Këshillimi bëhet në linkun <http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss?ukaz=GETID>

Për vitin 2016, mbas një pune intensive sektoriale, rezultojnë këto të dhëna:

- |   |                 |
|---|-----------------|
| <b>1.</b> Fondi i përgjithshëm i BSH-së:  | 64 910 vëllime. |
| <b>2.</b> Numri i përdoruesve të BSH-së:  | rreth 800.      |
| <b>3.</b> Numri i titujve të periodikëve: | 104 tituj       |
| a. Nga këta në gjuhë të huaj              | 56 tituj.       |

I rëndësishëm për BSH-në është komunikimi me akademikët dhe kërkuesit shkencorë,

proces i kryer nëpërmjet kontaktit me ta *online*, duke i përditësuar në lidhje me hyrjet e reja në BSH dhe rreth bibliografisë së botimeve shkencore të ASH-së për vitin 2016. Një tjetër mënyrë komunikimi me botën shkencore është përditësimi në lidhje me librin shkencor, botimet dhe bibliotekën shkencore në faqen zyrtare të ASH-së, *Libri akademik*, ASH, në të cilën janë bërë të njohura informacione të vazhdueshme rreth botimeve të reja shkencore, në lidhje me akademikë dhe kërkues shkencorë, lajme të rëndësishme për ngjarje e konferenca shkencore etj.

Formimi dhe aktiviteti shkencor i stafit të BSH-së është mjaft i rëndësishëm për karakterin specifik të vetë bibliotekës, në dimensionin shkencor të saj. Mund të thuhet se ky staf ka në përbërjen e tij dy punonjëse me gradën shkencore *Doktor i shkencave*, një kandidate për marrjen e kësaj grade dhe një punonjëse në nivelin *Master*. Në këtë kontekst, edhe pjesëmarrjet e punonjësve në veprimtari shkencore, përfaqësojnë denjësisht punën individuale, por kanë vlerë dhe për sektorin.

**Problematike për BSH-në mbetet mungesa e qasjes në burime elektronike shkencore ndërkombëtare.** Biblioteka ka bërë një studim mbi burime që ofrojnë mundësi qasjeje në një informacion gjigant të karakterit shkencor, në qindra mijë revista shkencore elektronike në varësi të pagesës vjetore, çka do të ishte në interes të kërkuesve shkencorë në Shqipëri.

Përgatitja me cilësi të lartë e botimeve shkencore të ASH-së, në përputhje me etikën dhe politikën e botimit të ASH-së, sipas *Rregullores mbi kriteret e botimeve në ASH* ka qenë një tjetër objektiv i rëndësishëm i punës së sektorit të botimeve dhe BSH-së. Përgatitja dhe dërgimi në shtyp i dy periodikëve shkencorë të ASH-së, dy revistave shkencore: *Studia albanica* (nga SSHSHA) dhe *Albanian Journal Natural and Technical Sciences* (AJNTS), nga SSHNT. Këta periodikë, me artikuj të përzgjedhur shkencorë të studiuesve shqiptarë e të huaj, janë përditësime mjaft të rëndësishme në sferën ndërkombëtare në lidhje me tema të rëndësishme të albanologjisë dhe shkencave natyrore.

Realizimi i procesit të botimeve të Akademisë ka ndjekur të gjitha hallkat:

1. Përgatitjen e dokumentacionit përkatës për këshillin botues;
2. Përgatitjen e veprave për botim, redaktimin e tyre, procese të veçanta që lidhen me shtypshkrimin (radhitje, korrektim, faqosje librash);
3. Procesin e përgatitjes së konferencave shkencore dhe veprimtarive të tjera të zhvilluara nga ASH-ja, përrurime botimesh shkencore, organizime ekspozitash, përgatitjet grafike (hartime e dizenjime të banderolave, fletëpalosjeve, posterave, ftesave) etj. Të tilla ishin: *Shekulli i Kadaresë*, konferencë shkencore ndërkombëtare, maj 2016; përrurimi i mjedisëve të reja të ASH-së, shtesa *Libri akademik*, maj 2016; Alfred Frashëri – *Ujërat minerale dhe termale të Shqipërisë*, përrurim libri, prill 2016; *Eposi shqiptar i kreshnikëve në pesë shtete të Ballkanit*, shtator 2016; *Dritëro!*, konferencë jubilarë, tetor 2016; *Koncert i përbashkët veprash kamerale-muzikë dhomë*, tetor 2016; *Akademik Tish Daija, në 90-vjetorin e lindjes*, nëntor 2016; përrurim i dy librave të akad. Muzafer Korkutit, dhjetor 2016.
4. Edhe për vitin 2016 botimet shkencore të ASH-së u përfaqësuan denjësisht në panairët kryesore të librit: në panairin ndërkombëtar të Shkupit, në panairin e librit në Prishtinë, në panairin e librit në Ulqin dhe panairin e librit në Tiranë.

Një angazhim i ri për sektorin e botimeve dhe BSH-në, në bashkëpunim me seksionet e ASH-së, ishte menazhimi i procesit teknik dhe administrimi i dosjeve të kërkuesve shkencorë konkurrues për çmimet shkencore kombëtare për vitin 2016, proces i kryer në kohë dhe me qasjen e duhur ndaj kësaj veprimtarie të rëndësishme të vlerësimit elitare të kërkimit shkencor.

Në lidhje me botimet shkencore të ASH-së, për një përfaqësim dinjitoz të arritjeve të kërkimit shkencor në Shqipëri e në rrjetet ndërkombëtare të shkencës, lind nevoja e krijimit

të një katalogu specifik vjetor me titujt shkencorë të botuar prej saj. Ky katalog mendojmë se duhet të përmbajë një abstrakt të shkurtër në shqip dhe në anglisht, të shoqërohet me skedën përkatëse të botimit, e cila përmban titullin, autorin, shtëpinë botuese, numrin e faqeve, ISBN-në dhe kopertinën e librit. Në këtë mënyrë jo vetëm studiuesit shqiptarë njihen me botimet e reja të ASH-së, por bëhet i mundur edhe promovimi i shkencës shqiptare në botë nëpërmjet qarkullimit të këtij katalogu si pjesë e procesit të shkëmbimit që kryen sektori i botimeve shkencore dhe BSH me institucione analoge në botë, biblioteka e institucione kërkimore, universitete, qendra shkencore etj.

Një risi për ASH-në për vitin 2016 ishte dhe krijimi i qendrës së re *Libri akademik*, dedikuar përrurimit dhe ekspozimit të librave studimorë të akademikëve, profesorëve dhe kërkuesve shkencorë, shqiptarë dhe të huaj. Përmes ristrukturimit të mjedisëve, ASH-ja çmoi rëndësinë që ka popullarizimi i drejtpërdrejtë për publikun i botimeve shkencore të akademikëve shqiptarë e përpos tyre edhe i mendimit shkencor shqiptar. ASH është ndër botuesit kryesorë të studimeve shkencore cilësore në Shqipëri. Botimet e saj përbëjnë një kontribut të vlershëm; ato u përkasin shumë lëmenjve të dijeve shkencore dhe mbajnë firmën e emrave të njohur të botës akademike. Që nga themelimi i saj në vitin 1972, numërohen më shumë se 400 vepra që kanë parë dritën e botimit dhe çdo vit botohen mesatarisht rreth 10-20 tituj, numër që ndryshon sipas fondeve në dispozicion si edhe sipas propozimeve shkencore: fjalorë gjuhësorë a terminologjikë, fjalorë enciklopedikë, vepra normativizuese, monografi që dokumentojnë historinë apo zhvillimin e gjuhës shqipe, studime të historisë së letërsisë apo kritikës letrare, studime nga fushat e shkencave natyrore, që kanë si fokus lexuesin shkencor. E gjithë kjo pasuri titujsh ekspozohet dhe qarkullon në mjediset e *Librit akademik*, e shoqëruar edhe me klasifikime përkatëse dhe me materiale të tjera promovuese. Mjediset e *Librit akademik* përfshijnë: sallën e ekspozimit të librit akademik (rreth 600 tituj të ekspozuar); sallën *Akademikët* për takime dhe përrurime botimesh; mjedisin e magazinimit të librit akademik.

Gjatë vitit 2016 në qendrën e *Librit akademik* janë zhvilluar mjaft takime shkencore, seminare, përrurime botimesh të akademikëve e kërkuesve shkencorë, shkëmbime opinionesh shkencore mbi problematika të rëndësishme aktuale etj.

Në kuadër të projektit ***Bashkëpunimi dhe krijimi i sistemit bibliografik kombëtar për evaluimin e rezultateve të kërkimeve shkencore në Shqipëri*** midis ASH-së dhe Institutit të Shkencave të Informacionit (IZUM), Maribor, Slloveni, gjatë vitit 2013–2016 është bërë i mundur implementimi i sistemit COBISS, i cili përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin bibliotekar të informacionit, që përfshin katalogimin e përbashkët, bazën e përbashkët të të dhënave bibliografike (katalogun unik), bazat lokale të të dhënave të bibliotekave, sistemet bibliografike për vlerësimin e rezultateve të veprimtarisë kërkimore, funksionet e tjera të të ashtuquajturës bibliotekë virtuale. Për realizimin e këtij projekti është punuar për krijimin e bazës së përbashkët COBISS.AL e cila përfaqëson një sistem bibliografik të ndërtuar mbi platformën COBISS (Sistemi dhe Shërbimet e Përbashkëta Bibliografike Online), dhe përdoret për vlerësimin e rezultateve të kërkimit në Shqipëri.

Sfidë për sektorin e botimeve dhe BSH-në për vitin 2017 është nisja e procesit të krijimit dhe përpilimit të bibliografive shkencore të kërkuesve shkencorë, në kuadër të projektit ***Bashkëpunimi dhe krijimi i sistemit bibliografik kombëtar për vlerësimin e rezultateve të kërkimeve shkencore në Shqipëri***, me qëllim krijimin për herë të parë të sistemit bibliografik *online* që do të përmbajë bibliografinë shkencore të kërkuesve shqiptarë nëpërmjet sistemit COBISS, duke krijuar kështu një informacion të hapur përmes këtij sistemi.

Në këtë mënyrë BSH-ja luan një rol të rëndësishëm në ndihmën dhe promovimin e

veprimtarive shkencore të akademikëve dhe hulumtuesve shkencorë në rrethet qendrore të shkencës botërore. Ky proces i shërben inkurajimit të elitës shkencore në evidentimin e rezultateve nëpërmjet sistemit COBISS, i cili mundëson një vlerësim të shpejtë, transparent dhe të besueshëm të punës së kërkuesve shkencorë në arenën ndërkombëtare.

Fillimviti 2017 nisi me krijimin e bibliografisë shkencore të akademikut Kristo Frashëri. Hartimi i bibliografisë së tij do të kryhet sipas këtij procesi:

1. Mbledhja e materialit në burime të ndryshme;
2. Përgatitja e listave bibliografike sipas llojit të botimit;
3. Katalogimi i veprave të akad. Kristo Frashërit në programin COBISS;
4. Kontrolli cilësor sipas standardeve ndërkombëtare i regjistrimeve bibliografike;
5. Redaktimi shkencor i listave bibliografike;
6. Përpilimi i bibliografisë *online* sipas udhëzimeve dhe manualeve të sistemit COBISS;
7. Synimi i përgatitjes për botim të bibliografisë së akademikut.

### III. Burimet njerëzore

Sipas rregullores së brendshme të institucionit, neni 30 dhe neni 33, përgjegjësja e sektorit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve zbaton dhe ndjek në vijimësi ligjet, vendimet, udhëzimet, urdhëresat, ndryshimet në to etj., të miratuara nga Kryesia e ASH-së dhe nga institucionet shtetërore, me të cilat ka bashkëpunim.

Gjatë muajit janar e në vijimësi, për vitin 2016, ka vazhduar bashkëpunimi me Departamentin e Administratës Publike (më tej: DAP) për zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për ndjekjen e procedurës dhe plotësimin e dokumentacionit për rekrutimin e punonjësve të rinj, si dhe për vendet vakante në institucion.

Gjatë vitit 2016, sektori (përgjegjësja), në bashkëpunim DAP-in, ka bërë rekrutimet për disa pozicione pune dhe vende vakante. Është bërë emërimi i z. Shaban Sinani, në pozicionin e sekretarit shkencor të SSHSHA-së, sipas ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*; i znj. Irida Bineri, në pozicionin e bibliotekares në sektorin e botimeve shkencore dhe bibliotekës; i z. Edmond Cane, duke marrë statusin e nëpunësit civil në pozicionin e specialistit të marrëdhënieve me jashtë dhe publikun; i znj. Anita Berberi, duke marrë statusin e nëpunësit civil në pozicionin e asistentes së SSHNT-së; i znj. Albana Velianj, si nëpunëse civile në pozicionin e përgjegjësës së sektorit të botimeve shkencore dhe bibliotekës.

Në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit 2016 (çdo muaj), është bërë raportimi me formularët e rekrutimit *online* në sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve të Këshillit të Ministrave, për vendet vakante, lirimet, emërimet, proceset gjyqësore dhe ankimimet e nëpunësve civilë.

Gjatë muajve prill–nëntor 2016 nga Shkolla e Administratës Publike janë bërë trajnime të herëpashershme: për nëpunësit civilë në periudhë prove, nëpunësit civilë me status, si dhe për përgjegjësen e sektorit për përditësimin e legjislacionit në fuqi dhe hedhjen e të dhënave në sistemin *online* HRMIS për burimet njerëzore të institucionit.

Për vitin 2016, sektori (përgjegjësja), në bashkëpunim të vazhdueshëm me ISSH-në, ka bërë verifikimin dhe kontrollin e dokumentacionit për punonjësit që kanë dalë në pension, për të cilët lëshohet vërtetim mbi të dhënat e dokumentuara në regjistrin themeltar të punonjësve, sipas kërkesës së të interesuarit.

Gjatë vitit 2016 është punuar për kontrollin dhe plotësimin e dokumentacionit të dosjeve të punonjësve dhe të anëtarëve të ASH-së, me dokumentacionin e sjellë nga vetë punonjësit, lidhur me kualifikimet, trajnimet etj., të cilat hidhen edhe në sistemin *online* HRMIS.

Sektori (përgjegjësja), ndjek në mënyrë të vazhdueshme planifikimin e lejeve vjetore të



punonjëse, si dhe përpilimin e shkresave, në bazë të procedurave përkatëse, në zbatim të ligjeve në fuqi.

Gjatë muajit janar dhe në vijimësi për gjithë muajt e vitit, është bërë planifikimi për administrimin e sallave të ASH-së për përdorimin me qira nga të tretët, si dhe nga ana e asaj vetë, për konferencat shkencore, simpoziumet, promovimet e botimeve të reja të akademikëve, aktivitetet dhe veprimtaritë e ndryshme social-kulturore, si dhe për dhënie leksionesh nga ana e anëtarëve të Asamblesë.

Disa problematika që kemi hasur gjatë vitit, për krijimin e kushteve optimale dhe për mbarëvajtjen e punëve në realizimin e detyrave, kanë ardhur edhe për shkak të mungesës së fondeve, por si sektor propozojmë që për çdo seksion të bëhet me përafërsi një listë me kërkesat e vitit, sepse edhe planifikimi i fondeve bëhet më i saktë, pavarësisht emergjencave, që janë të paparashikuara.

Sektori (në varësi të fondeve të planifikuara në buxhet për institucionin), ka në vijimësi shqetësimin për plotësimin e infrastrukturës me pajisjet e domosdoshme, si për zyrat ashtu edhe për sallat e ASH-së (të cilat jepen në përdorim për të tretët), për të pasur një mbarëvajtje sa më të mirë, duke bërë edhe propozime për plotësimin dhe përmirësimin e kësaj infrastrukture.

Në fillim të muajit janar e deri në fund të muajit mars të vitit 2016, ky sektor ka bashkëpunuar me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 *Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*; ka udhëzuar subjektet përkatëse në plotësimin e deklaratave për vitin 2015 (kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe dy drejtuesit e seksioneve të ASH-së), deri në dorëzimin e formularëve në ILDKPKI, brenda afatit të përcaktuar në ligjin e mësipërm.

Sektori (përgjegjësja), ka dërguar shkresat përkatëse në ILDKPKI si dhe ka përgatitur vërtetimet dhe vetëdeklarimet për subjektet që kanë detyrimin për deklarimin e pasurive në bazë të ligjit.

Procedurat e mësipërme janë pasqyruar edhe me shkëmbimin e shkresave, të cilat janë regjistruar në protokollin e institucionit, si dhe në librin e protokollit të vetë sektorit. Gjatë muajit janar e në vijimësi sektori ka punuar për zbatimin me përpikëri të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 *Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*, në zbatim të akteve nënligjore të miratuara nga titullari për identifikimin dhe regjistrimin e interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave, si *autoritet përgjegjës*, në zbatim edhe të rregullores së brendshme të këtij ligji, si dhe të ligjit nr. 119/2014 *Për të drejtën e informimit* si koordinator i institucionit, për garantimin e një vendimmarrjeje transparente, të paanshme, në mbështetje të realizimit të objektivave dhe detyrave kryesore të ASH-së, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj këtij institucioni, nëpërmjet parandalimit të konfliktit midis interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari, në ushtrimin e funksioneve vendimmarrëse. Për gjithë veprimtarinë dhe detyrat që ka *autoriteti përgjegjës* i institucionit në fillim të muajit janar raporton në ILDKPKI për vitin paraardhës.

Përgjegjësja e sektorit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve ka si detyrë funksionale edhe detyrën e sekretares së Kryesisë. Gjatë vitit 2016, në mënyrë të vazhdueshme, në bashkëpunim edhe me sektorët e tjerë:

**1.** Ka kontribuar për realizimin e disa konferencave shkencore dhe veprimtarive kulturore (si dhënie dekoratash, medaljesh, ditëlindje të anëtarëve të Asamblesë etj.) të organizuara nga ASH-ja;

**2.** Ka punuar për realizimin e lidhjeve të titullarëve me organe e institucione të tjera, me



të cilat bashkëpunon Akademia;

**3.** Ka koordinuar punën me sektorët për pritjet e ndryshme të Kryesisë, në takimet me delegacione, personalitete, përfaqësues institucionesh shtetërore e private.

Gjatë muajve të vitit 2016 është punuar edhe për zbardhjen e vendimeve të mbledhjeve të Asamblesë, Këshillit Ekzekutiv, Kryesisë së ASH-së.

Pjesë e strukturës së sektorit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve janë edhe:

**Specialistja e IT-së**, e cila ka zbatuar detyrat e përcaktuara për vendin e punës, duke i realizuar ato në kohë dhe duke i kryer sipas porosive për:

**1.** Menazhimin e përpunimit të informacionit shkencor në ASH nëpërmjet dizenjimit, implementimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së bazave të të dhënave, rrjetit kompjuterik, aplikacioneve *web* mbështetur në kërkesat funksionale të Kryesisë dhe sektorëve të Akademisë;

**2.** Kontaktimin në mënyrë të vazhdueshme me Kryesinë, me sektorët dhe me nëpunës të tjerë të aparatit të ASH-së, për problemet që lindin në lidhje me përpunimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e informacionit;

**3.** Menazhimin e punës për dizenjimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare të ASH-së bazuar në një bazë të dhënash e cila aksesohet në bazë të një politike të vendosur nga ASH-ja për marrjen e informacioneve në mënyrë *online* nga akademikë, universitete e punonjës shkencorë që shfrytëzojnë këtë informacion;

**4.** Popullarizimin me informacion të rrjeteve sociale (*facebook, twitter, youtube*) të aktivitetit dhe veprimtarisë shkencore të akademikëve dhe të ASH-së;

**5.** Mirëmbajtjen e arkitekturës *hardware* dhe *software* të sistemeve të informacionit të ngritura në ASH (rrjeti kompjuterik, internet, e-mail, administrimin e bazës së të dhënave, aplikacionet, sigurinë, administrimin e serverit në platforma të ndryshme etj.);

**6.** Vlerësimin e teknologjisë që përdoret nga ASH-ja dhe rekomandimet për përmirësime sipas nevojës;

**7.** Konfigurimin, përditësimin e LAN, Hubs, Switches;

**8.** Monitorimin e problemeve të rrjetit, dështimet e lidhjeve me HTTP, HTTPS, SMTP, FTP, SSL, ICMP, VOIP dhe protokollat e tjera;

**9.** Identifikimin e nevojave për përmirësimin dhe plotësimin e mangësive në rrjet apo për rritjen e kapaciteteve të rrjetit për t'iu përgjigjur kërkesave;

**10.** Mbështetjen teknike për aktivitetet e kryera në sallën *Aleks Buda* dhe në sallën e *Librit akademik*.

Në shërbimin e arkiv-protokollit gjatë vitit 2016 puna ka qenë korrekte, duke zbatuar ligjin në fuqi. Dokumentet e brendshme dhe ato dërguese kanë qenë të sakta, nuk ka pasur probleme dhe janë shpërndarë sipas udhëzimeve të titullarëve. Dokumentacioni për institucionet, si brenda dhe jashtë vendit, është shpërndarë në bashkëpunim me postën. Sipas udhëzimeve (vendime, urdhra etj.) të Kryesisë, gjatë vitit 2016 është bërë protokollimi sipas kërkesave për dosjet shkencore, që janë paraqitur nga studiues dhe kërkues të ndryshëm. Është dorëzuar në AQSH dokumentacioni (dokumente historike kombëtare dhe dokumente të përkohshme), i përpunuar dhe i inventarizuar për vitin 2005. Është duke u punuar për vitin 2006 dhe po vazhdojnë proceset e fundit për t'i dorëzuar në AQSH. Është në proces klasifikimi i dokumenteve sipas viteve.

## SHTOJCË II

### Veprimtaritë shkencore vetjake të akademikëve, anëtarë të SSHSHA-së dhe të punonjësve të tjerë të këtij seksioni<sup>17</sup>

#### I. Sipas raportimit të SSHSHA-së

##### I.A. Projekte kombëtare e ndërkombëtare në kuadër të programeve të BE-së (FP6 dhe FP7 etj.) dhe të organizatave të tjera

1. Në raportimin përpara *Committee on the Elimination of Discrimination against Women (CEDAW)*, gjatë vitit 2016 **akad. asoc. Aurela Anastasi** kontribuoi me përgatitjen e raportit hiqe ndaj raportit të paraqitur nga qeveria shqiptare, të cilin e prezantoi në sesionin e 64-t të Komitetit të CEDAW-t, në korrik.

2. **Akad. Beqir Meta, Historia e Shqipërisë dhe shqiptarëve gjatë shek. XX**. Ky projekt ka filluar në vitin 2010 dhe përfundoi në vitin 2016 ku dhe u miratua për botim në këshillin shkencor të Institutit të Historisë. Ka punuar për të përfunduar pjesën si autor i 700 faqeve të këtij studimi. Është përfunduar redaktimi shkencor i veprës dhe përgatitja për botim.

3. **Akad. Marenglen Verli** ka përfunduar hartimin e pjesëve të caktuara për projektin dyvëllimësh *Historia e shqiptarëve të shek. XX*, projekt i Institutit të Historisë pranë QSA-së, financuar nga MASH-i; si dhe redaktimin e pjesëve të hartuara prej studiuesve nga Kosova e Maqedonia.

4. Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar me Akademinë e Shkencave të Bullgarisë, vazhdon projekti i përbashkët me Institutin e Shkencave Shoqërore, në kuadrin e takimit të Berlinit, mbi sfidat e integritimit europian për vendet e Ballkanit. Grupi i bashkëpunimit përbëhet nga: **akad. Vasil Tole**, drejtues i projektit; **akad. Aurela Anastasi**, **akad. asoc. Kosta Barjaba**, dhe studiuesi I. Gëdeshi, pjesëmarrës. Problemi është qendror për veprimtarinë me jashtë të SSHSHA-së dhe ndiqet nga shërbimi i marrëdhënieve me jashtë të ASH-së.

##### I.B. Aplikime të reja për projekte në kuadër të programeve e organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë

Nuk janë raportuar të dhëna nga asnjë prej anëtarëve dhe kjo çështje mbetet problematike për SSHSHA-në. Nuk ka asnjë aplikim të raportuar për projektin europian "**Horizon 2020**". Nuk ka asnjë të dhënë për nisma bashkëpunimi në kuadër të **Procesit të Berlinit** dhe të **InterAcademic Partnership (IAP)**. Ftesa për të qenë palë në këto nisma kemi pasur nga ASHAM-i dhe ASHAMZ-i, po ashtu dhe nga disa universitete europiane.

##### I.C. Pjesëmarrje në konferenca shkencore

Anëtarët e SSHSHA-së kanë qenë aktivë me pjesëmarrjen e tyre në konferenca shkencore brenda e jashtë vendit. Midis tyre mund të përmendim:

<sup>17</sup> Edhe në raportimin analitik janë përfshirë dhe raportimet për punën shkencore të punonjësve me detyra administrative në SSHSHA (sekretari shkencor etj.)

• Pjesëmarrje në konferenca jashtë vendit<sup>18</sup>:

1. Akad. Albert Doja, *Post-imperial truth claims and postcolonial knowledge production in the post-communist Balkans*, Paper presented at the Princeton Conjunction on Imperial Reverb: Exploring the Postcolonies of Communism”, University of Princeton (USA), 13-15 May 2016;

2. Akad. Albert Doja, *Raw Madness and Cooked Evil: the unspeakable politics of mass rapes as a military strategy and instrument of ethnic cleansing*, Paper presented at the International Conference on War and Sexual Violence, Graduate Center, City University of New York (U.S.A.), 28-29 April 2016;

3. Akad. asoc. Aurela Anastasi, *La liberta di religione nella Costituzione albanese*, referat i mbajtur në konferencën shkencore me titull *L’Albania nell’Unione Europea tra tradizione e sviluppo della liberta religiosa*, organizuar nga Universiteti i Bolonjës, Ravenna, 22-23 shkurt, 2016, botuar me proceedings;

4. Akad. asoc. Aurela Anastasi, anëtare e bordit shkencor të konferencës ndërkombëtare mbi *Reformën në drejtësi*, organizuar nga Universiteti i Tiranës dhe Universiteti *La Sapienza*, Romë, Itali;

5. Akad. Beqir Meta, *Hapja e kurseve arsimore në Tokat e Liruar*. Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore të organizuar në Shkup, 20 nëntor 2016;

6. Akad. Beqir Meta, *Profili politik i Isa Boletinit në kryengritjen e vitit 1912*. Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore të organizuar nga ASHAK, Prishtinë, 25 nëntor 2016;

7. Akad. Floresha Dado, *Mjeda – tri poetika në një*, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore ndërkombëtare *Ndre Mjeda, në 150-vjetorin e lindjes*, organizuar nga ASHAK dhe ASH, Prishtinë, 15 shtator 2016;

8. Akad. Floresha Dado, *Jevrenia and Qyste Jakudia in the Albanian Epos of the Warriors*, në konferencën shkencore ndërkombëtare *The Balkan Jews & the Minority issue in South-Eastern Europe*, 7-9 november 2016, Warsaw, Poloni;

9. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç, *“Shqyptarija” në vjershat dhe në veprimtarinë shoqërore, gjuhësore dhe politike të Ndre Mjedës*, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore *Ndre Mjeda, në 150-vjetorin e lindjes*, organizuar nga ASHAK-u në bashkëpunim me ASH-në, Prishtinë, 15 shtator 2016;

10. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç, *Përfundime të “Komisës Letrare” që meritojnë të rikundrohen edhe sot*, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore *Komisia Letrare Shqipe (1916–1918) dhe gjuha letrare sot*, Prishtinë më 26 tetor 2016;

11. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç, *Ndikime morfosintaksore çoroditëse prej përkthimeve të këqija në shqipen*, në konferencën shkencore të organizuar nga IAP, tetor 2016;

12. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç, *Vlerat dialektologjike dhe sociolinguistike të së folmes së arbëneshëve të Zarës*, mbajtur në konferencën shkencore të organizuar nga IAP, nëntor 2016;

13. Akad. Marenglen Verli, *Dimensioni historik i figurës së Adem Demaçit*, kumtesë (përgatitur në bashkautorësi me Sabit Sylën) mbajtur në konferencën shkencore me titull *Veprimtaria atdhetare dhe intelektuale e Adem Demaçit*, organizuar nga IAP, Instituti i Historisë dhe Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, Prishtinë, 29 shkurt 2016;

14. Akad. Marenglen Verli, *Kongresi Arsimor i Elbasanit, i shtatorit 1909, në optikën e*

<sup>18</sup> Renditja sipas alfabetit.

**diplomacisë austro-hungareze**, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore *Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Austro-Hungarisë nga mesi i shek. XIX deri në ditët tona*, organizuar nga Instituti i Studimeve Politike dhe Ndërkombëtare, Shkup; Universiteti UBT, Prishtinë; Universiteti Kadri Zeka, Gjilan; Universiteti i Prishtinës; shtëpia botuese Logos-A (Shkup), Prishtinë, më 9-10 shtator 2016;

**15. Akad. Marenglen Verli, *Shembull nga historia e shkollave shqipe në Prespë në vitet 1942–1943***, kumtesë mbajtur në konferencën shkencore me titull *75-vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore*, organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve (Shkup), në bashkëpunim me IAP-in dhe QSA-në, Shkup, 20 tetor 2016;

**16. Akad. Marenglen Verli, *Kontributi i Isa Boletinit për Pavarësinë e Shqipërisë***, kumtesë mbajtur në konferencën e organizuar në Prishtinë nga ASHAK, Prishtinë, më 25 nëntor 2016;

**17. Akad. Vasil Tole, *Sazet***, leksion i hapur në Akademinë Zosimea, Janinë, dhjetor 2016;

**18. Prof. Shaban Sinani, *Ikja prej rimës gramatikore si ikje prej rapsodisë***, kumtesë mbajtur në konferencën e organizuar nga ASHAK kushtuar Ndre Mjedës, Prishtinë, 15 shtator 2016;

**19. Prof. Shaban Sinani, *Migjeni i Esad Mekulit***, kumtesë mbajtur në konferencën kushtuar 100-vjetorit të lindjes së Esad Mekulit, organizuar nga ASHAK, Prishtinë, 6 dhjetor 2016;

**20. Prof. Shaban Sinani, *Padre Giorgio Guzzetta e l'identità albanese***, kumtesë mbajtur në konferencën kushtuar 260-vjetorit të lindjes së At Gjergj Guxetës, organizuar nga Eparkia e Piana degli Albanesi.

**21. Prof. Shaban Sinani, *Quelque actes internationaux atténuant l'entrée des juifs en Albanie pendant les deux guerres mondiales***, kumtesë paraqitur në konferencën e organizuar nga AIESEE për hebrenjtë në Ballkan në rrjedhë të shekujve, 7-9 nëntor 2016, Varshavë.

**22. Prof. Shaban Sinani, *Arkivat e Kosovës dhe integrimi i tyre në bashkësinë arkivistike botërore***, kumtesë në konferencën e organizuar me rastin e 65-vjetorit të themelimit të shërbimit arkivor të Kosovës, Prishtinë, 21 mars 2016.

• **Pjesëmarrje dhe kontribute në konferenca brenda vendit:**

**1. Akad. asoc. Aurela Anastasi, *Vlerësimi i riskut dhe menazhimi i pasigurive gjatë reformimit të sistemeve ligjore***, kumtesë e mbajtur në konferencën e katërt shkencore ndërkombëtare organizuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, botuar me proceedings në *Auditimi publik*, Tiranë 2016;

**2. Akad. asoc. Aurela Anastasi, *Çështje të reformës në drejtësi, në mbështetje të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm***, mbajtur në konferencën shkencore kombëtare *Rrjeti shqiptar i grave në shkencë, në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm*, Tiranë, 20 dhjetor 2016;

**3. Akad. asoc. Aurela Anastasi**, kryetare e bordit shkencor të konferencës shkencore *Gjyqtari në demokraci*, konferencë shkencore ndërkombëtare e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, Tiranë, 4 tetor 2016;

**4. Akad. Beqir Meta, *Kuvendi i Fierit në kontekstin e lëvizjes kombëtare shqiptare në Shqipërinë e Jugut***. Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore të organizuar në Fier, 27 nëntor 2016;

**5. Akad. Beqir Meta, *Federata panshqiptare "Vatra" dhe lëvizja kombëtare në Korçë***,

kumtesë në konferencën shkencore të organizuar në Korçë, 9 dhjetor 2016;

**6. Akad. Floresha Dado, prof. Shaban Sinani, *Shekulli i Kadaresë***, referat i mbajtur në konferencën shkencore ndërkombëtare *Shekulli i Kadaresë*, Tiranë, Gjirokastrë, 13-14 maj 2016;

**7. Akad. Floresha Dado, *Një dhuratë Dritëro Agollit: Migjeni shqip pas 60 vjetësh***, mbajtur në konferencën jubilarë *Dritëro!*, me rastin e 85-vjetorit të lindjes së shkrimtarit Dritëro Agolli, ASH, Tiranë, 13 tetor 2016;

**8. Akad. Floresha Dado, *Raporti i imagjinatës artistike me intuitën shkencore në eseistikën kadareane***, mbajtur në konferencën shkencore *Studia kadareiana albanica et humanitatis*, organizuar nga Fakulteti Histori-Filologji, UT, Tiranë, 15 dhjetor 2016;

**9. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç, *Fjalëkrijimi dhe fjalëformimi të Kadareja, si shfaqje e mëtimeve të tij gjuhëruajtëse e gjuhëpasuruese***, mbajtur në konferencën shkencore kushtuar 80-vjetorit të lindjes së Ismail Kadaresë, organizuar nga Universiteti i Tiranës, dhjetor 2016;

**10. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç, *Elemente të etnografisë së ligjërimit në romanin "Sikur të isha djale" të Haki Stërmillit***, mbajtur në simpoziumin *120-vjetori i lindjes së shkrimtarit Haki Stërmilli*, organizuar nga shoqata *Bashkësia Dibrane*, në Muzeun Historik Kombëtar, 15 maj 2016;

**11. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç, *Pjetër Budi lëvrues dorëmbarë i shqipes, luftëtar i paepur në fushën politike, kishtare dhe letrare kombëtare***, në konferencën shkencore për nder të 450-vjetorit të lindjes së P. Budit, Tiranë, 22 dhjetor 2016;

**12. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç, *Izoglosat e ADGJSH-së për sintaksën*** (vlerësime metodologjike dhe përvojë pune si bashkautor), në konferencën shkencore të QSA-së, dhjetor 2016;

**13. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç, *Këngët e vallet e Malësisë së Veriut si pjesë e vlerave të hershme etnokulturore të popullit shqiptar***, kumtesë e mbajtur në Tropojë, dhjetor 2016;

**14. Prof. Shaban Sinani, *Shekulli i Kadaresë***, bashkëreferat në konferencën kushtuar 80-vjetorit të lindjes së I. Kadaresë, organizuar nga ASH; 13 maj 2016;

**15. Prof. Shaban Sinani, *Migjeni i Dritëro Agollit***, referat në konferencën kushtuar 85-vjetorit të lindjes së Dritëro Agollit, organizuar nga Biblioteka Kombëtare, Tiranë, tetor 2016;

**16. Prof. Shaban Sinani, *Tri drama të pabotuara të Dritëro Agollit***, kumtesë në konferencën kushtuar 85-vjetorit të lindjes së Dritëro Agollit, organizuar nga ASH, Tiranë, 13 tetor 2016;

**17. Prof. Shaban Sinani, *Kadare, Migjeni dhe Mandelshtam***, kumtesë mbajtur në konferencën kushtuar 80-vjetorit të Ismail Kadaresë, organizuar nga Universiteti i Tiranës, Tiranë, 15 dhjetor 2016;

**18. Prof. Shaban Sinani, *Pozicioni i shkrimeve të Gent Arbanës në veprën krijuese të I. Kadaresë***, kumtesë në konferencën e organizuar nga Universiteti i Elbasanit në 80-vjetorin e lindjes së shkrimtarit, Elbasan 2016;

**19. Prof. Shaban Sinani, *Dosja e eposit shqiptar dhe nderimi me çmimin "Europa Nostra"***, veprimtari shkencore e organizuar nga ASH, Tiranë, 21 shtator 2016;

**20. Prof. Shaban Sinani, *Aspekte etnologjike shqiptare të qëndrimit ndaj punës***, kontribut me bashkautorë në konferencën *Karta e gjelbër: rimodelimi i zhvillimit ekonomik*, organizuar nga ASH, Tiranë, 21 nëntor 2016;

**21. Prof. Shaban Sinani, *Korça në ditarët e komandës ushtarake franceze dhe italiane gjatë viteve 1916–1919***, kumtesë e mbajtur në konferencën kushtuar 100-vjetorit të vetëqeverimit të Korçës, organizuar nga ASH, Universiteti *F. Noli* i Korçës dhe QSA, Korçë, 9 dhjetor 2016.



## • Botime shkencore

Monografi, botime shkencore dhe botime të tjera:

1. Akad. Albert Doja, *Come costruire l'identità nel Regione Adriatico-Ionica: Prospettive culturali, regionali ed europei tra le idee civiche e le motivazioni stato-nazionale*, Innovazione e Integrazione nelle Politiche di Sviluppo Territoriale per la Regione Adriatico-Ionica: Proposte di Riflessione da una Prospettiva Locale e Regionale, Bologna: Adrigov, 2016, pp. 216-220;

2. Akad. Artan Fuga, *Murgu*, roman filozofiko-historik, trajtohen në formën *storytelling* probleme të marrëdhënieve midis shpirtërores dhe materiales në kohët e vjetra dhe të tanishme, bot. *Papirus*, Tiranë, 2016, 461 f.;

3. Akad. Artan Fuga, bashkëdrejtues shkencor dhe përgjegjës i botimit *Monitorim mbi cilësinë e ofertës televizive dhe reputacionin e TVSH-së*, me partneritet ndërkombëtar, me bord shkencor ndërkombëtar botimi, bot. *Edlora*, Tiranë, 2016, 143 f.;

4. Akad. Artan Fuga, bashkëdrejtues shkencor dhe përgjegjës i botimit: *Dixhitalizimi i transmetimeve televizive tokësore: sfida, paradokse, shpresa*, me partneritet ndërkombëtar dhe bord shkencor ndërkombëtar botimi, bot. *Edlora*, Tiranë, 2016, 622 f.;

5. Akad. Floresha Dado, *Lexuesi "në kurth": Eseistika e Ismail Kadaresë*, 328 f., monografi, bot. *Onufri*, Tiranë, 2016;

6. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaj ka rivështruar e ribotuar për nevojat e shkollave të larta librin *Dialektet e shqipes shqiptare*, bot. UFO Press, Tiranë, 2016;

7. Akad. Marenglen Verli, *Profile biografike – nga Kosova, për Kosovën* (950 f.), bot. ASH, Tiranë, 2016;

8. Akad. Vasil Tole, *Himni i flamurit*, botim monografik, Tiranë, 2016;

9. Akad. Vasil Tole, *Suita Pastorale* për flaut solo, 2016;

10. Akad. Vasil Tole, *Këngët patriotike në CD*, 2016;

11. Prof. Shaban Sinani, *Mite dhe demonë në veprën e I. Kadaresë*, studim monografik, bot. *Naimi*, Tiranë, 2016, 530 f.

## • Artikuj të botuar në revista shkencore

Gjatë vitit 2016 u miratua lënda për numrin 2/2015 dhe numrin 1/2016 të revistës *Studia albanica*, organ i SSHSHA-së. Mbetet për t'u miratuar nr. 2/2016. E pazgjidhur është çështja e kryeredaktorit, pas këmbënguljes së prof. Seit Mansakut për ta lënë këtë detyrë. SSHSHA-ja mban përgjegjësi për periodicitetin, cilësinë dhe problematikën e kësaj reviste, me të cilën qysh prej vitit 2008, pas ndarjes së institucioneve shkencore të vartësisë së saj, shkencat shoqërore dhe albanologjike identifikojnë veten në mjedisin e huaj shkencor. Kjo revistë merr tërthorazi ISSN, pasi kodifikohet nga **Ceeol**. Është urgjente që revista të rifitojë periodicitetin e vet. Nëse është e nevojshme të bëhen plotësime në redaksi, me qëllim shtimin e interesit për të, këto plotësime duhet të bëhen.

Sipas raportimeve vetjake gjatë vitit 2016 janë botuar këta artikuj:

### - Jashtë vendit:

1. Akad. Albert Doja (bashkautor), *Time and Narrative: Temporality, Memory, and Instant History of Balkan Wars*, *Time & Society*, 2016, vol. 26, pp. 1-34;

2. Akad. Albert Doja (bashkautor), *The past in the present: Time and narrative of Balkan wars in media industry and international politics*, *Third World Quarterly*, 2016, vol. 37, pp. 1-31;

3. Akad. Albert Doja (bashkautor), *International Representations of Balkan Wars: A Socio-Anthropological Account in International Relations Perspective*, Cambridge Review of International Affairs", 2016, vol. 29 (2), pp. 581-610;

4. Akad. Albert Doja (bashkautor), *From the communist point of view: Cultural hegemony and folkloric manipulation in Albanian studies under socialism*, Communist and Post-Communist Studies", vol. 49 (2), 2016, pp. 163-178;

5. Akad. Albert Doja, *Sipas këndvështrimit nga të huajt: Perandoria e pashenjtë dhe lindja e albanologjisë në shkrimet gjermane dhe austriake*, Gjurmime albanologjike (Folklor dhe etnologji), vol. 46, 2016 (në proces);

6. Akad. Beqir Meta, *Rrethanat ndërkombëtare të ripushtimit të Kosovës*, në revistën Kosova;

7. Akad. Beqir Meta, *Minoriteti bullgar (maqedon) në vitet 1925-1939*, në revistën Kosova;

8. Akad. Marenglen Verli, *Piruetat greke në Konferencën e Paqes rreth pretendimeve mbi Shqipërinë e Jugut në periudhën janar-maj 1919*, me bashkautor prof. M. Çamin, botuar në revistën Kosova, nr. 40 (2016);

9. Akad. Marenglen Verli, *Isa Boletini në mbrojtje të Shqipërisë së pavarur (në Vlorë, Londër, Durrës)*, në vëllimin: *Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare* (përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2015;

10. Prof. Shaban Sinani, *Letërsia e sotme në kornizën e së djeshmes*, në *Studime*, nr. 22, bot. i ASHAK, 12 f.;

11. Prof. Shaban Sinani, *Endonime dhe ekzonime për shqiptarët dhe fqinjët*, në *Studime*, nr. 23, bot. i ASHAK, 30 f.;

12. Prof. Shaban Sinani, *Naši smo, da nismo isti*, në *Albanische Forschungen*, Band 37, bot. Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 29 f.;

#### - Brenda vendit:

1. Akad. asoc. Aurela Anastasi, *Çështje të përgjegjësive institucionale në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve*, në *Jeta juridike*, botim i Shkollës së Magjistraturës, nr. 1, 2016;

2. Akad. asoc. Aurela Anastasi, *Në vëmendje të avokatëve: mbrojtja e parimit të barazisë gjinore në marrëdhëniet e pronësisë*, në *Avokatia*, nr. 16, 2016;

3. Akad. asoc. Aurela Anastasi, *Diskriminimi i shumëfishtë dhe roli i avokatit në adresimin e tij*, në *Avokatia*, në proces botimi;

4. Akad. Beqir Meta, recension librit *Shqipëria në Konferencën e Paqes*, Tiranë, 2015, në *Studime historike*, nr. 1-2/2016;

5. Akad. Beqir Meta, *Ndikimi i vendimit të Gjykatës së Hagës për shkollat private në procesin e kombëtarizimit të institucioneve shqiptare (1935-1938)*, në *Studime historike*, nr. 3-4/2016;

6. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç, *Libër me vlera e shqyrtime të hollësishme për marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe* (Anila Omari, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*), në *Studime filologjike*, bot. QSA (në proces botimi);

7. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç, *Qemal Haxhihasani, studiues i shquar i folklorit dhe dialektolog e sociolinguist*, në vëllimin *Qemal Haxhihasani personalitet i shquar i arsimit dhe i folklorit shqiptar*, akte të konferencës shkencore të Universitetit të Vlorës I. Qemali, bot. Ymeraj, 2016, f. 41-46;

8. Akad. asoc. Marenglen Verli, *Rreshtimi në koalicionin antifashist – alternativa e perspektivës për shqiptarët në vitet e Luftës së Dytë Botërore*, në *Studime historike*, nr. 3-4/2016;

9. Prof. Shaban Sinani, *Dy romane në një diptik?*, artikull në *Kadare, leximi dhe interpretimi*, bot. Onufri, Tiranë, 2016, 22 f.;

10. Prof. Shaban Sinani, *Prej shekullit të iluminizmit gjuhësor në shekullin e nacionalizmit gjuhësor*, në *Studime filologjike*, bot. QSA, Tiranë 2016, 21 f.;

11. Prof. Shaban Sinani, *De Rada dhe Millosau: rreth varianteve të emrit të autorit dhe të veprës*, në *Studimet letrare në proces*, bot. QSA, Tiranë 2016, 20 f.;

12. Prof. Shaban Sinani, *“Bëleta shqipëtare” e Th. Mitkos dhe “Bleta shqipëtare” e Gjergj Pekmezit*, në aktet e konferencës kushtuar 195-vjetorit të lindjes së Thimi Mitkos, bot. Universiteti i Korçës, 24 f.;

13. Prof. Shaban Sinani, *Disa mendime origjinale të Dritëro Agollit për Migjenin*, në *Illz*, revistë shkencore-kulturore e kryeqytetit, nr. 3, 12 f.;

14. Prof. Shaban Sinani, *Shekulli i Kadaresë* (me bashkautor), në *Illz*, revistë shkencore-kulturore e kryeqytetit, nr. 1, 10 f.

### - Aktivitete të tjera

Anëtarët e SSHSHA-së kanë zhvilluar edhe aktivitete të tjera në fushën e botimeve, si redaktime veprash shkencore, studime, raporte, ekspertiza për vlerësime të projekteve, *R&D country profile* etj.

1. Akad. asoc. Aurela Anastasi, anëtare e redaksisë së revistës *Kuvendi*, botim zyrtar i Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësuese e ASH-së pranë kësaj redaksie; anëtare e redaksisë së revistës shkencore *Studime juridike*, botim i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; anëtare e redaksisë së revistës shkencore *Jeta juridike*, botim i Shkollës së Magjistraturës së RSH-së; anëtare e redaksisë së revistës *Avokatia*, botim i Shkollës së Avokatisë.

2. Akad. Beqir Meta, Recension mbi botimin dokumentar nga Qerim Lita me titull *Tokat e liruar*, Shkup, 2016.

3. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaj ka botuar në faqen personale online librin *Urgjenca gjuhësore* (artikuj dhe biseda të ndryshme për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare, si dhe për figura të ndryshme, me përparësi për krahinën e Malësisë së Mbishkodrës, si për Ded Gjon Lulin etj.); ka përpunuar, shtuar, zgjeruar e bërë gati për shtyp ribotimin e librit të F. A. Santorit *Satia* (150 faqe, botimi i parë në *Studime filologjike*, 1982), i cili do të paraqitet për botim në kolanën e ASH-së; ka përgatitur e dorëzuar për botim artikullin *“Balta e arave” si shtegu i prurjeve gjuhëpasuruese dhe gjuhëdashëse të Dritëro Agollit*, në përmbledhjen me studime të zgjedhura që do të botohet nga QSA-ja.

4. Akad. Marenglen Verli, zëvendësredaktor i revistës *Studime historike*, Tiranë, 1-2, 3-4/ 2016; anëtar i redaksisë së revistës *Studia albanica*, Tiranë, 2016; anëtar i redaksisë së revistës *Kosova*, Prishtinë, 2016; anëtar i bordit të organizuar nga Ministria e Kulturës për ndërtimin dhe organizimin e muzeumeve, si përfaqësues i QSA-së; anëtar i bordit organizuar nga *Posta shqiptare* për përzgjedhjen dhe emetimin e serialeve të pullave postare si përfaqësues i QSA-së. Gjatë vitit 2016 janë botuar edhe disa artikuj të natyrës historike në një numër revistash brenda e jashtë vendit, si në revistën *Kuvendi* (Tiranë), *Kosova*, nr. 40 (Prishtinë).

5. Prof. Shaban Sinani (sekretar shkencor i SSHSHA-së), përgatitje botimesh (redaktim shkencor e gjuhësor, pajisje me shënime, parathënie / pasthënie): **Dritëro Agolli, *Skicat dhe tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar Migjeni***, bot. ASH, Tiranë, 2016, 162 f.; **Dritëro Agolli, *Tri drama***, bot. ASH, Tiranë, 2016, 323 f.; ***Eposi i kreshnikëve – monument i trashëgimisë kulturore shqiptare***, kryeredaktor, bot. IAP, vëllimi I, 576 f; vëllimi II, 670 f. Gjithashtu: në komisionin organizues të konferencës shkencore ndërkombëtare *Shekulli i Kadaresë*, organizuar nga ASH;

në komisionin organizues të konferencës shkencore ndërkombëtare *Dritëro!*, organizuar nga ASH; në komisionin organizues të konferencës shkencore ndërkombëtare *Njëqind vjet nga vetëqeverimi i Korçës*, organizuar nga ASH, Universiteti *Fan Noli* (Korçë) dhe QSA; në komisionin organizues të konferencës shkencore ndërkombëtare *Njëmijëvjetori i Shën Gjon Vladimirit*, organizuar nga ASH dhe ASHAMZ; në komisionin organizues të konferencës shkencore kushtuar *Njëqindvjetorit të Ndre Mjedës*, organizuar nga ASH dhe ASHAK; në komisionin organizues të konferencës kushtuar Adem Demaçit, organizuar nga ASH, si dhe vlerësues i jashtëm i librit në shërbim të mësimdhënies universitare pranë Agjencisë Ndërkombëtare ANVUR.

#### **- Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor**

**1. Akad. asoc. Aurela Anastasi**, titullare e lëndëve *E drejta kushtetuese* dhe *E drejta kushtetuese e krahasuar*, UT; titullare e lëndës *E drejta kushtetuese e avancuar dhe drejtësia kushtetuese*, Master, UT; titullare e lëndës *Institucionet politike dhe drejtësia kushtetuese*, Master, UT; titullare e lëndës *Instrumenti i kërkimit ligjor për parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit*, Doktoratë, UT; trajnere në formimin vijues të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Shkollën e Magjistraturës; pedagoge e lëndës *E drejta kushtetuese* në Shkollën e Magjistraturës; përgjegjëse e grupit të lëndëve të së drejtës publike në Shkollën e Avokatisë; udhëheqje shkencore në tri tema doktorature me studentë të UT-së.

**2. Akad. Beqir Meta**, udhëheqje shkencore të 3 temave të doktoraturave dhe 1 teze masteri të Shkollës Doktorale të Institutit të Historisë, QSA.

**3. Akad. Floresha Dado**, cikël leksionesh në lëndën *Metodat e interpretimit të teorisë së letërsisë*, Master, UT. Udhëheq dy tema doktorature.

**4. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç** edhe gjatë vitit akademik 2015-2016 ka vazhduar bashkëpunimin si pedagog i jashtëm për lëndët ku është titullar dhe autor i teksteve përkatëse: *Dialektologji* dhe *Dialektologji e diasporës*, në UT; si dhe për lëndën *Kultura e gjuhës* në Universitetin e Arteve. Po ashtu, si pedagog i jashtëm ka dhënë leksionet e lëndës *Shqipja e sotme* në Albanian University, ku është edhe anëtar i redaksisë së revistës *Optime*. Ka marrë pjesë në juri për mbrojtje doktoraturash e masterash dhe në komisione për dhënie titulli Prof. ose Prof. asoc. (në UT, me dy oponente, në QSA me dy oponente). Ka drejtuar disa tema studimesh të shkallës Master e Doktor i shkencave në UT dhe QSA.

**5. Akad. Marenglen Verli**, cikël leksionesh në UT; udhëheq një mikrotezë masteri (*Çështja e shpërnguljes së shqiptarëve në marrëdhëniet turko-jugosllave: 1923-1941*), QSA; udhëheq tezat e doktoraturës: *Shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1912-1941*, *Politika italiane ndaj shtetit shqiptar 1920-1924*, *Diplomacia e Britanisë së Madhe mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1919-1939)*, *Shqiptarët dhe serbët 1912-1918*, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1928-1934*.

**6. Prof. Shaban Sinani** ka mbajtur lëndën *Etnokulturë* si pedagog i ftuar në Beijing Foreign Studies University, lëndë semestrale, doktoratë; si dhe lëndën *Eurokulturë*, në Beijing Foreign Studies University, lëndë semestrale, doktoratë. Është titullar lënde për disiplinën *Folkloristikë krahasimtare*, Universiteti i Tiranës, master shkencor, lëndë semestrale; pedagog i ftuar për temën *Eposi shqiptar dhe eposet e popujve të Ballkanit*, ligjëratë e hapur në Universitetin e Poznanit. Drejtim shkencor në doktoratë, dy kandidatura; në master, dy kandidatura; supervizion shkencor: tri kandidatura doktorate jashtë vendit.



## II. Sipas raportimit të SSHNT-së

### II.A. Konferenca, seminare dhe forume shkencore

#### Forumi Shkencor “Dibra e Madhe dhe Radika”

Në mbështetje të trajtimeve shkencore të problematikave prioritare të vendit, në përputhje me strategjitë kombëtare, në zbatim të programit të Qeverisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike në bashkëpunim me shoqatën “Bashkësia Dibrane” në kuadër të programit “Edukimi në shkencë”, ka organizuar forumin shkencor “Mbi pasuritë e trashëgimisë kulturore dhe ato ujore”, nën këndvështrimin e botimit “Dibra e Madhe dhe Radika” me autorë msc. T. Jegeni, prof. dr. M. Kolaneci dhe dr. S. Shatku. Veprimtaria u zhvillua më **20 shkurt 2016** në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave. Qëllimi i forumit shkencor ishte evidentimi i gjendjes së ujërave ndërkufitare tokësorë të Shqipërisë, me fokus rastin e lumit të Radikës dhe problematikat në ditët e sotme; mbi orientimin e politikave, që duhen ndjekur për drejtmenazhimin e ujërave ndërkufitare të Shqipërisë me vendet fqinje në përgjithësi dhe në veçanti për rastin në fjalë. Forumi u organizua në formë debati shkencor me pjesëmarrje të gjerë të specialistëve, që merren me problemet e ujërave në Shqipëri në përgjithësi dhe në veçanti me ujërat ndërkufitare, si dhe me anëtarë të shoqatës “Bashkësia Dibrane”, përfaqësues të komunave të Dibrës së Madhe, të shoqatave mjedisore etj. Përveç kërkuesve shkencorë të Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujërave dhe Mjedisit, Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, të ish-Institutit të Studimit dhe Projektimit të Veprave Kullim-Ujitje. Forumi u ndoq edhe nga specialistë të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të Ministrisë së Energjisë dhe Ekonomisë, Sekretariatit Teknik të Ujërave, nga përfaqësues të projektit GIZ nga shoqëria civile dhe nga palë të interesit.

Botimi përmbledhës i studimeve për ujërat ndërkufitare mes Maqedonisë dhe Shqipërisë erdhi si protestë e miratimit të projekteve *Boshkov Most* dhe *Lukovo Pole*, për realizimin e të cilave u mor vendimi për të devijuar më shumë ujë nga Radika, lumi kryesor që ndikohet dhe cenohet nga ky vendim. Pjesa kryesore e hidrologjisë është punim shkencor origjinal, që përpiqet të tregojë, në bazë të të dhënave shumëvjeçare, prurjet e Radikës dhe sasinë e ujit të shfrytëzuar, përkatësisht, nga pala jugosllave dhe ajo maqedonase. Pjesa që trajton problemin ekologjik është një përmbledhje analizash që u janë bërë projekteve nga organizata të njohura mjedisore europiane, si dhe të dokumenteve e arsyetimeve, ku mbështeten Banka Botërore dhe Banka Europiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH). Pjesa e fundit, një vështrim i shkurtër për historinë e Maqedonisë dhe të shqiptarëve që jetojnë në pjesën perëndimore të saj, sjell përmbledhje të botimeve nga studiues të ndryshëm të historisë së Ballkanit, siç citohen në bibliografitë e pasqyruara në fund të çdo pjesë.

Problemet e ujërave ndërkufitare janë çështje me një ndjeshmëri shumë të lartë, madje kanë provuar se janë në gjendje të ndezin pasione të forta në mes të komuniteteve, siç qe rasti i Lumit të Radikës në Dibër të Madhe. Pikërisht ky rast u dha autorëve shtysën më të fortë për një studim shkencor, për të shpjeguar problemet e mundshme që mund të lindin nga realizimi i projekteve energjetike të parashikuara në lumin e Radikës. Përgatitja e botimit të studimit u realizua me një bashkëpunim të gjerë specialistësh, duke analizuar të dhëna shumëvjeçare nga burime të ndryshme. Pas paraqitjes së botimit “Dibra e Madhe dhe Radika” nga të tre autorët, pjesëmarrësit në auditor vlerësuan seriozitetin e ngritjes së problemit të



ndjeshëm të përdorimit të ujërave të Radikës, argumentet ndaj pretendimeve të Qeverisë Maqedonase etj.

Në mbështetje të problematikave ujore dhe domosdoshmërisë së zgjidhjes tyre me argumente shkencore, autorët e botimit, pjesëmarrësit e në veçanti shumë ekologë dhe anëtarë të shoqatës dibrane paraqitën me fakte vlerat e mrekullueshme të natyrës së rajonit të Dibrës së Madhe, rrethuar nga bjeshkë, pjesë e dy parqeve kombëtare: Mavrova dhe Shebenik – Jabllanica, lagur nga dy lumenj, njëri malor me ujë të pijshëm: Radika dhe Drini i Zi. Konkretisht, qyteti shtrihet në buzë të liqenit artificial, duke krijuar mundësinë për plazh, sporte ujore dhe peshkim e ku vlerat natyrore lidhen me shfrytëzimin e tyre në drejtime të ndryshme. Bjeshkët e Mavrovës ofrojnë peizazhe të papara dhe një nga terrenet më të mira për ski në Ballkan, të famshme për pyjet pa fund të ahut, livadhet alpine, lumenjtë dhe përrrenjtë e kulluar; me 17 liqene glaciale, si dhe liqenin artificial të Mavrovës. Një shumëllojshmëri specimesh të rralla: trofta, ujq, arinj dhe vidra jetojnë në park, por krijesa më e famshme është Rrëqebulli i Ballkanit (*Lynx balcanicus*).

Meqenëse problemi më shqetësues i sotëm për këtë trevë konsiderohet ai i Lumit të Radikës, një vend të gjerë në botim zënë argumentet shkencore për pasuritë ujore të trevës së Dibrës të mbështetura kryesisht në të dhëna reale shumëvjeçare, si në të dhënat brenda territorit të RSH-së, që përmbledhen sistematikisht në vjetarët hidrogjikë, por edhe në ato jashtë kufijve të shtetit shqiptar, nga vjetarët hidrogjikë të ish-Jugosllavisë, që disponohen në Shqipëri. Ndërsa për të dhënat nga vendet fqinje, fillimisht u ofrua Kosova, por ndihma më e madhe erdhi nga Shërbimet Hidrometeorologjike të Republikës së Serbisë.

Autorët e konsiderojnë trevën e Dibrës mjaft të pasur me ujëra, sepse në afërsi të qytetit të Dibrës konvergojnë të gjitha ujërat para se të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Karakteristika tepër e veçantë e Lumit të Radikës, thuhet me regjim alpin ujqor, ku sasia maksimale e ujit rrjedh në muajt prill-maj, që vjen nga shkërrja e borës së maleve, me kuota mbi 2000 m mbi nivelin e detit, tregon se ai ka një potencial ujqor shumë të fuqishëm, i cili në vlerë absolute ia kalon vetë Drinit të Zi. Gjatë forumit u theksua se kjo pasuri e madhe ujore është arsyeja që ndër vite është gjymtuar nga vendimmarrje thjesht tekniko-ekonomike, duke e copëtuar dhe duke e shpërndarë. Edhe sot shteti maqedonas ka synuar të përfitojë edhe një sasi të konsiderueshme të ujërave të Radikës për t'i shfrytëzuar për qëllime hidroenergjetike dhe për ujitjen e pjesës tjetër të Maqedonisë. Pjesëmarrësit në forum, veçanërisht ekspertë të ujërave e më gjerë, juristë, anëtarë të shoqatave dibrane dhe ekologjike argumentuan faktin se sot një veprim i tillë është i papranueshëm të realizohet, sepse ujërat e përbashkëta ndërmjet dy shteteve rregullohen me marrëveshje dypalëshe, bazuar në konventa e ligje ndërkombëtare. Autorët i kanë dhënë argumentet juridike bazuar në "Marrëveshjet për ujërat ndërmjet Republikës së Shqipërisë e Republikës Federative të Jugosllavisë dhe vlefshmëria e tyre në ditët e sotme", që aktualisht janë në fuqi ndërmjet dy vendeve, ku Shqipëria ndan me shtetet fqinje disa nga burimet ujore kryesore të saj. Më pas, me ndryshimet politike në Europën Lindore, e veçanërisht me shpërbërjen e RSFJ-së, në vitet '90, numri i shteteve fqinje me Shqipërinë, të cilat ndajnë burimet ujore, u dyfishua. Si pasojë, çdo marrëveshje e mundshme për ujërat ndërkufitare mori karakter shumëpalësh, më të ndërlikuar. Ndërlikimet që rrjedhin nga një situatë e tillë e bëjnë të rëndësishme pjesëmarrjen e vendeve ballkanike në konventat themelore europiane për ujin dhe mjedisin, si p.sh. në Konventën e Helsinkit për ujin të vitit 1992, dhe të marrëveshjeve të tjera të ngjashme, që rrjedhin prej tyre. Megjithatë pjesëmarrja në këto konventa nuk zëvendëson marrëveshjet ndërshtetërore për ujërat ndërkufitare ndërmjet vetë vendeve të rajonit për të adresuar problemet konkrete lidhur me to. Studiuesit e botimit i japin përgjigje pyetjes

kryesore më të ndjeshme për komunitetin shkencor, ambientalistët, komunitat përreth etj.

*“Pse u bë problem lumi i Radikës në kohën e sotme, kur ekziston një marrëveshje e nënshkruar nga të dyja palët?”* Ky problem u evidentua kur shteti i sotëm maqedonas ndërmoi projektin e ri për marrjen edhe të një pjese uji nga pellgu ujëmbledhës i Radikës, si dhe për ndërtimin e një dige 71 m të lartë për ta devijuar rishtas rrjedhën e lumit drejt sistemit të Mavrovës deri në lumin Vardar dhe në Detin Egje. Pretendimi i palës maqedonase është se nuk është marrë e gjithë sasia e ujit të përcaktuar në protokollin e vitit 1962. Në libër paraqiten argumentet, që e hedhin poshtë pretendimin e tyre për rimarrje të ujit nga Radika e, për më tepër, për tjetërsimin e rrjedhës dhe të shtratit natyror të lumit. Së pari, në pikën 6 të kësaj marrëveshjeje flitet për Radikën e Sipërme, ku thuhet se “...nga kjo zonë, duke filluar nga viti 1958, merren ujërat, të cilat më pas shkojnë në drejtim të Vardarit”, duke treguar se veprimi tashmë është kryer dhe se marrëveshja e vitit 1962 është konsumuar dhe nuk lë hapësirë për t’u riparë pas 50 vjetësh, e aq më pak për t’u vënë në jetë. Së dyti, marrëveshja e vitit 1962 është nënshkruar ndërmjet dy palëve, Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Në kushtet e sotme kjo marrëveshje, që të zbatohet, duhet të nënshkruhet nga Republika e Shqipërisë me tri shtete të tjera, me Republikën e Maqedonisë, Republikën e Kosovës dhe atë të Malit të Zi. Problemi i Radikës kurrësi nuk mund të shpëtohet nga konteksti i vetë marrëveshjes. Edhe shumë pjesëmarrës në debat theksuan këto argumente.

Përpos argumentit hidrologjik, u bë e qartë shumë shpejt se disa nga problemet kryesore të këtyre projekteve cenonin rëndë mjedisin, siç u theksua nga shumë shoqata mjedisore dhe shkencëtarë. Konkretisht, rrezikohet Parku i Mavrovës, si dhe shumë specie të rralla, si Rrëqebulli i Ballkanit. Arsyetimet dhe mendimet e shprehura për këto probleme nga specialistët të fushave përkatëse janë përgatitur në mënyrë koherente dhe i janë vënë përpara lexuesit shqiptar. Duhet theksuar se një ndikim të fuqishëm në zgjidhjen e problemeve shqetësuese në këtë rajon në kohët e fundit ka pasur Komiteti Drejtues i Konventës së Bernës që vendosi t’i rekomandojë Qeverisë së Maqedonisë, BERZH-it e organizatave të tjera financiare të mos vazhdojnë me projektet e Lukovo Poles dhe Boskov Mostit duke cituar një nga arsyet kryesore, dëmin që këto mund t’i shkaktojnë gjitarit të famshëm të Parkut Kombëtar të Mavrovës: Rrëqebullit të Ballkanit. BERZH vendosi ta pranonte plotësisht rekomandimin e Komitetit Drejtues të Konventës së Bernës për të mos financuar projektet hidrologjike në Parkun e Mavrovës për rreziqet ekologjike që paraqesin. Kjo përbën një fitore të rëndësishme për gjithë shoqërinë civile në Maqedoni dhe Shqipëri dhe sidomos për komunitetin dibran në Maqedoni, i cili e ka kundërshtuar me pasion dhe ka argumentuar me fakte e evidenca ndaj projekteve që nga viti 2011, kur u paraqit ideja e tyre. Autorët e botimit dhe pjesëmarrësit në forum theksuan rëndësinë e përgatitjes së raporteve vlerësuese ambientaliste duke i dhënë vëmendjen e duhur kësaj direktive të rëndësishme të legjislacionit europian. Gjithashtu, për reagimin e banorëve vendas ndaj projekteve hidroenergjetike, raporti i Komitetit të Konventës së Bernës konsideron ankesat e Komunitetit të Dibrës ndaj projektit (Boskov Most) për pakësimin e sasisë së ujit për ujitje dhe mungesën e pjesëmarrjes në planifikimin e projektit. Auditori theksoi se rekomandimet e Komitetit të Konventës së Bernës janë konfirmimi më i plotë i kauzës së drejtë të organizatave ambientaliste të Maqedonisë dhe të Shqipërisë si dhe ato ndërkombëtare, të banorëve dhe drejtuesve të komunave të prekura nga projektet si ai i Dibrës. **Studimet e kryera, botimet shkencore e sensibilizimi i komunitetit dhe protestat paqësore të mbështetura në rezultatet e kërkimit shkencor, bënë që Banka Botërore të tërhiqej nga mbështetja e Projektit të Radikës, duke marrë parasysh që ky kishte ndikim negativ në ekosistemin e faunës dhe florës në përgjithësi.**

## Workshop-i “ALBNANO 2016, Nanotechnology and Biosensors - Impact in health, environment, safety and security of Albania”

Më 29–31 maj 2016, Universiteti i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti Mjekësor i Tiranës dhe Instituti Katalan i Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë (ICN2), me mbështetjen e Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Ministrisë së Mjedisit, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Ambasadës së Spanjës në Tiranë, organizuan këtë veprimtari bashkëpunimi Shqipëri-Spanjë, e cila ishte edhe në kuadër të përgatitjes së projektpropozimit **ALBNANO (ALBanian Centre of NANObiotechnology and Biosensors)** në kuadër të Programit “Horizon 2020” të Komisionit Europian, të përgatitur nga institucionet e sipërpërmendura.

Akademia e Shkencave mori pjesë aktivisht në organizimin e workshop-it me anëtarët e Komitetit Organizativ: akad. S. Bushati, akad. asoc. E. Kongjika dhe akad. asoc. A. Veveçka.

Në workshop diskutuan së bashku kërkues shqiptarë, spanjollë dhe nga rajone të tjera në fushën e nanoshkencës, nanoteknologjisë, biosensorët dhe në fusha të përafërta me to. Nanoshkenca dhe nanoteknologjia janë sot mundësitë më të mëdha me ndikim në çdo aspekt të jetës. Qëllimi i takimit ishte të paraqitet gjendja e kërkimit shkencor në përgjithësi në fushën e nanoteknologjisë dhe biosensorëve në Shqipëri dhe veçanërisht për aplikimet në mbrojtjen e mjedisit, në shëndet, sigurinë ushqimore dhe biosigurinë. Kërkuesit nga universitete të ndryshme të Shqipërisë (UT, UBT, UPT dhe UM), si dhe nga ASHSH paraqitën përvojën e tyre në këtë fushë. Strategjitë dhe politikat mbështetëse ndaj shkencës dhe teknologjisë në vend u paraqitën nga përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, nga Ministria e Inovacionit dhe nga Akademia e Shkencave.

Kërkues të ftuar nga Spanja, drejtori i CERCA-s, dr. Lluís Rovira dhe drejtori i ICN2-shit, prof. Pablo Ordejon nga Barcelona paraqitën rezultate të kërkimit dhe strategjitë e zhvillimit në vendin e tyre dhe në institucionet përkatëse. Prof. Giuseppe Palleschi nga Universiteti Tor Vergata në Romë, Itali si dhe rreth 70 pjesëmarrës me prezantime orale/poster nga më shumë se 10 institucione shqiptare me bashkëpunëtorë me universitete në Gjermani, Spanjë, Itali, Holandë, Turqi etj. Kërkuesit gjithashtu shkëmbyen ekspertizat e tyre në zhvillimin dhe aplikimet në nanoteknologji, nanomaterialet dhe biosensorët. Në konferencë, nga Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike të ASHSH-së u paraqitën tri prezantime: (i) *An excellence center of nanotechnology and biosensors – a necessity of scientific development and applications of new technologies in Albania* (S. Bushati, E. Kongjika, 2016); (ii). *New opportunities of plant biotechnology in Albania using nanomaterials*. (E. Kongjika, V. Sota, 2016) dhe (iii) *Bulk nanostructured materials produced by severe plastic deformation processing*. (N. Izairi, A. Veveçka, 2016).

Punimet shkencore të paraqitura në workshop-in ALBNANO janë botuar në një numër special të revistës shkencore periodike të Akademisë së Shkencave *JNTS (Journal of Natural and Technical Sciences)*, që qarkullon edhe *online*. Botimi do të jetë i vlefshëm për lexuesit e *JNTS*-së të interesuar në këtë fushë për të shtuar bashkëpunimin midis kërkuesve shqiptarë dhe ndërkombëtarë, që punojnë në fusha komplementare dhe sinergjike dhe që mund të përdorin nanoteknologjinë, si dhe biosensorët për aplikime të ndryshme. Mbështetje të veçantë workshop-it ALBNANO i dha Ambasadorja e Spanjës në Tiranë, ms. Silvia Cortes Martin.

## Takimi rajonal i Ballkanit “Terra Madre Balkans” dhe konferenca shkencore ndërkombëtare “Putting farmers first”

Më 2 – 5 qershor 2016 u organizua në Tiranë takimi rajonal “Terra Madre Balkans” i prodhuesve të vegjël artizanë të ushqimit (Small-Scale Artisan Food Producers, SSAFPs) dhe komuniteteve të ushqimit nga Europa Jugore, së bashku me fermerë, seleksionues, aktivistë, shefa të kuzhinës dhe përfaqësues nga fusha akademike e kërkues të rinj nga rajoni. Në të u diskutua nevoja e SSAFPs për të qenë në qendër të agjendës së politikave si në nivel kombëtar, edhe në atë të BE-së. Të pranishmit në konferencë ishin të shumtë: 350 delegatë nga 13 shtete (Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë, Rumania, Serbia, Turqia, Italia dhe Shqipëria), të cilët u aktivizuan në veprimtaritë e organizuara. Në takim mori pjesë dhe presidenti i organizatës së “Slow Food”, dr. Karlo Petrini, disa ministra, si dhe kryebashkiaku i Tiranës, z. Erion Veliaj.

U zgjodh pikërisht Shqipëria për takimin “Terra Madre Balkans 2016”, pasi rrjeti “Slow Food” i vendit tonë po rritet me shpejtësi, duke pasur 22 produkte të regjistruara në “Slow Food Ark of Taste” – katalogu i produkteve ushqimore të rrezikuara, dy “Slow Food Presidia” si (Përmet Gliko dhe Mishavin, një djathë me origjinë nga Kelmendi, në Alpet Shqiptare), pesë “Slow Food Convivia” (lokale vendase), dhe qindra mbështetës.

Në kuadër të kësaj veprimtarie, më 4 qershor në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u mbajt konferenca shkencore “Putting Farmers First” me 2 sesione referimi: një sesion posterash dhe një tryezë e rrumbullakët. Akad. as. E. Kongjika dhe akad. N. Gruda u aktivizuan si anëtarë të komitetit shkencor të këtij aktiviteti shkencor rajonal.

Në konferencë morën pjesë kërkues nga vende të ndryshme të Ballkanit, përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, si dhe studentë nga universitete të ndryshme të Shqipërisë. Njëpërmjet mendimeve, ideve apo studimeve kërkimore, pjesëmarrësit dhanë ndihmesën e tyre duke marrë parasysh standardet e integritit në BE në çështjet e bujqësisë shumëfunktionale, të drejtat ligjore të prodhuesve të vegjël, të drejtësisë sociale, turizmit rural, marketingut të produkteve artizanale etj. Konferenca u hap nga prof. A. Ibraliu, kryetari i komitetit organizativ të konferencës dhe u përshëndet nga akad. S. Bushati, kryetar i SSHNT-së (ASHSH), prof. dr. S. Sulçe, prorektor i UBT, z. F. Laze, përfaqësues i MBZHRAU-t, znj. E. Vandecandelaere, përfaqësuese e FAO-s, z. O. Henriksen nga *SEREDI - GIZ Office Albania* si dhe z. P. Ambrosi, koordinator i *Terra Madre Balkan 2016* dhe udhëheqës i *VIS Shqipëri*.

Koordinatori i “Slow Food” për Ballkanin, z. M. Rumiz, në referimin plenar theksoi tendencat, mundësitë dhe sfidat e lëvizjes “Slow Food” në Ballkan, analizoi arritjet e deritanishme të kësaj lëvizjeje dhe shpalosi objektiva për zhvillim e kërkim shkencor në përputhje me nevojat e vendeve të Ballkanit në fushën e zhvillimit ekonomik në përgjithësi, e veçanërisht në ruajtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore dhe materiale dhe të ekoturizmit.

Referimet dhe diskutimet u përqendruan në dy probleme të rëndësishme: (i) biodiversiteti i ushqimeve dhe ruajtja e burimeve gjenetike; dhe (ii) fermerët artizanë, prodhues të vegjël, marketingu dhe përfshirja në tregje. Në sesionin e parë u diskutuan përfundimet e projektit “Essedra” nga prof. as. dr. D. Dimitrova dhe dr. T. Ivanova të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë, që u përshkruan me moton “Kërkimi shkencor – një forcë lëvizëse për ndryshim”. Prof. dr. A. Shundi nga Shqipëria diskutoi mbi trashëgiminë kulturore dhe materiale enogastronomike shqiptare duke theksuar trashëgiminë e pasur arbëreshe. Dr. Y. Kazakova, pasi diskutoi për projektin “IPARD II”, parashtrroi disa probleme shqetësuese për ruajtjen e biodiversitetit në Ballkan, veçanërisht në zonat rurale, ndërsa prof. dr. R. Ozimec paraqiti përvojën e Kroacisë në ruajtjen e varieteteve të vjetra bimore dhe të blegtorisë në zonën e



Mesdheut Perëndimor. Në sesionin e dytë, kërkuesit dhe auditori diskutuan problemet dhe perspektivën e tregut, ku duhet të përfshihen produktet artizanale. Prof. dr. S. Srbinska nga Maqedonia me një realizëm të spikatur shtroi problemet e higjienës si kryesore në kalimin e produkteve në treg. Përfaqësuesja e FAO-s, znj. E. Vandecandelare dhe dr. F. Lerin paraqitën disa kriteret standarde lidhur me indikatorët gjeografikë. Përfaqësuesi i AKTI-t, z. J. Zaimi solli përvojën e Shqipërisë në mbështetje për projektet në fushën e bujqësisë edhe për mundësitë e financimit nga programi “H2020”. Në sesionin e posterave u paraqitën 30 punime me autorë nga ASHSH-ja, UBT-ja, UT-ja, nga institucione shkencore të Prishtinës, Tetovës, të Bullgarisë etj. Nga Akademia e Shkencave u paraqit poster: *“In vitro conservation of autochthonous fruit trees germplasm, very important as a healthy local traditional food”* përgatitur nga **akad. asoc. E. Kongjika E., prof. as. dr. V. Sota**. Punimet e paraqitura do të botohen në një *Proceeding online* të aktivitetit, organizuar nën kujdesin e ASHSH-së dhe të UBT-së. Në fund të veprimtarisë u organizua tryeza e rumbullakët, ku u paraqitën përfundimet e konferencës dhe informacioni për veprimtaritë në të ardhmen.

### **Simpoziumi XII ndërkombëtar “Biodiversiteti dhe zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm”**

Më **21 dhjetor 2016**, në Tiranë u zhvillua simpoziumi XII ndërkombëtar “Biodiversiteti dhe zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm”, bashkëpunim i Akademisë së Shkencave, fondacionit “BLEKALB”, Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministrisë së Mjedisit, Universitetit Bujqësor, Universitetit Polis, Universitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë, Kosovë, Universitetit Shtetëror të Tetovës, Maqedoni. President i simpoziumit është prof. dr. K. Kume, koordinatori kombëtar i Resurseve Gjenetike Shtazore për Ushqim dhe Bujqësi dhe kryetar i bordit të drejtorëve të fondacionit “BLEKALB”. Akad. S. Bushati është aktivizuar si anëtar i komitetit organizativ të simpoziumit, kurse akad. asoc. E. Kongjika si anëtare e komitetit shkencor. Simpoziumi u përshëndet nga prof. dr. E. Panariti, ministër i Bujqësisë, akad. S. Bushati, kryetar i SSHNT të ASH-së dhe nga përfaqësues të universiteteve partnere në këtë simpozium nga Kosova, Maqedonia.

Në sesionet e simpoziumit u paraqitën 64 punime shkencore, në të cilat u trajtuan rezultate të kërkimit shkencor në fusha që lidhen me identifikimin, karakterizimin dhe përdorimin ekonomik dhe të qëndrueshëm të biodiversitetit në kafshët dhe bimët, që përdoren për bujqësi dhe ushqim, rolin dhe vlerën e biodiversitetit, në përgjithësi dhe agrobiodiversitetit në veçanti, si faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm rural, zhvillimin e prodhimit bio- dhe agroturizmit etj. Vend të veçantë iu kushtua paraqitjes së rezultateve të arritura në kërkimet shkencore në fushën e shkencave ekonomike, që trajtojnë çështje të zhvillimit të integruar në rajonet që karakterizohen nga shumëllojshmëria e resurseve natyrore.

Paraqitja e prioriteteve strategjike për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit u shoqërua me diskutimin e çështjeve që duhet të jenë objekt i kërkimit shkencor për të mbështetur zbatimin me sukses të planeve të veprimit, që synojnë realizimin e këtyre përparësive. Shkëmbimi i përvojave me kërkuesit nga vendet e rajonit dhe diskutimi i rrugëve për bashkëpunimin rajonal në kuadër të programeve që mbështeten nga marrëveshjet bilaterale dhe programet rajonale ishin pjesë e diskutimit në këtë aktivitet. Për të nxitur dhe vlerësuar arritjet në kërkimin shkencor në fushën e biodiversitetit dhe të përdorimit të tij për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, simpoziumi miratoi propozimin e konferencës e që u mbështet nga MBZHRAU si dhe nga Ministria e Mjedisit mbi dhënien në simpoziumet e ardhshme të çmimit *“Për rezultate të dalluara në kërkimin shkencor në fushën e biodiversitetit”* dhe çmimit *“Për arritje në ruajtjen dhe përdorimin e biodiversitetit”*.



## **Konferenca VII ndërkombëtare “Information Systems and Technology Innovations: the New Paradigm for a Smarter Economy”**

Me mbështetjen dhe bashkorganizimin e SSHNT-së të ASH-së me Departamentin e Statistikave dhe Informatikës së Aplikuar të Fakultetit të Ekonomisë të UT-së dhe me Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë të Kosovës u zhvillua në Tiranë, më 17-18 qershor 2016 konferenca VII ndërkombëtare “Information Systems and Technology Innovations: the New Paradigm for a Smarter Economy”. Kontribut në organizimin e konferencës kanë dhënë si anëtarë të bordit shkencor akademikët G. Beqiraj, S. Bushati dhe N. Frashëri. Konferenca pati si qëllim të forcojë dhe të zgjerojë më tej rrjetin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me kompanitë në sektorin e IT-së, me agjencitë qeveritare dhe me përfituesit e tjerë kryesorë në fushën e IT-së. Në fokusin e tendencave të sotme të teknologjisë dhe inovacionit, çështja kryesore e konferencës është “Smart Economy”, që përfaqëson ndërveprimin e ekonomisë, teknologjisë së informacionit dhe “Smart Cities”, që mund të përdoren si forcë lëvizëse ekonomike kryesore. Eksplorimi i rrugëve të reja dhe përkthimi i tyre në vlera të shtuara për mjedisin e shoqërinë tonë në përgjithësi konsiderohen synimet kryesore të teknologjive dhe shërbimeve të krijuara si pjesë e “Ekonomisë Smart”.

Në konferencë referuan rreth 240 autorë nga vende të ndryshme të rajonit dhe më tej duke përfshirë Suedinë, Norvegjinë, Austrinë, Italinë, Luksemburgun, Francën, Kosovën, Maqedoninë, Serbinë, Turqinë etj. Tematikat kryesore përfshijnë sistemet e informacionit, sigurinë e informacionit, inxhinierinë dhe rrjetet, “Cloud Computing” dhe rrjetet e lëvizshme, modelimet, simulimet dhe të dhënat “Big”, “Smart Economy” dhe çështje të lidhura me to. Akademikët N. Frashëri dhe J. Kaçani me bashkautorë paraqitën kumtesën “Environment Monitoring in Public Transport Vehicles” në sesionin “Engineering and Networks”.

### **Workshop-i “Alpet, një pasuri madhështore monumentale e natyrës”**

Me mbështetjen dhe bashkorganizimin e SSHNT-së të ASH-së me Ambasadën e Austrisë u zhvillua takimi “Alpet, një pasuri madhështore monumentale e natyrës” ku bashkësitë e studiuësve të Alpeve Austriake dhe ato Shqiptare shpalosën eksperiencat e tyre dhe perspektivat për të ardhmen, në sallën “Aleks Buda”, më 23 shtator 2016. Qëllimi i veprimtarisë ishte vlerësimi i pasurive të mrekullueshme natyrore të Alpeve Austriake dhe Shqiptare dhe si objektiv nxitja e turizmit malor në Shqipëri, kryesisht për Alpet Shqiptare, gjë që do të realizohet nëpërmjet një bashkëpunimi ndërmjet Bashkësisë së Studimeve të Alpeve Shqiptare dhe asaj të Alpeve Austriake. Në takim morën pjesë drejtues e studiuës nga universitetet dhe institucionet shkencore; politikëbërës nga Parlamenti i Shqipërisë, vendimmarrës, kryetari i komunës së Malësisë së Madhe, Z. Tonin Morina; ambasadori i Austrisë SH. T. dr. Johann Sattler, Ambasadori i Sllovakisë Sh.T. z. Milan Ciganik, përfaqësues të Ambasadës së Algjerisë në Tiranë, operatorë turistikë dhe amatorë të Alpeve Shqiptare dhe atyre Austriake. Fjalën e hapjes së këtij takimi e mbajti kryetari i SSHNT-së, akad. Salvatore Bushati, i cili theksoi se nuk është e rastit që ky takim zhvillohet në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, jo vetëm për nga rëndësia e këtij bashkëpunimi, por edhe në respekt të institucionit, që ka realizuar historikisht disa veprimtari në bashkëpunim me Austrinë, vendin ku u formuan mjaft intelektualë shqiptarë, një pjesë e të cilëve dhanë kontribute të çmuara në formimin dhe veprimtarinë e Akademisë dhe në zhvillimin e vendit. Ai theksoi rëndësinë

që paraqesin studimet e Alpeve në përgjithësi e atyre shqiptare në veçanti. Ai vlerësoi pasuritë e mrekullueshme të zonave malore të Alpeve Shqiptare dhe traditat e shkëlqyera të trashëgimisë popullore të banorëve në këto zona, ku turizmi që sapo ka filluar të zhvillohet, duhet të jetë një nga objektivat kryesorë të zhvillimit të qëndrueshëm me vlera lokale, por edhe rajonale. Akad. Bushati theksoi nevojën e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë e Austrisë për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm turistik, të domosdoshëm për treguesit optimalë si infrastruktura, ndërgjegjësimi i popullatës për përfitimet nga turizmi etj.

Takimin e përshëndeti ambasadori i Austrisë në Shqipëri Sh.T. dr. J. Sattler, i cili në fjalën e tij tha: “Ruajtja dhe mbrojtja në njërin anë, si dhe përfitimet prej këtij potenciali në anën tjetër kërkojnë ekspertizë dhe kompetencë. Në qoftë se projektet në vazhdimësi zhvillohen me zgjuarsi, atëherë synimet e caktuara nuk kanë pse të jenë kontradiktore. Malet shqiptare mund të jenë dhe tashmë janë një “motor” për turizmin e qëndrueshëm. Ai vlerësoi veprimtarinë e Shoqatës Austriake Alpine me mbi 150 vjet eksperiencë dhe më tepër se 500 mijë anëtarë dhe rëndësinë e punës vullnetare si “shtylla kurrizore e zhvillimit të qëndrueshëm në Alpet Austriake”. I pranishëm ishte edhe ambasadori i Republikës Sllovaqe në Tiranë, Sh. T. Z. M. Ciganik, i cili vlerësoi nismën e këtij bashkëpunimi, që lidhet sot ndërmjet Austrisë dhe Shqipërisë për zhvillimin e veprimtarive në Alpe ndërmjet dy vendeve.

Nxitja e turizmit malor është e lidhur ngushtë me përmirësimin e jetës së komunitetit të zonave malore. Në referimin e mbajtur nga prof. dr. K. Onuzi u theksuan disa nga hapat që duhen ndërmarrë në mënyrë që turizmi malor të jetë sa më cilësor, si më me rëndësi konsiderohet përgatitja e hartave turistike dhe vënia e tyre në dispozicion të institucioneve turistike brenda e jashtë vendit; publikime sa më të shumta, të sakta dhe cilësore mbi potencialet natyrore në rajonet malore të Shqipërisë, ku duhet dhënë realiteti siç është në këto zona malore në mënyrë që studiuesi apo turisti shqiptar dhe i huaj ta ketë të qartë situatën aktuale. Punë e madhe duhet t’i kushtohet ruajtjes së mjedisit dhe ngritjes së infrastrukturës së përshtatshme (ndërtimi i hoteleve të stilit alpin dhe përshtatja e shtëpive tradicionale për akomodimin e turistëve të huaj e vendas). Hap i rëndësishëm është dhe promovimi i produkteve ushqimore dhe i traditave kulturore të zonës. Z. B. Stummer, përfaqësues i Bashkësisë së Studiuesve të Alpeve Austriake paraqiti një historik të shkurtër mbi zhvillimin e turizmit malor në Alpet Austriake duke vënë theksin në ruajtjen e traditave të zonave dhe zhvillimin ekologjik të turizmit malor duke theksuar domosdoshmërinë e organizimit dhe funksionimit të shoqatave të turizmit malor me synim “për të përmirësuar njohuritë mbi Alpet, për të promovuar dashurinë për ta dhe për të nxitur zhvillimin e turizmit”. Z. Ch. Schreiter, kryetari i Bashkësisë së Studiuesve të Alpeve Austriake theksoi rëndësinë e rregullimit me ligj të çështjeve që lidhen me turizmin malor si dhe domosdoshmërinë e vullnetarizmit në mirëmbajtjen dhe shenjëzimin e shtigjeve malore. Procesi i bazuar në vullnetarizmin e anëtarëve të OAV (Österreichischer Alpenverein) bën të mundur rritjen e sigurisë dhe uljen e kostove të kërkimit dhe shpëtimit të të rrezikuarve.

Në këtë takim u lidh dhe një marrëveshje ndërmjet bashkësive shqiptare dhe austriake me qëllim realizimin e projekteve të përbashkëta, që synojnë studimin, evidentimin, pasqyrimin dhe promovimin e potencialeve natyrore të Alpeve Shqiptare në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare dhe vënien e këtyre potencialeve në dobi të komunitetit dhe zhvillimit të turizmit malor. Marrëveshja u firmos nga kryetarët e shoqatave, z. Ch. Schreiter për palën austriake dhe prof. dr. K. Onuzi për palën shqiptare.

## Mbështetje shkencore e Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për zhvillimin e konferencës “Frutikultura alternative”

Më 5 tetor 2016, në mjediset e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë u zhvillua konferenca shqiptare “Frutikultura alternative”. Konferenca u organizua nga QTTB-ja, Vlorë dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, por u mbështet fuqimisht nga Qendra e Kërkimit të Frutikulturës, Romë, Itali, nga kompania private “Apice Piante”, Pescara, Itali, nga UBT-ja, si dhe nga SSHNT-ja (ASH). Pas një panorame për speciet e reja autoktone, që marrin rëndësi të veçantë në kuadër të zhvillimeve moderne të frutikulturës europiane, të mbajtur nga specialistët e QTTB-së, Vlorë u paraqit përvoja pozitive e specialistëve italianë në këtë fushë. Dr. F. R. de Salvador, drejtor i Qendrës së Kërkimit Eksperimental të Frutikulturës në Romë, ndërmjet arritjeve të suksesshme të kësaj qendre kërkimore-shkencore, theksoi rëndësinë e përfshirjes së varieteteve të reja të specieve me përdorim të pakët në strukturën e frutikulturës moderne, që ndikon fuqimisht në shëndetin e njeriut. Kultivimi i specieve në vazo paraqitet si një metodë efektive dhe për specie të tilla “të vogla”. Me interes u ndoq referimi i dr. R. di Primio, titullar i kompanisë private “Apice Piante”, Pescara në Itali, që përdor metodën inovative bioteknologjike të kulturës *in vitro* për prodhimin e fidanëve të certifikuar nga ana fitosanitare dhe për pastërtinë gjenetike. Pas 35 viteve përvojë pune me standarde cilësore, në respekt të natyrës, kompetencës së kultivimit dhe sipas vizionit të tregut, kompania ka përfshirë në prodhim edhe speciet me përdorim të pakët, si fikun, lajthinë, bajamen, gështenjën, boronicën, mjedrën, manaferrën, luleshtrydhen, shegën, hiden, ftoin, manin, vadhëzën, marenë etj. Nga referuesi dhe auditori u mbështet fakti i domosdoshmërisë së prodhimit të fidanëve edhe në Shqipëri me anë të mikروشumimit me avantazh uniformitetin e tyre dhe mungesën e fitopatogjenëve. Me interes u ndoqën referimet e specialistëve për specie të veçanta, si për përfshirjen e shegës në pemëtarinë mesdhetare nga një grup specialistësh italianë, përfaqësuar nga dr. P. Preka; për përdorimin e teknologjive bashkëkohore në prodhimin e boronicës dhe mjedrës në trojet shqiptare nga prof. E. Kullaj në UBT dhe msc. K. Lepaja nga Universiteti Bujqësor i Prishtinës. Po kështu me interes u ndoq edhe sesioni i posterave, ku autorët akad. asoc. E. Kongjika (ASHSH), prof. asoc. dr. V. Sota (UT), dr. Dorian Bode (UBT), dr. Carmine Damiano (CRF, Romë, Itali) paraqitën studimet disave për konservimin *in vitro* të disa specieve frutore autoktone, si dhe të disa specieve me përdorim të pakët si shega, mërsina, hidja, dardhukla etj. në dy postera: *Biotechnological methods for raising collections of some under-utilized fruit trees with economic and health importance* dhe *In vitro collections of autochthonous species of Prunus genus germplasm*”.

Në tryezën e rrumbullakët të organizuar në fund të konferencës, përveç specialistëve të pemëtarisë nga institucione shkencore shqiptare dhe italiane, morën pjesë gjallërisht në diskutime dhe specialistë të tjerë të interesuar si fermerë, kultivues të pemëve frutore. Në qendër të diskutimeve ishin nismat që duhen ndërmarrë nga qendrat kërkimore si QTTB-ja, Vlorë, nga UBT-ja etj., të mbështetura nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Nga drejtuesit e tryezës u propozua përpilimi i një **deklarate** të konferencës për të sensibilizuar instancat politikëbërëse dhe vendimmarrëse për përfshirjen e frutikulturës alternative, si një rrugë e re e zhvillimit të frutikulturës shqiptare në kuadrin e zhvillimeve të sotme europiane. Akademia e Shkencave, duke pasur si mision të saj edhe bashkëpunimin me institucionet kërkimore brenda dhe jashtë vendit për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës dhe teknologjisë dhe veçanërisht bashkëpunimin me biznesin për zbatimet e produkteve të kërkimit shkencor dhe inovativ në ekonomi, e mbështet këtë nismë për frutikulturën alternative dhe sugjeron disa

opinione për organizimin e punës përgatitore për fillimin e kësaj veprimtarie të rëndësishme. Në radhë të parë, domosdoshmëri paraqet sensibilizimi i popullatës shqiptare për vlerat ushqyese dhe mjekësore të përdorimit të frutave alternative, si dhe i fermerëve për kultivimin e tyre me përfitim jo vetëm nga përdorimi në tregun e brendshëm, por me përparësi në tregun europian dhe global. Organizimi i veprimtarive të tilla si seminare, *workshop*-e nga institucione të kërkimeve bujqësore së bashku me Akademinë e Shkencave do të kontribuojnë në këtë drejtim. Ngritja e parcelave eksperimentale demonstrative në zona të ndryshme klimatike-tokësore të Shqipërisë për kultura të veçanta do të paraprijë zhvillimin në shkallë të gjerë të frutikulturës alternative. Përparësi duhet të ketë nxitja për krijimin e kooperativave të fermerëve, që do të merren me këtë drejtim të pemëtarisë në Shqipëri në mënyrë që të bashkërendohet prodhimi i fidanëve dhe përhapja e tyre, të studiohen tregjet e brendshme dhe veçanërisht ato jashtë vendit për eksportin e produktit bujqësor. Jo më pak vlerësim duhet të marrë për të ardhmen ngritja e kompanive private për prodhimin e fidanëve me anë të kulturës *in vitro* për të siguruar certifikimin fitosanitar dhe atë të pastërtisë gjenetike.

Konferenca konsiderohet si veprimtari e rëndësishme nxitëse për sensibilizimin e strukturave publike dhe veçanërisht të atyre private për përfshirjen e frutikulturës alternative në ekonominë shqiptare.

### **Konferenca kombëtare “Siguria e digave dhe menazhimi i tyre”**

Në përgjigje të problematikave të digave e ujëmbledhësve të hidrocentraleve të mëdha dhe rezervuarëve të vegjël e digave të tyre, më **17 tetor 2016**, në mjediset e hotelit “Tirana International” u mbajt konferenca kombëtare “Siguria e digave dhe menazhimi i tyre” organizuar nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujërave. Konferenca kishte si qëllim ndërgjegjësimin e institucioneve qendrore dhe vendore për detyrimet ligjore që ka secili në këtë fushë dhe propozimi i masave të mëtejshme që duhet të ndërmerren. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të lartë shtetërorë të angazhuar në fushën e menazhimit të digave; përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor në fushën e ujit; institucione të rëndësishme shkencore që kanë pjesë të veprimtarisë së tyre projektimin, menazhimin e mirëmbajtjen e digave; përfaqësues të pushtetit lokal që merren me menazhimin e digave dhe investitorë që operojnë në këtë sektor. SSHNT-ja mori pjesë në këtë konferencë me dy referime: “Vlerësimi i gjendjes fiziko-mekanike të digave të hidrocentraleve sipas të dhënave gjeofizike *in situ* të realizuara në kaskadën e Drinit dhe Matit” (S. Bushati, A. Frashëri) dhe “Monitorimi i rrëshqitjeve në shpatet e liqeneve të hidrocentraleve, sipas të dhënave gjeofizike zbatuar në zonën e Poravës, Fierzës dhe Ragamit në Vaun e Dejës” (A. Frashëri, S. Bushati). Në përfundim të punimeve të saj konferenca theksoi domosdoshmërinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve të këtij sektori si dhe të lidhjeve të ngushta ndërmjet institucioneve përgjegjëse të digave dhe institucioneve të kërkimit shkencor; vazhdimin e takimeve në rang kombëtar dhe lokal; nevojën e ngritjes së një grupi tekniko-shkencor, që do të bëjë inventarizimin teknik të të gjitha digave dhe ringritjen e një Instituti Kombëtar të Ujit.

### **Konferenca ndërkombëtare shkencore “Këshillimi shkencor” dhe mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Rrjetit Botëror të Akademive të Shkencave (InterAcademy Partnership, IAP).**

Nga **28 shkurt** deri më **2 mars 2016** u mbajtën në Hermanus të Afrikës së Jugut, si konferenca ndërkombëtare shkencore ashtu dhe mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme së IAP-it. Në këtë aktivitet mori pjesë i ftuar dhe i mbështetur nga Akademia e Shkencave e

Afrikës së Jugut, akad. Salvatore Bushati, kryetari i SSHNT-së. Duke analizuar aktivitetin trevjeçar të IAP-it rezulton se akademitë e shkencave të vendeve të ndryshme kanë luajtur vazhdimisht rolin e sintetizimit të rezultateve shkencore më të fundit dhe kanë dhënë këshilla të besueshme të pavarura dhe vlerësime për politikëbërësit. Por akademitë nuk janë burimi i vetëm i këshillimit shkencor për qeveritë, gjithashtu dhe komitetet e ekspertëve dhe mekanizma të tjerë janë përdorur gjerësisht në vende të ndryshme. Mekanizma të tillë u shqyrtuan gjatë konferencës së IAP-it nga një sërë ekspertësh të përfshirë në ofrimin e këshillimit shkencor nëpërmjet një seri sesionesh interaktive si: “Këshillimi shkencor për ekosistemin”, “Gatishmëria e vendit për këshillimin shkencor” dhe “Ndërveprimi mes këshillimit shkencor, politikës dhe mediave”. Dy seanca shtesë patën një fokus më të veçantë, përkatësisht “Këshillimi shkencor në kohën e fatkeqësive/emergjencave” dhe “Këshillimi shkencor në arenën ndërkombëtare me një fokus të veçantë biologjinë sintetike”.

ASHSH ekspozoi publikime nga veprimtari të kërkimit shkencor të zhvilluara në kuadër të programit “Edukimit në shkencë”, të shkencës në diplomaci, të pasurive ujore, rrezikut natyror dhe emergjencave civile, të shëndetit, biodiversitetit, bioteknologjisë, si dhe të studimeve të tjera që kontribuojnë në realizimin e strategjive kombëtare si ajo e kërkimit për zhvillimin teknologjik dhe inovativ etj. dhe këshillimit të politikëbërjes për zhvillimin në përgjithësi të vendit. Stenda e ASHSH-së u vizitua masivisht dhe publikimet u vlerësuan pozitivisht nga pjesëmarrësit, si produkte shkencore me ndikim kombëtar dhe më gjerë në përputhje me politikat e IAP-it. Vlerësime për Shqipërinë u dhanë edhe për punën që bën ASH-ja në lidhje me stimulimin e kërkuesve të rinj, duke i bërë pjesë të veprimtarive të zhvilluara nga IAP-i.

### **Konferenca ndërkombëtare shkencore “Technology + Society ‘!?’ Future”**

Akademia e Shkencave dhe Arteve e Malit të Zi organizoi më **19 – 21 maj 2016** në Podgoricë Konferencën ndërkombëtare shkencore “Technology + Society ‘!?’ Future” në bashkëpunim me Akademinë Botërore të Artit dhe Shkencës (WAAS), Akademinë Europiane të Shkencave dhe Arteve (EASA), Global Round-Table (GRT) dhe Federatën Europiane të Akademive Kombëtare të Shkencave Natyrore dhe Humane (ALLEA). Konferenca u organizua nën kujdesin e kryeministrit të Malit të Zi, Sh.T. z. Milo Gjukanoviç. Në të morën pjesë më shumë se 60 pjesëmarrës nga 30 vende të botës, personalitete të njohura për angazhimin e tyre profesional në tematikat e konferencës, si: teknologjia e progresit – sfidat dhe kërcënimet; teknologjia dhe vlerat e saj në ditët e sotme; teknologjia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare; pjesëmarrje në ndërtimin social dhe progresin teknologjik; kontrolli i teknologjisë, kufizimet ligjore dhe etike, qëndrueshmëria; varësia teknologjike, pushteti dhe burokracia; teknologjia, spiritualizmi e feja; teknologjia, edukimi për të ardhmen dhe i prapambetjes kulturore; inteligjenca artificiale dhe e ardhmja e njerëzimit; teknologjia e gjinia etj.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë u paraqit në këtë konferencë me dy referate: “*The tragedy of innovation – reflections on innovation and disruption impacts*” (G. Beqiraj, N. Frashëri, 2016) dhe “*Encourage the creativity starting at the early childhood - the most effective investments for quality young researchers in the future*” (A. A. Bushati, S. Bushati, 2016).

Akademikët G. Beqiraj dhe N. Frashëri në referimin e tyre theksuan rolin aktual të inovacioneve, të cilat janë çështje themelore në programet e ndryshme politike, në strategjitë dhe programet e zhvillimit, që konsiderohen si një faktor i rëndësishëm për rritjen ekonomike



dhe hapjen e vendeve të reja të punës duke theksuar se “risia ka qenë motori i zhvillimit”. Në anën tjetër, risitë e detyruara / të përshpejtuara krijojnë thyerje në kompleksin e marrëdhënieve shoqërore-ekonomike, që janë praktikisht të pamundura për t’u kuptuar dhe për t’u menazhuar plotësisht. Ky lloj ndikimi është në kundërshtim me qëllimet politike të inovacionit. Ata argumentuan se thyerjet e shkaktuara nga risitë nuk përmirësojnë apriori proceset ekonomike, por mund të çojnë në optimizime, ndoshta edhe spektakolare por lokale, që mund të jenë problematike për optimizimin global të ekonomisë. Fokusi duhet të mos jetë thjesht të risia në vetvete, por të përfshijë marrëdhëniet njerëzore të ndikuara nga risia. Kjo dukuri mund të jetë edhe tragjike për vendet e vogla në zhvillim, veçanërisht në kushtet e globalizimit. Politikat në vendet e vogla në zhvillim duhet të përshtaten me kujdes duke shmangur importimin e ideve nga vendet e mëdha dhe të zhvilluara në mënyrë që të nxisin rritjen e qëndrueshme. Pyetje të rëndësishme janë të lidhura me atë se për çfarë shkence dhe inovacioni kemi nevojë dhe se si mund të shfrytëzojmë rezultatet e tyre. Të rendurit verbërisht drejt temave “të njohura” dhe me faktor ndikimi (subjektiv), kur ka burime më të vogla në krahasim me vendet e tjera, është aventurë e padobishme. Edhe në rastin e risive të rëndësishme, ato duhet të eksportohen për marketing atje, ku kapaciteti ekonomik dhe industrial është i përshtatshëm për thithjen e saj dhe zhvillimin e mëtejshëm. Gjithashtu autorët theksuan se nevojat aktuale të fushës kërkimore shkencore kërkojnë bashkëpunimin ndërmjet politikës e kërkimit, jo në formën e strategjive dhe platformave të shkruara bukur, por përmes bashkëpunimit konkret e përfshirjes në procesin e zgjidhjes praktike të nevojave.

Inovacioni ka në themel të pikënisjes së tij kreativitetin dhe dëshirën për të zbuluar mënyra të reja që të përmbushin sa më shpejt dhe më mirë nevojat që lindin në fusha dhe aspekte të ndryshme të jetës. Duke vlerësuar rolin e kreativitetit, në referimin e mbajtur nga akad. S. Bushati dhe msc. A. Bushati, iu kushtua vëmendje e veçantë inkurajimit të kreativitetit që nga fëmijëria e hershme, si investimi më efektiv për kërkuesit e rinj të së ardhmes. Shpeshherë mbi nocionin e të qenit kreativ qarkullojnë pikëpamje sipërfaqësore. Kështu për shembull, ekziston mendimi se kreativiteti i përket vetëm fushave artistike, ndërkohë që kreativiteti aplikohet në fusha të ndryshme, përfshirë ato shkencore.

Fëmijët janë aktorë socialë në të tashmen dhe në të ardhmen. Si të tillë, fëmijët janë pikërisht ata të cilët do të marrin pjesë në transformimin e së ardhmes duke u bërë udhëheqës dhe kërkues në fusha të ndryshme të dijës. Ndaj, është e domosdoshme të shihet me përparësi dimensionin e edukimit: çfarë mësojnë dhe si mësojnë fëmijët. Një nga thelbet e kreativitetit është edhe aftësia për të zgjidhur probleme e për të menduar jashtë skemave të ngurta, pasi ndihmojnë në ndryshime shoqërore, kulturore, politike, në përparimin ekonomik etj. Një çështje kritike e shoqërisë së sotme është pikërisht aftësia e fëmijëve për të përballur sfidat e së ardhmes. E megjithatë, edhe pse shkolla synon të edukojë për të ardhmen, ajo mbetet e paparashikueshme. Në këtë kuptim, zhvillimi i aftësisë krijuese që në moshë të hershme është element thelbësor për zhvillimin e shoqërisë. Të gjithë njerëzit kanë potencial të shumëllojshëm aftësish, por këto aftësi fillojnë dhe zbehen me rritjen e njeriut. Ironikisht, një nga arsytet se pse ndodh kjo është ndikimi i shkollimit. Dhe pikërisht këtu roli i mësuesit është thelbësor. Në përgjithësi, shkolla nuk promovon aftësinë për të rrezikuar dhe ndodh që kur fëmijët gabojnë, ata ndëshkohen nëpërmjet vlerësimit negativ. Ndërkohë, gabimi e ndihmon fëmijën që të mësojë dhe të hulumtojë diçka të panjohur. Shpeshherë, programet shkollorë nuk inkurajojnë mjaftueshëm shpirtin krijues të fëmijës në të gjitha fushat e të nxënies, përfshirë hulumtimin fëmijor dhe më tej kërkimin shkencor. Çfarë duhet bërë? Aftësia për të krijuar duhet të inkurajohet që në moshë të hershme. Gjithashtu, kurrikula duhet të përfaqësojë në mënyrë më të baraspeshuar lëndët shkencore dhe ato artistike. Duke iu

referuar shkollës përsëri, fëmijët angazhohen në mësimin formal, si për shembull shkrim, lexim, matematikë, por ndërkohë vëmendja nuk është e mjaftueshme për të zhvilluar mendimin kritik dhe aftësitë krijuese në mënyrë të balancuar në të gjitha fushat e dijës. Esencial është rikonceptimi i edukimit dhe i prioriteteve, me qëllim që të nxitet te fëmijët sensi i inovacionit, i cili më vonë do reflektohet në interesin e të rinjve në fusha të ndryshme të shkencës dhe kërkimit shkencor, duke rritur kështu kontigjente të reja kërkuesish të suksesshëm e me moshë mesatare sa më të re të produktivitetit të tyre shkencor. Përdorimi i kreativitetit mund të hapë dyert dhe mundësi të reja në një botë, ku problemet e reja dhe ndryshimet sociale do të kërkojnë mënyra të reja të menduarit dhe zgjidhje krijuese. Kjo nuk do të thotë që dikush do të jetë një shkencëtar dhe do të gjejë zgjidhje të reja, por është e rëndësishme që të vlerësohet të menduarit krijues, si një proces i cili zbatohet në fusha dhe hapësira të ndryshme të jetës. Zbatimi i mënyrave të reja krijuese të mësimdhënies dhe të promovimit të kreativitetit, dhe jo mbështetja e ideve kufizuese, që përcaktojnë atë që duhet të jetë arsimi apo kreativiteti, është e rëndësishme, kur shikohet drejt së ardhmes duke kërkuar stimulimin e mënyrave të reja të menduarit. Themelore është përpjekja për të riparë edukimin dhe prioritetet e tij se si transmetohen njohuritë dhe si mund të shpaloset kreativiteti i fëmijëve “për të nxitur ndjenjën e inovacionit”, e cila është aq thelbësore për nxitjen e interesit të të rinjve në shkencë dhe hulumtim.

Nga debatet të zhvilluara, u theksua se ka ende shumë për të bërë dhe shumë dilema duhet të zgjidhen, por procesi i rishikimit të gjithë sistemit të lidhur veçanërisht me kreativitetin, tashmë mund të sigurojë një fillim të mirë.

### **Konferenca “EO Open Science Conference 2016”**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë përfaqësohet me një referim në konferencën “EO Open Science Conference 2016” në ESA (European Space Agency), organizuar në Frascati, Itali më **12 – 14 shtator 2016**, me autorë akademikët N. Frashëri, G. Beqiraj dhe S. Bushati, si dhe prof. A. Frashëri. Në përgjigje të zbatimit të teknologjive inovative paraqitet përdorimi i teknologjive të imazheve satelitore në zgjidhjen e problematikave mjedisore me përdorimin e imazheve satelitore SAR në “pika të nxehta” si në zonën e Semanit dhe atë të Liqeneve të Prespës dhe Ohrit. Për këtë qëllim u përdorën imazhet e radarit “Envisat” në harkun kohor 2003–2010 dhe imazhet e radarit ERS2 në 1999 dhe 2002. Metodologjia kryesore konsiston në: (i) kombinimin e intensiteteve prej imazheve RGB në vite dhe sezone të ndryshme; (ii) identifikimet që lidhen me ndryshimet e vegjetacionit në kohë; dhe (iii) interferometria diferenciale e fazës për dallimin e lëvizjeve vertikale. Nga studimi arrihen disa përfundime, të cilat përmbledhtazi mund të raportohen si më poshtë:

- Në Ultësirën Pranadriatike, në periudhën dimër–pranverë–verë për vitin 2003 dallohet shkalla e ndryshimit në zonat e tokave të ulëta në lindje me ato kodrinore në perëndim, të cilat kanë reflektim të lartë në dimër në krahasim me zonat malore të lindjes dhe Rivierës në pranverë.

- Në periudhën dimër–pranverë–verë për vitin 2010 dallohet reflektim në tokat e ulëta në lindje dhe atë të Ultësirës Pranadriatike, ndërsa në pjesët më jugore të Ultësirës Pranadriatike identifikohet një reflektim i lartë në pranverë.

- Në periudhën e verës 2003–2007–2010 dallohen reflektime të larta në tokat e ulëta në Ultësirën Pranadriatike në verën e 2007-s, si dhe në tokat e ulëta në lindje në verën e 2003-shit ose vjeshtën e 2010-s. Sipërfaqet më të larta të maleve në pjesën më jugore kanë reflektim të lartë në verën e 2007-s.

- Në zonën e Maliqit në periudhën e dimrit 2003–2007 vrojtohen diferenca të reflektimit ndërmjet tokave të ulëta (në dimër dhe verë) dhe zonave malore (në pranverë dhe verë), me disa breza reflektimi gjatë pranverës në majat e vargjeve malore jugore në vitet 2003–2007–2010; pjesa perëndimore e territorit është me reflektim më të lartë në pranverë, ndërkaq zonat malore në lindje dallohen nga reflektim i lartë në dimër; ndërsa në verë, zonalitete të vogla dallohen në tokat e sheshta në lindje. Në dimër, dallohen shirita reflektimi në zonën e Maliqit.

- Në zonën e Prespës së Vogël, në verën e viteve 2003–2007–2010 dallohen ndryshime në zonat e brigjeve të kultivuara në lindje të Prespës së Vogël me një reflektim në verë të 2003-shit, si edhe në brigjet e liqenit në verën e 2007-s. Në verën e 2003-shit, zona në jugperëndim në mbyllje të liqenit, në “bishtin” e tij shfaq reflektim të lartë.

-Në Rivierën Joniane 2007–2010, nga imazhet satelitore dallohen sedimentet, që derdhen në det nga përrrenjtë malorë.

- Nga imazhet ERS të vitit 1999 dhe 2002, kombinimi i intensiteteve të RGB-së paraqet disa ndryshime ndërmjet kodrave në veriperëndim dhe atyre në juglindje.

- Gjithashtu, dallohen diferencat e fazave që korrelojnë me tipare të relievit DEM nëpërmjet imazheve të ERS për 1999 dhe 2002; interferograma e imazheve ERS dëshmon për ndryshime në kodrat rreth digës së Vaut të Dejës dhe në kodrat e Torovicës.

Përdorimi i këtyre metodave hap rrugën për aplikimin e tyre me sukses në vlerësimin e problematikave mjedisore.

Konferenca shkencore ndërkombëtare “Water, Knowledge and Innovation in the Danube Region”

Më 3 – 4 nëntor 2016 në Bratislavë, Sllovakia u zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare “Water, Knowledge and Innovation in the Danube Region”, organizuar nga Komisioni Europian, referimet kryesore u mbajtën nga zëvendës drejtori i përgjithshëm për politikat rajonale dhe urbane i Komisionit Europian, z. N. Papens; drejtori i përgjithshëm i Qendrës për Kërkime të Përbashkëta i Komisionit Europian, z. V. Sucha; presidenti i Komisionit Ndërkombëtar të Mbrojtjes së Danubit, z. P. J. Kalas; ministri i Mjedisit të Sllovakisë z. L. Solymos, si dhe ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Inovacionit të Sllovakisë, z. M. Sarcevic. Më pas u zhvilluan 6 *workshop*-e, në secilin prej të cilave u trajtuan problematika të rëndësishme me fokus: (1) *pasurimin e njohjeve të shoqërisë me vizionin e përbashkët për Danubin në drejtim të transferimit të njohurive* (shoqëria e dijeve, aftësi profesionale, përshtatshmëria e rajonit, si dhe eksperiencat e edukimit dhe trajnimit në Sllovakia dhe vendet e tjera të Danubit); (2) *uji – jo alternativë, por domosdoshmëri për jetën* (dinamikat e menazhimit të integruar me synim ndryshimet klimatike, ujërat dhe bujqësia, projektet strategjike etj.); (3) *së bashku për inovacione* (modelet për një qeverisjeje ndërshtetërore, vendet joeuropiane në EUSDR – çështje dhe perspektiva etj.); (4) *mbështetje shkencore drejt strategjisë për Danubin, si dhe* (5) *Programi ndërshtetëror i Danubit*; (6) *harmonizimi i fondeve me Strategjinë*.

Pas një seance diskutimesh të lira për problematikën e ndryshme u raportua në lidhje me thirrjen e dytë të *Programit* ndërshtetëror *INTERREG – Danubi*, i cili do të hapet në janar 2017. Projektet në këtë thirrje do të fokusohen në partneritete të bashkëpunimit ndërmjet vendeve me 4 tematika prioritare dhe objektiva. Në diskutimet e konferencës, në lidhje me prioritetet e paraqitura nga drejtuesja e *Programit* *INTERREG – Danubi* zhvilloi një diskutim akad. prof. dr. S. Bushati, i cili prezantoi interesat e Shqipërisë në kuadër të këtij programi dhe objektivave që ai synon të zgjidhë.

## Konferenca shkencore ndërkombëtare “Sistemet e informacionit të teknologjive strategjike të energjisë (SETIS Conference – informacion për vendimmarrësit)”

Një nga tematikat më të rëndësishme në programet e BE-së është ai i energjisë, si faktor përcaktues i zhvillimit të qëndrueshëm dhe, në këtë kuadër, u zhvillua në Bratislavë, më 30 dhjetor 2016, konferenca shkencore ndërkombëtare *Sistemet e informacionit të teknologjive strategjike të energjisë (SETIS Conference – informacion për vendimmarrësit)*. Në konferencë ishte i ftuar akad. S. Bushati, kryetar i SSHNT-së (ASH). Në konferencë u shpalos Strategjia e Zhvillimit të BE-së. Referatet kryesore u përqendruan në problemet kyçe të energjisë si: evolucioni për kërkesat energjetike dhe prodhimi sot. Nga referuesit u analizuan çështje: *mbi materialet për prodhimin e energjisë; më pak sasi karboni në ngrohje dhe ftohje; procesi i kapjes së karbonit përdorimit dhe depozitimit, prodhimi i energjisë në centralet bërthamore e strategjia për të ardhmen (kapacitetet e prodhimit në botë dhe kërkesat) e probleme të tjera që lidhen me të; qelizat e karburantit dhe hidrogjeni; energjia gjeotermale; hidroenergjia; bioenergjia; industria e energjisë nga turbinat e erës dhe ujit etj.*

Në reflektim të problematikave të konferencës, mund të theksohet se problemi përparësor i energjisë duhet të jetë prioritet i edukimit, kërkimit dhe inovacionit, i shoqatave e sistemeve universitare. Duhet të merret përvojë nga vendet e BE-së ku, në veprimtaritë për energjinë janë përfshirë: 202 universitete, nga ku 25 universitete përfshihen në Hapësirën Europiane të Kërkimit (ERA); 861 tematika shkencore bazë e aplikative të kërkimit; 451 doktoratura dhe 579 programe master; gjithashtu numërohen 9 milionë njerëz që merren me problemet e energjisë, bashkëpunimit me biznesin dhe ekspertë të jashtëm. Në seancën e diskutimeve akad. Bushati diskutoi në lidhje me gjendjen e burimeve energjetike në Shqipëri dhe nevojat e ndërmarrjes së nismave në këndvështrimin e kontributit që kërkohet të jepet nga kërkimi shkencor. Mendojmë se ka vend që pas disa vitesh zbatimi të Programit Kombëtar për Ujin dhe Energjinë të rishikohet programi në përputhje me përparësitë e energjisë dhe stimulimin e prodhimit të energjive të rinovueshme në harmoni me strategjitë e zhvillimit të vendit, i cili aktualisht implementohet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike i ASH-së edhe në të ardhmen do të vazhdojë ta ketë si përparësi të saj zhvillimin e veprimtarive për energjinë.

### II.B. Referime në konferenca shkencore

1. **Agastra E., Frashëri N., Floqi T., Kaçani J., Premti F., Selmani E., Teta J., Xhafka E.** *Environment monitoring in public transport vehicles*. 7th International Conference “Information Systems and Technology Innovations: The New Paradigm for a Smarter Economy” ISTI2016, Tirana, 17-18 June 2016;

2. **Baruti B., Malollari I., Sadiku M, Lajqi N, Dobroshi F., Kelmendi M., Aliu M.** *Treatment possibility to use solar photovoltaic systems in public lighting in the municipality of Mitrovica*. International Conference Gredit 2016, Green Development, Infrastructure, Technology Book of Abstracts, Skopje, 31 March – 2 April 2016, COBISS.MK-ID 100833290, ISBN: 978-608-4624-22-6, 236 p.;

3. **Bushati S., Kongjika E.** *An excellence center of nanotechnology and biosensors – a necessity of scientific development and applications of new technologies in Albania*. ALBNANO 2016, Workshop on Nanotechnology and Biosensors Impact in health, environment, safety and security of Albania, A collaboration event between Albania and Spain, May 29-31, 2016 in Tirana, Albania;



4. **Canj XH., Beqiraj I., Malollari I.** *Characterization of crude oil from various natural resources in Albania using instrumental analysis.* International Conference Gredit 2016, Green Development, Infrastructure, Technology, Book of Abstracts, Skopje, 31 March – 2 April 2016, COBISS.MK-ID 100833290, ISBN: 978-608-4624-22-6, 251 p.;
5. **Canj Xh., Malollari I., Beqiraj I., Liçi L.** *An Improved Simulation Method of Crude Oil Fractional Separation to Achieve a Higher Quality in Natural Source Management,* VII International Scientific Agriculture Symposium AGROSYM 2016, Book of Proceedings, <http://www.agrosym.rs.ba>, ISBN: 978-99976-632-7-6 COBISS.RS-ID 6216984;
6. **Dobroshi F., Malollari I., Kochubovski M.** *Physico-chemical analysis of drinking water, its impact on health in several villages in the municipality of Mitrovica North.* International Conference Gredit 2016, Green Development, Infrastructure, Technology. Book of Abstracts, Skopje, 31 March – 2 April 2016, COBISS.MK-ID 100833290, ISBN: 978-608-4624-22-6, 223 p.;
7. **Frashëri A., Bushati S.** *Vlerësimi i gjendjes fiziko-mekanike të digave të hidrocentraleve, sipas të dhënave gjeofizike in situ të realizuara në kaskadën e Drinit dhe Matit.* Konferenca kombëtare “Siguria e digave dhe menazhimi i tyre”. Tiranë, 17 tetor 2016;
8. **Frashëri A., Bushati S., Frashëri N.** *Kontrolli dhe monitorimi i qëndrueshmërisë së shpateve dhe rrëshqitjeve sipas të dhënave gjeofizike.* Konferenca kombëtare “Siguria e digave dhe menazhimi i tyre”. Tiranë, 17 tetor 2016;
9. **Frashëri A., Pano N., Bushati S.** *Human and economic benefits of the geothermal waters of the Kozan well: the call for investments.* Konferenca shkencore ndërkombëtare “1000-th anniversary of St. John Vladimir”, 21 - 22 tetor 2016;
10. **Frashëri N.** *Some reflections on matrix simulations in economy.* Workshop “Modelling and Simulation in Business Informatics”, ISTI2016, Tirana 17 June 2016;
11. **Frashëri N., Atanassov E.** *Scalability Issues for Wind Simulation using OpenFOAM.* COST Action IC1305 3-rd Workshop NESUS2016, 6-7 October, 2016, Sofia, Bulgaria;
12. **Frashëri N., Beqiraj G.** *The tragedy of innovation – reflections on innovation and disruption impacts.* International Conference “Technology + Society Future”, May 19–20, 2016, Podgorica, Montenegro;
13. **Frashëri N., Beqiraj G., Bushati S.** *Investigation of environmental changes using satellite radar images – experiences from Albanian hot spots.* EO Open Science Conference 2016, Frascati 12-14 September, 2016;
14. **Gruda N.** *FAO Workshop “Good Agricultural Practices - Vegetable production in South-Eastern-European Countries”,* Izmir, Turkey, April 11-14, 2016;
15. **Gruda N.** *Introducing private-public cooperation activities to enhance innovation and the quality of higher education.* 5th EU Tempus Project Meeting of ‘Renewable Energy Studies in Western Balkan Countries’, Tirana, Albania, September 4-7, 2016;
16. **Guxho G., Kaçani J.** *Textile Department and the Manufacturing Sector in Albania;* 7-th International Textile Conference. 10-11 November, 2016, Tirana, Albania;
17. **Haxhimihali Dh., Proko (Jazexhiu) V.** *Terminologjia e kimisë nga Fjalori terminologjik (1963) deri më sot: arritje dhe probleme,* takimi XI vjetor i Institutit ALB-Shkenca, Tiranë, 01-03 shtator 2016;
18. **Izairi N., Veveçka Priftaj A.** *Bulk Nanostructured materials produced by Severe Plastic Deformation Processing.* ALBNANO 2016, Workshop on Nanotechnology and Biosensors Impact in health, environment, safety and security of Albania, A collaboration event between Albania and Spain, May 29-31, 2016, Tirana, Albania;
19. **Kaçani J.,** *Education & research, Msc. Programmes supporting the market and*



- answering to the challenges, 3rd Tirana Gas Pipelines Safety Workshop “Gasification of Albania builds safety capacity”, November 18, 2016 Sheraton Tirana Hotel;
20. **Karakus M., Durrësi A.** *A Scalability Metric for Control Planes in Software Defined Networks (SDNs)*. Proceedings of 30th IEEE International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA), 2016, pp. 282-289;
21. **Karakus M., Durrësi A.** *Economic Viability of QoS in Software Dened Networks (SDNs)*. Proceedings of 30th IEEE International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA), 2016, pp. 140-146;
22. **Kongjika E., Sota V.** *In vitro conservation of autochthonous fruit trees germplasm, very important as a healthy local traditional food*. Conference “Putting Farmers First. Slow Food. Terra Madre Balkans 2016” Topic: Food Biodiversity and Conservation of Plant Genetic Resources. Academy of Sciences and Tirana Agricultural University. 4 June 2016, Tirana;
23. **Kongjika E., Sota V.** *New opportunities of plant biotechnology in Albania using nanomaterials*. ALBNANO 2016, Workshop on Nanotechnology and Biosensors Impact in health, environment, safety and security of Albania, A collaboration event between Albania and Spain, May 29-31, 2016, Tirana, Albania;
24. **Kongjika E., Sota V., Bode D., Damiano C.** *In vitro collections of autochthonous species of Prunus genus germplasm*. Konferenca shqiptare “Frutikultura alternative”, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë, 5 tetor 2016;
25. **Malollari I., Cani Xh., Kaçani J., Liçi L., Buzo R., Qyra M.** *Batch process testing for anaerobic co-digestion as an alternative for renewable biogas*, VII International Scientific Agriculture Symposium AGROSYM 2016, Book of Proceedings, <http://www.agrosym.rs.ba>, ISBN: 978-99976-632-7-6, COBISS.RS-ID 6216984
26. **Malollari I., Cani Xh., Liçi L., Buzo R.,** *Organic waste biodigestion process simulation under different operating conditions*. 7th International Metallurgical Congress, Materials, Environmentals, Book of Abstracts, June 2016, 31 Ohrid - Macedonia June 2016, Book of Abstracts, IN9;
27. **Malollari I., Liçi L., Cani Xh., Lajqi V.** *Albanian Challenges for Agriculture Wastes Pretreatment for Biogas Profit*, EURASIA 2016, Waste Management Symposium, Istanbul, Turkey, [www.eurasiasymposium.com](http://www.eurasiasymposium.com), Proceedings, 653-659;
28. **Malollari I., Xhagolli L., Liçi L., Hodaj H., Dhroso A., Cani Xh., Koraj Dh.** *On Treatment Methods of Organic Biomass, their Selection and Application Possibility for Albanian Actuality*, International Conference Gredit 2016, Green Development, Infrastructure, Technology, Book of Abstracts, Skopje, 31 March – 2 April 2016, COBISS.MK-ID 100833290, ISBN 978-608-4624-22-6, 131 p.;
29. **Merkoçi A.** *Paper-based nanobiosensors in diagnostics: from health, safety and security to environment monitoring*, Invited speaker at NanoBiomed Conference, Barcelona, November 23d, 2016;
30. **Merkoçi A.** *“Nanobiosensors-based diagnostics”*, Invited talk at University of Alcalá de Henares in the framework of PhD School of Chemistry, June 24th, 2016;
31. **Merkoçi A.** *Building Simple Plastic and Paper-Based Diagnostic Devices Using Graphene and Other Nanomaterials*, Invited Talk at Cambridge Graphene Centre, University of Cambridge, United Kingdom, January 28th, 2016;
32. **Merkoçi A.** *Diagnostic Devices using Graphene and other Nanomaterials*, Invited Talk at NanoSpain2016 - [www.nanospainconf.org/2016](http://www.nanospainconf.org/2016) Logroño (Spain) - March 15-18, 2016;
33. **Merkoçi A.** *Diagnostics using nanobiosensors*, Keynote lecture at: BioNanoMed 2016

Nanotechnology enables Personalized Medicine, April 6-8, 2016, Krems /Austria;

34. **Merkoçi A.** *From paper to nanopaper-based biosensors. Current challenges and future perspectives*, Keynote talk, Biosensors 2016, 26th Anniversary World Congress on Biosensors, 25-27 May, 2016, Gothenburg, Sweden;

35. **Merkoçi A.** *Graphene biosensors in diagnostics*, Invited talk at 6th edition of Graphene Conference Series, European Event in Graphene and 2D Materials, Genoa, Italy, 19th - 22th April, 2016;

36. **Merkoçi A.** *Graphene-based biosensors*, Invited Talk at "International Graphene Innovation Conference (GRAPCHINA 2016), Qingdao, China, September 24th, 2016;

37. **Merkoçi A.** *Graphene-based platforms for (bio)sensing applications*, Invited Talk at Graphene & 2-D Materials Conference: From Research to Applications, NPL UK, 16 & 17 November, 2016;

38. **Merkoçi A.** *Graphene-based Platforms for Biosensing Applications*, Plenary Talk, Nanotech France 2016, Nanotech France 2016, International Conference and Exhibition, 01 June - 03 June 2016, Paris- France;

39. **Merkoçi A.** *Graphene-based Platforms for Biosensing Applications*, Invited talk at "Graphene and related materials: properties and applications, GM-2016" International Conference, Paestum, Italy, May 23 - 27, 2016;

40. **Merkoçi A.** *Graphene-Based Platforms for Biosensing Applications*, Keynote at: 2-D Materials Workshop, Organized by The Karlsruhe Institute of Technology (KIT), the National Institute of Standards and Technology (NIST), the Swiss Federal Laboratories for Materials Science and Technology (Empa) and the Federal Institute for Materials Research and Testing Germany (BAM), March 21-23, 2016, Switzerland. <http://www.nanomat.de/2DMat2016.php>;

41. **Merkoçi A.** *Nanobiosensors for diagnostics applications*, Invited talk at Institute of Aquaculture, University of Stirling, Stirling, Scotland, UK, November 3d, 2016;

42. **Merkoçi A.** *Nanobiosensors for Diagnostics Applications*, Key Note Lecture At: Conference Advanced Functional & Industrial Printing, 2-3 March, 2016 - Radisson Blu Scandinavia, Düsseldorf, Germany;

43. **Merkoçi A.** *Nanobiosensors for diagnostics applications*, Keynote Lecture at AACC CPOCT International Symposium, The Benefits and Challenges of Point-of-Care Testing Across the Clinical Spectrum, September 21-24, 2016, Copenhagen, Denmark;

44. **Merkoçi A.** *Nanobiosensors for Diagnostics*, Invited talk Université Tunis ElManar, Faculté des Sciences de Tunis, Département de Chimie, Campus Universitaire de Tunis El-Manar, Tunis, Tunisia, May 19th, 2016;

45. **Merkoçi A.** *Nanobiosensors in Diagnostics Applications*, Invited talk at Tor Vergata University, Department of Chemistry, March 9th, 2016;

46. **Merkoçi A.** *Nanobiosensors in Diagnostics*, Invited talk at 2nd Annual Bioelectronics & Biosensors Congress, November 2017, London, UK;

47. **Merkoçi A.** *Nanobiosensors-based Diagnostics*, Invited talk at Institute for Materials Science and Max Bergmann Center of Biomaterials, Dresden University of Technology, Dresden, Germany, June 16th, 2016;

48. **Merkoçi A.** *Nanobiosensors-based Diagnostics*, Invited talk at Institute of Chemistry - UNICAMP, Campinas-SP, Brazil, April 28th, 2016;

49. **Merkoçi A.** *Nanobiosensors-based Diagnostics*, Invited talk at School of Bioanalytical Chemistry, University – Unicamp, Campinas, Brazil, April 26th, 2016;

50. **Merkoçi A.** *Nanomaterial-based Biosensors*, Invited talk at First Workshop On

Electrochemistry Devices: (Bio)Sensors – Porto, Portugal, October 13-14, 2016;

51. **Merkoçi A.** *Nanomaterials-based Biosensors: From Health to Safety and Security Applications*, Invited talk at: National Institute of Biology (NIB), Ljubljana, Slovenia, February 24th, 2016;

52. **Merkoçi A.** *Nanomaterials-based Biosensors: From Health to Safety and Security Applications*, Invited talk at: National Institute of Biology, Marine Biology Station Piran, Piran, Slovenia, February 23d, 2016;

53. **Merkoçi A.** *Nanomaterials-based sensors for diagnostics applications*, Plenary talk at 3rd International Congress on Biosensors, Ankara, Turkey, 5th-7th October, 2016;

54. **Merkoçi A.** *Nanotechnology and Biosensors: Opportunities in Albania*, Plenary lecture, Academy of Sciences of Albania, Preconference of ALBNANO 2016, Workshop on Nanotechnology and Biosensors Impact in health, environment, safety and security of Albania, A collaboration event between Albania and Spain, May 29-31, 2016, Tirana, Albania;

55. **Merkoçi A.** *Paper-based biosensors for diagnostics*, Invited talk at 2nd Microfluidics Congress Utilizing Microfluidic Technologies as a Tool for Progressing Medical Research and Patient Care, 20-21 October, 2016, London, UK;

56. **Merkoçi A.** *Paper-based nanobiosensors*, Invited talk, ALBNANO 2016, Workshop on Nanotechnology and Biosensors Impact in health, environment, safety and security of Albania, A collaboration event between Albania and Spain, May 29-31, 2016, Tirana, Albania;

57. **Merkoçi A.** *Paper-based nanobiosensors: simple biosensing platforms compatible with smart phones*, Plenary talk at: Rapid Methods Europe, The RME Conference Series, 11th Conference Food, Feed, Water Analysis, Animal Human Diagnostics, 7-9 November, 2016, Amsterdam, Netherland;

58. **Merkoçi A.** *Paper-based Optical Biosensors for Accurate Enough Diagnostics. A hot topic of nowadays research and development with interest for technology transfer to the market*, Research trend presentation at Photonics PPP Annual Meeting 2016 in Brussels (WG3, Health), Brussel, March 2d, 2016;

59. **Merkoçi A.** *Paper-based sensors for diagnostics*, Invited talk at National Center for NanoSci & Tech, Beijing, China, July 25th, 2016;

60. **Merkoçi A.** *Paper-based sensors for diagnostics*, Plenary talk at "Optofluidics 2016", Beijing, China, July 25-27, 2016;

61. **Merkoçi A.** *Paper-based sensors*, Invited talk at Sensors Strategic Workshop, National Institute of R&D for Technical Physics, September 20-21, 2016, Iasi, Rumania;

62. **Neziri A., Marku E., Malollari I.** *Organochlorine Pesticides Concentrations in Surface Waters of Lakes Of Shkodra, Ohrid and Prespa*. International Conference Gredit 2016, Green Development, Infrastructure, Technology, Book of Abstracts, Skopje, 31 March – 2 April, 2016, COBISS.MK-ID 100833290, ISBN: 978-608-4624-22-6, 57;

63. **Porta M., Çiço B., Kaczmarek P., Frashëri N., Cantoni V., Vandamme F.** *New Trends in Information Technologies and their Integration in University Curricula: a Brief Study in the Context of the FETCH European Thematic Network*. International Conference on Computer Systems and Technologies - CompSysTech'16, 23-24 June 2016, Palermo, Italy.

64. **Ruan Y., Durrësi A., Alfantoukh L.** *Trust Management Framework for Internet of Things*. Proceedings of 30th IEEE International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA), 2016, pp. 1013-1019;

65. **Sota V. Kongjika E., Damiano C.** *Biotechnological methods for raising collections of*

some under-utilized fruit trees with economic and health importance. Konferenca shqiptare "Frutikultura alternative", Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë, 5 tetor 2016;

66. **Sheme E., Holmbacka S., Lafond S., Lucanin D., Frashëri N.** *Datacenters Powered by Renewable Energy: A Case Study for 60 Degrees Latitude North*. The 24th International Conference on Software, Telecommunications and Computer Networks. Split, Croatia September 22-24, 2016;

67. **Sheme E., Pierson JM., Da Costa G., Stolf P., Frashëri N.** *Efficient Energy Resource Scheduling in Green Powered Datacenters: A Cloudsim Implementation*. COST Action IC1305 3-rd Workshop NESUS2016, 6-7 October 2016, Sofia, Bulgaria;

68. **Veveçka Priftaj A., Bendo A., Buzra U., Bejko B., Schafner E., Zehetbauer MJ.** *Study of mechanical properties of nanocrystalline Ti-36Nb (wt%) alloy processed by severe plastic deformation*. THERMEC 2016 Graz, Austria, 28 May- 3 June, 2016;

69. **Vila F., Frashëri N., Mandija F.** *Vlerësimi satelitor dhe lokal i aerosoleve në zonën e Shkodrës*, Java e Shkencës, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë, 10 – 12 maj, 2016. Prishtinë.

## II.C. Projekte shkencore

### • Projekte të Këshillit të Ministrave

1. Projekt fizibiliteti për projektpropozimin për Këshillin e Ministrave "Mbi gjendjen dhe masat që propozohen për mënjanimin e ndikimit të veprimtarisë antropogjene në Liqenin e Prespës së Vogël". Akademia e Shkencave e Shqipërisë me një grup specialistësh të shkencave natyrore, teknike e inxhinierike ngritën shqetësimin e gjendjes së përkeqësuar të ekosistemit të Liqenit të Prespës së Vogël dhe ndikimit që ka edhe në sistemin ujor e më gjerë në Liqenin e Prespës së Madhe e Liqenin e Ohrit. Në përgjigje të këtij shqetësimi të komunitetit shkencor, kryeministri Edi Rama urdhëroi ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e një raporti studimor të fizibilitetit "Mbi gjendjen dhe masat që propozohen për mënjanimin e ndikimit të veprimtarisë antropogjene në Liqenin e Prespës së Vogël". Studimi i fizibilitetit duhet të japë një raportim të plotë të përditësuar të situatës në Liqenin e Prespës së Vogël, si një nga liqenet më të shkatërruara në Shqipëri, i cili do të prodhojë dhe termat e referencës për realizimin e një projekti së bashku me ekspertë të jashtëm në fokusin e investimeve dhe ndërhyrjeve në liqen, me qëllim ndalimin e përkeqësimit, rehabilitimin e mundshëm e përmirësimin e situatës aktuale trofike të Liqenit të Prespës së Vogël.

Fillimisht, si fazë e parë u përgatit një studim i fizibilitetit, i cili do të prodhojë termat e referencës për një projekt shkencor për zgjidhjen e detyrave të vëna nga Këshilli i Ministrave. Argumentet shkencore për gjendjen ekzistuese të tërësisë së ekosistemit, të projektit të fizibilitetit, termat e referencës etj. janë trajtuar në disa tryeza të rrumbullakëta të organizuara nga Komisioni i Posaçëm i Ujërave Ndërkufitare në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit të Ujërave të MBZHRAU-t; nga Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike i Akademisë së Shkencave me anëtarët e seksionit (**akademikët S. Bushati, N. Frashëri, G. Beqiraj** dhe **akad. asoc. E. Kongjika**) si dhe ekspertët e jashtëm (prof. dr. N. Pano, prof. dr. A. Frashëri). Grupi ndërinstitucional i punës për realizimin e studimit për Sistemin Ujor: Prespat – Ohër u kryesua nga zëvendësministri i Bujqësisë, i Zhvillimit Rural dhe i Administrimit të Ujërave, z. Gj. Jaku dhe në përbërje të tij ka:



1. Përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
2. Përfaqësues nga Ministria e Mjedisit;
3. Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
4. Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
5. Përfaqësues nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
6. Përfaqësues nga Akademia e Shkencave (akad. S. Bushati dhe prof. dr. N. Pano);
7. Përfaqësues nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.

Studimi i fizibilitetit është mbështetur në botime shkencore, një sërë artikujsh e punimesh që trajtonin të gjitha problematikat e Liqenit të Prespës e ato që lidhen me to, të paraqitura nga ASH-ja; UT-ja, FSHN-ja; Agjencia e Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Shërbimi Gjeologjik Shqiptar etj. Janë marrë në konsideratë edhe materialet nga grupi i ekspertëve të depozituara në MBZHRAU. Sipas studimit të fizibilitetit u konsideruan problematikat si më poshtë:

- Liqeni i Prespës së Vogël tashmë ka humbur tiparet e një liqeni për shkak të eutrofikimit të tij;

- Nga një sërë studimesh në vite në këtë sistem nuk janë dhënë zgjidhje reale për problematikat e paraqitura;

- Nevojitet një studim i ri për përditësimin e studimeve mbi gjendjen aktuale, me kohëzgjatje njëvjeçare, për të cilin do të nevojitet një buxhet i përafërt prej 90 mijë eurosh;

- Bazuar në rezultatet e studimit, do të ishte e domosdoshme përgatitja e një projektzbatimi për ndërhyrje me investime për rehabilitime të mundshme apo për ndalim të përkeqësimit të gjendjes në këtë sistem ujor liqenor.

Në fillim të muajit janar 2017 iu dërgua Qeverisë *Raporti i studimit të fizibilitetit* i përfunduar si pjesë e parë e projektit madhor me synim investimet për të përmirësuar situatën aktuale të dëmtuar në gjendje optimale në Liqenin e Prespës së Vogël. Bazuar në studimin e fizibilitetit do të zhvillohet projekti, i cili do të drejtohet nga MBZHRAU dhe do të zbatohet nga Agjencia e Zhvillimit Rajonal nr. 3, Korçë, pasi mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Menazhimit të Integruar të Burimeve Ujore, duhet të harmonizohet patjetër me Autoritetet e Baseneve Ujore dhe në rastin tonë duhet të respektojë edhe autoritetin e Komisionit të Ujërave Ndërkufitare.

Duke marrë në konsideratë bazën ligjore përkatëse dhe trashëgiminë e studimeve të zhvilluara deri më tani, me synim gjetjen e zgjidhjeve për të ardhmen e Liqenit të Prespës së Vogël, metodologjia e mikroprojektit të propozuar nga grupi i punës (*Mbi gjendjen dhe masat që propozohen për mënjanimin e ndikimit të veprimtarisë antropogjene në Liqenin e Prespës së Vogël*) do të bazohet në këto faza studimore: (1) mbledhja dhe përpunimi i të gjitha studimeve ekzistuese të prodhuara për Liqenin e Prespës së Vogël; (2) njohja me terrenin dhe punime speciale për përcaktime të vëllimeve sedimentare të fundit të liqenit; (3) analiza të thjeshta fiziko-kimike dhe interpretimi i tyre; (4) përdorimi i sistemit GIS dhe teknologjive të imazheve satelitore për diagnostikim e planifikim; (5) bashkëpunimi me autoritetet greke, përgjegjëse për pjesën greke të liqenit, në kuadër të marrëdhënieve ndërkufitare dhe ato të fqinjësisë së mirë; (6) prodhimi i termave të referencës për një projekt investimesh në të ardhmen e afërt; (7) raporti përfundimtar.

Projekti është plotësisht në përputhje me *Direktivën Kuadër të Ujit dhe Strategjinë Kombëtare të Menazhimit të Integruar të Burimeve Ujore*, e cila është në fazën përfundimtare. Realizimi i Projektit do të ketë një kontribut në objektivat e vlefshëm kombëtarë të zhvillimit për shkak se është i lidhur fort me politikat e ujit ndjekur nga MBZHRAU në çështjet e ujitjes në këtë zonë, si dhe me administrimin e integruar dhe cilësinë e ujit, do të ketë ndikim



pozitiv mbi sasinë dhe cilësinë e ujit si edhe mbi biodiversitetin. Duke marrë në konsideratë aspektet shkencore dhe ekonomike, projekti do të ndikojë pozitivisht në çështjet e ujit të pijshëm, furnizimit me ujë për tokat bujqësore, ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit, që së bashku shërbejnë për ruajtjen e përgjithshme të ekuilibrave natyrorë të liqenit dhe të zonave përreth.

Projekti parashikohet të prodhojë rekomandime me ndikim pozitiv për: (i) mundësi zhvillimi për turizmin e huaj; (ii) plotësimin e kërkesave në sektorin privat, në veçanti për peshkim, bujqësi dhe blegtori; (iii) në mënyrë indirekte do të kontribuojë në kërkesat e zhvillimit.

Bashkëpunimi në mes të MBZHRAU-t, Ministrisë së Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, AZHR3-së dhe ekspertëve të jashtëm konsiderohet kyç për të realizuar me sukses këtë projekt.

• **Projekte në kuadër të *Protokollit të Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik* midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës**

**1. Hartimi i monografisë “Prodhimi cilësor i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve”,** koordinatore e projektit akad. asoc. E. Kongjika, (ASHSH, SSHNT); për ASHAK, SSHN, akad. L. Susuri, në kuadër të këtij Protokollit (2013-2015), i cili është zhvilluar në vazhdimësi në vitet 2015-2017 (pika 12 - promovime veprash të rëndësishme shkencore dhe artistike të akademive, produksioni vjetor).

Monografia me autorë kryesorë **akad. asoc. E. Kongjika, prof. dr. A. Zajmi, prof. as. dr. A. Myrta dhe akad. L. Susuri**, është hartuar nga një grup më i madh autorësh (22 autorë). Monografia u dorëzua për shtyp më 2016 dhe do të botohet në fillim të vitit 2017. Në hartimin e veprës kanë dhënë kontributin e tyre specialistët më me përvojë në fusha të ndryshme të pemëtarisë, të mbrojtjes së bimëve, të certifikimit, të biologjisë molekulare, bioteknologjisë, të njohjes së legjislacionit europian e të vendit për prodhimin e fidanëve etj., si në Shqipëri dhe Kosovë. Botimi i ri monografik prej 350 faqesh përfshin një diapazon të gjerë çështjesh, që ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve shqetësuese të pemëtarisë në Shqipëri dhe Kosovë, kur me hapjen e kufijve të tregut europian dhe në qarkullimin e lirë të produkteve bimore, lindi si domosdoshmëri, rregullimi në nivel komunitar dhe kombëtar përmes një programi shkencor dhe legjislativ të lidhur me prodhimin, certifikimin dhe tregtimin e materialit të shumimit të pemëve frutore, që lëviz dhe tregtohet në të gjithë botën. Vepra do të jetë një kontribut konkret në duart e specialistëve në Shqipëri e Kosovë për ngritjen e një sistemi të përbashkët të certifikimit në prodhimin e materialit bimor të kategorisë “bazë”. Ky sistem i përket mbrojtjes së specieve bimore me rëndësi ekonomike nëpërmjet detektimit të hershëm të sëmundjeve virusale me anë të përdorimit të metodave serologjike e molekulare të detektimit të fitopatogjenëve kryesorë viralë, që nuk luftohen me asnjë metodë tjetër, përveç kulturës *in vitro* të meristemës, kombinuar me termoterapinë në prodhimin e fidanëve të shëndetësuar dhe në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit për certifikimin e materialit bimor fidanor të specieve frutore.

**2. Projekti pilot “Studimi i ndryshimeve mjedisore në një segment të zonës ndërkufitare Shqipëri-Kosovë”,** në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit Shkencor e Artistik ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (2015-2017), (pika 6 – përdorimi i teknologjive të reja në studimin e problemeve të mjedisit). Koordinator i projektit për ASHSH-në është akad. G. Beqiraj, zëvendëskryetar i ASHSH-së, kurse anëtarë të grupit shkencor janë: akademikët S. Bushati dhe N. Frashëri, si dhe akad. asoc. E. Kongjika. Për realizimin e projektit aktivizohen dhe ekspertët të jashtëm si prof. dr.

A. Mullaj, florist, përgjegjës i Qendrës Kërkimore të Florës dhe Faunës në Fakultetin e Shkencave Natyrore, UT, prof. dr. K. Onuzi, president i Shoqatës së Studimeve Malore dhe dr. A. Pambuku, drejtor i Drejtorisë së Politikave Ujore, MBZHRAU.

Në nëntor 2016 u organizua takimi i parë në mjediset e ASHAK-ut ndërmjet grupit të akademikëve të ASHSH-së (G. Beqiraj, S. Bushati, N. Frashëri, E. Kongjika) dhe të ASHAK-ut (I. Krasniqi, N. Daci, F. Krasniqi, M. Dushi etj.), ku u diskutua për hartimin e planit të punës, pjesëmarrësit në projekt, metodikën e punës gjatë realizimit të projektit etj. Gjatë muajve të fundit të vitit 2016 u hartua projekti i plotë nga grupi i ekspertëve nga Shqipëria, i cili do të diskutohet në mars të 2017 me partnerët e ASHAK-ut. Përdorimi i imazheve satelitore mundëson analizën e ndryshimeve hapësinore dhe kohore të parametrave mjedisore, në radhë të parë të bimësisë, duke lehtësuar identifikimin e zonave të dëmtuara dhe atyre me interes ekonomik, dhe duke zvogëluar koston e studimeve të stërzgjatura në terren. Identifikimi i zonave të nxehta apo me interes del nga studimi i imazheve satelitore dhe krahasimi i të dhënave me studimet ekzistuese. Më pas, vlerësimi i gjendjes reale në terren bëhet vetëm në zonat e parazgjedhura dhe për parametra mjedisore specifike të identifikuar gjatë studimit. Studimi synon eksperimentimin pilot të kësaj metodologjie në vlerësimin e gjendjes mjedisore në një segment të zonave të mbrojtura në brezin ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Kosovës. Propozohet si zonë studimi ekosistemi natyror malor Korab – Koritnik. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 898 datë 21.12.2011 shpall ekosistemin natyror malor Korab - Koritnik si një "Park natyror" me një sipërfaqe prej 55,550.2 ha (555.5 km<sup>2</sup>). Ekosistemi është pjesë e rajonit alpin, i përfshirë në rajonet e Kukësit dhe Dibrës. Parku shtrihet nga kufijtë e Kosovës në Shqipërinë Verilindore deri në Malin e Deshatit në kufijtë jugorë me Maqedoninë. Zona e Ekosistemit Natyror Malor "Parku Natyror Korab - Koritnik" strehon ekosisteme të vlefshme dhe habitate përgjithësisht të mirëruajtura për shkak të një numri relativisht të ulët banorësh në zonë, investimeve të ulëta, nivelit të ulët të prodhimit bujqësor dhe vendndodhjes së largët gjeografike të zonës. Megjithatë, presionet janë shtuar gjatë viteve të fundit dhe tendencat negative mjedisore duket që janë më të forta se në të kaluarën, dhe shumë habitate, veçanërisht ato pyjore, janë shkatërruar dhe copëzuar nga shpyllëzimi. Presion tjetër është erozioni në zonat malore, i lidhur në mënyrë të natyrshme me shumë faktorë si gjeologjikë, fizikë dhe karakteristikat klimaterike, megjithatë prerja intensive e pyjeve në zonën e mbrojtur i shton zonat ku ndodh erozioni. Kthimi i natyrshëm i pyjeve në zona të gërryera është pothuajse i pamundur. Degradimi i cilësisë së ujit nga ndotja kërcënon habitatet ujore, llojet endemike dhe të rralla dhe cilësinë e ujit të pijshëm.

Duke u bazuar në vizionin për të ardhmen e këtij ekosistemi, janë identifikuar objektivat afatgjatë për menazhimin e zonës Korab-Koritnik, që fokusohen mbi ruajtjen, çlodhjen, shkencën dhe edukimin, dhe në sistemin e menazhimit në zonë. Këto janë hartuar për të ofruar mbrojtje dhe ruajtje të biodiversitetit unik dhe për të mirëmbajtur proceset ekologjike kyçe të zonës së mbrojtur, ndërkohë që mundëson veprimtaritë e përshtatshme çlodhëse. Objektiv kryesor konsiderohet ruajtja e habitateve të ndryshme të zonës së mbrojtur, ruajtja e llojshmërisë së florës dhe faunës, kombinimit të ekosistemeve ujore dhe tokësore, sigurimi i ujit të pastër në lumenj dhe përrenj dhe ruajtja e proceseve unike natyrore dhe biologjike dhe sistemeve të mbështetjes së jetës. Menazhimi i përdorimeve rekreative dhe kulturore të zonës siguron bashkëjetesën e objektiveve të mbrojtjes së natyrës dhe zhvillimit të llojeve të ndryshme të veprimtarive turistike.

Imazhet satelitore janë bërë sot një mjet tepër i fuqishëm për studimin e problemeve mjedisore. Në planin teknik, imazhet e sateliteve si Landsat dhe MODIS japin pamje të sipërfaqes së tokës në bandat e dritës blu, të gjelbër, të kuqe dhe më tej një seri në brezin

tejet të kuq, kombinimi i të cilave mundëson jo vetëm pamjen natyrale të truallit, por edhe vlerësimin e situatave mjedisore si indeksi i bimësisë, temperatura e tokës, përbërja gjeologjike, lagështia, ndotja e ajrit etj. Një pjesë e imazheve që paraqesin këto parametra jepen nga agjencitë përkatëse në internet. Grupi i punës i ASHSH-së ka përvojë të pasur në studime të tilla. ASHSH-ja në bashkëpunim me UPT-në dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar kanë realizuar disa studime me përdorim tepër efektiv të imazherisë satelitore për disa zona me problematika mjedisore si: Liqenet e Ohrit dhe Prespës, Liqeni i Shkodrës, Bregu i Detit Adriatik në rajonin e Semanit dhe Patokut, shkarjet e tokës në kodrat e Kavajës dhe Vaut të Dejës. Rezultatet janë paraqitur në disa konferenca të Agjencisë Europiane të Hapësirës (ESA), janë botuar në revistën *JNTS* të ASHSH-së dhe në raportet për *Programet Kombëtare të Kërkimit të Agjencisë Kombëtare të Teknologjisë dhe Inovacionit*, AKTI në Tiranë. Gjithashtu në kuadrin e *Projektit European SEE-GRID-SCI të Programit Kuadër FP7* është realizuar edhe aplikimi *CHERS* për llogaritjen e prirjes së ndryshimeve në kohë të parametrave mjedisorë nga seritë kohore të imazheve satelitore. Rezultatet janë paraqitur në konferencat *Balwois'2010*, *Balwois'2012*, si dhe publikuar në serinë *Springer Earth Science Informatics*.

Zona është me status të mbrojtur dhe e studiuar me hollësi shumë vite përpara. Konkretisht, projekti pilot parashikon vlerësimin e ndryshimeve vjetore dhe stinore të bimësisë (indeksi diferencial i normuar NDVI) në segmentin Korab – Koritnik (KK) të brezit kufitar midis Shqipërisë dhe Kosovës. Projekti parashikon disa etapa të punës: (1) sinteza e studimeve ekzistuese të bimësisë në zonën KK; (2) analiza e imazheve satelitore për dallimin e ndryshimeve të bimësisë; (3) krahasimi i të dhënave satelitore me ato të studimeve paraardhëse dhe caktimi i pikave me interes për skanim në terren; (4) realizimi i *skanim* të pikave me interes në terren; (5) vlerësimi përfundimtar e të dhënave të mbledhura.

Rezultatet e studimit vlejné si për të kuptuarit e dukurive mjedisore, edhe për përmirësimin e planifikimit të veprimtarive të qëndrueshme ekonomike e turistike në rajon. Projekti i shërben hapjes së rrugës për studime më të thelluara mbi ndryshimet mjedisore në hapësirë dhe kohë të shtrira në rajon, në shërbim të mbrojtjes së mjedisit dhe planifikimit të veprimtarive të qëndrueshme ekonomike e turistike. Përfituesit nga realizimi i projektit pilot do të jenë institucionet e interesuara për problemet mjedisore dhe zhvillimin ekonomik në Shqipëri dhe Kosovë, njësitë kërkimore në fushën e mjedisit në vend dhe rajon, ndërmarrjet ekonomike në fushën e turizmit etj. Për vitin 2017 parashikohen këto veprimtari të përbashkëta ndërmjet ekspertëve nga Shqipëria e Kosova: sinteza e të dhënave nga studimet ekzistuese; analiza e imazheve satelitore dhe krahasimi i të dhënave; identifikimi i pikave me interes dhe organizimi i vizitave në terren; evidentimi dhe fotografimi i gjendjes së bimësisë dhe intervista me banorët dhe autoritetet lokale; ballafaqimi i gjendjes në terren me të dhënat satelitore; nxjerrja e përfundimeve mbi gjendjen dhe prirjen mjedisore; saktësimet e metodikës teknike për trajtimin e imazheve satelitore dhe për krahasimin e të dhënave; shkrimi i raportit teknik: Studimi i të dhënave të bimësisë në zonën KK; paraqitja e rezultateve në konferenca në Tiranë / Prishtinë; botimi i artikullit në revista shkencore; publikime në masmedia në Shqipëri dhe Kosovë.

Viti 2017 do të jetë viti i realizimit të pjesës më të madhe të veprimtarive të projektit pilot nga ana e ekspertëve të Shqipërisë dhe Kosovës. Projekti parashikohet të përfundojë më 2018.

#### • **Projekte në kuadër të bashkëpunimit shkencor midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe institucioneve shkencore të huaja**

Projekt i SSHNT-së (koordinator akad. S. Bushati) në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Gjeofizikës dhe Vullkanologjisë, Romë, Itali (koordinator dr. Massimo Chiappini) me

mbështetje të Bashkisë së Tiranës. Falë një bashkëpunimi prej vitesh të Akademisë së Shkencave, institucioneve shkencore shqiptare në fushën e shkencave të tokës, si Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe institucioneve universitare me Institutin Kombëtar të Gjeofizikës dhe Vullkanologjisë, Romë, Itali (Istituto Nazionale di Geofisica e Vulcanologia INGV), do të realizohet ngritja e **një observatori magnetik në Shqipëri**, i pari i këtij lloji në vend. Vëzhgimet e fushës hapësinore gjeomagnetike të Tokës nëpërmjet monitorimit të të dhënave në mënyrë të vazhdueshme janë të një rëndësie të veçantë për vendin dhe rajonin. Të dhënat e përfuara nga observatori do të japin kontribut në kërkimet shkencore me vlera teorike e praktike, rreth fenomeneve të fushës magnetike, por gjithashtu për kontribute në monitorimin *meteorologjik hapësinor*, emergjencat e mjedisin. Të dhënat e përfuara do t'u vihen në dispozicion institucioneve qeveritare e atyre shkencore, të cilat merren me observimet e tokës, si Agjencisë së Sigurimit të Informacionit të Gjeoshkencave (ASIGJ) etj.

Observatori do të ndërtohet sipas standardeve ndërkombëtare, pajisjet dhe ndërtimi i të cilit do të dhurohen nga Instituti Kombëtar Gjeofizikës dhe Vullkanologjisë. Bashkia e Tiranës, me mbështetjen e kryebashkiakut Z. Erion Veliaj, po jep një mbështetje për të gjitha procedurat ligjore dhe morale për ngritjen e observatorit të parë magnetik shqiptar, në hapësirat e Parkut të Madh të Tiranës.

## II.Ç. Propozime të reja

1. SSHNT-ja gjatë vitit 2016 ka punuar intensivisht për përgatitjen e propozimit për projektin e ri **ALBNANO (ALBAnianCentre of NANObiotechnology and Biosensors)** në kuadër të programit "Horizon 2020" të Komisionit European. Strategjia Shqiptare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin (2009-2015) dhe draftstrategjia për 2016-2020 theksojnë se ndërkombëtarizimi dhe integrimi në zonën europiane të kërkimit (European Research Area) mund të realizohet vetëm nëpërmjet përmirësimit dhe forcimit të kapaciteteve lokale të kërkimit shkencor. Në këto strategji specifikisht i jepet prioritet ngritjes së 4-5 qendrave të ekselencës për kërkimin shkencor në Shqipëri. Përpjekjet e Qeverisë janë mbështetje për krijimin e qendrave të reja të ekselencës dhe Seksioni synon që **ALBNANO të jetë qendra e parë e këtij lloji**. ALBNANO propozon një ekip nga komuniteti i kërkimit bio- dhe nanoteknologji në Shqipëri në bashkëpunim me Institutin Katalan të Nanoshkencave dhe Nanoteknologjisë ([www.icn2.cat](http://www.icn2.cat)) në Barcelonë për të krijuar Qendrën Shqiptare të Nanobioteknologjisë dhe Biosensorëve – ALBNANO në Shqipëri. Vizioni për ALBNANO-n e bën Qendrën të gjenerojë njohuri në kërkime bazë përmes zhvillimit dhe inovacionit për aplikime reale dhe për shfrytëzimin e njohurive të krijuara përmes arsimimit dhe transferimit të teknologjive dhe veprimtarive të biznesit. Qeveria shqiptare ka vendosur të mbështesë projektin për impaktin social-ekonomik të projektit. Projekti bazohet në krijimin e një sipërmarrjeje të përbashkët afatgjatë midis pjesëmarrësve si ministritë shqiptare (Arsim dhe Sporte/Inovacion), universitetet shqiptare (UBT, UT, UPT, UMT) dhe ASHSH-së për pjesën shqiptare, dhe nga ana tjetër një partner i ekselencës institucionale, shkencore, teknologjike dhe inovative, Fundació Institut Català de Nanociència I Nanotecnologia (ICN2).

Zgjedhja e fokusit të projektit ALBNANO bazohet në disa faktorë kryesorë: (i) rëndësia e bujqësisë, shëndetit dhe mjedisit në ekonominë shqiptare; (ii) potenciali i nanobioteknologjive dhe biosensorëve për të pasur ndikim në këta sektorë, dhe në një numër sfidash sociale të H2020-s; (iii) gjerësia dhe fushëveprimi i veprimtarive kërkimore ekzistuese dhe të planifikuara, të lidhura me këto fusha; (iv) rëndësia e kërkimit shkencor i nanobioteknologjisë



dhe biosensorëve të ICN2 dhe (v) bashkëpunimi ekzistues shqiptar me ICN2 nëpërmjet akad. prof. dr. Arben Merkoçit, lider grupi për nanobioelektronikën dhe biosensorët. Misioni i ALBNANO-s do të jetë realizimi i aktiviteteve dhe përfitimi i njohurive në një Qendër të Ekselencës në nivel kombëtar, në nivel më të gjerë të Ballkanit dhe në shkallë ndërkombëtare. Në periudhën fillestare 12-mujore do të zhvillohet plani i detajuar i biznesit.

### **Misioni dhe *output*-et konkrete**

ALBNANO ka si qëllim krijimin e Qendrës së re të Ekselencës në kërkimin dhe inovacionin për nanobioteknologjinë dhe biosensorët në Shqipëri. Qendra do të fokusohet në fusha me rëndësi të madhe shkencore, teknologjike dhe ekonomike në 4 platforma, si: (I) nanomaterialet, sinteza dhe vetitë; (II) biofunksioni i nanomaterialeve; (III) teknologjitë nanobiosensore dhe (IV) vlerësimi dhe metrologjia. Duke pasur parasysh rëndësinë e nanoteknologjisë dhe të biosensorëve dhe nevojat e Shqipërisë, fushat e aplikimit të tyre do të fokusohen në fushat prioritare: (1) bujqësia dhe siguria ushqimore e biosiguria, (2) mjedisi, (3) shëndeti dhe teknologjitë e mjekësisë, (4) akuakultura dhe fushat e kulturës detare, (5) fushat e shkencave biologjike dhe të kimisë etj. ALBNANO ka për qëllim të implementojë një strategji të shkencës bazuar në një strukturë bazë, që kombinon kërkimin në 4 platformat e sipërpërmendura, të cilat ndërthuren me zhvillimin dhe inovacionin në 5 fushat aplikative. Fusha e kërkimit do të përfshijë veprimtari për të zhvilluar dhe përmirësuar nanomaterialet (nanogrimca, nanotuba, grafen etj.) për aplikime të nanobioteknologjisë, duke zgjeruar veprimtaritë shqiptare ekzistuese dhe duke e plotësuar me të reja: (1) zhvillimi i nanomaterialeve të reja me kapacitete të larta për materiale aktive (bio)kimike; (2) zhvillimi i nanomaterialeve dhe nanostrukturave për të mbështetur teknologjitë e reja të biosensorëve (nanomateriale aktive elektrike dhe optike); (3) zhvillimi dhe karakterizimi i materialeve të nanostrukturuara (nanogrimca magnetike, nanokompozite (aliazhe të bazuara në Zr), nanoxhelet dhe nanoaliazhe (me alumin ose magnez) me potencial të lartë për aplikime në bioteknologji; (4) studime të aplikimit të sistemeve rreze X për përgatitjen në shkallë të gjerë të nanokompoziteve, nanogrimcave e nanoxheleve nga materiale në masë të madhe; (5) analiza e biokompatibilitetit të materialeve për të përcaktuar përshtatjen për aplikime novel biomjekësore, agroushqimore e bioteknologjike etj.

Shqipëria është një nga vendet më të varfra dhe më pak të zhvilluara në Europë. Si një vend kandidat që po shkon me progres aktiv drejt anëtarësimit në BE, potenciali është tepër i lartë për një aksion të implementuar mirë si ekip për të pasur efekte pozitive të dukshme dhe afatgjata në shkencën dhe sistemin shqiptar të inovacionit. Zgjedhja e nanobioteknologjisë dhe biosensorëve si fusha të rëndësishme, që përfaqësojnë shkenca transversale dhe multidisiplinore me mbështetje të fuqishme në "H2020" dhe me rëndësinë e sektorëve kryesorë të ekonomisë shqiptare (bujqësia, ushqimi, shëndeti, mjedisi) ka potencial të lartë për të bashkuar synimet për pjesëmarrje në "H2020" me impaktin e lartë në inovacionin lokal dhe konkurrencën dhe si pasojë në krijimin e vendeve të reja të punës. Projekti "ALBNANO" ofron mundësinë e lidhjes së ekspertizës më të mirë në Shqipëri në fusha të ndryshme që sigurojnë sukses, si dhe që shërbejnë si model të një qendre të ekselencës për fusha të tjera specifike.

Në terma afatgjatë pas 7 vitesh, misioni i ALBNANO-s do të arrijë ekselencën shkencore dhe teknologjike në nivel ndërkombëtar në nanobioteknologji dhe për biosensorët, për të lehtësuar integrimin dhe inovacionin në këto teknologji nga industria shqiptare që të adresojë sfidat sociale e për të siguruar trajnimin më të lartë e zhvillimin e karrierës për kërkuesit e



rinj, duke krijuar një pol për tërheqjen e mbajtjen e talenteve të reja lokale e ndërkombëtare në Qendrën e Ekselencës. Objektivat për stadin e parë (7 vjet) të projektit janë: të realizojë instalimet fizike të ALBNANO-s dhe të pajisë laboratorët, si dhe lehtësirat e tjera sipas standardeve ndërkombëtare; të tërheqë dhe të mbajë talentet shkencore lokale dhe ndërkombëtare në Qendër duke realizuar veprimtari kërkimore solide në të gjitha linjat e përcaktuara në *Strategjinë e Shkencës dhe Inovacionit*; të implementojë proceset praktike më të mira në trajnimin dhe zhvillimin e karrierës për kërkuesit e rinj, duke përfshirë aftësitë profesionale e sipërmarrëse; të demonstrojë kapacitetin menazherial dhe financiar siguruar nga një portofol i gjerë i projekteve konkurruese dhe industriale të K&Zh; të angazhohen sektorët shqiptarë kyç si agroushqimet, shëndetësia dhe mjedisi, duke përmirësuar kapacitetet e tyre inovative dhe konkurrencën globale përmes projekteve të përbashkëta K&Zh, trajnimit dhe ofrimin e shërbimeve teknike bashkëkohore; të implementojë një proces planifikimi strategjik dhe operacional afatgjatë me kontroll çdo tre vjet lidhur me fuqizimin e angazhimeve dhe të çdo lloj mbështetjeje nga klientët e ALBNANO-s; të stimulojë rolin e grave dhe të grupeve të tjera të papërfaqësuar sa duhet dhe të pafavorizuara në shkencë; mbi të gjitha, të arrijë ekselencën në nivel ndërkombëtar në shkencë, në transferimin e teknologjisë dhe menazhimin; realizimi i një programi inkubator *spin-off*.

**ASHSH me përfaqësues akad. S. Bushati, akad. as. E. Kongjika dhe akad. as. A. Veveçka,** do të përfshihet në strategjinë dhe komunikimin e ALBNANO-s në kontekstin edhe të *Iniciativës së Investimeve të Infrastrukturës të K&Zh* për të cilën vendi ka planifikuar të investojë në një numër fushash kërkimi, duke përfshirë nanoshkencën dhe nanomaterialet e reja, një fushë e interesimit formal të vendit dhe rajonit. Përveç kësaj, ASHSH-ja duke qenë me status ligjor si institucioni më i lartë shkencor, autonom në veprimtaritë e saj dhe e aftë për të krijuar grupe shkencore multidisiplinore bazuar në marrëveshje të ASHSH-së me universitete shqiptare do të kontribuojë në fushat e kërkimit të lidhura me teknologjitë e nanoplatformave/nanobisoensoreve të përdorura në bioteknologji në përgjithësi dhe në veçanti për sigurinë ushqimore dhe biosigurinë. ASHSH ka fituar përvojë në krijimin e një vizioni bashkëkohor për stimulimin e kërkimit shkencor në Shqipëri. Akad. S. Bushati ka marrë pjesë në përpilimin e *Strategjive Shqiptare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin*, ku përfshihet prioriteti për ngritjen e 4-5 qendrave të ekselencës për kërkimin shkencor në Shqipëri, ndërmjet të cilave dhe Qendra e Ekselencës "ALBNANO". Gjithashtu anëtarë të ASHSH-së kanë përvojë dhe kanë bashkëpunim ndërkombëtar në disa projekte si projekti bilateral Shqipëri – Austri "Ti-Nanoalloys for biomedical applications" (2015-2016), dy projekte bilaterale Shqipëri – Itali "Mechanical Behaviour of nanocrystalline grained AA 2000 induced through ECAP" (2008-2011) dhe "Analysis of Enhanced Mechanical Properties of Light Nanoalloys" (2005-2007), dhe një projekt kombëtar në kuadër të *Programit Kombëtar për Zhvillim dhe Kërkim* "Production of Nanomaterials through Severe Plastic Deformation (2007-2010), të drejtuara nga akad. asoc. A. Veveçka, kurse akad. asoc. E. Kongjika si kërkuese shkencore në bioteknologji ka përvojë në shumë projekte shkencore, ku nevojitet përdorimi i nanomaterialeve për efektivitet të lartë të metodave bioteknologjike.

Roli i ASHSH-së në këtë projekt përqendrohet në implementimin e disa paketave të punës si partner në menazhimin e cilësisë dhe të rrezikut, në propagandimin dhe publikimet sensibilizuese rreth projektit. Parashikohet të krijohet një *bazë të dhënash* e përfituesve nga projekti dhe raporti final do të përfshijë përfundimet për veprimtaritë si dhe do të japë rekomandime të vlefshme. I rëndësishëm konsiderohet edhe roli në ndërgjegjësimin e komunitetit industrial, ku vlerësohet organizimi i sesioneve specifike dialoguese me NMV-të, që do të përfshihen në një *bazë të dhënash*. Gjithashtu ASHSH-ja ka detyra për të

përcaktuar agjendën e kërkimit në terma të afateve të gjata për kërkim fundamental dhe të aplikuar për të identifikuar tematikat e reja të kërkimit për të ardhmen e Qendrës së Ekselencës në bazë edhe të përvojës së vlefshme të ICN2-shit.

2. Në kuadër të projektpropozimeve të reja, u përgatit projekti **“Young Researchers Forum is a key factor in sustainable development of Albania and West Balkan Countries”**, nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH), akad. S. Bushati me partnerë Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK), akad. I. Krasniqi, sekretar shkencor; me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (ASHAM), akad. V. Matevski, zëvendëspresident në projektet e InterAcademy Partnership, Itali.

Projekti synon të krijojë Forumin e Kërkuesve të Rinj (FKR). Në kuadër të Strategjisë së IAP-it, shumica e akademive të shkencave e kanë krijuar FKR-në, por jo në Shqipëri. Aktivitetet e shkencëtarëve të rinj shqiptarë në Shqipëri, Kosovë, Republikën e Maqedonisë dhe në diasporë janë të organizuara në Institutin Alb-Shkenca, me të cilin ASHSH-ja ka realizuar një marrëveshje bashkëpunimi me synim kërkuesit e rinj. Hulamtuesit duke nxitur krijimin e FKR-së, mund të marrin pjesë në zhvillimin ndërkombëtar të politikave të shkencës, të koordinojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e tyre me kolegët përtej kufijve; synimet e mëtejshme janë për krijimin e mundësive të përfshirjes së FKR-së me *Rrjetin e Akademive të Kërkuesve të Rinj* duke komunikuar në një rrjet virtual. Synohet që të rinjtë në shkencë të jenë pararojë të lëvizjeve ndërkombëtare të shkencëtarëve të rinj dhe të formojnë një zë të fuqishëm për të ndikuar në zhvillimet globale për një kërkim shkencor më efektiv, nëpërmjet lidhjes më të mirë, masave të përmirësuara të arritjeve dhe cilësisë së lartë të arsimimit shkencor. Aktualisht, ka një mungesë të bashkëpunimit të kërkuesve të rinj, si në vendin tonë ashtu dhe ndërmjet vendeve të rajonit e me studiuesit e diasporës, që është një problem shumë i rëndësishëm dhe që mbetet objektivi i seksionit.

Pak informacion i përditësuar është në dispozicion mbi aktivitetin e shkencëtarëve të rinj, sidomos të atyre që punojnë jashtë vendeve tona si pasojë e dukurisë së largimit të trurit (drain brain) pas viteve '90 në vendin tonë. Ka një mungesë të bashkëpunimit të kërkuesve të rinj, si ndërmjet vendeve, ashtu dhe me studiuesit e diasporës.

Në kuadër të këtij projekti do të vlerësohet informacioni aktual i ASHSH-së për kërkuesit e rinj nëpërmjet organizimit të një seminari, ku do të ftohen të gjithë personat kyç në ministritë, institucionet tona kërkimore (në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni), si dhe projekte të ndryshme që lidhen me këtë temë. Synohet që të identifikohen studiuesit në diasporë duke kontaktuar universitetet, institucionet shkencore në çdo vend, përmes anëtarëve të ASHSH-së, të krijohet një bazë të dhënash në faqen e internetit si një burim të hapur për të pasur informacion në kohë reale. Procesi i udhëheqjes së FKR-së do të jetë në përputhje me standardet dhe rregullat e IAP-it; Projekti është në përputhje me misionin dhe Planin Strategjik të IA Partnership.

Projekti synon të rrisë kapacitetet njerëzore dhe bashkëpunimin e hulamtuesve të rinj, jo vetëm brenda secilit vend, por edhe në rajon si dhe në Zonën Europiane të Kërkimit. Synohet të arrihen disa objektiva kryesorë si: (i) krijimi i FKR-së, një bazë të dhënash në faqen e internetit, i aksesueshëm në kohë reale e i hapur për të gjithë, Kosovën, shqiptarët e Republikës së Maqedonisë dhe të diasporës; (ii) aktivizimi i bashkëpunimit ndërmjet studiuesve në secilin vend të rajonit tonë dhe në diasporë; (iii) integrimi i hulamtuesve nga diaspora në kërkimin shkencor dhe shoqërinë e secilit vend; (iv) rritjen e rolit të FKR-së në zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve tona, dhe (v) rritjen e bashkëpunimit mes kërkuesve të rinj (KR) nga vendet tona kudo që janë aktivë.

Pritshmëritë e projektit do të kenë ndikim në: (i) rritjen e nivelit shkencor të studiuesve duke përdorur transferimin e *know-how* të studiuesve e nga diaspora në Shqipëri e më gjerë

në rajon; (ii) zgjerimin e mundësive të kërkuesve për punë; (iii) kërkuesit e rinj do të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e menazhimit të kapaciteteve shkencore, të vendimmarrjes në Shqipëri e vendet e rajonit tonë, si dhe (iv) bashkëpunimi ndërmjet tyre do të rritet edhe nëpërmjet përdorimit të rrjetit dhe portalit të kërkuesve të rinj.

## **II.D. Pjesëmarrje e anëtarëve të SSHNT-së në projekte**

Gjithashtu, akademikët e SSHNT-së kanë drejtuar dhe kanë marrë pjesë në realizimin e disa projekteve ndërkombëtare në fusha të ndryshme të teknologjisë së informacionit, energjisë në përgjithësi e asaj të rinovueshme në veçanti, transportit, edukimit, rasteve emergjente dhe problematikave që lidhen me to etj.

### **Akad. as. Afërdita Veveçka**

**1. Nanolidhjet e titanit për aplikime biomjekësore**, Programi i Bashkëpunimit Bilateral Shqipëri-Austri: akad. as. A. Veveçka, prof. Erhard Schafner (Universiteti i Vjenës), 2014-2016. Njohja me metodat e deformimit të fortë plastik (metoda e presionit të lartë në përdredhje), bazuar në lidhjet e titanit. Fondi nga AKTI, financimi për UPT, FIMIF. Në kuadër të projektit të mësipërm bilateral është realizuar një vizitë 10-ditore në Universitetin e Vjenës (18.05.2016 – 27.05.2016) ku u kryen eksperimente mbi lidhjen Ti-36% Nb e paracaktuar për përdorime biomjekësore.

### **Akad. Arben Merkoçi**

**1. Development of a novel highly sensitive and interference-free endotoxin detection system using new nanobiomaterials and phenomena**, reference: BIO2013-49464-EXP; Funded by: Ministerio de Economía y Competitividad Period: 01/09/2014 – 31/08/2016 Partners: Fundació Institut Català de Nanociència i Nanotecnologia (ICN2); Universitat Autònoma de Barcelona (UAB). Krijimi i sistemit nanomaterial me biosensorë për detektimin e endotoksinave për testimin e mostrave konvencionale dhe me interferencë të ulët të nanomaterialeve.

**2. Smart printed paper: Printed Electronics for new paper functionalities**, reference: RTC-2014-2619-7, Funded by: Ministerio de Economía y Competitividad Period: 01/02/2014-31/12/2016 Partners: Fundació Institut Català de Nanociència i Nanotecnologia (ICN2); Centre Nacional de Microelectrònica (CNM); JUSMER, S.L.

**3. Suport a Grups de Recerca (SGR) reconeguts per la Generalitat de Catalunya (grup consolidat)**, reference: 2014 SGR 260; Funded by: AGAUR (Generalitat de Catalunya) Period: 01/01/2014-31/12/2016 Partners: Fundació Institut Català de Nanociència i Nanotecnologia (ICN2); Universitat Autònoma de Barcelona (UAB).

**4. Nuevas Soluciones basadas en PRINTED ELECTRONICS para la detección de variables físicas y la liberación de compuestos orgánicos**, reference: TSI-100101-2013-94 Funded by: Ministerio de Industria, Energía y Turismo Period: 2014-2016 Partners: CREACIONES AROMATICAS INDUSTRIALES, S.A.; Fundació Institut Català de Nanociència i Nanotecnologia (ICN2) and D+T Microelectrònica / IMB-CNM (CSIC) as subcontracted. Zhvillim i sensorëve dhe aktivizuesve duke përdorur teknologjinë e printimit për ambalazhimin e produkteve.

**5. Sensing toxicants in Marine waters makes Sense using biosensors (SMS)**, reference: 613844 Funded by: European Commission Program: FP7-OCEAN 2013.1 Official web site of the project: <http://www.project-sms.eu/> Period: 01/12/2013 – 31/08/2017 Partners:

Fundación Privada Institut Català de Nanotecnologia (ICN); Università degli Studi di Roma Tor Vergata (U2), Agenzia Nazionale Agenzia Nazionale Per Le Nuove Tecnologie, L'energia E Lo Sviluppo Economico Sostenibile, Acromed Invest Nacionalni Institut Za Biologijo (University Of Thessaly), Systems Technology Advance, Université Hassan II Mohammadia Casablanca, Microbia Environnement SAS, Alienoreu SPRL; Krijimi i një sistemi të ri në rrjet të automatizuar, i aftë që në kohë reale të monitorojë *in situ* gjendjen ekologjike dhe kimike të ujërave detare në zona bregdetare nga detektimi i një serie ndotësish, duke demonstruar se ICT-ja, bioteknologjia dhe nanoteknologjia mund të rritin potencialin e biosensorëve për aplikimet detare.

**6. Nanobioconjugated paper/plastic platforms for improved diagnostics applications (NAP2DIAGNOSTICS)**, (Period: 2015-2017) project funded by MINECO (Spanish Government).

**7. Development of a Nanodiagnostic platform for monitoring of Cancer cell secreted proteins (NACANCELL)** Period: 1 Nov, 2016 to 31 Oct, 2019, project funded by MINECO (Spanish Government).

**8. Development and application of Novel, Integrated Tools for monitoring and managing Catchments (INTCATCH <http://intcatch.eu/> )**, Period: 1 Jun, 2016 to 31 Jan, 2020 (Funded by: European Commission Program: H2020).

#### **Akad. as. Arjan Durrësi**

**1. INFEWS/T2: iFEWCoordNet - a secure decision support system for coordination of adaptation planning among FEW actors in the Pacific Northwest**, funded by NSF-USDA

**2. Large-Scale Distributed Scientific Experiments on Shared Substrate**, funded by National Science Foundation (NSF), Computer and Network Systems.

**3. An Application Delivery Platform for Mobile Apps on Global Clouds**, funded by National Science Foundation (NSF), Computer and Network Systems.

**4. Secure Data Architecture: Collaborative Research: Assured Mission Delivery Network Framework for Secure Scientific Collaboration**, funded by National Science Foundation (NSF), Computer and Network Systems.

#### **Akad. as. Ilirjan Malollari**

Projekte të mbështetura nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZH–AKTI),

**1. Transnational Cooperation Programme Interreg, Balkan Mediterranean 2014 2020, CCI 2014TC16M4TN003**, Applied January 2016, Project Partner.

**2. Assessing the state of conservation in places of worship of different Religions and promoting a Common Strategy of tourist development. Promote the sustainable valorisation and preservation of natural and cultural heritage as growth assets in the ADRION area**, Project Partner March 2016.

#### **Akad. Jorgaq Kaçani**

1) Projekti “**Normak Sustainable Energy**” ku janë realizuar:

a) Forcimi i bashkëpunimit midis universiteteve të Ballkanit Perëndimor dhe sidomos atyre shqipfolës (Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Europës Juglindore, Tetovë;

b) Ngritja e kapaciteteve intelektuale që operojnë në fushën e energjisë;

c) Hapja e programit *Master Shkencor në Menazhimin e Energjisë* përmes asistencës së partnerit norvegjez dhe bashkëpunimit me partneret lokalë;



d) Zhvillimi i aktiviteteve kërkimore-shkencore në fushat e energjetikës dhe me fokus kryesor përmirësimin e eficiencës së energjisë të hidrocentraleve të vogla.

2) Projekti **“RES”** është financuar nga Komisioni European në kuadër të programit “Tempus”. Partner nga vendet e BE-së kanë qenë: Universiteti i Hoheimhemit, Gjermani, si koordinator, si dhe universitete partnere nga Austria, Sllovakia dhe Bullgaria.

Objektivat e Projektit:

a) Ngritja e programeve të studimit *Master* në fushën e energjisë së rinovueshme në vendet e Ballkanit Perëndimor (W.B.C);

b) Ngritja e programeve të doktoraturës në fushën e energjive të rinovueshme në WBC;

c) Krijimi i mjeteve të bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe industrisë në fushat e energjive të rinovueshme;

d) Mbështetja e stafit akademik në publikimin e punimeve shkencore dhe konferenca;

e) Përhapjen dhe stimulimin e metodave inovative në praktika të grupeve të interesit në fushat e energjive të rinovueshme;

f) Në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor u hartua dhe funksionon një master i ri shkencor në energjitë e rinovueshme.

### **Akad. Nazim Gruda**

1. **Renewable energy studies in Western Balkan Countries (2013-2016)** – Një projekt i *Tempus*-it me pjesëmarrjen e disa institucioneve shkencore të Gjermanisë (Universitët Hohenheim, Universitët Stuttgart, Zyra Federale e Ushqimit dhe Bujqësisë), Austrisë (University of Natural Resources and Life Sciences, Vienna), Bullgarisë (Technical University of Sofia), Sllovakisë (University of Technology in Bratislava), Shqipërisë (Agriculture University of Tirana dhe Polytechnic University of Tirana), Malit të Zi (University of Montenegro) e Bosnje Hercegovinës (University of Zenica dhe University of Mostar), si edhe disa ndërmarrjeve të prodhimit në sektorin e bujqësisë e industrisë energjetike e fushave simotra nga Shqipëria e Bosnje Hercegovina. Koordinues: Universiteti i Hohenheimit, Gjermani.

### **Akad. Neki Frashëri**

1. Projekti **FETCH** i Programit European ERASMUS për mbështetjen e edukimit dhe trajnimit informatik në të ardhmen, me koordinator Universitetin e Ruses në Bullgari. Akad. Prof. Dr. N. Frashëri është anëtar i grupit të punës të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe bashkautor në dy botime të projektit:

**a. Report on Work Package 4, Deliverable 4.4 (version 1.3)** European Evaluation Framework for Computing Education and Training 2020 (EEFCET 2020). ERASMUS Thematic network – Future Education and Training in Computing: How to Support Learning at Anytime Anywhere. Grant Agreement number: 2013 – 3862 / 001 – 001. FETCH 2016 [contributor];

**b. Report on Work Package 3, Deliverable 3.3 (version 1.3)** European Strategic Framework for Computing Education and Training 2020 (ESFCET 2020). ERASMUS Thematic network – Future Education and Training in Computing: How to Support Learning at Anytime Anywhere. Grant Agreement number: 2013 – 3862 / 001 – 001. FETCH 2016 [contributor];

2. Projekti **VI-SEEM i “Horizon2020”** për krijimin e platformës virtuale rajonale për përpunimin paralel të të dhënave me aplikime nga meteorologjia biologjia dhe trashëgimia kulturore. Akad. prof. dr. N. Frashëri është drejtues i grupit të punës të Universitetit Politeknik të Tiranës. Është studiuar skalabiliteti i softuerit *OpenFOAM* për simulimin e erës mbi terrenin malor të vendit.

3. Është marrë pjesë në veprimtaritë e projektit european **COST IC1305 NESUS** për



zhvillimin e sistemeve kompjuterike paralele, me pjesëmarrje në përgatitjen e një artikulli dhe prezantime të punimit mbi inversionin e anomalive të gravitetit në sistemet paralele.

4. Përfundoi projekti 30467 "Environmental Changes 2010-2015 in Albania" i Agjencisë Hapësinore Europiane, ESA.

## **II.Dh. Edukimi në shkencë**

Në kuadër të programit "Edukimi në shkencë" për masivizimin e shkencës janë realizuar veprimtari të rëndësishme dhe interesante: përrurime të veprave shkencore (kombëtare e ndërkombëtare); nderim për figura të shquara të shkencës shqiptare; "Ditë informimi" dhe "Ditë të hapura" të institucioneve shkencore, mbështetje e shkencëtarëve të rinj në institucione shkencore elitare ndërkombëtare etj. Nxitja e të rinjve në shkencë ka qenë në fokusin e përparësive të Seksionit dhe në kuadër të programit "Edukimi në shkencë". Tërheqja e brezit të ri për karrierë në shkencë, çka arrihet edhe me paraqitjen e kapaciteteve tona në komunitetin shkencor, ka demonstruar përmirësimin e imazhit të Seksionit në drejtim të efektivitetit të punës së tij. Është koha e përshtatshme për zgjedhjen, mbështetjen dhe vlerësimin e pjesës më të mirë të kërkimit shkencor.

### **Prezantimi i studimit "Bazat e Teorisë së Relativitetit" i autorit prof. dr. H. Sykja**

Më 5 shkurt 2016, në sallën "Aleks Buda" të ASH-së u zhvillua prezantimi i botimit "Bazat e Teorisë së Relativitetit" i autorit prof. dr. Halil Sykja. Veprimtaria është vazhdim i veprimtarive të Akademisë për "Vitin e Ajshtajnit". Në takim morën pjesë akademikë, kërkues shkencorë, kolegë dhe miq të autorit si dhe shumë studentë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Fjalën e hapjes e mbajti akad. S. Bushati, kryetari i SSHNT-së (ASH). Mbi botimin folën prof. dr. M. Hafizi, prof. dr. A. Minga dhe prof. dr. Z. Mulaj. Gjithashtu e mori fjalën dhe akad. A. Uçi duke e trajtuar botimin nga ana filozofike. Të pranishmit i përshëndeti dhe vetë studiuesi me përvojë prof. dr. H. Sykja, si dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral major J. Bazo. Studimi përmbledh edhe zbulime të kohëve të fundit në fushën e kozmologjisë, duke sjellë në duart e studiuesve të rinj e atyre universitarë, një vepër më të plotë e të përditësuar me hulumtimet më të fundit të zbulimeve të Ajshtajnit.

### **Takimi shkencor "Ujërat termominerale dhe minerale të Shqipërisë"**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë në kuadër të programit "Edukimi në shkencë" dhe në bashkëpunim me Shoqatën e Gjeofizikantëve të Shqipërisë organizoi takimin shkencor "Ujërat termominerale dhe minerale të Shqipërisë" për prezantimin e studimit më të fundit në lidhje me këtë problem të prezantuar nga autorë prof. dr. R. Eftimi dhe prof. dr. A. Frashëri që u zhvillua më **8 prill 2016** në sallën "Aleks Buda" të ASH-së. Të ftuar ishin studiues dhe specialistë të gjeoshkencave nga institucionet shkencore të vendit. Referatin mbi librin e mbajti prof. R. Eftimi, i cili theksoi se vepra shkencore me të njëjtin titull konsiderohet si botimi i parë i plotë mbi ujërat minerale të Shqipërisë. Në të përshkruhen të gjitha burimet e njohura natyrore termale dhe minerale, si dhe ato të zbuluara nga shpimet e thella të kërkimit të naftës dhe gazit. Gjithashtu përshkruhen burimet e industrializuara (të pijshëm). Lexuesi mund të gjejë analiza të veçorive sasiore dhe cilësore të grupeve kryesore të ujërave termale dhe minerale, sistemet ujëmbajtëse, që i ushqejnë ato, faktorët që kontrollojnë formimin e cilësive fiziko-kimike, si dhe grumbullimin dhe riprodhimin e rezervave të tyre. Karakterizimi i ligjësive të formimit dhe përhapjes së ujërave termale dhe minerale jepet në lidhje të ngushtë me ndërtimin gjeologjik dhe karakteristikat hidrogjeologjike të përgjithshme të Shqipërisë.

Përshkruhet përdorimi i tyre në fushën e shëndetit, në jetën sociale dhe ekonomike të vendit.

Ndërmjet ujërave termominerale të Shqipërisë, autorët veçojnë përdorimin më të gjerë të burimeve të mirënjohura të Llixhave të Peshkopisë dhe Elbasanit, si dhe uji i shpimit të thellë Ishmi-2, në Bilaj të Fushë-Krujës. Përvoja e vendit tonë dhe e shumë vendeve ka treguar se përdorimi i këtyre ujërave është i shumëfishtë, për kurimin e mjaft sëmundjeve nëpërmjet banjave, inhalacionit dhe pirjes, për zhvillimin e turizmit gjithë sezonal dhe të shumanshëm (kurues, rekreativ, ekologjik, njohës etj.), për shfrytëzimin e energjisë termike për ngrohje (mjedisesh publike, serash, pellgësh për rritje industriale të peshkut) dhe për prodhimin industrial të kripës, sqfurit, bromit, jodit dhe elementeve të tjera të vyera.

Vepra është mbështetur dhe në botimin shkencor “Atlasi gjeotermal i Shqipërisë dhe platforma e shfrytëzimit të nxehtësisë së Tokës” (ASHSH dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, 2016), si dhe në projektin e përbashkët të Fakultetit Gjeologji-Miniera (UPT), dhe Instituti i Gjeofizikës së Akademisë së Shkencave të Republikës Çeke, 1995.

### **Simpozium shkencor me rastin e 90-vjetorit të lindjes së akademik Teki Biçoku.**

Në kuadër të veprimtarive të promovimit të trashëgimisë shkencore shqiptare, në sallën “Aleks Buda” të ASH-së, më datë **17 maj 2016** u mbajt simpoziumi shkencor “Akademik Prof. Teki Biçoku - Një jetë e kushtuar shkencave të tokës”. Ky simpozium u organizua nga ASH-ja dhe nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në kuadër të programit “Edukimi në shkencë”, që përkon me rastin e 90-vjetorit të lindjes të akad. Teki Biçokut. Të ftuar ishin akademikë, drejtues të institucioneve universitare, profesorë, kërkues shkencorë, kolegë, studentë dhe të afërm të akad. Teki Biçokut. Fjalën e hapjes e mbajti kryetari i ASHSH-së, akad. M. Korkuti dhe u mbajtën disa referate mbi veprimtarinë shkencore dhe drejtuese të akad. Teki Biçokut: “Aspekte nga jeta dhe puna e akad. prof. dr. Teki Biçoku” nga dr. V. Doda, drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar; “Trashëgimia shkencore botuese në vite e akad. Teki Biçokut në fushën e Gjeoshkencave” nga akad. S. Bushati, kryetar i SSHNT-së dhe “Profesor Teki Biçoku në memorien e kolegëve, bashkëpunëtorëve e miqve të tij” nga prof. A. Serjani e prof. F. Arkaxhiu. Gjithashtu fjalën e morën dhe prof. M. Koçi dhe ing. S. Bonjako, të cilët si kolegë dhe bashkëpunëtorë të akad. Teki Biçoku sollën momente nga puna dhe veprimtaria e tij.

Akad. prof. dr. ing. Teki Biçoku është figurë e spikatur në shkencën shqiptare me një trashëgimi të vyer në fushën e shkencave të tokës, me kontribut të çmuar në drejtim të ngritjes së institucioneve dhe strukturave të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, me ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit, në studimet, kërkime-zbulimet e naftës, gazit, mineraleve të ngurta (kromit, bakrit etj.). Ai ka qenë studiues dhe botues i veprave madhore në fushën e gjeoshkencave dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që nga formimi i saj. Në përfundim të simpoziumit, akademikut Teki Biçoku iu akordua nga ministri i Energjisë dhe Industrisë, z. Damian Gjijnuri, medalja “Mirënjohje publike” – pas vdekjes, me rastin e 90-vjetorit të lindjes me motivacionin “Për kontribut të shquar në fushën e gjeologjisë së Shqipërisë”. Medalja në emër të ministrit të Energjisë dhe Industrisë iu dorëzua bashkëshortes së akad. Teki Biçoku, znj. Tefta Mosko, nga kryetari i ASHSH-së, akad. M. Korkuti dhe drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, dr. V. Doda.

### **Seminari shkencor ndërkombëtar “New wine in old wine flasks? Of the importance of documenting traditional plant uses in Albania”**

Gjatë ditëve të zhvillimit të veprimtarive të “Terra Madre Balkans” dhe në kuadër të programit “Edukimi në shkencë”, akad. prof. dr. Andrea Pieroni, anëtar nderi i Akademisë

së Shkencave të Shqipërisë, zëvendësrektor i Universitetit të Gastronomisë së Torinos mbajti seminarin *“New wine in old wine flasks? Of the importance of documenting traditional plant uses in Albania”*, me ekspertë dhe pasuniversitarë të përzgjedhur nga universitetet, institucionet dhe qendrat shkencore në Shqipëri, që janë të interesuar për studime të këtij lloji. Seminari u zhvillua në mjediset e ASH-së më **2 qershor 2016**. Aktiviteti u organizua nga akad. S. Bushati dhe akad. as. E. Kongjika. Kërkimet e akad. Pieronit fokusohen në etnobotanikën gastronomike dhe mjekësore në hapësirën mesdhetare, në Ballkan dhe midis komuniteteve të emigrantëve në Europën Perëndimore. Etnobiologjia është një fushë ndërdisiplinore dhe ndërkulturore, që kombinon shkencën të ndryshme, të tilla si bujqësia tradicionale dhe ekologjike, antropologjia, arkeologjia, botanika, ekologjia, gjeografia, gjuhësia, mjekësia dhe veterinaria, farmakologjia, sociologjia, zoologjia dhe fushat e lidhura me të. Pasi shpjegoi konceptet kryesore të etnobiologjisë, prof. Pieroni theksoi qëllimin e etnobotanikës në veçanti, për studimin se si dhe pse njerëzit përdorin dhe konceptojnë bimët në mjediset e tyre lokale. Nëpërmjet rasteve studimore nga zonat e Kelmendit, Shalës, nga Gora si dhe Peshteku (fshat në Serbinë Juglindore, në zonën e Sanxhakut) vuri theksin mbi veçoritë e krijimit të identitetit dhe komunikimit me fqinjët. Lektori u përqendrua dhe në rëndësinë e studimeve etnobiologjike mbi strategjitë e bazuara në komunitetin e bioruajtjes, zhvillimin rural lokal (ekoturizmi), produktet ushqimore specifike, trashëgiminë biokulturore lokale (ekomuze, kopshte etnobiologjike), sigurinë e ushqimit e politikat e shëndetit publik dhe të ushqyerit, si dhe në drejtimet e tjera të reja për studimet e të ushqyerit.

Në fund të seminarit, akademiku i nderit A. Pieroni dhe akad. asoc. E. Kongjika shpërndanë certifikata për pjesëmarrësit, në më të shumtën studentë të Universitetit të Tiranës dhe atij Bujqësor të Tiranës, të cilët shprehën entuziazmin dhe interesimin e tyre për këtë degë të shkencës dhe shprehën kërkesën për më tepër organizime të kësaj natyre.

### **Takim shkencor mbi arritjet në fushën e teknologjive të informacionit e komunikimit të prof. dr. Mira Mezinis dhe vlerësimi i saj me dhënien e medaljes “Nderi i Akademisë”**

Më datë **21 tetor 2016**, në sallën “Aleks Buda” të ASHSH-së u zhvillua ceremonia e dorëzimit të medaljes “Nderi i Akademisë”, prof. dr. Mira Mezinis me motivacionin: *Shkencëtares shqiptare, vlerësuar botërisht si kërkuese ekselente dhe si lider në trendet bashkëkohore në fushën e programimit dhe softuerit të shpërndarë në “cloud”*. Prof. dr. Mira Mezinis aktualisht konsiderohet si një nga ekspertet më të mira në lëmin e shkencave kompjuterike në Gjermani. Puna e saj kërkimore është e fokusuar në fushën e inxhinierisë së softuerit dhe përqendrohet rreth gjuhëve dhe mjeteve të programimit. Është autore dhe bashkautore e mbi 150 publikimeve shkencore të botuara në revista dhe site prestigjioze për inxhinierinë kompjuterike dhe gjuhët e programimit. Ka shërbyer rregullisht në komitetet drejtuese, komitetet organizative dhe bordet editoriale të konferencave dhe revistave të nivelit të lartë në fushën e informatikës. Informaticienja Mezinis është fituese e *ERC Advanced Grant* për vitin 2012 me shumën prej 2.3 milionë eurosh që shkojnë për hulumtimin e koncepteve të reja të programimit, inxhinierinë kompjuterike dhe gjuhët e programimit në “cloud”. Në vitin 2013 është nderuar me titullin “Doktor Honoris Causa” nga Universiteti i Tiranës.

## II.E. Botimet

### • Botimet periodike

**Journal of Natural and Technical Sciences (JNTS)**, revistë shkencore shumëdisiplinore në gjuhën angleze. Revista ka realizuar botimet e saj vjetore që përfshihen në 2 numra me artikuj shkencorë në disa fusha si në: matematikë, ekonomi-matematikë, fizikë e zbatuar dhe fizikë bërthamore, kimi, kimi ushqimore, ndotje radioaktive e mjedisit të jashtëm (tokë dhe ujë) dhe mjedis i brendshëm, ndotje liqenore nga njeriu, bioteknologji bimore dhe biologji molekulare, biologji, mjekësi, industri e tekstileve, gjeologji, inxhinieri mekanike, inxhinieri ndërtimi; informacione shkencore. Karakteristikë është se një pjesë e artikujve shkencorë janë fryt i studimeve ndërdisiplinore. Gjithashtu në një numër të veçantë të revistës janë paraqitur punimet shkencore të prezantuara në *workshop*-in “ALBNANO 2016”, që mbështetin hartimin e projektit madhor të formimit të Qendrës së Ekselencës “ALBNANO”. Në vitin 2016 u botuan 31 artikuj shkencorë dhe informacione shkencore shkruar nga 69 autorë, prej të cilëve 29 janë femra dhe 40 meshkuj. Prej këtyre artikujve, 19 janë në bashkautorësi edhe me autorë të huaj. Artikulli me numrin më të madh të autorëve (6) është “*Electrochemical Impedance spectroscopy and the sweat/textile electrode interface*”, me autorë **Ilda Kazani, Genti Guxho, Carla Hertleer, Lieva van Langenhove, Benoit Lair** dhe **Gilbert de Mey**, botuar në numrin e parë të revistës. Artikujt me numrin më të madh të autorëve (secili 4) janë “*Micropropagation of some Albanian cultivars of Malus domestica Borkh. throughout direct organogenesis*” me autore **Marinela Grazhdani, Valbona Sota, Brunilda Çuko, Efigjeni Kongjika**, dhe “*Determination of trace elements in moss samples with different multi element analytical techniques, such as ENAA and ICP-AES*” me autorë **Shaniko Allajbeu, Flora Qarri, Sonila Kane** dhe **Pranvera Lazo**, botuar respektivisht në numrin e parë e të dytë të revistës. Për sa u takon autorëve të huaj, pjesa me e madhe e tyre i përket Universitetit të Ghentit, Belgjikë (4). Revista është pajisur me një numër të ri ISSN-je: 2489-0484 dhe me faktor impakti global 0.6.

Artikujt u recensuan nga 42 recensentë gjithsej (2 recensentë për çdo artikull). **Bordi i redaksisë i përbërë nga 27 anëtarë (17 nga vendi dhe 10 nga bota) falënderon për punën e përkushtuar recensentët e përzgjedhur prej tij për kontributin e dhënë në drejtim të vlerësimit e besueshmërisë së punës kërkimore-shkencore të paraqitur në përmjet artikujve më 2016:** Adelaida Andoni, Alfred Frashëri, Angjelin Shtjefni, Arben Merkoçi, Arjan Durrësi, Denis Saatçiu, Dhurata Tarifa, Elda Marku, Eralda Xhafka, Ermira Shehi, Flora Qarri, Gjergji Foto, Halil Sykja, Ilia Mikerezi, Ilir Shinko, Irakli Prifti, Jul Bushati, Majlinda Ikononi, Markela Muça, Mensi Prela, Miriam Ndini, Nefton Kodheli, Neki Frashëri, Nevila Xoxa, Niko Pano, Pranvera Lazo, Rrapo Ormeni, Salvatore Bushati, Selami Meçe, Spiro Thodhorjani, Steljan Buzo, Tonin Kola, Vilson Silo dhe Ylber Muceku.

Numri special i revistës, i cili përkon me 20-vjetorin e themelimit të saj, pasqyron historikun e saj që prej botimit të parë, më 1996, kur një grup kërkuesish të instituteve dhe qendrave kërkimore-shkencore (deri më 2008, pjesë e strukturës së Akademisë), vendosën të publikonin arritjet e tyre shkencore përmes një reviste multidisiplinore periodike *Journal of Natural and Technical Sciences (JNTS)*, organ i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në këtë revistë publikohen artikuj që kanë të bëjnë me çdo aspekt të shkencave të natyrës, teknike dhe atyre mjekësore dhe bujqësore. Një vëmendje e veçantë i kushtohet atyre artikujve, që me përmbajtjen e tyre unifikojnë konceptet



e shkencës me të dhënat, qofshin këto të dhëna vëzhgimore apo thjesht teorike, si për ato të produkteve shkencore bazë dhe të aplikuara. Në revistë botohen artikuj të kërkimit shkencor, komunikime të shkurtra, informacione shkencore, përmbledhje librash, lajmërimet dhe arritjet shkencore. Revista botohet periodikisht dy herë në vit dhe, kur është e nevojshme edhe me botim të numrave specialë shtesë.

Kontribut të veçantë kanë dhënë me publikimet e tyre shumë anëtarë të seksionit duke drejtuar punimet kërkimore-shkencore në fusha të ndryshme: **Salvatore Bushati, Efigjeni Kongjika, Neki Frashëri, Nazim Gruda, Jani Vangjeli, Arjan Durrësi etj.**

Festimi i njëzetvjetorit të revistës përkon me një kohë kur publikimet shkencore përballesh me revolucionin e botimeve elektronike (*online*). Qëllimi ynë është qasja *online* e revistës në çdo cep të vendit dhe nga çdokush, veçanërisht nga ana e kërkuesve të rinj.

Në këtë botim do të citohen të gjithë artikujt që prej fillimit të daljes së revistës, që janë pjesë e arkivit të zyrës së redaksisë në fushat e matematikës, biologjisë, fizikës, kimisë, mjekësisë, informatikës, shkencave të tokës, mekanikës etj., si dhe të nënfushave përkatëse.

Është hasur shumë vështirësi për numrat e parë për të cilët është përdorur makina e shkrimit. Artikulli i parë i publikuar është "*On the cut-off phenomenon in a queue on random environment*", nga prof. Llukan Puka, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, UT.

Që prej vitit 1996, janë shkruar 600 artikuj nga 1330 autorë në këto fusha të shkencës<sup>19,20</sup>: i) shkencat e natyrës 20 %; ii) inxhinieritë dhe teknologjia 35 %; iii) mjekësia dhe shkencat e shëndetësisë 25% dhe iv) shkencat bujqësore 25%<sup>21</sup>. Nga 13330 autorë, 799 (60%) janë meshkuj dhe 531 (40%) janë femra. Duke u bazuar në vendet nga kanë ardhur artikujt, 1160 autorë (87.2%) janë nga Shqipëria dhe 170 autorë (12.8%) janë nga pjesa tjetër e Europës, Amerika e Veriut dhe e Jugut, Lindja e Largët, e Afërt dhe e Mesme etj. Numri mesatar i autorëve për titull është 2.5. Bordi i revistës ka mbështetur gjithmonë fort gruan në shkencë dhe për këtë arsye, rritja e numrit të grave në shkencë është sfidë më vete.

Më 2014, sipas vendimit nga anëtarët e bordit, titulli i revistës u ndryshua nga *Albanian Journal of Natural and Technical Sciences (AJNTS)* në *Journal of Natural and Technical Sciences (JNTS)*, duke synuar një ndërkombëtarizim gradual të revistës, siç u theksua gjatë takimeve me ekspertë të ndryshëm europianë. Një ndryshim tjetër është dhe ndërkombëtarizimi i bordit editorial. Duke qenë se revista mbulon një spektër të gjerë problematikash, artikujt parashtrajnë çështjet e një interesi kombëtar si mjedisi dhe ruajtja e biodiversitetit, cilësia e jetës, ndryshimet klimatike, ndotja, burimet ujore, shëndeti, siguria ushqimore, si dhe në mbështetje të agjendës, që janë përcaktuese për shkencat natyrore dhe teknike duke përfshirë shkencat e tokës, biologjinë, bioteknologjinë, nanoteknologjinë, kiminë, fizikën, mjekësinë etj. Vëmendje i kushtohet ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor, sepse interesi i përbashkët i tejkalon interesat e ngushtë kufitarë me qëllim promovimin e paqes dhe miqësisë. Bashkëpunimi ndërkufitar në fushat e shkencës dhe publikimet e tyre

<sup>19</sup> Klasifikimi i fushave të shkencës u bazua mbi **Field of Science and Technology Classification (FOS 2007)** e Bashkimit Europian.

<sup>20</sup> **Shkencat e natyrës**: matematika, shkencat kompjuterike dhe informacionit, fizika, toka dhe shkencat e mjedisit që lidhen me të, shkencat e tjera të natyrës; **Inxhinieritë dhe teknologjia**: inxhinieria civile, inxhinieria elektronike, inxhinieria e informacionit, inxhinieria e mjedisit, bioteknologjia mjedimore, bioteknologjia industriale, nano-teknologjia, teknologjitë e tjera inxhinierike; **Shkencat mjekësore dhe shëndetësisë**: mjekësia bazë, mjekësia klinike, shkencat e shëndetësisë, bioteknologjia në shëndetësi dhe shkencat e tjera mjekësore; **Shkencat e bujqësisë**: Bujqësia, pyjtaria e peshkataria, Shkencat e biologjisë së kafshëve dhe e produkteve të qumështit, Shkencat veterinarë, bioteknologjia bujqësore, shkencat e tjera të bujqësisë.

<sup>21</sup> Duke qenë se shumica e artikujve janë shumëdisiplinorë, kjo mund të shkaktojë konfuzion të të dhënave.



mbështeten fort nga seksioni e bordi i revistës.

Seksioni i shpreh mirënjohjen të gjithë atyre që kontribuuan në një kërkim shkencor cilësor: autorëve, recensentëve dhe bordeve të redaksisë ndër vite.

SSHNT-ja kryen dhe koordinon veprimtari që lidhen me fushën që seksioni mbulon dhe vëzhgon ecurinë e tyre. Veprimtaritë pasohen nga publikimet përkatëse në botimet speciale. Deri më tani ka pasur katër botime speciale në fushat: sizmikë, bioteknologji, algjebër dhe nanoteknologji. Botimi i parë special daton në vitin 2001 dhe mbulonte fushën e sizmikës. Në këtë numër, redaksia përbëhej nga personalitete të shquara të sizmikës nga vendi dhe bota. Botimi i dytë special daton më 2003 dhe mbulonte punime të referuara në konferencën e organizuar nga akad. asoc. E. Kongjika në fushën e bioteknologjisë bimore. Numri i tretë special daton në vitin 2010 dhe mbulon fushën e algjebërës duke pasuar konferencën mbi algjebërën, mbajtur në Elbasan dhe e organizuar nga akad. P. Petro. Numri i katërt special që mbulon fushën e nanoteknologjisë do të jetë pjesë e botimeve të Akademisë për vitin 2017. Ky botim pason *workshop*-in e organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë; *Catalan Institute of Nanoscience and Nanotechnology (ICN2)*; CSIC, CERCA Institution, Barcelona, Catalonia, Spanjë; Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Universiteti i Tiranës. Në këtë *workshop* rol thelbësor luajtën akad. Salvatore Bushati, akad. asoc. Efigjeni Kongjika dhe akad. Arben Merkoçi, i cili është dhe i ftuari special në këtë publikim bashkë me prof. dr. Majlinda Vasjari, Universiteti i Tiranës.

***Journal of Agriculture of Animal Production Sciences for the Rural Development (JAAPSR)***, botim i përbashkët i SSHNT-së me fondacionin "BLELAL". Në të dy numrat e revistës paraqiten studime mbi probleme aktuale, që shqetësojnë mbarështimin në blegtori dhe kultivimin e bimëve bujqësore me synim dhe rritjen e efektivitetit ekonomik të fermave në Shqipëri. Gjithashtu preken dhe probleme të marketingut si faktor kyç në bizneset e agropërpunimit, si dhe përmirësimin e legjislacionit shqiptar për problemet aktuale në këto fusha të rëndësishme të ekonomisë. Ekoturizmi, si mundësi reale për zhvillimin e qëndrueshëm rural, problemet e sigurisë ushqimore, programet dhe skemat financiare në mbështetje të fermerëve janë në qendër të studimeve të paraqitura në revistën shkencore.

#### • **Libra dhe monografi**

*Atlasi i Florës së Shqipërisë*, vol 1, me autor **akad. Jani Vangjeli**, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 931 f.

Botimi përbën një domosdoshmëri në studimet e thelluara për florën e Shqipërisë dhe do të kontribuojë në studimet e tjera në fushën e pyjeve, kullotave, bimëve aromatike e mjekësore, farmaceutikës, leksikografisë etj.

Në këtë vëllim janë përfshirë rreth 1700 specie bimësh spontane dhe të kultivuara që njihen deri tani në Shqipëri, me emrat shkencorë dhe sinonimet popullore të përdorura në Shqipëri dhe në Kosovë, me shkurtime e formave biologjike, e muajve të lulëzimit, e korologjisë dhe e habitateve ku rriten bimët, me fotot, shkallën e kërcënueshmërisë sipas klasifikimit dhe kriterëve të IUCN-së dhe me hartat e përhapjes të çdo specieje shoqëruar me listën e vendndodhjeve përkatëse.

Libri përbëhet nga rreth 931 faqe, ku pjesën kryesore dhe themelore e përbëjnë hartat e shpërndarjes të çdo specieje, të shoqëruara me listat e vendndodhjeve konkrete, ku janë gjetur bimët që nga viti 1935 dhe deri në ditët e sotme. Të dhënat janë nxjerrë nga ekzemplarët bimorë të Herbarit Kombëtar si edhe nga rreth 120.000 të dhëna në bazën e të dhënave në programin Excel, ku përfshihen gjithashtu të dhëna nga botimet e shumta mbi florën e

Shqipërisë të botanistëve shqiptarë dhe të huaj. Në fund, libri është pajisur dhe me treguesin shqip dhe atë latinisht të specieve dhe familjeve.

*Ndryshimi i klimës në tokë është shkaku i fenomeneve shkatërruese që do të shkaktojnë fatkeqësi të mëdha në jetën e njerëzimit dhe ndikimi i tyre në Shqipëri me autor akad. Edmond Pinguli, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 214 f.*

Botimi është me vlera tekniko-shkencore dhe ekonomiko-shoqërore. Autori pasqyron dhe analizon konkretisht dukurinë e ndryshimit të klimës që nga gjysma e dytë e shekullit XX. Shumë studime dhe monitorime janë kryer nga institucione ndërkombëtare prestigjioze, si edhe nga specialistë të mirëfilltë, të angazhuar seriozisht për këtë problem madhor, që kërcënon Tokën. Ata janë të fushës së: hidrometereologjisë, gjeologjisë, sizmikës, biologjisë, demografisë, bujqësisë, oqeanografisë, kimisë, teknologjisë, fizikës, politikës, ekonomisë etj. Autori është munduar të japë një pasqyrë konkrete të arritjeve dhe mendimeve të shkencëtarëve të fushave të përmendura më sipër duke u përqendruar në fatkeqësitë që i kanosen njerëzimit. Dukuritë si: tërmetet, cunamet, uraganet, tajfunet, tornadot, përmytjet, shkarjet e tokës, thatësira, zjarret etj. janë analizuar për të treguar fatkeqësitë e mëdha që i kanosen dhe që do të vazhdojnë të bëhen më shkatërruese për jetën e njerëzimit në botë dhe në Shqipëri.

Ky është një mesazh për masat që duhen marrë me përgjegjësi të plotë nga shtetet, për të programuar dhe planifikuar, që të ketë sa më pak dëme në jetën e popujve dhe ekonomitë e tyre. Një gjë është e qartë tashmë, që këto dukuri nuk do të ndodhin në mënyrë uniforme në të gjithë planetin. Prandaj është e kuptueshme, si për shembull në vendin tonë, se Shqipëria duhet të përgatitet për dukurinë e tërmeteve, cikloneve, shkarjeve masive të tokës, përmytjeve, cunameve, thatësirave, mungesës së ujit të pijshëm etj. Tronditëse kanë qenë përmytjet në tetor dhe në 10-ditëshin e parë të janarit të vitit 2016. Sirenat e alarmit tani kanë rënë me forcë dhe të gjithë ne duhet të marrim në dorë këtë situatë të tmerrshme, që pritet të vijë.

Ky libër është i ndarë në pesë pjesë:

1. *Politika për ndryshimin e klimës dhe ngrohjen globale në tokë.* Analizohet historikisht dhe politikisht ndryshimi i klimës në Tokë që nga viti 1539. Politika botërore është marrë herë pas here me dukuritë e rrezikshme që nga Samiti i Rios në vitin 1992, e deri në vitin 2015 në Samitin e Parisit. Në këtë të fundit, 197 vendet e botës i morën më me seriozitet angazhimet, duke hartuar një dokument, i cili kishte planifikimin ekonomik e financiar me monitorim, për zbatimin e tij.

2. *Studimet shkencore mbi ndryshimin e temperaturave dhe ngrohjen globale.* Analizohen faktorët, që sjellin ndryshimin e klimës dhe ngrohjen globale në tokë nëpërmjet një materiali shkencor të studiuar prej një periudhe të gjatë kohore, si edhe të ndjekjes vazhdimisht në kohë gjatë një pune sistematike praktike prej disa dhjetëvjeçarëve (1971–2015). Studimet kanë arritur në përfundimin se ndryshimet që po ndodhin në sistemin tonë diellor, janë shkaktuar nga materiali me ngarkesë të lartë, i cili po vërehet në këtë sistem tani, pikërisht në këtë rajon të Galaktikës. Nga analiza del qartë se kjo dukuri e rrezikshme për jetën e njerëzimit në Tokë, nuk vjen nga specia *Njeri*.

3. *Cunami.* Autori analizon një dukuri të rrezikshme për jetën në planet, që ndodh periodikisht në Tokë si në oqeanet Atlantik, Indian dhe Paqësor dhe në Detin Mesdhe. Aty jepen tabelat e cunameve të ndodhura historikisht, si edhe të atyre më të mëdha dhe të rrezikshme. Cunami mund të dëmtojë rëndë Ultësirën Perëndimore dhe Jugun e Shqipërisë.

4. *Epoka e akullit.* Analizohen studimet e organizatave shkencore, që lajmërojnë se mbas vitit 2035 Dielli do të bjerë në gjumë dhe Toka do të përjetojë një "Epokë Akulli". Është

llogaritur nga shkencëtarët se rreth 60% do të bjerë aktiviteti i tij në mesin e viteve 2020-2040. Këto kushte nuk janë përjetuar që nga epoka e fundit e akullit (1645-1715). Kjo epokë do të zgjasë  $60 \pm 80$  vjet.

5. *Situata në botë dhe në Shqipëri, sot dhe në të ardhmen*, ku autori analizon konkretisht, se çfarë dukurish natyrore me përmasa të jashtëzakonshme mund të ndodhin në periudha të ndryshme në planet. Kjo mbi bazën e përfundimeve të arritura, se me një ngritje të temperaturës prej vetëm 2 gradë celsius mbi nivelet paraindustriale, do të jetë një “recetë për shkatërrim”. Parashikimi europian i motit nga institucionet e ndryshme, thotë, se ditë shumë të vështira dhe të këqija do të vijnë në të ardhmen. Pikërisht nga stuhia e Mesdheut në tetor të vitit 2015 ndodhën përmbytje në Europë dhe Shqipëri, të cilat janë pasqyruar me vërtetësi. Gjithashtu janë analizuar temperaturat e larta të pazakonta pikërisht në Shqipëri. Një analizë faktike për dukuritë e ndodhura është bërë për javën e fundit të dhjetorit 2015 në botë. Po ashtu i bëhet një analizë tërmeteve, që mund të rrezikojnë Shqipërinë, por edhe përmbytjeve e shkarjeve të tokës, të cilat do të shkaktonin fatkeqësi të paparashikuara dhe me pasoja të rënda për njerëzit dhe ekonominë.

Si përfundim, botimi është material i parë, që tregon këtë problem sa madhor, po aq edhe të rrezikshëm. Ky material i vjen në ndihmë shtetit shqiptar, për të planifikuar masat, që duhen marrë për të përballuar katastrofat.

*Ndryshimi i klimës në Planet, pasojat në Shqipëri dhe ujësjellësi “Vau Dejës-Brindizi”. Përmirësimi i prodhimit të energjisë elektrike në kaskadën e Drinit Vau Dejës – Koman – Fierzë, me autor akad. Edmond Pinguli, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 177 f.*

Botimi është me vlera sa tekniko-shkencore dhe ekonomiko-sociale. Autori është munduar të pasqyrojë dhe të analizojë dukurinë e ndryshimit të klimës dhe atë të ngrohjes globale, që ndikojnë negativisht në furnizimin me ujë të banorëve të Tokës. Vlera gjithnjë në rritje e ujit për njerëzimin dhe industrinë në përgjithësi, shqetësimet mbi cilësinë e sasisë së tij, vetëdija mbi problematikën e gjerë, të gjeneruar nga mungesa që ai sjell, kanë justifikuar shndërrimin e kësaj çështjeje në një çështje globale, të koordinuar me politika të posaçme. Ai është i paracaktuar të mbajë sot peshën e mjaft konflikteve me karakter politik, ekonomik dhe industrial midis shteteve dhe rajoneve të ndryshme. Si rezultati i kësaj atmosfere të rrezikshme, ekspertët e FAO-s paralajmërojnë një mundësi serioze për konflikt. Sipas tyre, çështja e ujit është detyruar të shpërthejë, pasi procesi demografik i popullatës në botë po bëhet gjithmonë e më i madh.

Që nga viti 1968, Këshilli i Europës në Strasburg miratoi “Kartën Europiane të Ujit”, që e konsideron atë si pasuri të përbashkët të njerëzimit. Që nga Forumi i Parë më 1997, respektivisht janë mbajtur rregullisht konferenca ndërkombëtare deri tani në 2015, për të zgjidhur këtë problem të madh njerëzor. Prandaj edhe UNESCO është angazhuar, që menazhimi i ujit në të gjitha dimensionet, të përfshihet në objektivat për një zhvillim të qëndrueshëm. Ky botim është i ndarë në dy pjesë.

1. Uji, ky mineral i çmuar për jetën në planet dhe Ujësjellësi Shqipëri-Itali Vau Dejës-Brindizi.

2. Përmirësimi i prodhimit të energjisë elektrike në kaskadën e heceve të Drinit Vau Dejës – Koman – Fierzë. Mendime për të mos ndërtohet hidrocentralin e Skavicës.

Në pjesën e parë autori analizon konkretisht dhe ritmiksht në vite, politikën e ujit të paraqitur në forumet e ndryshme ndërkombëtare si dhe masat që janë marrë për përmirësimin edhe menazhimin e këtij minerali të çmuar për ekzistencën e jetës së njerëzimit. Ndërsa në pjesën e dytë ka dhënë mendimin se nuk është e nevojshme të ndërtohet një digë e madhe në Skavicë, pasi shkatërron mjedisin në atë zonë; përmbyt rreth 100 km<sup>2</sup> sipërfaqe toke;

përmbyt të gjithë infrastrukturën rrugore, ura, ujësjellës dhe banesa, të cilat duhet të ndërtohen të reja; lëviz rreth 35 000 banorë. Është fakt se u deshën 10 vjet të lëvizin 8 000 banorë të Kukësit në qytetin e ri të ndërtuar për këtë qëllim, gjatë ndërtimit të HEC-it të Fierzës; shkatërron të gjithë bujqësinë e zonës duke përmbytur Fushë-Alinë, që është një nga tokat më produktive; zhduk historinë e luftërave të Skënderbeut me turqit, që janë zhvilluar aty; zhduk historinë e banimit të hershëm prej mijëra vjetëve të banorëve të zonës (rreth 8 000 vjet); vegjetacioni i përmbytur poshtë liqenit të saj prodhon vazhdimisht gaz metan, i cili është mbi 20 herë më i fuqishëm sesa dyoksidi i karbonit (CO<sub>2</sub>), duke helmuar të gjithë zonën për banorët, që do të jetojnë rreth tij, duke shkaktuar një ndikim negativ të pariparueshëm për mjedisin e Shqipërisë.

Botimi është një material me vlera teknike, shkencore, ekonomike, sociale dhe mjedisore për sot dhe në të ardhmen e zhvillimit të vendit. Kjo do të ndihmojë sadopak, për të mbështetur dhe planifikuar më saktë rrezikun katastrofik të parashikuar tashmë nga organizmat e shumtë shkencorë. Gjithashtu ndihmon në ndërgjegjësimin për përfitimet nga menazhimi dhe shfrytëzimi i resurseve të vendit në dobi të ekonomisë dhe zhvillimit tonë. Rritja ekonomike mbi bazën e studimeve dhe projekteve konkrete është dhe do të mbetet pararoja e zhvillimit të një shteti, i cili duhet të mendojë për të mirën e popullit të tij në çdo moment dhe me përgjegjësi të lartë.

***Vështrim enciklopedik në hortikulturë me autorë akad. Nazim Gruda dhe prof. dr. Andrea Shundi, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 839 f.***

Botimi mbush një boshllëk në një fushë ku bota akademike ka shumë nevojë. Traktati përbëhet nga 850 faqe, 4600 terma me qindra sinonime dhe një fjalorth me rreth 500 fjalë shqipe ose të shqipëruara. Gjithë materiali përshkohet nga një hulumtim i kujdesshëm shkencor me saktësi e thellësi të mendimit, prurje të informacionit, si atij bashkëkohor botëror ashtu edhe atij specifik shqiptar, shumëllojshmëri të përdorimit të gjuhës së saktë shkencore dhe të pastër shqipe. Të gjithë termat dhe fjalët janë të shoqëruara me barasvlerësit e tyre në anglisht dhe në rastin e emrave të bimëve a të sëmundjeve edhe në latinisht. Për çdo lloj bime janë paraqitur vlerat ushqyese dhe zbukuruese, veçoritë biologjike, si dhe të dhënat e ekologjisë dhe agronomisë, por dhe ato historike apo të traditës shqiptare. Për të veçuar janë përshkrimet jo vetëm të bimëve të rëndësishme në Shqipëri, por edhe të bimëve të rralla, që ende nuk e kanë gjetur rrugën e tyre në fushë, serë, kopsht apo ballkon. Zgjedhja e emërimit “hortikultura” dhe jo “kopshtaria” është bërë me vetëdije nga autorët, meqenëse e para është një fushë më e gjerë që e përfshin të dytën; është shumë më e pasur sidomos nga pikëpamja shkencore dhe ajo kulturore, si dhe nga larmia e fushave dhe shkencave të ndërmjetme. Me të drejtë, autorët shkruajnë në hyrjen e botimit që “zhvillimi dhe arritjet e një shoqërie, kultura e jetesës së tyre maten edhe me qëndrimin dhe përkujdesjen e tyre ndaj bimëve dhe mjedisit në tërësi”.

***Prodhimi dhe certifikimi i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve në Shqipëri dhe Kosovë, me autorë akad. as. Efigjeni Kongjika, prof. dr. Agim Zajmi, prof. as. dr. Arben Myrta, akad. Latif Susuri dhe 23 autorë të tjerë nga Shqipëria dhe Kosova, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 350 f.***

Ky botim shkencor është rezultat i përvojës dhe rezultateve të fituara nga projekti “Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri”, i realizuar në kuadër të *Protokollit të Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik* midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së

Shkencave dhe Arteve të Kosovës nga viti 2009 deri më 2013.

Grupi kryesor i autorëve është mbështetur nga puna e një numri të madh autorësh specialistë të njohur në fusha të ndryshme të pemëtarisë, të fitopatologjisë, biologjisë molekulare, bioteknologjisë, njohës të legjislacionit evropian dhe shqiptar për certifikimin e fidanëve të drurëve frutorë (gjithsej 27 autorë). Monografia në 350 faqe paraqitet në 13 kapituj:

1. "Pemëtaria në Shqipëri dhe Kosovë: rëndësia e kultivarëve të vendit" (R. Osmani, A. Zajmi, F. Krasniqi, I. Çiçi, H. Ismaili, K. Lepaja, L. Lepaja);
2. "Vreshtaria dhe verëtaria në Shqipëri dhe Kosovë" (B. Koronica, L. Susaj);
3. "Ulliri dhe agrumet në Shqipëri. Rëndësia e kultivarëve të vendit" (H. Ismaili, V. Anagnosti, Dh. Panajoti);
4. "Tradita, aktualiteti dhe perspektiva e prodhimit të fidanëve të pemëve frutore dhe hardhisë në Shqipëri dhe Kosovë" (R. Osmani, L. Susaj, A. Zajmi, B. Koronica, I. Çiçi, K. Lepaja, L. Lepaja, I. Cikaqi)
5. "Metodat kryesore të prodhimit të fidanëve të pemëve, hardhisë, ullirit dhe agrumeve" (A. Zajmi, I. Çiçi, H. Ismaili, L. Susaj, B. Koronica, K. Lepaja, L. Lepaja);
6. "Patogjenët më të rëndësishëm në prodhimin e fidanëve të pemëve frutorë dhe hardhisë" (A. Myrta, Sh. Çali, L. Susuri);
7. "Patogjenët më të rëndësishëm në prodhimin e fidanëve të ullirit dhe agrumeve" (D. Frashëri, A. Manglli, A. Myrta);
8. "Legjislacioni evropian për prodhimin e fidanëve të drufrutorëve dhe të hardhisë në Bashkimin Evropian" (A. Myrta, L. Susuri);
9. "Legjislacioni vendor për prodhimin e fidanëve. Normativat për drufrutorët, ullirin, hardhinë dhe agrumet në Shqipëri dhe Kosovë dhe nevojat për përmirësimin e tij" (Sh. Çali, A. Myrta, F. Elezi, I. Meta, V. Ibro, I. Cikaqi);
10. "Rëndësia e seleksionimit klonal dhe sanitar për kultivarëve e vendit në drufrutorë" (B. Ferraj, M. Digiaro, A. Myrta);
11. "Metodat diagnostiko të patogjenëve në certifikimin e fidanëve" (A. Bacu, A. Myrta);
12. "Metodat e shëndetësimit: Termoterapia dhe kultura *in vitro* e meristemës" (E. Kongjika, V. Sota, E. Papakosta, B. Ferraj, A. Veizaj);
13. "Ruajtja e materialit të pastër, bankat gjenetike *in vitro*" (E. Kongjika, V. Sota, E. Papakosta, B. Ferraj).

Rëndësia e këtij botimi shkencor paraqitet në disa drejtime:

- Do të ndihmojë autoritetet shkencore dhe zyrtare shqiptare dhe kosovare në vlerësimin e gjendjes shëndetësore të specieve frutore, hardhive, ullirit dhe agrumeve. Shumë nga këto specie përdoren si nënshartesa dhe/ose si mbishartesa, prandaj njohja e gjendjes fitosanitare ka rëndësi të dorës së parë në prodhimin e kultivarëve të rinj të painfektuar. Si në Shqipëri dhe në Kosovë janë identifikuar infeksione në pemëtore dhe fidanishte në masë të konsiderueshme, gjë që duhet të alarmojë institucionet përgjegjëse për fitokontrollin dhe prodhimin e fidanëve të kumbullës.

- Konstatim për herë të parë i pranisë së viruseve të reja, specifike në Shqipëri dhe në 18 lokalitete të Kosovës.

- Botimi në fjalë vjen pas publikimit të botimit shkencor "Sëmundjet e pemëve frutore dhe të hardhisë" me autorë akad. L. Susuri dhe prof. as. dr. A. Myrta (2012) dhe mbush një boshllëk të ndjeshëm në literaturën e fitopatologjisë. Është kjo një tërheqje vëmendjeje për fushën e prodhimit të fidanëve dhe fillimin e praktikimit të prodhimit të fidanëve të shëndetësuar e të certifikuar.



- Në botim paraqiten metodat më bashkëkohore të biologjisë molekulare, të realizuara për herë të parë për detektimin e viruseve dhe viroideve në bimë si metoda ELISA, e amplifikimit të gjeneve Multiplex RT-PCR dhe e hibridizimit molekular.

- Për herë të parë paraqiten të dhëna për shëndetësimin e materialeve mbjellëse të drurëve frutorë me përdorimin e metodave *in vitro* të meristemës për eliminimin e viruseve për speciet me rëndësi të gjinisë *Prunus*, *Malus* dhe *Pyrus* të rritura në Shqipëri dhe Kosovë në Laboratorin e Kulturave Indore dhe Qelizore të Departamentit të Bioteknologjisë të FSHN-së të Universitetit të Tiranës (ish-Instituti i Kërkimeve Biologjike). Gjithashtu paraqiten eksperimentet e realizuara në Laboratorin e mirëpajisur *in vitro* të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë, MBUMK, në kuadër të projektit të Komisionit European INTERREG III Itali-Shqipëri.

- Rëndësi ka paraqitja e një protokollit të plotë për të gjitha fazat e certifikimit dhe seleksionimit sanitar e gjenetik, që duhet të jetë në bazë të prodhimit të materialit mbjellës në fidanishtet mëma të specieve frutore në një pemëtari moderne.

- Kontribut me vlerë janë të dhënat për legjislacionin e prodhimit të fidanëve në dy kapitujt: "Legjislacioni evropian për prodhimin e fidanëve të drufrutorëve dhe të hardhisë në Bashkimin Evropian" dhe "Legjislacioni vendor për prodhimin e fidanëve në Shqipëri dhe Kosovë dhe nevojat për përmirësimin e tij".

Botimi i ri do të ndihmojë në krijimin e bashkëpunimeve midis dy vendeve për sa i përket mbrojtjes së specieve bimore me rëndësi ekonomike nëpërmjet detektimit të hershëm të sëmundjeve virusale; do të përmirësojë ekspertizën e kërkuesve të rinj në përdorimin e metodave serologjike e molekulare të detektimit të fitopatologjive kryesore virusale, në prodhimin e fidanëve të shëndetësuar dhe në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit për certifikimin e materialit bimor fidanor të specieve frutore.

***Matematizimi dhe informatizimi i problemeve të gjeofizikës ndër vite në Shqipëri me autorë akad. Gudar Beqiraj, akad. Neki Frashëri, prof. dr. Alfred Frashëri dhe akad. Salvatore Bushati, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 417 f.***

Toka shqiptare ka në gjirin e saj pasuri të mëdha natyrore, shtratime nafte e gazi, trupa xeherorë kromi, hekur-nikeli etj. Industria minerare, e cila ka qenë në krye të zhvillimit ekonomik të vendit është mbështetur në kërkimet gjeologjike-gjeofizike-gjeokimike komplekse. Këto kërkime janë kryer duke futur përdorimin e metodave dhe teknologjive moderne të kohës, duke pasur parasysh parimin dialektik se prodhimi nxit dhe realizon zhvillimin e shkencës, ndërsa kërkimi shkencor siguron efektivitetin e lartë dhe të qëndrueshëm të këtyre kërkimeve. Rezultatet e matematizimit dhe informatizimit të kërkimeve gjeofizike, që si tregues kryesor kanë pasur kërkimin e vendburimeve të reja të mineraleve të dobishme, nuk kanë mbetur vetëm në raportet tekniko-shkencore. Ato janë referuar në 49 kongrese e konferenca shkencore dhe janë botuar në literaturën shkencore të vendit dhe ndërkombëtare. Të mirëpritura dhe të vlerësuara në 26 kongrese botërore, arritjet e gjeoshkencave në Shqipëri kanë marrë vlerësimet më të larta nga institucionet shkencore prestigjioze botërore, si dhe kanë rritur autoritetin e kërkimeve gjeologjike komplekse dhe të gjeoshkencave në Shqipëri. Nga ana tjetër, në përgjigje të zgjidhjes së problematikave shkencore e aplikative të kohës, kërkohet kryerja e studimeve gjeologjike në shkallë më të gjerë rajonale, të ndërtimit gjeologjik të *Albanideve*, pozicionit e lidhjes me *Dinaridet*, *Helenidet* etj., të cilat kërkoni zgjerimin e përdorimit të gjeofizikës e të disiplinave të reja të aplikimeve të saj; këto zhvillime e bënë të domosdoshme zgjerimin e metodave matematike ekzistuese dhe përdorimin e metodave inovative informatike, të cilat kishin gjetur zhvillime në nivele më të larta, të mbështetura nga arritjet e teknologjive të teknikave llogaritëse

*hardware*. Matematizimi dhe informatizimi i gjeofizikës në Shqipëri ka qenë një veprimtari komplekse dhe ka kaluar në disa faza: kuptimi dhe shtrimi i problemeve, studimi i metodave llogaritëse dhe përzgjedhja e më racionalës, ndërtimi i algoritmeve, hartimi i programeve për kompjuterët, kolaudimi dhe eksperimentimi i tyre, duke i shndërruar përfundimisht në programe standarde. Mjafton të përmendim se vetëm në fillimet e para për kërkimet gravimetrike u hartuan organigrama e programe me vlera studimore dhe aplikative për përpunimin e vrojttimeve fushore, interpretimin gjeologo-gjeofizik duke hedhur bazat e matematikës llogaritëse në studimet gravimetrike në Shqipëri, një punë 15-vjeçare e botuar në 1986; në punimet gjeoelektrike u hartuan 36 programe standarde, paketa e të cilave u botua në vitin 1987. Botimet u realizuan nga Katedra e Gjeofizikës në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave së bashku me Institutin e Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar (INIMA). Kurorëzimi i kësaj pune ka qenë zbatimi i këtyre programeve nga ekspeditat gjeofizike të prodhimit. Zbatimi i metodave matematike dhe përdorimi kompjuterit në shkencat e tokës e veçanërisht në gjeofizikë përfshiu të gjitha fazat e studimeve: projektimet, përpunimin e të dhënave të vrojttimeve fushore, korrigjimet për ndikimin e relievit, filtrimin e vlerave të vrojtuar, ndërtimin e hartave dhe profileve gjeofizike, veçimin e anomalive gjeofizike – analiza e prirjes dhe vlerësimin e besueshmërisë së këtyre anomalive. Krahas, tyre realizohej përpunimi statistikor i madhësive të vetive petrofizike të shkëmbinjve dhe xeherorëve. Modelimi matematikor i objekteve gjeologjike dhe interpretimi i të dhënave të vrojttimeve në terren duke kryer inversionin gjeofizik, rritën cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të vrojttimeve. Këto arritje lejuan të zgjidhen probleme të ndërlikuara të vrojttimeve në terren dhe të interpretimit të rezultateve të tyre. Krahas gjeofizikës në kërkimin e naftës dhe të gazit, si edhe të mineraleve të ngurta, bakrit, kromit hekur-nikelit etj. u krijuan kushtet për zgjerimin e fushave të zbatimit të metodave gjeofizike për zgjidhjen e detyrave inxhinierike dhe mjedisore, që vitet e fundit u shoqëruan edhe me përpunimin e vrojttimeve satelitore.

Përmbledhja e studimeve, që i paraqitet lexuesit, ka për qëllim që rezultatet e studimeve më të arrira dhe problemore të vihen më gjerë edhe në shërbim të specialistëve, sidomos atyre të rinj. Studimet e paraqitura në botim ruajnë origjinalitetin në gjuhën e botimit të tyre, në shqip për studimet e botuara në Tiranë dhe në anglisht për botimet në buletinet shkencore ndërkombëtare.

#### **Botime të tjera të anëtarëve të seksionit**

1. **Malollari I. Xhagolli L., Manaj H., Dhroso A.** *Laboratorë në Inxhinierinë Kimike, (Laboratory in chemical engineering)*, INFBOTUES, Tirana, 2016, 352 f., ISBN: 978-9928-173-40-9;

2. **Xhagolli L., Malollari I.** *Dinamika e Proceseve Kimike (Chemical Process Dynamics)*, Onufri, Tiranë 2016, 401 f., ISBN: 978-9928-226-25-9;

3. **Malollari I., Dhroso A.** *Bazat e Reologjisë së produkteve*, Tiranë, 2016, 235 f.;

4. **Gruda N., G. Gianquinto, Y. Tüzel, D. Savvas** *Soilless Culture*, 533 – 537: In: Lal. R. (Ed.) *Encyclopedia of Soil Sciences*, Third Edition, 2016. CRC Press Taylor & Francis Group, ISBN 9781498738903, pp. 2804.;

5. **Gruda N., J. Caron, M. Prasad, M.J. Maher** *Growing Media*, 1053 – 1058: In: Lal. R. (Ed.) *Encyclopedia of Soil Sciences*, Third Edition, 2016, CRC Press Taylor & Francis Group, ISBN 9781498738903, pp. 2804.

• **Artikuj në revista shkencore**

Anëtarët e Seksionit kanë botuar rezultatet e kërkimeve të tyre në 109 artikuj shkencorë në revista shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare.

1. **Adaris M. López\_Marzo, Merkoçi A.** *Paper-based sensors and assays: a success of the engineering design and the convergence of knowledge areas.* Lab Chip 2016, 16: 3150–3176;

2. **Alfonso F., Cuesta J., Bastante T., Rivero F., Garcia-Guimaraes M., Alvarado T., Benedicto A., Cortese B., Byrne R., Kastrati A.** *Bioresorbable vascular scaffolds in patients with acute myocardial infarction: a new step forward to optimized reperfusion.* J Thorac Dis 2016, 8: E417-23;

3. **Alizoti A., Vila F., Mulaj Z., Dhoqina P.** *Physic Subject matter in Secondary Education.* Journal of Environmental Protection and Ecology 2016, 17(1): 387-393;

4. **Baber U., Dangas G., Cohen DJ., Gibson CM., Mehta SR., Angiolillo DJ., Pocock SJ., Krucoff MW., Kastrati A., Ohman EM., Steg PG., Badimon J., Zafar MU., Chandrasekhar J., Sartori S., Aquino M., Mehran R.** *Ticagrelor with aspirin or alone in high-risk patients after coronary intervention: Rationale and design of the TWILIGHT study.* Am Heart J 2016, 182: 125-134;

5. **Baptista Pires L., Mayorga-Martínez CC., Medina Sanchez M., Monton H., Merkoçi A.** *Water Activated Graphene Oxide Transfer Using Wax Printed Membranes for Fast Patterning of a Touch Sensitive Device.* ACS Nano 2016, 10: 853-860;

6. **Baruti B., Malollari I., Sadiku M., Lajqi N., Dobroshi F., Kelmendi M., Aliu M.** *Treatment possibility to use solar photovoltaic systems in public lighting in the municipality of Mitrovica.* Mechanical Engineering Scientific Journal 2016, 34(1): 161–164;

7. **Begaj B., Resuli B., Marqeshi A., Cuko L., Prifti S., Osmani D.** *Significant reduction in the prevalence of Helicobacter pylori infection in Albanian children.* Advances in Life Science & Technology 2016, 40: 40-45;

8. **Bemlochner I., Jaitner J., Fries V., Dommasch M., Mayer K., Ott I., Langwieser N., Fusaro M., Laugwitz KL., Kastrati A., Ibrahim T.** *High on-treatment platelet reactivity and outcomes after percutaneous endovascular procedures in patients with peripheral artery disease.* Vasa 2016, 45: 155-61;

9. **Bemlochner I., Mayer K., Orban M., Morath T., Jaitner J., Rossner L., Gross L., Laugwitz KL., Kastrati A., Sibbing D.** *Ticagrelor versus prasugrel in patients with high on-clopidogrel treatment platelet reactivity after PCI: The ISAR-ADAPT-PF study.* Platelets 2016, 27: 796-804;

10. **Braun D., Knipper A., Orban M., Sibbing D., Petzold T., Braun S., Schulz S., Hausleiter J., Kastrati A., Mehilli J., Massberg S.** *Platelet function and coagulation in patients with STEMI and peri-interventional clopidogrel plus heparin vs. prasugrel plus bivalirudin therapy (BRAVE 4 substudy).* Thromb Res, 2016, 137: 72-8;

11. **Bushati S., Kongjika E.** *An excellence center of nanotechnology and biosensors – a necessity of scientific development and applications of new technologies in Albania.* JNTS (Journal of Natural and Technical Sciences). Special Edition, No. 43. XXII, 5-11, [http://akad.gov.al/ash/pdf/periodike/07\\_jnts\\_1\\_2017.p](http://akad.gov.al/ash/pdf/periodike/07_jnts_1_2017.p)

12. **Byrne RA., Kastrati A.** *Disappearing scaffolds, dissolving expectations.* Lancet 2016, 388: 2451-2452;

13. **Cadevall M., Ros J., Merkoçi A.** *Bismuth based nanomaterials and platforms for sensing and biosensing applications*, Chapter 8, p. 159-174, at “Functional and Physical Properties of Polymer Nanocomposites”, Edited by Aravind Dasari and James Njuguna, John Wiley &

Sons Ltd, 2016, DOI: 10.1002/9781118542316.ch8;

14. **Canj Xh., Beqiraj I., Liçi L., Malollari I.** *Characterization of crude oil from various natural resources in Albania using instrumental analysis.* Mechanical Engineering Scientific Journal 2016, 34(1): 173–177;

15. **Canj Xh., Beqiraj I., Malollari I.** *Karakterizimi i naftës bruto nga disa burime të vendit për përcaktimin e pseudokomponenteve përbërës të saj.* Buletini i Shkencave të Natyrës 2016, Nr. 21, 164-17

16. **Canj Xh., Malollari I., Beqiraj I., Lici L.** *Process Optimization for Albanian Crude Oil Characterization.* [online]. World Academy of Science, Engineering and Technology. 2016, 39(3): 1 - 5. <http://waset.org/abstracts/50929> .

17. **Cassese S., Byrne RA., Ndrepepa G., Kufner S., Wiebe J., Repp J., Schunkert H., Fusaro M., Kimura T., Kastrati A.** *Everolimus-eluting bioresorbable vascular scaffolds versus everolimus-eluting metallic stents: a meta-analysis of randomised controlled trials.* Lancet 2016, 387:537-44;

18. **Cassese S., Hoppmann P., Kufner S., Byrne RA., Wiebe J., Colleran R., Giacoppo D., Harada Y., Laugwitz KL., Schunkert H., Fusaro M., Kastrati A.** *Intraindividual Comparison of Everolimus-Eluting Bioresorbable Vascular Scaffolds Versus Drug-Eluting Metallic Stents.* Circ Cardiovasc Interv 2016, 9: e003698;

19. **Cassese S., Kastrati A.** *Bioresorbable Vascular Scaffold Technology Benefits From Healthy Skepticism.* J Am Coll Cardiol 2016, 67: 932-5;

20. **Cassese S., Kufner S., Kastrati A.** *Contemporary drug-eluting stents and companion polymers: durable is not synonymous with harm.* J Thorac Dis 2016, 8: E1413-e1415;

21. **Cassese S., Kufner S., Xhepa E., Byrne RA., Kreutzer J., Ibrahim T., Tiroch K., Valgimigli M., Tolg R., Fusaro M., Schunkert H., Laugwitz KL., Mehilli J., Kastrati A.** *Three-year efficacy and safety of new- versus early-generation drug-eluting stents for unprotected left main coronary artery disease insights from the ISAR-LEFT MAIN and ISAR-LEFT MAIN 2 trials.* Clin Res Cardiol 2016, 105: 575-84;

22. **Cassese S., Ndrepepa G., Liistro F., Fanelli F., Kufner S., Ott I., Laugwitz KL., Schunkert H., Kastrati A., Fusaro M.** *Drug-Coated Balloons for Revascularization of Infrapopliteal Arteries: A Meta-Analysis of Randomized Trials.* JACC Cardiovasc Interv 2016, 9: 1072-80;

23. **Cassese S., Xhepa E., Kastrati A.** *Biodegradable-polymer drug-eluting stents: back to the future?.* Heart 2017, 103: 91-92;

24. **Chamorro-Garcia A., de la Escosura-Muñiz A., Espinosa-Castañeda M., Rodriguez-Hernandez CJ., de Torres C., Merkoçi A.** *Detection of Parathyroid Hormonelike Hormone in Cancer Cell Cultures by Gold Nanoparticle-based Lateral Flow Immunoassays.* Nanomedicine: Nanotechnology, Biology and Medicine 2016, 12: 53-61;

25. **Colleran R., Byrne RA., Kastrati A.** *Bifurcation intervention with a two-stent strategy: can one size fit all?.* Eur Heart J 2016, 37: 3406-3408;

26. **de la Escosura-Muñiz A., Baptista-Pires L., Serrano L., Altet L., Francino O., Sánchez A., Merkoçi A.** *Magnetic bead/gold nanoparticle double-labeled primers for electrochemical detection of isothermal amplified Leishmania DNA.* Small 2016, 12(2): 205– 213;

27. **De la Escosura-Muñiz A., Merkoçi A.** *Nanochannels for electrical biosensing.* TrAC Trends in Analytical Chemistry 2016, 79: 134–150;

28. **Dhima P., Vila F.** *The influence of the corona discharge on electrostatic charge of polyethylene.* AIP Conference Proceedings 1722, 290001 (2016); doi: 10.1063/1.4944287

29. **Fiedler KA., Ndrepepa G., Schulz S., Floh S., Hoppmann P., Kufner S., Bemlochner**



**I., Byrne RA., Schunkert H., Laugwitz KL., Kastrati A.** *Impact of bivalirudin on post-procedural epicardial blood flow, risk of stent thrombosis and mortality after percutaneous coronary intervention.* *EuroIntervention* 2016, 11: e1275-82;

30. **Frashëri N., Bushati S., Beqiraj G., Lamaj M.** *Application of differential interferometry for analysis of ground movements in Albania.* *JNTS* 2016;

31. **Giacoppo D., Cassese S., Harada Y., Colleran R., Michel J., Fusaro M., Kastrati A., Byrne RA.** *Drug-Coated Balloon Versus Plain Balloon Angioplasty for the Treatment of Femoropopliteal Artery Disease: An Updated Systematic Review and Meta-Analysis of Randomized Clinical Trials.* *JACC Cardiovasc Interv* 2016, 9: 1731-42;

32. **Giacoppo D., Kastrati A.** *Optimal periprocedural antithrombotic therapy in percutaneous coronary intervention: Between a rock and a hard place?.* *Cardiovasc Revasc Med* 2016, 17: 491-493;

33. **Giustino G., Mastoris I., Baber U., Sartori S., Stone GW., Leon MB., Serruys PW., Kastrati A., Windecker S., Valgimigli M., Dangas GD., Von Birgelen C., Smits PC., Kandzari D., Galatius S., Wijns W., Steg PG., Stefanini GG., Aquino M., Morice MC., Camenzind E., Weisz G., Jeger.** *Correlates and Impact of Coronary Artery Calcifications in Women Undergoing Percutaneous Coronary Intervention with Drug-Eluting Stents: From the Women in Innovation and Drug-Eluting Stents (WIN-DES) Collaboration.* *JACC Cardiovasc Interv* 2016, 9: 1890-901;

34. **Grazhdani M., Sota V., Çuko B., Kongjika E.** *Micropropagation of some Albanian cultivars of *Malus domestica* Borkh. via direct organogenesis.* *JNTS (Journal of Natural and Technical Sciences)*, 2016/v. XXI (1), 77-88.

35. **Gruda N., Popsiminova G.** *Status-quo and perspectives of protected vegetables for a sustainable production in South-East Europe.* *Acta Hort.* 2016, 1142: 429-434. DOI: 10.17660/ActaHortic.2016.1142.65;

36. **Gruda N., Tanny J.** *Protected crops – Recent advances, innovative technologies and future challenges.* *Acta Hort.* 1107: 271-277;

37. **Guha Roy A., Conjeti S., Carlier SG., Dutta PK., Kastrati A., Laine AF., Navab N., Katouzian A., Sheet D.** *Lumen Segmentation in Intravascular Optical Coherence Tomography Using Backscattering Tracked and Initialized Random Walks.* *IEEE J Biomed Health Inform* 2016, 20: 606-14;

38. **Guxho G., Kacani J.** *Textile Department and the Manufacturing Sector in Albania;* 7-th International Textile Conference. 10-11 November, 2016, Tirana, Albania. Book of Proceedings;

39. **Harada Y., Colleran R., Kufner S., Giacoppo D., Rheude T., Michel J., Cassese S., Ibrahim T., Laugwitz KL., Kastrati A., Byrne RA.** *Five-year clinical outcomes in patients with diabetes mellitus treated with polymer-free sirolimus- and probucol-eluting stents versus second-generation zotarolimus-eluting stents: a subgroup analysis of a randomized controlled trial.* *Cardiovasc Diabetol* 2016;

40. **Harada Y., Kastrati A.** *Interventional cardiology: Polymer-free drug-eluting stents - a safe and effective option for ACS.* *Nat Rev Cardiol* 2016, 13: 447-8;

41. **Harada Y., Michel J., Koenig W., Rheude T., Colleran R., Giacoppo D., Kastrati A., Byrne RA.** *Prognostic Value of Cardiac Troponin T and Sex in Patients Undergoing Elective Percutaneous Coronary Intervention.* *J Am Heart Assoc* 2016, 5:00;

42. **Haxhimihali Dh., Proko (Jazexhiu) V.** *Terminologjia e kimisë nga Fjalori terminologjik (1963) deri më sot: arritje dhe probleme,* *Buletini i Shkencave Natyrore (online) Nr. 22,* 2016, 63-75.



43. **Heli B., Morales-Narváez E., Golmohammadi H., Ajji A., Merkoçi A.** Modulation of population density and size of silver nanoparticles embedded in bacterial cellulose via ammonia exposure: visual detection of volatile compounds in a piece of plasmonic nanopaper. *Nanoscale* 2016, 8: 7984–7991;
44. **Hilgers, J., Gruda N., Noga G. Artemia sp.** Cysten als Aufzuchtfutter für *Macrolophus pygmaeus*: eine Evaluation unter Praxisbedingungen. *Gesunde Pflanzen* 2016, 68(3): 135-143. DOI: 10.1007/s10343-016-0372-6;
45. **Hoppmann P., Kufner S., Cassese S., Wiebe J., Schneider S., Piniack S., Scheler L., Bemlochner I., Joner M., Schunkert H., Laugwitz KL., Kastrati A., Byrne RA.** Angiographic and clinical outcomes of patients treated with everolimus-eluting bioresorbable stents in routine clinical practice: Results of the ISAR-ABSORB registry. *Catheter Cardiovasc Interv* 2016, 87: 822-9;
46. **Husser O., Kessler T., Burgdorf C., Templin C., Pellegrini C., Schneider S., Kasel AM., Kastrati A., Schunkert H., Hengstenberg C.** Conduction Abnormalities and Pacemaker Implantations After SAPIEN 3 Vs SAPIEN XT Prosthesis Aortic Valve Implantation. *Rev Esp Cardiol (Engl Ed)* 2016, 69: 141-8;
47. **Husser O., Pellegrini C., Kessler T., Burgdorf C., Thaller H., Mayr NP., Kasel AM., Kastrati A., Schunkert H., Hengstenberg C.** Predictors of Permanent Pacemaker Implantations and New-Onset Conduction Abnormalities with the SAPIEN 3 Balloon-Expandable Transcatheter Heart Valve. *JACC Cardiovasc Interv* 2016, 9: 244-54;
48. **Hyseni K., Frashëri N.** Code and message footprints of generated code for embedded devices as components of SOA. *International Journal of Science, Innovation and New Technology* 2016, Issue June, pX-Y. 8p;
49. **Hyseni K., Frashëri N.** Integrating embedded devies in SOA through optimized re-targetable code generation. *International Journal on Information Technologies & Security* 2016, 8(3): 3-28;
50. **Hyseni K., Frashëri N.** Low cost SOA based platform independent back-end data acquisition system. *International Journal on Information Technologies & Security* 2016, 8(3): 53-64;
51. **Izairi N., Veveçka Priftaj A.** Bulk Nanostructured materials produced by Severe Plastic Deformation Processing (Materialet masivë nanostrukturorë të prodhuar me anë të Deformimit të Fortë Plastik) *JNTS* 2016;
52. **Karakus M., Durrësi A.** A Scalability Metric for Control Planes in Software Defined Networks (SDNs). *Proceedings of 30th IEEE International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA), 2016*, pp. 282-289;
53. **Karakus M., Durrësi A.** A Survey: Control Plane Scalability Issues and Approaches in Software-Defined Networking, (SDN). *Computer Networks*, Accepted for publication, 2016;
54. **Karakus M., Durrësi A.** Economic Viability of QoS in Software Dened Networks (SDNs). *Proceedings of 30th IEEE International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA), 2016*, pp. 140-146;
55. **Karakus M., Durrësi A.** Quality of Service (QoS) in Software Defined Networking (SDN): A Survey. *Journal of Network and Computer Applications*, Accepted for publication December, 6 2016;
56. **Karakus M., Durrësi A.** Service Cost in Software Defined Networking (SDN). Accepted for publication The 31-st IEEE International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA-2017);

57. **Kastrati A., Colleran R., Ndrepepa G.** *Cardiogenic Shock: How Long Does the Storm Last?* J Am Coll Cardiol 2016, 67: 748-50;
58. **Kongjika E., Sota V.** *In vitro conservation of autochthonous fruit trees germplasm, very important as a healthy local traditional food. Review.* Proceedings of the Conference "Putting Farmers First. Slow Food. Terra Madre Balkans 2016" Topic: Food Biodiversity and Conservation of Plant Genetic Resources. Academy of Sciences and Tirana Agricultural University. 4 June 2016, 16 p. (in press);
59. **Kongjika E., Sota V.** *New opportunities of plant biotechnology in Albania using nanomaterials.* JNTS (Journal of Natural and Technical Sciences). Special Edition, No. 43. XXII, 23-37, [http://akad.gov.al/ash/pdf/periodike/07\\_jnts\\_1\\_2017.p](http://akad.gov.al/ash/pdf/periodike/07_jnts_1_2017.p)
60. **Kongjika E., Sota V., Bode D., Damiano C. (2016).** *Koleksionet in vitro të gjermoplazmës së specieve autoktone të gjinisë Prunus. (In vitro collections of autochthonous species of Prunus genus germplasm).* Buletini i Shkencave Bujqësore. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë, Botim periodik, nr. XX, 2016, 82 – 96.
61. **Kufner S., Byrne RA., Valeskini M., Schulz S., Ibrahim T., Hoppmann P., Schneider S., Laugwitz KL., Schunkert H., Kastrati A.** *Five-year outcomes from a trial of three limus-eluting stents with different polymer coatings in patients with coronary artery disease: final results from the ISAR-TEST 4 randomised trial.* EuroIntervention 2016, 11: 1372-9;
62. **Kufner S., Cassese S., Ndrepepa G., Kastrati A., Fusaro M.** *Diagnosis and management of intramyocardial hematoma after coronary artery perforation: case studies of the Deutsches Herzzentrum Munchen.* Coron Artery Dis 2016, 27: 327-30;
63. **Kufner S., Sorges J., Mehilli J., Cassese S., Repp J., Wiebe J., Lohaus R., Lahmann A., Rheude T., Ibrahim T., Massberg S., Laugwitz KL., Kastrati A., Byrne RA.** *Randomized Trial of Polymer-Free Sirolimus- and Probucol-Eluting Stents Versus Durable Polymer Zotarolimus-Eluting Stents: 5-Year Results of the ISAR-TEST-5 Trial.* JACC Cardiovasc Interv 2016, 9: 784-92;
64. **Lansky AJ., Kastrati A., Edelman ER., Parise H., Ng VG., Ormiston J., Wijns W., Byrne RA.** *Comparison of the Absorbable Polymer Sirolimus-Eluting Stent (MiStent) to the Durable Polymer Everolimus-Eluting Stent (Xience) (from the DESSOLVE I/II and ISAR-TEST-4 Studies).* Am J Cardiol 2016, 117: 532-8;
65. **Lukaj E., Vila F., Mandija F.** *Impact of radon gas concentration in the aerosols profile.* AIP Conference Proceedings 1722, 270005 (2016); doi: 10.1063/1.4944277
66. **Malollari I., Kotori P., Hoxha P., Liçi L., Lajqi V., Baruti B., Cani Xh., Buzo R.** *Anaerobic codigestion of organic substrate for energetic biogas obtaining and review.* Journal of Environmental Protection and Ecology 2016, 17(1): 323-330;
67. **Mars A., Parolo C., de la Escosura-Muñiz A., Raouafi N., Merkoçi A.** *Control of Electron-transfer in Immunonanosensors by Using Polyclonal and Monoclonal Antibodies.* Electroanalysis 2016, 28: 1 – 9;
68. **Medina-Sánchez M, Miserere S, Cadevall M., Merkoçi A.** *Enhanced detection of quantum dots labelled protein by simultaneous bismuth electrodeposition into microfluidic channel.* Electrophoresis 2016, 37: 432–437;
69. **Medina-Sánchez M., Mayorga-Martinez CC., Watanabe T., Ivandini TA., Honda Y., Pino F., Nakata K., Fujishima A., Einaga Y., Merkoçi A.** *Microfluidic platform for environmental contaminants sensing and degradation based on boron-doped diamond electrodes.* Biosensors and Bioelectronics 2016, 75: 365–374;
70. **Merkoçi A. and Chamorro-Garcia A.** *Nanobiosensors in diagnostics.* Nanobiomedicine 2016, Special Issue: Meeting the Needs of Health Care across the Globe, 3: 1–26;

71. **Merkoçi A., Alarcon-Angeles G., Álvarez-Romero GA.** *Emerging nanomaterial for analytical detection.* Chapter at *Comprehensive Analytical Chemistry, Vol.74. Biosensors for Sustainable Food - New Opportunities and Technical Challenges*, 1st Edition, 2016, Print ISBN 9780444635792, Electronic ISBN 9780444635808;
72. **Ndrepepa G., Braun S., Cassese S., Fusaro M., Laugwitz KL., Schunkert H., Kastrati A.** *Relation of Gamma-Glutamyl Transferase to Cardiovascular Events in Patients with Acute Coronary Syndromes.* *Am J Cardiol* 2016, 117: 1427-32;
73. **Ndrepepa G., Braun S., Cassese S., Mayer K., Lohaus R., Lahmann AL., Fusaro M., Laugwitz KL., Schunkert H., Kastrati A.** *Prognostic Value of High-sensitivity Troponin T After Percutaneous Coronary Intervention in Patients with Stable Coronary Artery Disease.* *Rev Esp Cardiol (Engl Ed)* 2016, 69: 746-53;
74. **Ndrepepa G., Braun S., Schunkert H., Laugwitz KL., Kastrati A.** *Gamma-glutamyl transferase and prognosis in patients with coronary artery disease.* *Clin Chim Acta*, 2016, 452: 155-60;
75. **Ndrepepa G., Colleran R., Braun S., Cassese S., Hieber J., Fusaro M., Kufner S., Ott I., Byrne RA., Husser O., Hengstenberg C., Laugwitz KL., Schunkert H., Kastrati A.** *High-Sensitivity Troponin T and Mortality After Elective Percutaneous Coronary Intervention.* *J Am Coll Cardiol* 2016, 68: 2259-2268;
76. **Ndrepepa G., Colleran R., Luttert A., Braun S., Cassese S., Kufner S., Hieber J., Fusaro M., Laugwitz KL., Schunkert H., Kastrati A.** *Prognostic value of gamma-glutamyl transferase in patients with diabetes mellitus and coronary artery disease.* *Clin Biochem* 2016, 49: 1127-1132;
77. **Ndrepepa G., Groha P., Lahmann AL., Lohaus R., Cassese S., Schulz-Schupke S., Kufner S., Mayer K., Bemlochner I., Byrne RA., Fusaro M., Laugwitz KL., Schunkert H., Kastrati A.** *Increased bleeding risk during percutaneous coronary interventions by arterial hypertension.* *Catheter Cardiovasc Interv* 2016, 88: 184-90;
78. **Ndrepepa G., Iijima R., Kufner S., Braun S., Cassese S., Byrne RA., Sorges J., Schulz-Schupke S., Hoppmann P., Fussaro M., Laugwitz KL., Schunkert H., Kastrati A.** *Association of progression or regression of coronary artery atherosclerosis with long-term prognosis.* *Am Heart J* 2016, 177: 9-16;
79. **Ndrepepa G., Kastrati A.** *Mechanical strategies to enhance myocardial salvage during primary percutaneous coronary intervention in patients with STEMI.* *EuroIntervention* 2016, 12: 319-28;
80. **Ndrepepa G., Xhepa E., Colleran R., Braun S., Cassese S., Fusaro M., Laugwitz KL., Kastrati A.** *Gamma-glutamyl transferase and atrial fibrillation in patients with coronary artery disease.* *Clin Chim Acta* 2016, 465: 17-21;
81. **Neziri A., Marku E., Malollari I.,** *Organochlorine Pesticides Concentrations In Surface Waters Of Lakes Of Shkodra, Ohrid And Prespa,* *Journal of Environmental Protection and Ecology* 2016, 17(3): 857-863;
82. **Orozco J., Mercante LA., Pol R., Merkoçi A.** *Graphene-based Janus Micromotors for Dynamic Removal of Pollutants.* *J. Mater. Chem. A* 2016, 4: 3371–3378;
83. **Owens H., Durrësi A.** *Multi-Domain Video over Software-Defined Networking (MDVSDN).* Accepted for publication The 31-st IEEE International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA-2017);
84. **Owens H., Durrësi A.** *Video Over Software-Defined Networking.* *Journal of Computer Networks* 2016, 92(2): 341-356;
85. **Petro P., Dine J., Hila K.** *On Relation Q-gamma in le- $\tilde{A}$ -semigroups* *Filomat* 2016,

30(5): 1127-1134;

86. **Pino F., Mayorga-Martinez CC., Merkoçi A.** High-performance sensor based on copper oxide nanoparticles for dual detection of phenolic compounds and a pesticide. *Electrochemistry Communications* 2016, 71: 33–37;

87. **Rabti A., Mayorga-Martinez CC., Baptista-Pires L., Raouafi N., Merkoçi A.** Ferrocene-functionalized graphene electrode for biosensing applications. *Analytica Chimica Acta* 2016, 926: 28–35;

88. **Rabti A., Raouafi N., Merkoçi A.** Bio(Sensing) devices based on ferrocene-functionalized graphene and carbon nanotubes. *Carbon* 2016, 108: 481-514;

89. **Resuli B., Sallaku A.** Hepatocellular carcinoma in Albania: Incidence and risk factors. *International Journal of Science and Research* 2016, 5 (1): 1178-1183;

90. **Rischpler C., Dirschinger RJ., Nekolla SG., Kossmann H., Nicolosi S., Hanus F., van Marwick S., Kunze KP., Meinicke A., Gotze K., Kastrati A., Langwieser N., Ibrahim T., Nahrendorf M., Schwaiger M., Laugwitz KL.** Prospective Evaluation of 18F-Fluorodeoxyglucose Uptake in Postischemic Myocardium by Simultaneous Positron Emission Tomography/Magnetic Resonance Imaging as a Prognostic Marker of Functional Outcome. *Circ Cardiovasc Imaging* 2016, 9: e004316;

91. **Rohla M., Tentzeris I., Freynhofer MK., Farhan S., Jarai R., Egger F., Weiss TW., Wojta J., Geppert A., Kastrati A., Stone GW., Huber K.** Impact of bivalirudin on mortality and bleeding complications in acute coronary syndrome patients undergoing invasive revascularization: A real world experience. *Wien Klin Wochenschr* 2016, 128: 906-915;

92. **Ruan Y., Durrësi A.** A survey of trust management systems for online social communities Trust modeling, trust inference and attacks *Knowledge-Based Systems* 2016, 106: 150-163;

93. **Ruan Y., Durrësi A.** A Trust Management Framework for Cloud Computing Platforms. Accepted for publication The 31-st IEEE International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA-2017);

94. **Ruan Y., Durrësi A.** Measurement Theory Based Trust Management Framework for Online Social Communities. *ACM Transactions on Internet Technology*, Accepted for publication November, 8 2016;

95. **Ruan Y., Durrësi A., Alfantoukh L.** Trust Management Framework for Internet of Things. Proceedings of 30th IEEE International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA), 2016, pp. 1013-1019;

96. **Santos AFM., Macedo LJA., Chaves MH., Espinoza-Castañeda M., Merkoçi A., Lima F CA., Cantanhêde W.** Hybrid Self-Assembled Materials Constituted by Ferromagnetic Nanoparticles and Tannic Acid: A Theoretical and Experimental Investigation. *J. Braz. Chem. Soc.* 2016, 27: 727-734;

97. **Schneider S., Spinner CD., Cassese S., Promny D., Hapfelmeier A., Byrne RA., Baumann M., Jager H., Steinlechner E., Laugwitz KL., Kastrati A.** Association of increased CD8+ and persisting C-reactive protein levels with restenosis in HIV patients after coronary stenting. *Aids* 2016, 30: 1413-21;

98. **Sibbing D., Kastrati A., Berger PB.** Pre-treatment with P2Y12 inhibitors in ACS patients: who, when, why, and which agent?. *Eur Heart J* 2016, 37: 1284-95;

99. **Sinha N., Rai H., Cassese S., Kumar S., Kapoor A., Kastrati A.** Long-term clinical impact of polymer-free sirolimus-eluting stents in unselected patients. *Coron Artery Dis* 2016, 27: 385-90;

100. **Sota V. Kongjika E., Damiano C.** Metoda bioteknologjike për ngritjen e koleksioneve



të disa specieve frutore me përdorim të pakët me rëndësi ekonomike dhe të shëndetshme (Biotechnological methods for raising collections of some under-utilized fruit trees with economic and health importance). Buletini i Shkencave Bujqësore. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë, Botim periodik, nr. XX, 2016, 25 - 39.

101. **Steppich B., Hadamitzky M., Ibrahim T., Groha P., Schunkert H., Laugwitz KL., Kastrati A., Ott I.** Stem cell mobilisation by granulocyte-colony stimulating factor in patients with acute myocardial infarction. Long-term results of the REVIVAL-2 trial. *Thromb Haemost* 2016, 115: 864-8;

102. **Sheme E, Frashëri N.** Using renewable energy to supply datacenters: case study for Albania. *JNTS* 2016(1).

103. **Sheme E, Frashëri N.** Implementing workload postponing in CloudSim to maximize renewable energy utilization. *International Journal of Engineering Research and Applications (IJERA)*

104. **Shivaraju A., Ott I., Cassese S., Bourier F., Kastrati A., Kasel AM., Thilo C., von Scheidt W.** Fluoroscopic calcification-guided optimal deployment projection during transcatheter aortic valve replacement – “The eye of the pigtail.” (Follow the right cusp rule – Part II). *Catheter Cardiovasc Interv* 2016, 87:996-8;

105. **Teta J., Xhafka E., Agastra E., Kacani J., Floqi T.** Monitorimi mjedisor me rrjeta me sensore duke perdorur si vektore mjete te transportit public, Buletini i Shkencave Teknike, UPT, 2016;

106. **Wiebe J., Colleran R., Kastrati A.** Drug-Eluting Balloons or Stents for Bare-Metal Stent Restenosis. *JACC Cardiovasc Interv* 2016, 9: 1256-8;

107. **Wiebe J., Hoppmann P., Kufner S., Harada Y., Colleran R., Michel J., Giacoppo D., Schneider S., Cassese S., Ibrahim T., Schunkert H., Laugwitz KL., Kastrati A., Byrne RA.** Impact of stent size on angiographic and clinical outcomes after implantation of everolimus-eluting bioresorbable scaffolds in daily practice: insights from the ISAR-ABSORB registry. *EuroIntervention* 2016, 12: e137-43;

108. **Xhepa E., Tada T., Kufner S., Ndrepepa G., Byrne RA., Kreutzer J., Ibrahim T., Tiroch K., Valgimigli M., Tolg R., Cassese S., Fusaro M., Schunkert H., Laugwitz KL., Mehilli J., Kastrati A.** Long-term prognostic value of risk scores after drug-eluting stent implantation for unprotected left main coronary artery: A pooled analysis of the ISAR-LEFT-MAIN and ISAR-LEFT-MAIN 2 randomized clinical trials. *Catheter Cardiovasc Interv* 2017, 89: 1-10;

109. **Zamora-Gálvez A., Ait-Lahcen A., Mercante LA., Morales-Narváez E., Amine A., Merkoçi A.** Molecularly Imprinted Polymer-decorated Magnetite Nanoparticles for Selective Sulfonamide Detection. *Analytical Chemistry*, 2016, 88: 3578-3584.

## II.F. Veprimtari të tjera

### • Veprimtari shkencore organizuese

**Merkoçi A.** Koordinator (së bashku me M. Vasjari) i workshop-it “ALBNANO 2016, Nanotechnology And Biosensors - Impact in health, environment, safety and security of Albania”, 29-31 maj, 2016, Tiranë.

**Beqiraj A., Bushati S., Frashëri N.** Members of Scientific Board of 7<sup>th</sup> International Conference “Information Systems and Technology Innovations: the New Paradigm for a Smarter Economy”, June 17-18, 2016, Tirana.

**Durrësi A.** Associate Editor of the *International Journal of Virtual Technology and*



*Multimedia (IJVTM)*, Published by Inderscience Publishers, ISSN (Print): 1741-1874, March 2010 - present.

**Durrësi A.** Editorial Board Member of the *Journal of Wireless Sensor Network*, Published by Scientific Research Publishing, ISSN Print: 1945-3078, ISSN Online: 1945-3086, 2011-Present.

**Durrësi A.** Editorial Board Member of the *Journal of Network and Computer Applications* Published by Elsevier, ISSN: 1084-8045, April 2008 – present.

**Durrësi A.** Area Editor of *ICST Transactions on Networks and Communications*, ISSN: 2032-9423 2009 - Present.

**Durrësi A.** Editorial Board Member of the *Journal of Ubiquitous Computing and Intelligence -JUCI*, Published by American Scientific Publishers, 2005-present.

**Bushati S., Kongjika E. Gruda N.** Anëtarë të komitetit shkencor të aktivitetit shkencor rajonal “*Terra Madre Balkans – Putting Farmers First*”, 2 – 5 qershor 2016, Tiranë.

**Bushati S., Kongjika E.** Organizatorë të seminarit shkencor “*New wine in old wine flasks? Of the importance of documenting traditional plant uses in Albania*”, 2 qershor 2016, Tiranë.

**Bushati S., Kongjika E., Veveçka A.** Anëtarë të komitetit organizativ të workshop-it “*ALBNANO 2016, Nanotechnology And Biosensors - Impact in health, environment, safety and security of Albania*”, 29-31 maj, 2016, Tiranë.

**Bushati S.** Anëtar i komitetit organizativ të simpoziumit ndërkombëtar “*Biodiversity and Economic Development*”, 21 dhjetor, 2016, Tiranë.

**Kaçani J.** Kryetar në gjashtë komisione vlerësimi për doktoraturat në Universita degli Studi di Perugia.

**Kaçani J.** Kryetar në komisionin e vlerësimit për doktoraturë në New Seconda Universita degli Studi di Napoli.

**Kaçani J.** Kryetar në dy juri vlerësimi doktoraturash.

**Kaçani J.** Kryetar në tri komisione vlerësimi për dhënien e titujve “*Profesor*” dhe “*Profesor i asocuar*”.

**Kongjika E.** Mbështetje shkencore për zhvillimin e konferencës “*Frutikultura alternative*”, QTTB, Vlorë, 5 tetor 2016, Vlorë.

**Kongjika E.** Anëtare e komitetit shkencor të simpoziumit ndërkombëtar “*Biodiversity and Economic Development*”, 21 dhjetor 2016, Tiranë.

**Gruda N.** Kryerja e detyrave në emër të Zyrës Federale të Bujqësisë dhe Ushqimit të Gjermanisë. Ato përfshijnë vlerësimin, miratimin dhe shoqërimin e disa projekteve kërkimore shkencore, nga aplikimet e universiteteve dhe shkollave të larta, institucioneve kërkimore shkencore, organizatave shtetërore e NGO-s, e ndërmarrjeve të prodhimit e shërbimit; si edhe raportimin e risive në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit eksperimental në fushën e bujqësisë dhe ushqimit.

**Gruda N.** Bashkëdrejtues i thirrjes për projekte kërkimore të mbrojtjes së qëndrueshme të bimëve ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve, Gjermani.

**Gruda N.** Bashkëdrejtues i thirrjes për projekte kërkimore në fushën e ndikimit të ndryshimit të klimës ndaj rritjes së bimëve, Gjermani.

**Gruda N.** Bashkërendues i projektit të standardeve të cilësisë së frutave dhe perimeve: Ministria e Bujqësisë, Shqipëri dhe Zyra Federale e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Gjermani.

**Gruda N.** Koordinues i grupit rajonor të punës “*Prodhimet e serrave në Evropën Jug-Lindore*”, FAO.

**Gruda N.** Anëtar i komitetit drejtues për takimin e projektit *Tempus* të BE-së “*Renewable Energy Studies in Western Balkan Countries*”, Mostar, Bosnia-Herzegovina, April 6-9, 2016.

**Gruda N.** Pjesëmarrje në takime të projekteve të ndryshme të promovuara nga Zyra Federale e Bujqësisë dhe Ushqimit e Gjermanisë.

**Gruda N.** Pjesëmarrje aktive si i ftuar i komitetit drejtues të projektit “HortInnova”, Bonn, Gjermani.

**Gruda N.** Pjesëmarrje në standin e Ministrisë Federale të Bujqësisë në Panairin Ndërkombëtar të Bimëve në Essen, Gjermani.

**Gruda N.** Veprimtari recensuese për Zyrën Federale të Ushqimit dhe Bujqësisë, Gjermani.

**Gruda N.** Veprimtari recensuese për revistat shkencore: *Acta Horticulturae*, *Journal of the Science of Food and Agriculture*, *Journal of Food Quality*, *Archives of Agronomy and Soil Science*

**Petro P., Sema R.** Organizatorë të seminarit “Relacionet e përgjithësuara të Green-it në gjysmëgrupe dhe unaza”.

**Petro P., Beqiri O.** Organizatorë të seminarit “Ë-gjysmëgrupet , gjysmëgrupet plotësisht të rregullt dhe 0-unazat”.

**Petro P., Cela F.** Organizatorë të seminarit “Ideat e njëanshme kryesore dhe teoremat Goldi”.

## II.G. Bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor

### • Mësimdhënie

#### • Afërdita Veveçka

“Fizika 1, 2” dhe “Shkenca dhe Teknologjia e Materialeve”;

Leksione në Shkollën e Doktoraturës pranë Departamentit të Fizikës Inxhinierike, Universiteti Politeknik i Tiranës për lëndët:

1. Metodatat eksperimentale në Fizikë,
2. Njohuri të thelluara të Shkencës së Materialeve,
3. Nanomaterialet .

#### • Arben Merkoçi

Koordinator i modulit “Nanodiagnostics” në “Master of the Nanotechnology” në UAB dhe leksione mbi nanobiosensorët (6 orë).

*Nanotechnology and nanomaterials-based sensors and applications in diagnostics.* Université Tunis El-Manar, Faculté des Sciences de Tunis, Département de Chimie, Campus Universitaire de Tunis El-Manar, Tunis, Tunisia, May 16-19th, 2016. Dita I (2 orë): Nanotechnology and nanomaterials. General introduction. Research topics in nanotechnology. Nanoparticles, general properties and applications; Dita II (2 orë): Nanomaterials-based electrochemical and optical sensors. Research and applications; Dita III (2 orë): Microfluidics, paper/graphene-based sensors and applications.

#### • Arjan Durrësi

Kursi pasuniversitar *Advanced Mobility and Cloud Computing*, Indiana University Purdue University, USA, pranverë 2016;

Kursi pasuniversitar *Trustworthy Computing*, Indiana University Purdue University, USA, vjeshtë 2016;

Kursi pasuniversitar *Data Communications and Computer Networks*, Indiana University Purdue University, USA, vjeshtë 2016.

#### • Gudar Beqiraj

*Matematikë*, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Mesdhetar

• **Efigjeni Kongjika**

*Kulturat Qelizore & Indore*, cikli i dytë, 120 orë, Master Shkencor në bioteknologji molekulare dhe industriale, Departamenti i Bioteknologjisë, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës.

• **Floran Vila**

Cikli I Universitar, lënda *Fizika Moderne*, Departament i Fizikës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës.

Cikli II Universitar, (Master), lëndët: *Bazat e optikës, Probleme të Fizikës Moderne*. Departament i Fizikës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës.

Cikli III (Shkolla e doktoraturës) lëndët: *Fizika e Atmosferës, Plotësime të Fizikës*. Departament i Fizikës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës.

• **Ilirjan Malollari**

- Semestri i parë (2016-17) gjithsej: 330 Orë

1. Modelimi dhe simulimi i proceseve, MSH. K. Ind;
2. Modelimi dhe simulimi i proceseve, MSH. T. Ush;
3. Modelimi matematik dhe fizik proceseve në inxhinieri kimike, inxh. kimike I;
4. Simulimi i proceseve dhe optimizimi, inxh. kimike II;
5. Projektimi i proceseve dhe impianteve II, inxh. kimike II.

- Përpunim *syllabus*-esh / kurrikulash. Është rishikuar *syllabus*-i i masterit shkencor "Inxhinieria e proceseve kimike"

- Rishikim i leksioneve / seminareve / laboratorëve:

1. Rishikim, riformulim dhe riorganizim i leksioneve të inxhinierisë së reaksioneve kimike;
2. Rishikim dhe riformatim i praktikave laboratorike të inxhinierisë kimike.

• **Nazim Gruda**

Ligjërues i ftuar në kuadrin e ERASMUS+ nga Universiteti i Zagrebit në Kroaci, maj 2016; Bashkëligjërues në modulën "Horticultural Production Systems" (rreth 70 msc.-studentë), Rheinische Friedrich-Wilhelms-Universität Bonn, Germany;

Bashkëligjërues në modulën "Grundnahrungsmittel" (rreth 200 bsc.-studentë), Rheinische Friedrich-Wilhelms-Universität Bonn, Gjermani;

Bashkëligjërues në modulën "Anbau und Physiologie der Sonderkulturen" (rreth 60 bsc.-studentë), Rheinische Friedrich-Wilhelms-Universität Bonn, Gjermani.

Neki Frashëri

*Programimi në mjedise të shpërndara* në degën inxhinieri informatike (bsc.) në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit në Universitetin Politeknik, Tiranë;

*Kriptografia* në degën inxhinieri informatike (msc.) në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit në Universitetin Politeknik, Tiranë;

*Siguria e sistemeve* në degën inxhinieri informatike (MP) në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit në Universitetin Politeknik, Tiranë;

*Sistemet e shfrytëzimit* në degën e informatikës (bsc.) në Fakultetin Ekonomik Universiteti i Tiranës (i jashtëm);

*Sistemet e shfrytëzimit* në degën e informatikës (bsc.) në Universitetin Mesdhetar (i jashtëm);

*Sistemet paralele dhe te shpërndara* me degën e informatikës (msc.) në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës (i jashtëm).

• **Salvatore Bushati**

*Fizika e Globit*, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Universiteti Politeknik i Tiranës

## • Drejtim shkencor në shkallët master e doktoratë

### • Afërdita Veveçka

- Nertila Ogreni, *"Përpunimi me teknikën HPT i lidhjeve të Titanit për aplikime biomjekësore"*, master, Departamenti i Fizikës Inxhinierike, Universiteti Politeknik i Tiranës (mbrojtur në shtator 2016)

### • Arben Merkoçi

- Xavier Llopis, *"Integrated analytical biosystems for industrial and environmental applications"* Autonomous University of Barcelona, Bellaterra (Barcelona), Spain (Co-director: Salvador Alegret, Julian Alonso) (05.02.2016);

- Luis Pires *"From nanoparticles to graphene: architecting novel (bio)sensing platforms and devices"* Autonomous University of Barcelona, Bellaterra (Barcelona), Spain (04.11.2016).

### • Arjan Durrësi

- Pinga Zhang, Yefeng Ruan, Lina Alfantoukh, Harold Owens, Murat Karakus në Indiana University Purdue University USA;

- Shpëtim Latifi, në South East European University, Tetovë, Maqedoni;

- Esmeralda Make, në Universitetin Politeknik të Tiranës;

- Kumud Bhat në Indiana University Purdue University (master).

### • Efigjeni Kongjika

- Matilda Deliaj, *"Klonimi i disa varieteteve elite të arrës (Juglans regia L.) në Shqipëri dhe ruajtja e tyre me disa metoda të kulturës "in vitro" 2012 - 2016*, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë);

- Marinela Grazhdani, *"Shëndetësimi in vitro i fidaneve të disa kultivarëve të mollës (Malus domestica Borkh.) të rrethit të Korçës me anë të kulturës së meristemës dhe kontrolli fitosanitar i tyre"*, 2011 - 2016, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë), dorëzuar për mbrojtje;

- Brunilda Çuko, *"Krahasimi i metodave të ndryshme të kulturës së meristemës të dy kultivarëve të mollës"*. Master 2015 – 2016, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë).

### • Floran Vila

- Pranvera Dhima, *"Studim mbi elektrizimin e polimerëve"* ;

- Edmond Lukaj, *"Studim mbi ngarkimin elektrostatik të aerosoleve atmosferike dhe bashkëveprimin jon aerosol"*;

- Alion Alizoti, *"Studim mbi trajtimin teoriko-eksperimental të fizikës në shkollën e mesme"*;

- Rovena Spahija, *"Rrezatimi X dhe aplikime të tij"* (master).

### • Ilirjan Malollari

- Erinda Piluri, *"Studimi i prodhimit të biogazit nga përzierje të mbetjeve të manureve të kafshëve dhe të aktivitetit agro-bujqësor"*;

- Anisa Rexhepi, *"Trajtimi biologjik i shkarkimeve ujore të industrive ushqimore në vendin tonë dhe projektimi inxhinierik i një impianti pilot"*.

### • Jorgaq Kaçani

- Ilir Dervishi, *"Menaxhimi i avancuar, analiza e cilësisë dhe vlerësimi i riskut të projekteve inxhinierike"* (UPT, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), mbrojtur më 14 janar 2016;

- Indrit Vozga, *"Riciklimi i mbetjeve plastike: inxhinieria e procesit dhe impakti mjedisor"* (UPT, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike) mbrojtur më 3 mars 2016.

- **Nazim Gruda**

- Undergraduate Mentor/Bachelor's Thesis Chairperson. Thesis title: "*Physiologische Reaktion veredelter Tomatenpflanzen (Lycopersicon esculentum L.) auf Salzstress*", 9. February, 2016. Rheinische Friedrich-Wilhelms-Universität Bonn.

- **Neki Frashëri**

- Elma Kolce, "*Metodat informatike në mjekësi*";
- Enida Sheme, "*Aspekte të sistemeve cloud*" (përfundoi në 2016);
- Kujtim Hyseni (nga trojet – Presheva), "*Mbi sistemet e shpërndara te rregullimit*";
- Enkli Ylli, "*Probleme të sigurisë në sistemet informatike*";
- Igli Hakrama, "*Probleme të inteligjencës artificiale në sistemet ekonomike*".

- **Petra Petro**

- Orgest Beqiri, "*A-gjysmëgrupet inversive dhe A-unazat inversive*" (në proces);
- Florion Cela, "*Relacionet e Green-it në unaza dhe lidhja e tyre me relacionet e Green-it në gjysmëgrupet e shumëzimit të unazave përkatëse*", (në proces).

- **Salvator Bushati**

- Keis Kostaqi, "*Studimi i përcaktimit të elementeve të fushës gjeomagnetike në Shqipëri*"

## II.Gj. Detyra të parashikuara për vitin 2017

- **Afërdita Veveçka**

- Vazhdim i punës mbi studimin e strukturës dhe vetive të materialeve nanostrukturorë të përfutur me anë të *deformimit të fortë plastik*;
- Përfundimi i projektit bilateral Shqipëri-Austri "*Nanolidhjet e Titanit për aplikime biomjekësore*";
- Udhëheqje doktoraturash dhe masterash.

- **Arben Merkoçi**

- Vazhdim i i punës në projektet e EU etj.;
- 2 udhëheqje doktoraturash (mbrojtje);
- Kërkim projektesh të tjera (H2020 etj.).

- **Arjan Durrësi**

- Vazhdim i punës në projektet ekzistuese si dhe në projekte të reja;
- Publikimi në konferenca dhe revista shkencore;
- Udhëheqje shkencore të studentëve ekzistues.

- **Edmond Pinguli**

- Botim i monografisë "*Studime tekniko-shkencore mbi mundësinë dhe problemet e shfrytëzimit të lumenjve Drini i Zi dhe Vjosa*". 94 f.

- **Efigjeni Kongjika**

- Zbatimi i detyrave si sekretare shkencore e Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike për realizimin e objektivave shkencorë; informimin shkencor për veprimtari shkencore për krijimin e lehtësive në pjesëmarrje në programe, projekte etj.

- Vazhdim i punës në projektet ekzistuese si dhe për projektpropozimet;
- Publikime në konferenca dhe revista shkencore;
- Botim i monografisë "*Hapësira bregdetare Divjakë-Karavasta në Adriatik*", me bashkautorë;
- Udhëheqje të një doktorature në Departamentin e Bioteknologjisë, Fakulteti i Shkencave Natyrore, UT.



#### • **Floran Vila**

- Elektrizimi i polimerive:

1. Do të bëhen eksperimente shtesë për cilësitë elektrike të polimerëve, si dhe për efektin e shkarkesës kurorë në të;

2. Përpunimi dhe interpretimi i të dhënave eksperimentale;

3. Përpunimi i teorisë së përgjithshme të përcaktimit të përcjellshmërisë elektrike të polimerëve me anën e triodës kurorë;

4. Do të studiohen lidhjet ndërmjet efekteve të temperaturës dhe morfologjisë, në përcjellshmërinë elektrike specifike të polimerëve.

- Fizika e atmosferës:

1. Do të bëhet përpunimi dhe interpretimi i rezultateve eksperimentale;

2. Vlerësimi i ndikimit të parametrave themelorë atmosferikë në proceset e bashkëveprimit elektrostatik të binomit jon-aerosol;

3. Përcaktimi i lidhjeve funksionale të përqendrimeve të aerosoleve dhe grup-joneve atmosferike;

4. Nxjerrja e konkluzioneve teorike bazuar në interpretimet e matjeve eksperimentale, si dhe futja e koncepteve të reja.

- Udhëheqja e doktoratave dhe diplomave të masterit shkencor

- Leksione sipas parashikimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës.

#### • **Ilirjan Malollari**

- Vazhdimi i kërkimit shkencor në drejtimet e mëposhtme:

1. Metodologjia inxhinierike për modelimin, simulimin, optimizimin dhe projektimin inxhinierik të proceseve kimike;

2. Eksperimentim dhe projektim impiantesh për përpunim biomase agro-pyjore dhe veterinarë për kompostim, pirolizë dhe degradim anaerobik të saj, për përfitim biogazi për energji;

3. Studimi i metodave të eliminimit të ndotjeve nga hidrokarburet e derdhura në ujëra (lumenj, liqene e dete). Nxitja e ngritjes së strukturës laboratorike për eksperimentim konkret;

4. Trajtimi i kontaminimit të ujërave sipërfaqësore nga industria ushqimore e vendit, harta e ndotjeve, modelimi i tyre dhe hartimi i strategjive për eliminimin inxhinierik të tyre.

• Vazhdimi i punës kërkimore për 2 doktoratat si më sipër: eksperimente, llogaritje inxhinierike, projektme procesesh e pajisjesh, modelime e simulime kompjuterike në shërbim të doktoratave.

• Vazhdimi i punës kërkimore për masterat shkencorë në "Inxhinierinë e Proceseve Kimike". Ka filluar shpërndarja e tematikave për secilin student (7 studentë Masteri) dhe gjashtëmujorin e parë deri në korrik duhet të përfundojnë përgatitjen.

#### • **Nazim Gruda**

• Vijimi i punës në projektet ekzistuese si dhe hartimi i projektpropozimeve të reja;

• Publikime në konferenca dhe revista shkencore;

• Udhëheqje studentësh në tema të masterit dhe doktoratës.

• Përfundimi i manualit të FAO-se për Praktikat e mira Bujqësore në Evropën Juglindore.

#### • **Neki Frashëri**

• Realizimi i hapave për integrimin e sistemit paralel të UPT-së në platformën virtuale rajonale në kuadrin e projektit VI-SEEM;

• Vazhdimi i simulimit të erës mbi terren të thyer në kuadrin e projektit VI-SEEM;

• Vazhdimi i studimit të mundësive dhe rrugëve për shfrytëzimin e imazheve satelitore dhe radar dhe zbatimin e tyre në problemet mjedisore;

- Ndjekja e veprimtarive në projektet *VI-SEEM, COST IC1305*;
- Mbulimi i procesit mësimor sipas planit;
- Drejtimi i doktoratave dhe i diplomave.
- **Salvator Bushati**
  - Realizimi hap pas hapi i zbatimit të detyrave të Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike për mbështetjen nga ana e Seksionit të anëtarëve në realizimin e objektivave shkencorë; informimin shkencor dhe lidhjet e anëtarëve me komunitetin shkencor nga akademitë e botës (IAPartnership; ICSU, ALLEA etj.; përfaqësimin e Seksionit në strukturën e Akademisë; ideimin e krijimin e lehtësive për pjesëmarrje në programe, projekte etj.
  - Studime të metodologjive gjeofizike për zbatimin e teknologjive të reja në shkencat e tokës;
  - Vazhdimi i studimit i mundësive dhe rrugëve për shfrytëzimin e imazheve satelitore dhe radarit dhe zbatimin e tyre në problemet mjedisore;
  - Vazhdim i studimeve në kuadër të ndërtimit në Shqipëri të Observatorit të parë magnetik në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Gjeofizikës dhe Vullkanologjisë, Rome, Itali;
  - Botim monografik mbi “Bazat e zbatimit të Gjeofizikës: Sizmikës, Gravimetrisë dhe Studimit gjeofizik të puseve” (me bashkautorësi);
  - Mbulimi i procesit mësimor sipas planit (si lektor i jashtëm në UPT, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave);
  - Punë shkencore në zbatimin e projekteve shkencore që zhvillohen në kuadër të programeve të bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës;
  - Përgatitje kurrikule mësimore për një lëndë të re universitare e pasuniversitare;
  - Pjesëmarrje në punë shkencore të tjera që ideohen gjatë vitit 2017 (vetëm apo me bashkautorë).